



LIGJËRIMI POLITIK VERSUS LIGJËRIMI MEDIATIK

Gjatë fushatave zgjedhore të viteve 2009 dhe 2013

Isida Hoxha

Dorëzuar

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të doktoratës në Shkenca Sociale, me profil në Shkencat e komunikimit, për marrjen e gradës shkencore *Doktor*.

Udhëheqës shkencor: PhD/ Henri Çili

Numri i fjalëve: 78523

Tiranë, qershor, 2019

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time, deklaroj se ky punim është shkruar prej meje, nuk është paraqitur asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar asnjëherë, i plotë apo me pjesë. Punimi nuk përmban material të shkruar nga dikush tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara sipas rregullave të shkrimit akademik.

Isida Hoxha

ABSTRAKT

Në një sistem demokratik, roli i medias dhe i politikës, për të promovuar zgjedhje demokratike është i rëndësishëm për mbrojtjen e demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Procesi elektoral është një mundësi vendimtare për të shqyrtuar qëndrimin mediatik dhe politik, si dhe një mundësi për të analizuar një numër të madh institucionesh dhe procesesh të lidhura me të. Qëndrimi i medias kur është i paanshëm dhe profesional, bazuar në parimet e sipërpërmendura është një aspekt kyç i procesit zgjedhor, që kontribuon apo kërcënon natyrën demokratike të zgjedhjeve.

Hulumtimet shkencore në këtë studim janë bërë përmes analizës së ligjëritimit, duke përdorur analizën kritike të ligjëritimit si një qasje ndërdisiplinare, që adapton qasjen funksionaliste dhe më konkretisht studimin e ligjëritimit si gjuhë në përdorim, e lidhur me kontekstin në të cilin përdoret. Hipotezat që ndërtojmë në këtë punim referuar dy akteve kryesore, logjikës politike dhe mediatike janë: Mungesa e dallimeve ideologjive e majtë/e djathtë prodhon kulturë politike konfliktuale e drejtuar nga liderë dominantë. Prania e një kulture politike konfliktuale reflektohet në axhendën e medias dhe në ligjëritimin mediatik. Për të mbërritur në gjetjet e këtij punimi fillimisht është zhvilluar analiza e kontekstit, pasi përmes hulumtimit të kontekstit pas viteve 1990, ndërtohet një tablo e plotë e cila lejon mbledhjen e informacionit të nevojshëm për këtë studim. Analiza e kontekstit bëhet kryesisht përmes qasjes metodologjike përshkruese. Studimi i ligjëritimit nuk zhvillohet pa e lidhur me kontekstin, në funksion të eksplorimit të marrëdhënieve të pushtetit të përfshira në diskurs dhe lidhjes së tyre me kontekstin. Burimet në lidhje me pushtetin, dominimin, paragjykimin, pabarazitë që lindin, zhvillohen, riprodhohen dhe ndryshohen, duke u analizuar në funksion të kontekstit politik, historik, ekonomik, shoqëror.

Së dyti, është zhvilluar në rrafshin teorik dilema e vazhdimësisë apo jo e dikotomisë e majtë/e djathtë, përmes autorëve të njohur që kundërshtojnë apo mbrojnë tezën e dikotomisë, në raport me ndarjen ideologjike e majtë/ e djathtë. Pastaj merren në studim partitë politike shqiptare, në raport me ideologjinë e majtë/ e djathtë dhe karakteristikat që ato shpërfaqin.

Më pas, punimi kalon në fazën më të rëndësishme dhe thelbësore, analizimin e ligjërimit politik dhe ligjërimit mediatik për të kuptuar raportin që ekziston midis tyre apo më konkretisht ‘kush dominon kë’? Për këtë është përdorur analiza cilësore dhe sasiore e të gjithë artikujve dhe kryeartikujve të publikuar në organet mediatike të përzgjedhura, gjatë fushatave zgjedhore 2009 dhe 2013, dhe fjalimeve politike të mbajtura nga aktorët politikë të “Partisë Socialiste” dhe “Partisë Demokratike”, të botuara përkatësisht në gazetatat zyrtare, “Zëri i Popullit” dhe “Rilindja Demokratike” si dhe tek gazeta “55”.

Në këtë studim, do të fokusohemi në disa organe të shtypit të shkruar, për të hulumtuar dhe analizuar shkrimet, tematikat e tyre, truket e përdorura në favor apo disfavor të subjekteve kryesore politike të përfshira në këto zgjedhje. Duke pasur parasysh kontekstin historik në të cilin ndodhet vendi ynë, atij të një tranzicioni të tejzgjatur postkomunist, do të përfshimë në këtë studim edhe leksikun e përdorur në këto fushata nga subjektet politike kundrejt njëra-tjetrës si dhe pasqyrimin e tyre në media.

Media e shkruar jep një pasqyrë të vërtetë të lirisë së shprehjes, së lirisë së gjykimit në mënyrë të pavarur dhe të argumentuar. Një pasqyrim sa më i drejtë dhe objektiv i një ngjarje apo një teme e cila ka interes mbarëkombëtarë (edhe zgjedhjet elektorale janë një e tillë), sjell demokratizimin dhe legjitimitetin e medias si pushteti i katërt.

Pushteti i medias si i tillë, sjellë pasoja në ndikimin e drejtëpërdrejtë të vendimmarrjes së lexuesit, që në këtë rast janë zgjedhësit potencial, për ngjyrën që do i japin votës së tyre.

Pikërisht për rëndësinë që ka shtypi i shkruar dhe jo vetëm, do të shqyrtojmë gjatë këtij studimi përmes ligjërimit mediatik, sesi media kryen realisht funksionet e saj në raport krahasues me rrafshin teorik. Në studimin dhe analizimin e ligjërimit politik dhe mediatik gjatë fushatave zgjedhore të viteve 2009 dhe 2013, është përdorur si lëndë kryesore arkiva e shtypit të shkruar për këtë periudhë kohore, si dhe literatura të autorëve të ndryshëm, të cilët kanë trajtuar dhe studiuar çështjet që lidhen me temën e këtij studimi.

Fjalët Kyç: *Analizë ligjërimi, analizë kritike e ligjërimit, zgjedhjet në Shqipëri 2009/2013, ligjërimi mediatik, ligjërimi politik, konfliktualiteti, ideologjia e majtë/ e djathtë*

ABSTRACT

In a democratic system, media's role and politics, to promote democratic elections is important for the protection of democracy and human rights. The electoral process is a decisive possibility to check over the mediatic and political posture, as well as a possibility to analyze a great number of institutions and processes related to. The democracy of the process itself usually depends on biased or unbiased attitude of media. The methodology of this study is based on discourse analysis. Using the critical discourse analysis as an interdisciplinary method, I have tried to adapt the functioning form of discourse, understanding discourse as the language in use connected with the context in which the language is used. Referring the main axis of the study, which are politics and media, the hypotheses are: The lack of the left and right ideology produces conflicting political culture, which is carried by dominant leadership.

The second hypothesis is; This conflictual culture is represented in independent media agenda setting and in mediatic discourse. The findings of the study are gathered from the context analysis. I have analyzed the context during the years 1990, forming a completed picture of context to be studied. Context analysis is made by narrative approach. The discourse analysis can't be done without studying the context, without the exploration of power relationships connected with the context. Based in well known authors, the study analyzes the continuity or non continuity of left/right dichotomy. After the left and right ideology the study makes an analysis of political parties in Albania, separating them by their left or right ideology. After these analyses the study comes to the main analysis, which is the analysis of political discourse and analysis of media discourse. I try to understand the relationship between these two discourses, also the power relation between them, "which of the discourses is being dominated by whom?". To answer this question I have used the quantitative and qualitative method in the articles and headlines found in the written press during the elections 2009 and 2013. The speeches of political actors of "Socialist Party" and "Democratic Party" published in the political journals, "Zëri i Popullit", "Rilindja Demokratike" and "Gazeta 55", are also materials to be analyzed. The study is focused in the articles of news paper, the themes of newspapers and the tricks the press uses to work in the advantage or disadvantage of the political parties. Being aware of the historical context in which the

study takes place, the post communist transition in continuum, the lexic used by political subjects to each other during the elections represented in media, will be part of the analyze. The press is a real mirror of freedom of speech of freedom of decision making. A proper and objective presantation of a situation with an nationwide interest brings democratisation and legitimation of press. It makes it a real power in the society for the society. With such a power media has its influences in the reader's decision making process. Media itself plays an important role in the votes as well. This precise and important role of press makes important the aim of this study. Using the discourse analyzis the study will bring to light the functions of media, explaining them theoretically and practically we will understand what has happend during the elections between the society and politics. For the analyzes of media discourse I have used the newspaper of indipendent press during the elections 2009 and 2013. The archive of press during these periods has been the main source of material gathering. I have also used bibliography related to elections for the significative period for this study .

Key words: *discourse analyze, critical discourse analyze, elections Albania 2009/2013, media discourse, political discourse, conflictuality, left/right ideology*

DEDIKIM

Familjes sime, në mënyrë të veçantë, Irisit & Herës!

FALENDERIME

Faleminderit për mbështetjen, profesorit udhëheqës të kësaj teme, Henri Çilit dhe profesorëve të UET, në mënyrë të veçantë, Lorena Licenjit dhe Belina Budinit.

Faleminderit profesorëve dhe kolegëve të universitetit “Luigj Gurakuqi”, për mbështetjen e dhënë, gjatë kohës së përgatitjes së këtij punimi.

Falenderimi i fundit, por jo për nga rëndësia, i kushtohet familjes dhe shoqërisë sime, që patën durimin për të më dhënë suportin e duhur, gjatë kohës së zhvillimit të këtij studimi.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Abstrakti

Falenderime

KAPITULLI I

HYRJE

1.1. Objekti i studimit.....	fq 1.
1.2. Problematikat e përgjithshme të punimit	fq 7.
1.3. Hipotezat e ngritura	fq 8.
1.4. Metodologjia e punimit	fq10.
1.5. Struktura e punimit	fq 13.

KAPITULLI II

Hulumtime të literaturës teorike

2.1. Analiza kritike e ligjërimit	fq 16.
2.1.1. Ligjërimi, ideologjia dhe pushteti.....	fq 19.
2.1.2 Analiza kritike e ligjërimit e Fairclough.....	fq 22.
2.2. Teoria e përcaktimit të axhendës	fq 24.
2.3. Narrativa e tekstit	fq 30.
2.3.1. Leksiku	fq 35.
2.4. Ligjërimi mediatik	fq 37.
2.4.1. Funkcionet e medias	fq 27.
2.4.2. Konfliktualiteti si logjikë e brendshme mediave.....	fq 41.
2.4.3. Gjuha mediatike	fq 44.
2.5. Ligjërimi politik.....	fq 46.
2.6. Partitë politike dhe funksionet e tyre	fq 48.
2.7. Ideologjia e majtë dhe e djathtë	fq 50.
2.7.1. Ideologjia e partive politike shqiptare	fq 54.

2.7.2 Kultura politike konfliktuale.....	fq 55.
2.8. Personalizimi partiak në partitë shqiptare.....	fq 58.

KAPITULLI III

Konteksti historik, mediatik dhe politik

3. 1. Ndryshime ekonomike dhe shoqërore në vite.....	fq 60.
3. 2. Elitat dhe roli i tyre në shoqërinë shqiptare.....	fq 62.
3. 3. Personalizimi institucional.....	fq 64.
3. 4. Zgjedhjet parlamentare në Shqipëri pas vitit 1990.....	fq 67.
3. 5. Vlerësimet e ndërkombëtarëve.....	fq 71.
3.6. Fazat e zhvillimit të medias në Shqipëri, pas viteve 1990.....	fq 74.
3.7. Modelet e shtypit.....	fq 76.
3.7.1 Problematikat në shtypin shqiptar.....	fq 77.
3.8. Krijimi i partive politike në Shqipëri.....	fq 82.
3.8.1 Partitë kryesore në Shqipëri dhe liderët e tyre.....	fq 84.

KAPITULLI IV

Analiza e ligjërimit politik në zgjedhjet e vitit 2009 dhe 2013

4.1. Ligjërimit politik, përmes fjalimeve, 2009.....	fq 90.
4.1.1.Ligjërimit politik i majtë përmes fjalimeve, 2009.....	fq 90.
4.1.2 Ligjërimit politik i djathtë përmes fjalimeve, 2009	fq 100.
4.2. Analizë e ligjërimit politik në raport me ideologjinë e majtë/e djathtë, 2009. fq	108.
4. 3. Ligjërimit politik, “ne dhe ata”, 2009	fq 112.

4.4. Ligjërimi politik, përmes fjalimeve, 2013	fq 117.
4.4.1. Ligjërimi politik i majtë përmes fjalimeve, 2013	fq 118.
4.4.2 Ligjërimi politik i djathtë përmes fjalimeve, 2013	fq 130.
4.5. Analizë e ligjërimit politik në raport me ideologjinë e majtë/e djathtë, 2013.	fq 140.
4. 6. Ligjërimi politik, “ne dhe ata”, 2013	fq 143.

KAPITULLI V

Analiza e ligjërimit mediatik në zgjedhjet e vitit 2009 dhe 2013

5.1. Ligjërimi mediatik përmes kryeartikujve, “Gazeta Shqiptare” 2009	fq 151.
5.2. Ligjërimi mediatik përmes kryeartikujve, gazeta “Panorama”, 2009	fq 162.
5.3. Ligjërimi mediatik përmes kryeartikujve, gazeta “Panorama”, 2013	fq 169.
5.4. Ligjërimi mediatik përmes kryeartikujve, gazeta “Shekulli”, 2013	fq 174.
5.5. Ligjërimi mediatik përmes kryeartikujve, “Gazeta Shqiptare”, 2013	fq 183.
5.6. Ligjërimi mediatik, gazetari procesi apo gazetari përmbajtje	fq 190.
5.7. Kategoritë burimore tek gazeta “Shekulli” në fushatën zgjedhore 2013.....	fq 195.
5.8. Personalizimi, konfliktualja dhe negativja në ligjërimit mediatik	fq 201.

PËRFUNDIME	fq 211.
-------------------------	---------

BIBLIOGRAFIA	fq 214.
---------------------------	---------

Lista e Shkurtimeve

AKL	Analiza Kritike e Ligjërimit
KE	Komisioni European
KiE	Këshilli i Europës
KQZ	Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve
LSI	Partia Lëvizja Socialiste për Integrim
ODHIR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
OSBE	Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin European
OECD	Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillim
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
PD	Partia Demokratike
PS	Partia Socialiste
RD	Rilindja Demokratike
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
TIA	Transparency International Albania
USAID	U.S Agency for International Development

KAPITULLI I

Hyrje

1.1 Objekti i studimit

“ E vetmja fortesë e lirisë është një qeveri e fortë e cila mbron interesat e popullit dhe një popull i fuqishëm dhe i mirëinformuar për të ushtruar kontrollin e tij suprem mbi këtë qeveri.”

Franklin Delano Roosevelt, Fireside Chat, April 14, 1938

Në vendet me tradita të hershme të demokracisë dhe lirisë së shtypit, janë një sërë garancish që mbrojnë lirinë e fjalës, lirinë e shtypit, si dhe të drejtën e qytetarëve për informim të saktë, të paanshëm dhe të kuptueshëm, pasi në këto vende, gazetarët dhe reporterët zbatojnë me përpikmëri rregullat dhe parimet profesionale. Problematike mbeten vendet me një demokraci të brishtë siç është edhe vendi jonë, një vend që ende vuan pasojat e rregjimit komunist, një vend që po përjeton trazicionin më të gjatë në gjithë vendet e rajonit, prandaj për qytetarët e këtyre vendeve është shumë e rëndësishme të kërkojnë profesionalizëm në mediet, të cilat zhvillojnë dhe pasqyrojnë aktivitetin politik të aktorëve politikë, kandidatëve dhe çështjeve publike.

Objekti i studimit, në këtë punim doktore, është ligjërimi mediatik gjatë fushatave zgjedhore, të vitit 2009 dhe 2013. Qasja e përzgjedhur në këtë studim në raport me ligjërimit mediatik për të kuptuar se për çfarë na shërben gazetaria, është qasja e cila median e shkruar e vlerëson si një mjet që duhet të ndihmojë qytetarët për të kuptuar më mirë botën dhe vendin që ata zënë në të, pasi ligjërimit gazetaresk është një ndër format më të fuqishme të ligjërimeve. Studimi ndalet gjerësisht tek identifikimi i tematikave që përbëjnë axhendën mediatike gjatë kësaj periudhe, tek mënyra e përzgjedhur për trajtimin e tyre, tek identifikimi i ligjërimit gazetaresk të përdorur, për të kuptuar çfarë informacioni i përcillet publikut dhe rolin e tij në raport me pabarazitë, ideologjinë dhe pushtetin ekzistues.

Për të ndërtuar një studim të plotë mbi ligjërimit mediatik, është e nevojshme të bëhet pjesë e këtij studimi edhe politika dhe ligjërimit politik sepse sipas Chilton, “politika përfshin pajtimin e dallimeve përmes diskutimit dhe bindjes, prandaj komunikimi është thelbësor për politikën” (2004: 4 cituar nga Hague et al. 1998: 3-4). Për këtë arsye,

studimi ndërtohet përmes dy akseve kryesore logjikës politike dhe logjikës mediatike, fillimisht në rrafshin teorik dhe më pas në atë praktik, për të kuptuar dhe ndërtuar paralelet ndërmjet ligjërimit politik dhe atij mediatik. Mungesa e dallimeve ideologjike e majtë/e djathtë në ligjërimin politik, kultura politike, liderët politikë, axhenda mediatike, format e ligjërimit gazetaresk të përdorur, për të kuptuar çfarë informacioni i përcillet publikut janë elementët bazikë, mbi të cilët ndërtohen logjika politike dhe mediatike.

Ky studim është i nevojshëm për të kuptuar më mirë lidhjen politikë-media, raportin mes tyre, për të na ndihmuar të krijojmë premisat e duhura për studimin e medias dhe rolit të saj. Qëllimi i këtij studimi, është të argumentojë se në ligjërimin dhe axhendën mediatike reflektohet prania e një kulture politike konfliktuale, e përforcuar nga liderë dominantë. Për të provuar këtë, është e nevojshme që të studiohet ligjërimi politik përmes fjalimeve të mbajtura nga aktorët politikë të dy partive kryesore që dominojnë jetën politike në vend, “Partisë Socialiste” e cila i përket spektrit të majtë dhe “Partisë Demokratike” që i përket spektrit të djathtë në raport me ideologjitë përkatëse, si dhe ligjërimi mediatik përmes kryeartikujve dhe artikujve të publikuar gjatë zhvillimit të fushatave zgjedhore, me të gjithë elementët përbërës, që merren në studim. Prandaj objektivat e këtij punimi, fillojnë me vendosjen e objektiveve në raport me ligjërimin politik, për të vendosur më pas, objektivat përsa i përket ligjërimit mediatik:

- a) Të analizohen fjalimet politike në raport me ideologjinë e majtë/djathtë.
- b) Të analizohen modelet ligjërimore përmes të cilave ndërtohet kultura politike konfliktuale dhe nxirren në pah tiparet e liderit.
- c) Të analizohen tematikat që ndërtojnë axhendën mediatike, për periudhën maj-qershor 2009, 2013.
- d) Të analizohen elementët narrativë që ndërtojnë ligjërimin e medias.
- e) Të analizohet si reflektohet në ligjërimin mediatik pushteti jo i barabartë ndërmjet aktorëve politikë.
- f) Të analizohen format me të cilat prodhohet kultura konfliktuale në median e shkruar.

Megjithëse gjatë këtij punimi burimet e para për analizë kanë qenë gazetatat “Panorama”, “Gazeta Shqiptare” për fushatën zgjedhore të vitit 2009 dhe “Panorama”, “Gazeta

Shqiptare” dhe “Shekulli” për fushatën zgjedhore të vitit 2013, gjatë hulumtimit në lidhje me pasqyrimin e ideologjisë politike të majtë dhe të djathtë, rezultoi që në gazetatat e përditshme, partitë politike nuk prezantojnë asnjëherë programe të plota politike. Ky argument është i rëndësishëm për të kuptuar edhe mungesën e rëndësishme që i jepet dallimit mes të majtës dhe të djathtës, përse i përket anës ideologjike të ndërtimit të partisë. Prandaj burim me interes për këtë punim bëhet shtypi partiak, me konkretisht: Gazetat “Rilindja Demokratike”, “Gazeta 55” dhe “Zëri i Popullit”, të cilat përzgjidhen për të analizuar mënyrën se si vetë, partitë politike, përdorin organet e tyre të shtypit për të krijuar të ndryshmen mes tyre. Janë analizuar fjalimet e aktorëve politikë të ndryshëm, gjatë periudhës maj-qershor, meqënëse vetë editorialet nuk përmbajnë informacione ideologjike.

Qasja që sugjerojnë studiuesit Fairclough&Fairclough(2012), mbi studimin e ligjëritimit politik, është që ligjëritimi politik është një formë e argumentimit, që përfshin argumente në raport me mënyrat e veçanta të të vepruarit, duke përzgjedhur ndërmjet alternativave të ndryshme: “Politika është kryesisht për të bërë zgjedhje se si të veprohet në përgjigje të rrethanave dhe qëllimeve, ka të bëjë me zgjedhjen e politikave, dhe zgjedhje të tilla dhe veprimet që rrjedhin prej tyre bazohen në argumente praktike” (2012:1).

Analizimi i fjalimeve politike të aktorëve politikë të dy partive kryesore në Shqipëri, zhvillohet pas trajtimit në rrafshin teorik mbi vazhdimësinë apo jo të diadës e majtë/ e djathtë, pasi për disa studiues nuk ka më kuptim të flitet, për dallimet ideologjike mes së majtës dhe të djathtës, pas fitores së kapitalizmit mbi alternativën tjetër kundërshtarë. Një ndër studiuesit që kundërshton këtë qasje, është Bobbio (1997: 9), për të cilin pohimi i krizës së ideologjive është më se ideologjik, sepse e majta dhe e djathta kontrastohen jo vetëm përmes ideve, por edhe përmes interesash dhe vlerësimesh për drejtimin që i duhet dhënë shoqërisë, sepse përmes dallimeve ideologjike mes së majtës dhe të djathtës, mund të ndërtohen analizat e programeve dhe sjelljes politike të partive. Pas dakordësisë që është e pamundur të analizohen fjalimet politike pa iu referuar dallimeve ideologjike përkatëse, janë përcaktuar kriteret mbi të cilat dallon e majta nga e djathta, si tradita, liria, barazia, në nivelin teorik, për të kaluar më pas në grumbullimin dhe analizimin e të dhënave të përftuara nga analiza e tekstit.

Studimi i kulturës politike në Shqipëri, në këtë studim, orientohet nga definicioni që i

bën studiuesi Lijphart(1999), duke i'u referuar ndarjes ndërmjet kulturës konsensuale dhe asaj konfliktuale, për t'u studiuar në raport shkak-pasojë me mungesën e dallimeve ideologjike ndërmjet të majtës dhe të djathtës.

Studiuesi Van Dijk (1998), e klasifikon ideologjinë si një bazë e riprezantimit shoqëror dhe skemë e riprezantimit përmes dy grupeve në dhe ata. Sipas “katrorit ideologjik-politik” të Van Dijk(1997), riprezantimi “ne” dhe “ata” thekson veprimet tona të mira në krahasim me veprimet e tyre të këqia, prandaj sipas Chilton(2004:45), në komunikimin politik do përdoret një vetëprezantim pozitiv që shërben për të legjitimuar pushtetin brenda grupit në dhe një prezantim negativ për të delegjitimuar grupin tjetër, ata.

Prandaj modelet ligjërimore legjitimuese/delegjitimuese përmes një antagonizmi të theksuar, të shoqëruara me stragjitë referuese dhe ato pohuese, shërbejnë për të kuptuar si ndërtohet kultura politike konfliktuale dhe nxirren në pah tiparet e liderëve.

Sipas teorisë së përcaktimit të axhendës (Griffin dhe të tjerë, 2015; Littlejohn dhe të tjerë, 2009, 2017; Lippman 1998), mediet kanë aftësitë e duhura që të transferojnë interesin për çështje nga axhenda e tyre tek axhenda e publikut, prandaj analiza sipas kësaj teorie ndërtohet fillimisht duke studiuar çfarë ka vendosur media të përfshijë në axhendën e vet dhe sa hapësirë apo rëndësi ka lajmi në raport me vendosjen që zë në gazetë. Por ky punim, nuk synon vetëm të identifikojë çfarë shkruhet në gazetatat e përzgjedhura gjatë fushatave zgjedhore të vitit 2009 dhe 2013, por edhe mënyrën se si ligjërimi mediatic prodhohet, si argumentohet dhe si ligjërimi mediatic mund të përforcojë pabarazitë, ideologjinë apo pushtetin ekzistues, arsye të mjaftueshme për të na drejtuar drejt analizës kritike të ligjërimit. Analiza kritike e ligjërimit është një qasje ndërdisiplinare, e zhvilluar në fund të viteve 1980 nga studiues të ndryshëm ku më kryesorët për këtë punim janë Fairclough(1992a; 1995a; 1997; 2000; 2003; 2012) Van Dijk(1977; 1988; 1991; 1998; 2008), dhe Wodak(1997; 2001; 2009). AKL është kthyer në një ndër fushat më me influencë të analizës së ligjërimit, përmes interpretimit të kuptimeve të tekstit, lidhjes së tij me kontekstin dhe marrëdhënien ndërvepruese mes prodhuesit të tekstit, tekstit dhe konsumuesit të tekstit.

Analiza e këtij studimi i referohet qasjes së Fairclough i cili AKL e zhvillon përmes një strukture tredimensionale, që konsiston në: Analizën e tekstit, analizën e praktikave diskursive dhe analizën e praktikave shoqërore. Analiza e tekstit ndërtohet përmes leksikut i cili shoqëroret me identifikimin e strategjive të përzgjedhura sipas modelit të Van Dijk (1997; 1998) dhe Chilton (2004), si dhe narrativës së tekstit, ku një ndër elementët kryesorë narrativë për këtë studim është historia e cila ndryshe nga fabula që i referohet ngjarjes ashtu si ajo ka ndodhur, historia lidhet me mënyrën se si prezantohet fabula, “duke e prezantuar ngjarjen në një këndvështrim” (Fairclough, 2003: 83). Ky element narrativ është i rëndësishëm për këtë punim, sepse na mundëson studimin krahasues ndërmjet ligjërimeve që trajtojnë të njëjtat ngjarje, por që e fokusojnë ngjarjen në përputhje me interesat dhe ideologjitë e organeve mediatike.

Në strukturën tredimensionale të Fairclough, trajtohen praktikat diskursive të cilat na ndihmojnë për të kuptuar prodhimin e tekstit sipas modelit të zhvilluar nga Hall (1980: 136-138) që emërtohet “kodimi dhe dekodimi”, për të kuptuar që e njëjta ngjarje mund të kthehet në lajm përmes mënyrave të ndryshme të përzgjedhura nga prodhuesit. Ajo që ia vlen të theksohet është ndryshimi ndërmjet atyre që klasifikohen prodhues sipas modelit të Hall, dhe qasjes së përzgjedhur në këtë punim. Nëse për Hall, janë të rëndësishëm edhe gazetarët në procesin e prodhimit të lajmit, në këtë studim më tepër i referohemi atyre që kanë në pronësi këto organe mediatike, për vetë specifikat dhe problematikat që shfaq shtypi shqiptar, prandaj në këtë studim organet mediatike të përzgjedhura për analizë, i përkasin grupeve mediatike të ndryshme, për të kuptuar si influencon ky faktor në ligjërimin mediatik. Nëse praktikat diskursive profesionale i referohen etikës si një ndër elementët e rëndësishëm të kësaj kategorie të përfshirë në këtë studim, duke iu referuar “Kodit Etik” dhe studiuesve të tjerë vendas dhe të huaj që studiojnë rregullat dhe parimet profesionale, praktikat diskursive organizacionale referuar vlerave dhe kritereve që përdoren për të kthyer një ngjarje në lajm, si personalizimi, konfliktualiteti dhe negativiteti datojnë që me punën e hershme të Galtung dhe Ruge(1965:64-91) dhe vazhdojnë të jenë dominuese edhe në studime më të vona nga Blumler&Gurevich(1995), Harcup&O’Neill(2001) etj, prandaj studimi i ligjërimin mediatik, përmes këtyre kritereve, do trajtojë kulturën konfliktuale në media, në çështjen e fundit të punimit .

Një ndarje e rëndësishme sipas përcaktimit të Hansen (2009) është gazetaria e procesit që përqëndrohet te taktikat politike, aleancat politike, manipulimet dhe beteja për pushtet, në raport me gazetarinë e përmbajtjes, e cila përqëndrohet tek pasojat e vendimeve politike dhe tek dallimet politike dhe ideologjike, prandaj përmes gazetës “Panorama”(përzgjedhje e rastësishme ndërmjet gazetave të marra në studim), zhvillohet një analizë sasiore e kryeartikujve dhe artikujve të rubrikës politike, për të përcaktuar relevancën gazetari procesi dhe gazetari përmbajtje dhe efektet që sjell dominimi i gazetarisë së procesit dhe kornizimi strategjik i lajmeve, të cilat për studiues kritikë të medias si Capella&Jamieson(1997:139), rrisin cinizmin e audiencës.

Elementi i tretë sipas strukturës tredimensionale të Fairclough (1997:55) është studimi i ligjërimit si një praktikë shoqërore, që sugjeron një lidhje dialektike ose dy mënyrëshe, ngjarja ligjërimore formohet nga situatat, institucionet dhe strukturat sociale, por ajo gjithashtu i formon ata. Tek praktikat shoqërore për këtë studim me vlerë janë: Praktikrat politike që i referohen përdorimit të burimeve në media në funksion të ruajtjes së ideologjisë ekzistuese dominuese, e cila është një ndër elementët kryesorë të AKL-së. Fairclough i përkufizon ideologjitë si: “Prezantim të aspekteve të botës që mund të tregohen, për të kontribuar në ndërtimin, mbajtjen, dhe ndryshimin e marrëdhënieve shoqërore të pushtetit, dominimit” (2003:9). Për Althusser (2014: 239), aparatet shtetërore ideologjike si familja, kisha, media, partitë politike, arti etj, shërbejnë për të ruajtur rendin ekzistues në shoqëri, ndërsa për Antonio Gramscin politika vlerësohet si një luftë për hegjemoninë, një mënyrë e veçantë e konceptualizimit të pushtetit, që arrihet mes tjerash përmes konsensusit, dhe ku ideologjia zë një vend të rëndësishëm në ruajtjen dhe mbajtjen e marrëdhënieve të pushtetit, përmes institucioneve që përhapin ideologjinë e saj. Prandaj në bazë të analizës teorike ndërtohet analiza e tekstit përmes: Studimit të kategorive burimore tek gazeta “Shekulli”, (përzgjedhje e rastësishme ndërmjet gazetave, por që nuk kufizon studimin sepse në raport me përzgjedhjen e burimeve, gazetat shfaqin ngjashmëri), për të kuptuar rolin që luan gazeta në raport me ideologjinë ekzistuese të pushtetit dhe hegjemonisë.

Rëndësia e këtij studimi në fushën e shkencave të komunikimit është e veçantë, sepse trajton qasjen teorike në krahasim me atë praktike, duke sjellë një informacion të

sintetizuar për median, politikën, raportin mes tyre, përmes studimit të fushatave zgjedhore 2009 dhe 2013.

Kjo temë studimore ka pasur si shtysë kryesore trajtimin dhe analizimin e këtyre elementëve, në funksion të formimit profesional individual, për të kuptuar më tej raportin mes teorisë dhe praktikës, duke e parë median si një element të rëndësishëm në mirëfunksionimin e një shoqërie.

Po kujt i shërbejnë studime të kësaj natyre dhe pse shërbejnë? Ashtu si në shumë vende, zgjedhjet janë ndër ngjarjet më të rëndësishme politike, prandaj ky studim, i shërben studiuesve të cilët kanë interes studimi mbi ligjërimin politik, i shërben studiuesve për studime të mëtejshme në lidhje me fushatat zgjedhore, si dhe studentëve që kanë interes të konsultohen me materiale që lidhen me ligjërimin dhe kontekstin shqiptar.

Përfundimet e studimeve të këtij lloji, kontribuojnë në përmirësimin e qëndrimit mediatik në drejtim të aktorëve politikë dhe ofrimit të një informimi, mbi të cilin publiku mund të bazohet për të bërë zgjedhjet e tij politike të lira dhe të informuara.

1.2. Problematikat e përgjithshme të punimit

Disa nga problematikat e hasura gjatë këtij punimi janë si më poshtë:

Së pari, ishte numri i organeve të shtypit të shkruar, duke pasur fokus mbi gazetat e përditshme, të cilat botohen në një numër relativisht të lartë për një vend të vogël si yni. Ishte e pamundur që të merreshin në analizë të gjitha këto organe, por duke parë një tendencë të përgjithshme në trajtimin e ligjërimin dhe një ngjashmëri në realizimin e faqes kryesore dhe trukeve të ndryshme, jam munduar të përzgjedh disa organe të cilat bëjnë të mundur realizimin e objektivave të këtij studimi.

Vështirësi tjetër ka qenë mungesa e studimeve të ngjashme. Literatura teorike mbi analizën e ligjërimin, mbi rolin e medias etj, kanë qenë një ndihmesë e madhe në mënyrën e qasjes dhe këndvështrimit mbi temën, por studime statistikore të cilat shprehin monitorimin konkret mbi median e shkruar është vështirë ti gjejmë nga burime profesionale.

Kjo për shkak edhe se monitorime dhe raporte të tilla mbështetur edhe nga legjislacioni në fuqi, janë më tepër të përqëndruara te media vizive, radio apo televizioni.

Së treti është periudha kohore që merret në studim. Fushata për zgjedhjet elektorale zgjat një muaj sipas kodit zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, kështu që objekti i këtij studimi janë vetëm ligjërimet e kësaj periudhe, ndërkohë që ligjërimi mediatik në lidhje me zgjedhjet fillon muaj më parë dhe mbaron muaj më pas. Konteksti parazgjedhor është i rëndësishëm, pasi parapërgatit lexuesin dhe në këtë rast zgjedhësin drejt një drejtimi politik të caktuar. Por duke qënë se fushata është edhe periudha më e nxehtë e debateve, pozicionimeve dhe ndikimeve që ka tek qytetarët, kjo periudhë kohore e jep të qartë mesazhin dhe problematikat.

Gjatë një punimi është e pamundur të shmangësh subjektivitetin dhe qëndrimet personale, gjatë analizimit të ligjërimeve apo mënyrës sesi e trajton favoritin tënd politik. Duke u munduar të respektosh rregullat dhe parimet e objektivitetit dhe paanshmërisë, si në çdo fushë tjetër, edhe në studimet dhe analizat shkencore qëndron gjithmonë i fshehur me kujdes në rreshta, marzhi i gabimit subjektiv.

1.3. Hipotezat e ngritura

Argumenti kryesor i këtij punimi, referuar kontekstit dhe tekstit të shkruar, parashtron pretendimin se prania e një kulture politike konfliktuale e përforcuar nga liderë dominantë reflektohet në ligjërimin mediatik dhe axhendën mediatike, gjatë fushatave zgjedhore 2009 dhe 2013.

Pyetja themelore kërkimore që shtrojmë në këtë punim është: A reflekton ligjërimi mediatik dhe axhenda mediatike praninë e një kulture politike konfliktuale, gjatë fushatave zgjedhore 2009 dhe 2013?

Përgjigjja e pyetjes kërkimore të ngritur në këtë studim ndërtohet përmes dy akseve kryesore, logjikës politike dhe logjikës mediatike, për të kuptuar raportin mes tyre. Mungesa e dallimeve ideologjike e majtë/e djathtë në ligjërimin politik, kultura politike, liderët politikë, axhenda mediatike, karakteristikat e ligjërimit gazetaresk të përdorur, për të kuptuar çfarë informacioni i përcillet publikut janë elementët bazikë mbi të cilët ndërtohen logjika politike dhe mediatike.

Fillimisht ndërtohet hipoteza e parë: Mungesa e dallimeve ideologjike mes së majtës dhe të djathtës, prodhon kulturë politike konfliktuale, të drejtuar nga liderë dominantë. Pyetjet kërkimore në funksion të kësaj hipoteze janë si më poshtë:

- 1) Cilat janë konceptet me të cilat ndërton e majta dhe e djathta ideologjinë në ligjërimin e saj?
- 2) Cilat janë modelet ligjërimore përmes të cilave ndërtohet kultura politike konfliktuale?
- 3) Cilat forma ligjërimore nxjerrin në pah tiparet e liderit politik?

Por pyetja kërkimore mbetet e papërligjur nëse nuk ndërtohet hipoteza e dytë: Prania e një kulture politike konfliktuale, reflektohet në axhendën mediatike dhe në ligjërimin mediatik. Pyetjet kërkimore në funksion të kësaj hipoteze janë si më poshtë:

- 1) Cilat janë tematikat që ndërtojnë axhendën mediatike?
- 2) Cilët janë elementët narrativë që ndërtojnë ligjërimin e medias?
- 3) Si reflektohet në ligjërimin mediatik pushteti jo i barabartë ndërmjet aktorëve politikë?
- 4) Përmes cila formave prodhohet kultura konfliktuale në median e shkruar?

Në një sistem demokratik, roli i medias për të promovuar zgjedhje demokratike është i rëndësishëm për mbrojtjen e demokracisë dhe të drejtave të njeriut në çdo vend. Procesi elektoral është një mundësi vendimtare për të shqyrtuar qëndrimin mediatik, si dhe një mundësi për të analizuar një numër të madh institucionesh dhe procesesh të lidhura me të. Studimi dhe analizimi i ligjërimin mediatik, do na bëjë të mundur të prekim realisht dyshimet në realizimin apo mosrealizimin e misionit të gazetarisë. Ky mision mbi të gjitha është i rëndësishëm për publikun, pasi një informim i mirë shërben si një guidë, mbi të cilin publiku mund të bazohet për të bërë zgjedhjet e tij politike të lira dhe të informuara.

1.4. Metodologjia e punimit

Metodologjia e punimit: Qasjet empirike dhe teorike

Studimi mbështetet në qasje të ndërthurura metodologjike, ku përfshihen analiza e tekstit dhe kontekstit, si pjesë përbërëse të analizës kritike të ligjërimit:

Së pari, synohet të shpjegohet konteksti, duke iu referuar disa faktorëve të rëndësishëm. Gjatë këtij studimi është marrë parasysh konteksti historik, shoqëror e politik, që pas ndryshimit të sistemit politik (nga diktaturë në demokraci) duke përfshirë domosdoshmërisht edhe periudhën në të cilën ka vepruar subjekti i studimit.

Së dyti, analizohet teksti i shkruar duke krahasuar të dhënat empirike me të dhënat teorike.

Analiza e kontekstit bëhet kryesisht përmes qasjes metodologjike përshkruese. Ndërtohet një tablo e plotë kontekstuale përmes autorëve të ndryshëm, nga të cilët është mbledhur informacioni i nevojshëm për këtë studim. Pa një hulumtim të kontekstit nuk mund ta kuptojmë shtypin e shkruar dhe politikën, pasi janë rrethanat të cilat influencojnë si një zhvillim dhe vazhdim organik i ligjërimit mediatik dhe politik. Ai gjithashtu, lejon edhe interpretimin e ligjërimit mediatik dhe politik, prandaj kemi zhvilluar një kapitull, për të dhënë kontekstin historik e shoqëror të periudhës së marrë në studim.

Analiza e tekstit përfshihet në analizën kritike të ligjërimit, qëllimi i së cilës është investigimi në mënyrë kritike i pabarazive shoqërore, të shprehura, të sinjalizuara, të ndërhuara, të legjitimuara përmes gjuhës së përdorur. Ajo synon të marrë në studim një problem shoqëror dhe të mbledhë të dhëna përmes ligjërimit në funksion të evidentimit të faktit, që strukturat në dukje neutrale nuk janë në të vërtetë të tilla. Për efekt studimi do ta grupojmë ligjërimin mediatik, në median e shkruar sipas kategorive tematikore dominuese gjatë fushatës zgjedhore, të cilat do të na japin një panoramë më të qartë, në raport me axhendën mediatike dhe karakteristikat e ligjërimit mediatik. Analiza e tekstit mbështetet tek studimi i narrativës dhe leksikut.

Instrumentet e përdorura për të arritur tek analiza e objektit të studimit janë:

Librat e autorëve të ndryshëm, vendas apo të huaj, pasi kjo na ka dhënë një dimension më të plotë për mënyrën sesi funksionon media e politika dhe sesi duhet ta shohim nga ana studimore, duke cilësuar dhe kuptuar konceptet teorike, të cilat na ndihmojnë në analizën praktike të materialit që kemi në studim.

Grumbullimi, hulumtimi dhe përzgjedhja e kryeartikujve dhe artikujve të botuar në shtypin e shkruar të pavarur, gjatë periudhave të marra në studim, përmes shfrytëzimit të arkivës së bibliotekës “Marin Barleti”. Për fushatën zgjedhore të 2009 janë përzgjedhur gazetat: “Panorama” dhe “Gazeta Shqiptare”. Një specifikë për t’u theksuar është vështirësia në përzgjedhjen e gazetave pasi nuk ka të dhëna të sakta, në lidhje me tirazhin e shitjeve përveç të dhënave që publikojnë vetë pronarët e tyre. Para kësaj situate, janë specifikat përkatëse të tyre që bëjnë diferencën. Orientimi mbi të cilin është bërë përzgjedhja, ka qenë diversiteti, pasi gazetat i përkasin strukturave të ndryshme dhe grupeve mediatike jo të njëjta.

Gazeta “Panorama” doli fillimisht në botim në vitin 2002, si botim i “Panorama Group”, e cila boton dhe “Panorama Sport”. Suksesi dhe tirazhi i shitjes në tregun mediatik janë faktorët kryesorë për përzgjedhjen e kësaj gazete. Një ndër pronarët kryesorë të “Panoramës”, është Irfan Hysenbelliu, një emër i njohur gjithashtu si biznesmen në fushën e ndërtimit.

Një arsye e përzgjedhjes së “Gazetës Shqiptare” ishte origjina e huaj e pronësisë, përkatësisht italiane, duke qenë rasti i vetëm i pronësisë së huaj në median shqiptare. “Gazeta Shqiptare” në vitin 2009 ishte nën pronësinë e grupit Edisud Sh.a. Kjo specifikë dhe diferenca në çmim në raport me gazetat e tjera (“Gazeta Shqiptare” dhe “Shqip” janë gazetat e pavarura me çmimin më të lartë përkatësisht 50 lekë), ishte dhe një arsye e mirë për ta përzgjedhur.

Për fushatën zgjedhore të 2013 janë përzgjedhur gazetat: “Panorama”, “Shekulli” dhe “Gazeta Shqiptare”. Orientimi mbi të cilin është bërë përzgjedhja, përveç rëndësisë që këto gazeta kanë në tregun mediatik, është diversiteti dhe krahasimi.

Përcaktimi i renditjes së gazetave në tregun mediatik referuar tirazhit të tyre të shitjeve dhe të dhënave të mbledhura përmes studimit të “Institutit për Alternativa Kërkimi dhe

Zhvillimi”, në raport me leximin e gazetave për periudhën dhjetor 2011- maj 2012, nxjerr në vend të parë gazetën “Panorama”, e ndjekur nga “Shekulli” dhe “Gazeta Shqiptare”.

Si arsye përzgjedhje shërben diversiteti, pasi gazetat i përkasin strukturave të ndryshme dhe grupeve mediatike jo të njëjta, në rastin e gazetave “Panorama” dhe “Shekulli”, ndërsa për “Gazetën Shqiptare” krahasimi referuar ndryshimit të pronësisë, nga 2009 në 2013-tën.

Gazeta “Panorama” nuk ka ndryshime në vitin 2013 në raport krahasues me vitin 2009. Kjo gazetë ka arritur të ruajë të njëjtat karakteristika, mbi të cilat është bërë përzgjedhja në fushatën zgjedhore të vitit 2009.

Nëse në vitin 2009, një arsye e përzgjedhjes së “Gazetës Shqiptare” ishte origjina e huaj e pronësisë, përkatësisht italiane, në vitin 2011, gazeta si dhe “grupi mediatik Edisud në Shqipëri iu shit grupit mediatik Fokus” (Nezaj, 2014:233). Vazhdimësia e studimit mbi këtë organ mediatik, i referohet përveç të tjerave pikërisht këtij faktori, ndryshimit të pronësisë, për të kuptuar sa dhe si influencon ky element në ligjërimin mediatik.

Gazeta “Shekulli” u themelua në vitin 1997, duke u kthyer një ndër gazetat me peshë në tregun mediatik, nën pronësinë e një emri të njohur, Koço Kokëdhima. Ai njihet si një ndër biznesmenët e parë në Shqipëri, i cili përveç aktiviteteve të tjera tregtare investoi edhe në lindjen dhe zhvillimin e medieeve të ndryshme. Me interes është fakti që lidhet me bindjet e tij politike të majta, përmes të cilave në vitin 2013, përfshihet në jetën politike si deputet i së majtës, fakt i cili shërben për përzgjedhjen e kësaj gazete.

Grumbullimi, hulumtimi dhe përzgjedhja e fjalimeve politike për të identifikuar dhe kuptuar ligjërimin politik, në funksion të analizës së objektit të studimit. Për këtë janë shfrytëzuar organet partiake përkatëse si: Gazetat “Zëri i Popullit” për PS-në dhe “Rilindja Demokratike” për PD-në, gjatë fushatave zgjedhore 2009 dhe 2013. Për të ndërtuar një panoramë krahasuese të saktë, është përdorur dhe gazeta⁵⁵ për grumbullimin e fjalimeve politike të PD-së, pasi tek “Rilindja Demokratike” nga procesi i grumbullimit rezulton një numër minimal fjalimesh të publikuara krahasuar me

fjalimet politike të PS-së tek “Zëri i Popullit”.

Analiza e përdorur, sasiore dhe cilësore e teksteve, synon një dekodim të ligjëritimit mediatik, përmes mbledhjes së të dhënave dhe analizës së tyre. Kryeartikulli është shkrimi kryesor që cilësohet si artikulli më i rëndësishëm i ditës prandaj janë analizuar 60 kryeartikuj, 30 në gazetën “Panorama” dhe 30 tek “Gazeta Shqiptare” për fushatën zgjedhore 2009, ndërsa gjatë fushatës zgjedhore 2013 janë analizuar 90 kryeartikuj, 30 në gazetën “Panorama”, 30 tek “Gazeta Shqiptare” dhe 30 tek “Shekulli” duke ndërtuar fillimisht kategoritë tematike të përfuara përmes tematikave të identifikuara, gjatë periudhës së marrë në studim dhe më pas është studiuar narrativa e tekstit. Sipas së njëjtës logjikë, është bërë studimi i 339 artikujve tek gazeta “Panorama” për periudhën maj-qershor 2009 dhe 399 artikuj për periudhën maj-qershor 2013, për të kuptuar përmes cila formave prodhohet kultura konfliktuale në median e shkruar. Për të krijuar një panoramë të plotë studimore, është studiuar ligjëritimi mediatik përmes kriterëve të personalizimit, konfliktualitetit dhe negativitetit. Studimi i 256 artikujve tek gazeta “Shekulli” në fushatën zgjedhore 2013, ka si objektivi identifikimin e burimeve kryesore që kanë pushtetin për të përcaktuar axhendën mediatike në raport me aktorët e tjerë politikë.

Të dhënat lehtësisht të kuptueshme dhe më të drejtpërdrejta që mund të mblidhen, janë vlerësimet e thjeshta sasiore mbi sasinë e artikujve sipas kategorive tematike të përfuara nga studimi i ligjëritimit mediatik dhe sasinë që i ofrohet secilit subjekt politik në media, duke parë në një këndvështrim më të gjerë se nga anon në përgjithësi shtypi i shkruar. Të dhënat sasiore na japin vetëm një pamje të situatës, prandaj përdoret edhe analiza cilësore e teksteve. Elementë të rëndësishëm në këtë aspekt janë tematikat, mënyra e prezantimit të ngjarjeve (historia, strukturimi), toni, burimet, leksiku, të studiuara në funksion të objektit të studimit.

1.5. Struktura e studimit

Studimi është organizuar në pesë kapituj kryesorë:

Kapitulli I: Merr në shqyrtim objektin e studimit, kriteret e rëndësishëm të objektit studimor, duke përfshirë edhe problematikat dhe vështirësitë e hasura gjatë kërkimit,

pastaj në vijim kalohet tek pyetja kërkimore e ngritur dhe tek teza kryesore, e cila është njëkohësisht përgjigje e pyetjes kërkimore.

Kapitulli II: Ngrihet mbi një analizë dhe hulumtim të literatures teorike, që është përzgjedhur në funksion të modelit teorik, nga ku burojnë argumentet kryesore, mbi të cilat do të mbivendosen gjetjet empirike dhe përfundimet e këtij studimi, prandaj çështje thelbësore mbeten ligjërimi mediatik, funksionet e medias, gjuha mediatike. Analiza kritike e ligjëritimit, synon të marrë në studim një problem shoqëror dhe të mbledhë të dhëna përmes ligjëritimit, në funksion të evidentimit të faktit, që strukturat në dukje neutrale nuk janë në të vërtetë të tilla.

Trajtimi teorik mbi ligjërimin mediatik, funksionet e medias, vlerat e lajmit dhe konfliktualiteeti, mbeten çështje thelbësore në analizën dhe hulumtimin e këtij punimi. Një çështje e rëndësishme është trajtimi teorik mbi a) identitetet partiake sipas dikotomisë e majtë/ e djathtë, e cila po aq sa vihet në pikëpyetje nga disa studiues, po aq dhe legjitimohet si një mjet i domosdoshëm për të analizuar programet dhe sjelljen politike të partive, si dhe b) kulturën politike konfliktuale dhe dinamikat e saj, duke u kthyer në një ndër elementët kryesorë, në këtë punim.

Kapitulli III, trajton kontekstin historik, mediatik dhe politik, si një element të domosdoshëm për objektin e studimit, referuar marrëdhënies dialektike që ekziston ndërmjet tyre. Studimi i ligjëritimit nuk zhvillohet pa e lidhur me kontekstin, në funksion të eksplorimit të marrëdhënieve të pushtetit të përfshira në ligjërim dhe lidhjes së tyre me kontekstin. Përcaktimi i modeleve të shtypit, fazat e zhvillimit të medias në Shqipëri pas viteve 1990 si dhe problematikat e shtypit shqiptar, janë çështje integrale të studimit. Për të njohur dhe kuptuar kontekstin merren në studim: Ndryshimet ekonomike dhe shoqërore ndër vite, elitat e kohës dhe roli i tyre, institucionet, historiku i zgjedhjeve parlamentare në Shqipëri pas vitit 1990, si dhe vlerësimet e ndërkombëtarëve, e roli i tyre.

Kapitulli IV, studion ligjërimin politik përmes fjalimeve të aktorëve politikë të dy partive kryesore, në zgjedhjet e vitit 2009 dhe 2013, përmes një analize cilësore dhe sasiore, që synon t'i kthejë përgjigje pyetjeve kërkimore të ngritura. Analiza e ligjëritimit

politik ndërtohet në raport me ideologjinë e majtë/ e djathtë, si dhe përmes strategjive të përdorura nga partitë politike: “Ne/ata”.

Kapitulli V, përmes një analize cilësore dhe sasiore të ligjërimit mediatik, përmes kryeartikujve dhe artikujve, ka si objektivi t’i kthejë përgjigje pyetjeve kërkimore dhe të vërtetojë hipotezën. Për efekt studimi e klasifikojmë ligjërimit mediatik, në median e shkruar sipas kategorive tematikore dominuese gjatë fushatës zgjedhore, të cilat na japin një panoramë të qartë, në raport me axhendën mediatike dhe karakteristikat e ligjërimit mediatik.

Përfundimet janë edhe përmbyllja e këtij studimi.

KAPITULLI II

Hulumtime të literaturës teorike

2.1. Analiza kritike e ligjërimit

Termet ligjërim dhe analizë ligjërimit janë terma që kanë përcaktime dhe përkufizime të ndryshme, pasi ato kanë tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve. Qasja strukturaliste “fokusohet në formën që merr gjuha, dhe në mënyrë të veçantë, si ligjërimit arrin cilësinë e të qenurit i unifikuar dhe kuptimplotë” (Richardson, 2007: 22), duke pasur karakteristika si kohezioni, struktura narrative, shkakësia dhe motivimi.

Qasja funksionaliste e studion ligjërimitin si gjuhë në përdorim, duke përfshirë aspektin shoqëror të gjuhës dhe kontekstin. Në analizën e ligjërimit sipas kësaj qasjeje gjuha përdoret për të thënë dhe për të bërë diçka, duke qenë e lidhur me kontekstin në të cilën përdoret.

Analiza kritike e ligjërimit është një qasje ndërdisiplinare, e cila adapton qasjen funksionaliste. E zhvilluar në fund të vitëve 1980, ajo është kthyer në një ndër fushat më me influencë të analizës së ligjërimit. Struktura teorike e saj mbështetet fuqishëm në teorinë gjuhësore të Halliday(1985), e cila është e lidhur kryesisht me marrëdhënien ndërmjet gjuhës dhe elementëve e aspekteve të tjera të jetës shoqërore, qasja e së cilës në raport me analizën gjuhësore të tekstit është gjithmonë e orientuar nga karakteri shoqëror i tekstit.

E zhvilluar vitet e fundit AKL shërben për të studiuar strukturën e ligjërimit në raport me strukturat shoqërore. Sipas Chouliaraki & Fairclough (1999), ajo ka për qëllim të demonstrojë që tiparet diskursive janë të lidhura në mënyrë sistematike me atë çfarë është duke ndodhur shoqërisht dhe çfarë është duke ndodhur shoqërisht në fakt është duke ndodhur pjesërisht ose plotësisht në mënyrë semiotike ose linguistike, ose të dyja bashkë.

Qëllimi kryesor i analizës kritike të ligjërimit, është lidhja ndërmjet analizës gjuhësore me analizën shoqërore, duke e studiuar nga këndvështrimi i rolit që luan gjuha në prodhimin dhe riprodhimin e jetës shoqërore, atëherë si rrjedhojë ajo luan rol dhe në

prodhimin dhe riprodhimin e pabarazive shoqërore. Analiza kritike e ligjërimit në funksion të kësaj marrëdhënie thekson që jo të gjithë kanë të njëjtin pushtet përse i përket mundësisë së aksesit kundrejt burimeve linguistike dhe shoqërore. Këto burime mund të japin një sërë pasojash përse i përket marrëdhënieve jo të barabarta të pushtetit, prezantimit përmes tekstit në një mënyrë të caktuar dhe jo neutrale. Në funksion të kësaj lidhjeje, qëllimi i analizës kritike të ligjërimit është “investigimi në mënyrë kritike i pabarazive shoqërore, të shprehura, të sinjalizuara, të ndërhuara, të legjitimuara përmes gjuhës së përdorur” (Wodak & Meyer, 2001: 2).

Analiza kritike e ligjërimit e studion ligjërimin si një praktikë shoqërore, e cila nënkupton një marrëdhënie dialektike mes strukturës së ligjërimit dhe strukturës shoqërore. E zhvilluar si teori dhe metodologji njëherësh nga profesionistë të fushave të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme, ajo synon të marrë në studim një problem shoqëror dhe të mbledhë të dhëna përmes ligjërimit në funksion të evidentimit të faktit, që strukturat në dukje neutrale nuk janë në të vërtetë të tilla.

Sipas Van Dijk (1988) AKL është e interesuar në analizën e ligjërimit për të zbuluar burimet diskursive të pushtetit, dominimit, pabarazisë dhe paragjyqimeve dhe si këto burime iniciohen, ruhen, riprodhohen, dhe transformohen brenda kontekstit të veçantë social, ekonomik, politik dhe historik. Studimi i ligjërimit nuk zhvillohet pa e lidhur me kontekstin, në funksion të eksplorimit të marrëdhënieve të pushtetit të përfshira në ligjërim dhe lidhjes së tyre me kontekstin. Burimet në lidhje me pushtetin, dominimi, paragjykimi, pabarazitë lindin, zhvillohen, riprodhohen, ndryshohen, duke u analizuar në funksion të kontekstit.

Sipas analizës kritike të ligjërimit, lidhja ndërmjet ligjërimit dhe shoqërisë vjen përmes studimit të ligjërimit në lidhje me kontekstin dhe pushtetin në lidhje me ligjërimin. Referuar Van Dijk: “Ne kemi nevojë për perceptimin e së tërës, të kontekstit kompleks në mënyrë që të dimë se si pushteti është i lidhur me tekstin dhe bisedën, dhe më përgjithsisht se si ligjërimi riprodhon strukturat shoqërore” (2008, vii).

Jo të gjitha grupet janë njësoj të fuqishme, janë grupet me pushtetin më të madh të cilët tentojnë të ndërtojnë ligjërimin në mënyrë të tillë që të krijohet ideja që ideologjia dominuese të merret si e mirëqënë. Për një ndër studiuesit kryesorë në studimin e

ideologjisë, Louis Althusser (2014:256), ideologjia është praktike, sepse ajo nuk ekziston në 'botën e ideve' por në institucione dhe në praktikat specifike të tyre pasi ideologjia është një 'përfaqësim' i marrëdhënies imagjinare të individëve në kushtet e tyre të vërteta të ekzistencës.

Në funksion të qasjes që ligjërimi është patjetër ideologjik, AKL evidenton probleme shoqërore dhe analizon ligjërimin si një element, që ndërtohet nga strukturat shoqërore dhe i ndërton ato. "Analiza kritike e ligjërimin na bën të aftë ne të investigojmë dimensionin ligjërimor të abuzimit me pushtetin i cili lidhet me padrejtësitë dhe pabarazitë" (Flowerdew, Li & Tran, 2002: 323).

Analiza kritike e ligjërimin, si një qasje ndërdisiplinare ku përfshihen disiplina të ndryshme, gjuhësore, teori kritike, shoqërore etj, karakterizohet nga disa parime kryesore:

- *AKL lidhet me problemet shoqërore. Ajo nuk lidhet me gjuhën ose përdorimin e gjuhës në vetvete, por me karakterin gjuhësor të shoqërisë dhe proceset kulturore dhe strukturat.*
- *Marrëdhëniet e pushtetit kanë të bëjnë me ligjërimin dhe AKL studion forcën në ligjërim.*
- *Shoqëria dhe kultura janë të lidhura në mënyrë dialektike me ligjërimin: shoqëria dhe kultura formohen nga ligjërimi dhe në të njëjtën kohë përbëjnë ligjërimin. Çdo shembull i vetëm i përdorimit të gjuhës riprodhon ose transformon shoqërinë dhe kulturën, duke përfshirë lidhjet e pushtetit.*
- *Përdorimi i gjuhës mund të jetë ideologjik. Për ta përkufizuar këtë është e nevojshme që të analizohen tekste për të investiguar interpretimin, pritjen dhe efektet shoqërore.*
- *Ligjërimet janë historike dhe mund të kuptohen vetëm në lidhje me kontekstin. Në një nivel metateorik kjo korrespondon me përjashtjen e Wittgenstein sipas të cilës kuptimi i një shprehje qëndron në përdorimin e saj në një situatë të caktuar.*
- *Analiza e ligjërimin është interpretuese dhe shpjeguese. Analiza kritike sugjeron një metodologji sistematike dhe një lidhje mes tekstit dhe kushteve të saja shoqërore, ideologjive dhe lidhjeve të pushtetit. (Titscher & al, 2000:146).*

Duke iu referuar këtyre principeve mund të theksojmë se analiza kritike e ligjërimin mbështetet në disa pika të rëndësishme si: "Karakterit i përbërë dhe (ri) krijues i ligjërimin, pushteti dhe lidhja shoqërore në ligjërim, ideologjia dhe hegjemonia" (Richardson, 2007:27).

2.1.1. Ligjërimi, ideologjia dhe pushteti

Një ndër teoricienët kryesorë në studimin e ligjërimit është Michel Foucault, i cili është i mendimit se i ka shtuar kuptimet e ligjërimit, “duke e trajtuar atë ndonjëherë si fushë e përgjithshme e të gjitha deklaratave, nganjëherë si një grup individualizues i deklaratave, dhe nganjëherë si një praktikë e rregulluar që përbën një numër deklaratash”(Foucault, 1972: 80), ku theksohet se ligjërimet nuk janë mjete neutrale në analizimin e botës shoqërore, pasi ato ndërtojnë, rregullojnë dhe formësojnë identitetet dhe praktikatat e subjekteve (njerëzve).

Për drejtuesin e qendrës së “Studimeve Kulturore”, Stuart Hall (1997:6), ligjërimet janë mënyra të referuarit ose të ndërtuarit e njohurive rreth një temë të veçantë të praktikës, një grup idesh, imazhesh dhe praktikash, të cilat na sigurojnë mënyrat e të folurit, format e njohurive dhe përcillen të shoqëruara me një temë të veçantë, në shoqëri. Këto sisteme komunikimi janë të rëndësishme në raport me formimin e subjektivitetit njerëzor dhe realitetit shoqëror dhe mund të kthehen në një vend ku përplasen grupet e ndryshme shoqërore.

Studiuesit e shquar të AKL si Fairclough, Van Dijk, Wodak, të cilët janë influencuar nga puna e Foucault përsa i përket lidhjeve të pushtetit, rreth të ligjërimit dhe marrëdhënies pushtet-njohuri, fokusohen tek: Lidhja dialektike ndërmjet ligjërimit dhe shoqërisë. Ligjërimi sipas Fairclough dhe Wodak, përkufizohet: “...Si një formë e praktikës shoqërore. Të përshkruash ligjërimin si një praktikë shoqërore sugjeron një lidhje dialektike ose dy mënyrëshe, ngjarja ligjërimore formohet nga situatat, institucionet dhe strukturat sociale, por ajo gjithashtu i formon ata” (1997: 55). Ndërsa për studiuesin tjetër të AKL, Van Dijk, “ligjërimi është një tekst brenda një konteksti, por gjithashtu edhe një aksion dhe proces, ku të dhënat gjenden tek analiza empirike”(Van Dijk, 1977: 3).

Në qoftë se bëjmë një dallim ndërmjet tipeve të ligjërimeve mund të themi që ligjërimi gazetaresk është një ndër format më të fuqishme të ligjërimeve, pasi mund të sjellë ndryshime “përmes formimit të kuptimeve, influencimit, qëndrimeve të audiencës dhe besimeve (veçanërisht përmes përforcimit të tyre) dhe transformimit e vetëdijes së atyre që e lexojnë dhe e konsumojnë atë” (Richardson, 2007:28).

Gjatë analizës së ligjërimit mund të evidentojmë këto faza kryesore: prodhimi, konsumimi dhe të kuptuarit e ligjërimit, ku secila nga këto faza influencohet nga pushteti dhe lidhjet shoqërore. Grupet me influencë mund të ushtrojnë pushtet në forma të ndryshme, por në ligjërimin gazetaresk kjo realizohet jo përmes detyrimit, por përmes krijimit të një imazhi që paraqitetet si konsensual.

Për ta bërë më të qartë do ti referohemi Lukes (1974), i cili shpjegon konceptin e forcës dhe pushtetit, ku forma e parë dhe më e thjeshtë është që të kesh pushtet mbi tjetrin në mënyrë që të bëjë diçka që ai s'do ta bëjë, duke kaluar përmes një vendimarrje të qartë. Këtu duhet përfshirë edhe përpjekja që individi apo grupi me pushtet ndërmerr në krijimin dhe forcimin e vlerave në kuadrin shoqëror, politik, institucional, në mënyrë që procesi politik të mos sjellë në vëmendje ngjarje të dëmshme për të, pasi në këtë pikë është e rëndësishme të theksohet se pushteti influencon në mbajtjen të fshehtë, asgjësimin, mospërfshirjen në arenën e vendimarrjes kërkesat për ndryshimin e saj, duke mbrojtur interesat e veta dhe duke krijuar iluzionin e konsensusit.

Në strukturimin e sistemit, kryesore mbetet struktura shoqërore dhe kulturore, praktikat institucionale dhe jo veprimet individuale. Për ta përmbledhur autori argumenton që “A ushtron forcë mbi B kur A ndikon B në një mënyrë ndryshe nga interesat e B” (Lukes, 1974:34), e cila realizohet përmes ligjërimit dhe ideologjisë.

Ideologjia është një ndër konceptet kryesore të trajtuara në AKL, e cila i referohet studimit të Althusser dhe impaktit që pati puna e tij përgjatë viteve, ku paraqiten këndvështrimet e tij mbi ideologjinë ndërmjet studimit të marrëdhënieve mes shtetit dhe subjektit (shtetit dhe qytetarëve): Si një studiues marksist, ai e vlerëson marrëdhënien mes shtetit dhe qytetarëve dhe bindjen e këtyre të fundit kundrejt ligjeve dhe rregullave edhe nëse kjo nuk është në të mirë të tyre, si rrjedhojë e përkatësisë klasore, përmes dy formave: Aparateve shtetërore shtypëse dhe atyre ideologjike. Nëse të parat ku përfshihen policia apo sistemi i burgjeve kanë pushtet për të ndikuar në sjelljen e qytetarëve, në përputhje me “interesat e klasave sunduese” (Althusser, 2014:239), aparatet shtetërore ideologjike si familja, kisha, media, partitë politike, arti etj, janë institucione të cilat gjenerojnë ideologji që përvetësohen nga qytetarët, edhe pse formalisht janë jashtë kontrollit shtetëror, ato shërbejnë për të ruajtur rendin ekzistues në shoqëri.

Duke pasur parasysh faktin që është 'klasa sunduese' e cila mban pushtetin, pasi ka në dispozicion aparatet shtetërore shtypëse, ne mund të pranojmë faktin që kjo kategori sunduese është aktive dhe në aparaturat shtetërore ideologjike sepse "asnjë klasë nuk mund të mbajë pushtet shtetëror gjatë një periudhe të gjatë pa ushtruar në të njëjtën kohë hegjemoni mbi dhe në aparatet shtetërore ideologjike" (Althusser, 2014:245).

Fairclough i përkufizon ideologjitë si: "Prezantim të aspekteve të botës që mund të tregohen, për të kontribuar në ndërtimin, mbajtjen, dhe ndryshimin e marrëdhënieve shoqërore të pushtetit, dominimit" (Fairclough, 2003:9), këndvështrim i cili ndryshon nga qasja përshkruese e cila i studion ideologjitë si besime, vlera, zakone të cilat nuk vlerësojnë lidhjet e pushtetit dhe dominimit.

Në punën e saj media ka një rol të rëndësishëm në mënyrën se si transformon një ngjarje në lajm, duke i'u referuar stilit të të shkruarit, sepse stili nuk është i shkëputur nga ideologjia, pasi kodimi i mesazhit në artikull do të bëhet në mënyrë të tillë, që të mos rezultojë i panjohur për lexuesin, në mënyrë që të krijojë një marrëdhënie konsensuale mes lexuesit dhe personit që shkruan lajmin.

Koncepti më i rëndësishëm në funksion të ideologjisë është hegjemonia e zhvilluar nga Antonio Gramsci: Në veprën e Gramscit (1971), filozofit italian marksist, politika vlerësohet si një luftë për hegjemoninë, një mënyrë e veçantë e konceptualizimit të pushtetit, që arrihet mes tjerash përmes konsensusit, dhe ku ideologjia zë një vend të rëndësishëm në ruajtjen dhe mbajtjen e marrëdhënieve të pushtetit, pasi për të ruajtur konsensusin e domosdoshëm, elitat e një shoqërie duhet të punojnë në mënyrë të vazhdueshme, për të mos humbur pushtetin e tyre. Gramsci përta i përket sundimit ideologjik të klasave sunduese, është i mendimit se hegjemonia ushtrohet përmes intelektualëve, institucioneve që përhapin ideologjinë e saj, dhe në këtë mënyrë klasa sunduese merr miratimin nga të tjerët, duke arritur konsensusin e nevojshëm, që qytetarët të miratojnë sistemin dhe rolin e tyre brenda sistemit. Sipas kësaj teorie roli i medias në këtë proces është i madh, sepse: "Mediet janë mjetet që përdorin elitat qeverisëse për të përjetësuar pushtetin dhe statusin e tyre, (duke e popullarizuar) filozofinë, kulturën dhe moralin e tyre" (Boggs, 1976: 39).

Media përmes publikimit të informacioneve në mënyrë të vazhdueshme, jo thjesht vetëm raporton:

“... Hegjemonia tregon se si superiorët fabrikojnë dhe ruajnë mbështetjen për dominimin e tyre mbi inferiorët nëpërmjet propagandimit dhe shumëfishimit të informacionit që favorizon interesat e tyre dhe se si nga ana tjetër inferiorët e pranojnë ose e kundërshtojnë këtë informacion” (McNair, 2009: 71).

Sipas kësaj qasje mediet janë institucione që shërbejnë për të ruajtur superioritetin e klasës sunduese apo thënë ndryshe hegjemoninë, përmes propagandimit, informacionit favorizues, si dhe mënyrës se si media transformon një ngjarje në lajm.

2.1.2 Analiza kritike e ligjërimit e Fairclough

Fairclough është një ndër studiuesit kryesorë të AKL, i cili ndërtoi një teori shoqërore të ligjërimit, duke kontribuar kështu në pasurimin e AKL: Për Fairclough (2003), AKL u zhvillua si një përgjigje ndaj ndarjes tradicionale midis studimeve që fokusohen tek gjuha e teksteve dhe fushave të tjera të shkencave shoqërore, ku njëra palë priret të analizojë tekstet pa përfshirë kontekstin, ndërsa pala tjetër priret të mos analizojë tekstet. Analiza e tij klasifikohet si analizë ligjërimit e orientuar nga teksti, duke i'u referuar teorisë gjuhësorë të Halliday (1985), qasja e së cilës në raport me analizën gjuhësore të tekstit, është gjithmonë e orientuar nga karakteri shoqëror i tekstit.

Fair “Analiza e ligjërimit e cila synon të hulumtojë në mënyrë sistematike marrëdhëniet shpesh të paqarta të shkakësisë dhe të vendosmërisë ndërmjet teksteve, praktikave diskursive dhe strukturave më të gjera shoqërore dhe kulturore; dhe të hetojë se si këto praktika, ngjarje dhe tekste lindin dhe formohen në mënyrë ideologjike nga marrëdhëniet e pushtetit dhe luftën mbi pushtetin; dhe të eksplorojë se si padepërtueshmëria e këtyre marrëdhënieve midis ligjërimit dhe shoqërisë është në vetvete një faktor që siguron pushtet dhe hegjemoni”
(Fairclough, 1995a: 132)

clough e përkufizon AKL si:

Fairclough strukturoi studimin e ligjërimit përmes një strukturë tredimensionale, sepse analiza e Fairclough ndërtohet përmes analizës së tekstit (ligjërimit si tekst), analizës së praktikave diskursive (ligjërimit si praktika diskursive) dhe analizës së marrëdhënies dialektike ndërmjet ligjërimit dhe shoqërisë (ligjërimit si praktika shoqërore), të cilat shpesh është e vështirë që t'i studiosh ndarazi sepse integrohen tek njëra-tjetra. Sipas autorit “ata janë elementë të ndryshëm por jo elementë të ndarë plotësisht në mënyrë

diskrete” (Fairclough, 2000: 122), prandaj dhe në këtë studim këto elementë është e vështirë t’i studiosh të ndarë prerazi.

Studimi i tekstit në këtë punim do ndjekë logjikën e Fairclough (2003: 129), sipas të cilit: Në studimin e tekstit është i rëndësishëm identifikimi i aspekteve kryesore të botës të riprezantuara në tekst përmes temave kryesore dhe identifikimi i këndvështrimeve dhe perspektivave të veçanta përmes të cilave ata riprezantohen, duke përdorur metodën krahasuese ndërmjet teksteve të ngjashme.

Sipas Fairclough (1995a: 104), analiza e tekstit duhet bërë duke i’u referuar dy aspekteve kryesore të tekstit, strukturimit të propozimeve (propositions) dhe kombinimit të tyre. Analiza në funksion të strukturimit të propozimeve në të shumtën e herëve bazohet tek analiza e leksikut, ndërsa studimi i kombinimit të tyre duke i dhënë tekstit kuptimin e një njësie të strukturuar analizohet në një nivel më makro, përmes narrativës, prandaj narrativa dhe leksiku në këtë studim, janë elementë thelbësorë për të studiuar tekstin.

Në strukturën tredimensionale të Fairclough, praktikat diskursive lidhen me proceset e prodhimit dhe të konsumimit të tekstit, praktikat profesionale (etika) dhe praktikat organizacionale (përmes vlerave të lajmit dhe intertekstualitetit), prandaj me rëndësi për këtë pjesë të analizës janë prodhuesit, gazetarët dhe vendimet e tyre në raport me prodhimin e tekstit si dhe lexuesit që konsumojnë tekstin: Kjo shërben për të kuptuar që procesi fillon me kodimin që përcaktohet nga prodhuesit prandaj gazetaret e përzgjedhura, në këtë studim i përkasin grupeve mediatike të ndryshme, që kanë interesa dhe ideologji të ndryshme. Fairclough i referohet modelit të zhvilluar nga Hall i cili njihet si modeli i kodimit dhe dekodimit:

Kontributi i qëndrës së “Studimeve Kulturore” dhe drejtuesit të saj për shumë vite Stuart Hall, lidhet me risinë në raport me interpretimin që audienca, publiku i bën tekstit që serviret nga media, duke pranuar që njerëzit mund të mos pranojnë, biles të kundërshtojnë mesazhet e medias, prandaj modeli i zhvilluar nga Hall trajton kodimin dhe dekodimin duke përfshirë fazat e prodhimit, qarkullimin, shpërndarjen, konsumin dhe riprodhimin. “Hall inkorporon nocionin e prodhimit, që është esenciale për analizën e masmedias si entitete përmbajtje-prodhuese, në një kuadër Enkodimi/Dekodimi”

(Katz et al, 2009: 400), ndërsa thekson se procesi i dekodimit mund të mos jetë në përputhje me atë që synojnë prodhuesit tek procesi i kodimit (mediat prodhojnë mesazhin), pasi marrësit e mesazhit mund të dekodojnë në mënyra të ndryshme. Sipas Hall (1980: 136-138), mesazhi mund të dekodohet sipas kodit dominues duke ruajtur pozitën hegjemonike dominuese, sipas kodit negociues që konsiston në pranimin e ideologjisë dominuese përveçse në disa raste, dhe sipas kodit kundërshtues, në asimetri të plotë me kodimin, duke kundërshtuar në këtë mënyrë ideologjinë mbizotëruese.

Elementi i tretë në strukturën e zhvilluar nga Fairclough është studimi i praktikave shoqërore, që shqyrton lidhjen dialektike mes gazetarisë dhe shoqërisë, të cilat ndikojnë njëra-tjetrën: Sipas Richardson (2007: 114-115) kur analizojmë praktikat sociale të ligjërimit, ne kemi nevojë që të marrim parasysh: praktikat ekonomike- në raport me mënyrën e prodhimit, audiencën, praktikat politike- si strukturimi i influencës së institucioneve politike e ligjore dhe praktikat ideologjike- si roli i gazetarisë në shpërndarjen dhe mbështetjen e vlerave sociale. Me gjithë pushtetin që ka shoqëria për të influencuar në punën e gazetarëve përmes strukturave të saj, edhe gazetarët mund të influencojnë shoqërinë, duke prodhuar dhe riprodhuar realitetet shoqërore përmes ruajtjes apo transformimit të besimeve sociale, sepse “artikulimi dhe riartikulimi i rendit të diskursit është përkatësisht një pjesë e luftës hegjemonike” (Fairclough 1992a: 93), prandaj në koherencë me qëllimin e AKL për të kuptuar rolin e ligjërimit në raport me ruajtjen apo transformimin e pabarazive sociale, praktika ideologjike dhe politike, të trajtuara përmes identifikimit të burimeve dhe rolit të tyre, marrin një rëndësi të veçantë në këtë punim.

2.2. Teoria e përcaktimit të axhendës

Studimi i efekteve të medias, ka intriguar mjaft teoricienë të cilët, përmes studimeve të tyre kanë lëvizur mes ekstremiteve, duke filluar nga modeli i shiringës hipodermike e deri tek efektet e kufizuara të medias në raport me opinionin publik, prandaj historia e teorive që studiojnë efektet e medias, i referohet forcës që këto efekte kanë. Nëse do ti referohemi fazave të tyre, sipas Littlejohn dhe të tjerë (2017: 158-159), mund të ndërtojmë një tablo si më poshtë:

Faza e parë (1944-1963): E karakterizuar nga "teoritë e bindjes", sugjeron që media ka efekte direkte mbi audiencën, aq sa modeli mund të përshkruhet si modeli i shiringës hipodermike.

Faza e dytë (1944-1986): Përfshin "teoritë e audiencës aktive" dhe fokusohet në një audiencë më aktive e cila selekton atë që është ekspozuar dhe bën zgjedhje se si të përdorin mediat.

Faza e tretë (1955-1983): I kushtohet "teorive të kontekstit shoqëror" dhe thekson rolin e rrjeteve ndërpersonale për formimin e efekteve.

Faza e katërt (1933-1978): Fokusohet në "teoritë shoqërore dhe mediale" dhe shikon efektet afatgjata të akumuluarra të mediave në shoqëri dhe institucione. Teoria e kultivimit, është një shembull i kësaj faze dhe është zhvilluar për të shpjeguar ndikimin e fuqishëm të televizionit tek audiencat.

Faza e pestë (1972- 1987): Përbëhet nga "teoritë e efekteve interpretuese" dhe përfshin teoritë që vëzhgojnë në sferën dhe strukturën e qëndrimeve që rezultojnë nga mediat, si teoria e përcaktimit të axhendës dhe e kornizimit mediatik.

Kontributi i autorëve që zhvilluan teorinë e përcaktimit të axhendës në raport me efektet e medias, vlerësohet pasi vjen pas punimit "Influenca Personale" (1955) të Lazarsfeld në bashkëautorësi me Katz: Teoria e fluksit të komunikimit e zhvilluar në dy nivele nga këta autorë, mbërrin në përfundime që zgjedhjet ndikohen shumë më tepër nga liderët e opinionit publik sesa nga vetë mediat, pasi efektet e mediave janë të kufizuara.

Teoria e përcaktimit të axhendës thekson dy pika të rëndësishme përse i takon pushtetit që ka media e shkruar dhe mënyrës së zgjedhjes nga njerëzit si rezultat i lirisë që ata kanë, ku axhenda mediatike shërben si shkak për të orientuar mbi perceptimet e publikut, e studiuar si pasojë.

Teoria e përcaktimit të axhendës, edhe pse e paemërtuar në këtë formë mund të themi që fillesat e saj i ka më të hershme se studimi i McCombs dhe Shaw, pasi ajo mund të gjurmohet në studimin e hershëm të Walter Lippman, me titull "Opinion Public", në të

cilin argumentohet që mediat masive janë lidhja kryesore midis ngjarjeve në botë dhe imazheve në mendjet e publikut.

Për studiuesin Lippman, publiku nuk i përgjigjet ngjarjeve aktuale në mjedis por'fotografive në kokat tona' të cilat i quan pseudo-mjedis, sepse mjedisi i vërtetë është i madh, kompleks dhe shumë i largët për njohje të drejtëpërdrejtë:

"... Ne nuk jemi të pajisur për t'u marrë me kaq shumë hollësi, shumëllojshmëri, ndryshime dhe kombinime... Ne bashkarisht duhet të veprojmë në këtë mjedis, ne duhet ta rindërtojmë atë në një model më të thjeshtë përpara se ta menaxhojmë" (1998: 16).

Ky model i thjeshtuar na ofrohet nga media përmes përcaktimit të axhendës, edhe pse Lippman nuk e emërton në këtë mënyrë.

Teoria e përcaktimit të axhendës që u zhvillua nga McCombs dhe Shaw, fillimisht u përqëndrua tek efektet që ka media në lidhje me opinionin publik: Tematikat e përcaktuara si të rëndësishme në axhendën mediatike, perceptohen si të rëndësishme edhe nga opinionin publik. "... Kjo teori, tregoi korrelacione të forta mes mediave masive, hapësirës dhe sasisë së mbulimit të çështjeve politike me përgjigjet publike ndaj këtij informacioni..." (Littlejohn&Foss, 2009:759). Paradigma e saj qëndron në aftësinë që kanë mediat: "Që të transferojnë interesin për çështjet nga axhenda e tyre informative tek axhenda e publikut" (Griffin&al, 2015:372).

Studiuesit McCombs dhe Shaw studiuuan këtë marrëdhënie, duke u përqëndruar tek fushatat elektorale, ku si hap i parë ishte studimi i asaj se çfarë ka vendosur media të bëjë pjesë të axhendës së vet, si dhe analiza kuantitative përse i përket përcaktimit të rëndësisë së lajmit, në lidhje me hapësirën dhe vendosjen që zë ai në median e shkruar, apo kohën që zë në median vizive.

Për të mbështetur lidhjen shkak- pasojë, midis përcaktimit të axhendës mediatike si shkak dhe axhendës së publikut si pasojë, Griffin sjell shembuj të ndryshëm, duke i'u referuar studimeve kërkimore të zhvilluara mbi këtë marrëdhënie: Rezultatet tregojnë një element interesant që legjitimon këtë marrëdhënie, por duke theksuar gjithashtu një element që lidhet me kohën, pasi axhenda mediatike dhe axhenda e votuesve, nuk ndërveprojnë duke qenë thjesht reflektime të realitetit.

Me interes në funksion të teorisë është pjesa e studimit që përfshin klasifikimin e publikut në individë të cilët mund të reagojnë në mënyra të ndryshme, pasi jo të gjithë do të reagojnë njësoj. Për ta kuptuar më mirë këtë duhet të kemi parasysh individët, të cilët i referohen medias në funksion të orientimit dhe indeksit të kuriozitetit: “Që media të formësojë pikëpamjet e tyre të motivuara nga nevoja për të qenë të orientuar” (Po aty: 375). Në kuadër të studimeve të dy teoricienëve mbi sjelljen e publikut në raport me përparësitë që thekson media në axhendën e saj, janë përjashtuar votues të cilët ishin të sigurtë dhe janë përfshirë individë më të pavendosur, pikërisht për të kuptuar funksionin e mësipërm orientues.

Një përpunim i kësaj teorie është në lidhje me rolin e medias, në të cilin theksohet se media jo vetëm tregon për çfarë të mendojmë, por dhe si të mendojmë, pasi luan rol influencues në mënyrën se si mendojmë. Këtu përfshihet elementi i kornizimit mediatik, si “ideja qendrore organizuese për përmbajtjen e lajmeve, e cila e vendos atë në një kontekst dhe i jep asaj qenësi duke përdorur përzgjedhjen, theksimin, përjashtimin dhe përpunimin” (Po aty).

Ky përcaktim na ndihmon të kuptojmë që media jo vetëm ka në dorë të përzgjedhë mbi çfarë do të shkruajë, por edhe mënyrën që do të përzgjedhë për të specifikuar karakteristikat kryesore, që lidhen me atë subjekt që e mendon të rëndësishëm për ta përfshirë në axhendën e saj, duke iu referuar strukturimit.

*“Të strukturosh do të thotë të përzgjedhësh disa aspekte të një realiteti të perceptuar dhe t’i bësh ato më tërheqëse në një tekst komunikimi, në mënyrë të atillë që çështja të përkufizohet në mënyrën që duam ne, të interpretohet në mënyrë shkakësore, të ofrohet vlerësim moral ose të jepet një trajtim me rekomandime rreth subjektit të përshkruar”
(Po aty: 377).*

Media jo vetëm kryen funksionin se për çfarë të mendojmë, por edhe influencon mënyrën se si të mendojmë, çfarë të mendojmë. Studimet për të mbërritur tek ky rezultat, tregojnë që mënyrat e strukturimit nga media, duke iu referuar karakteristikave specifike të përzgjedhura ndikojnë publikun.

Studime të ndryshme të kryera gjatë periudhave elektorale mbi rolin e medias, tregojnë që është e pamundur të mendosh një lajm të pastrukturuar, prandaj duke iu referuar strukturimit të lajmit, interes për ne shfaqin karakteristikat ku përfshihen atributet

personale të aktorëve politikë, të cilat tregojnë se çfarë ka vendosur të përzgjedhë dhe të theksojë media në raport me ta, për të dërguar tek publiku.

Një faktor i rëndësishëm për këtë studim është përgjigjja e pyetjes: Kush e përcakton axhendën mediatike? Ekspertët që merren me studimin e medias e dinë që jo çdo ngjarje kthehet në lajm, duke u bërë pjesë e axhendës mediatike, pasi një sërë arsyesh ndikojnë në këtë pikë, ku përfshihen dhe vlerat e lajmit të cilat do të trajtohen më gjerë. Në këtë moment na intereson të kuptojmë që elita mediatike luan një rol thelbësor në raport me axhendën, sepse ajo “nuk përcaktohet asnjëherë pa ndërhyrjen e konkurrencës ndërmjet disa njerëzve të caktuar” (Griffin&al: 380), pasi këta njerëz kanë influencë për të përcaktuar axhendën dhe për të shërbyer si pikë referimi edhe për mediet e tjera, kur vendosin të publikojnë një lajm të rëndësishëm.

Si përcaktues të axhendës mediatike gjithashtu, klasifikohen edhe vetë kandidatët politikë, që konkurrojnë ndërmjet tyre gjatë fushatave elektorale, pasi përmes strategjive që ato përzgjedhin, arrijnë të tërheqin vëmendjen e medias.

Aktorët politikë me objektiva politike, si partitë politike, apo organizata të tjera, dallojnë nga njëra-tjetra në raport me pushtetin që kanë, pasi jo të gjitha partitë janë njëlloj të rëndësishme në arenën politike. Nëse i referohemi një analize krahasuese aktorët politikë kryesorë dallojnë nga të tjerët, nga kapitali financiar që zotërojnë, i cili mundëson dhe përcaktimin e axhendës nëpërmjet krijimit të lajmeve, si dhe nga kapitali kulturor, i mbështetur tek autoriteti dhe besueshmëria.

“...Për Hall dhe të tjerë, këta të parët për arsye të aksesit të tyre të privilegjuar në kanalet e komunikimit masiv, fitojnë statusin e përcaktuesve parësorë në debatin publik për çështjet aktuale. Interpretimet e tyre mbi ngjarjet, sistemi i tyre shpjegues brenda të cilit këtyre ngjarjeve u jepet një kuptim bëhen konsensuale, ndërsa shpjegimet dhe vlerësimet alternative përjashtohen ose flaken në qoshe me legjitimitet të mohuar” (McNair, 2009: 158).

Raporti që ndërtohet ndërmjet aktorëve politikë dhe medias është i diferencuar si pasojë e faktorëve të sipërmendur, apo thënë ndryshe si pasojë e pushtetit, pasi faktori kulturor (besueshmëria dhe autoriteti i burimeve), si dhe faktori organizativ i mbështetur tek nevoja e vazhdueshme për lajme dhe presioni i kohës për të respektuar afatin e dorëzimit na drejtojnë drejt premisë që media “... Mbron një model me akses të strukturuar, të diferencuar të saj, duke favorizuar ata në elitë ose në pozicionet dominante dhe duke diskriminuar grupet anësore ose vartëse...” (McNair, 2009: 158).

Modeli me akses të diferencuar i medias mund të përliqet nëse studiojmë axhendën dhe ligjërimin mediatik në mjaft raste, megjithatë nuk është e pamundur që ky model të mos ndryshojë, duke iu referuar karakteristikave të medias që deri tani nuk i cekëm dhe strategjive që mund të përdorin aktorët politikë jo kryesorë. Media mes tjerash është një biznes konkurrues për të siguruar të ardhura materiale, prandaj nëse ka informacione të vlefshme nga aktorë politikë jo kryesorë, ajo do të jetë e gatshme që t'i përfshijë në axhendën e saj.

Përveç sa thamë më lart, janë edhe profesionistët e marrëdhënieve me publikun, të cilët përdorin mjete si deklarata për shtyp apo komunikata, të cilat shërbejnë si burime të rëndësishme për gazetarët. Lidhja gazetar-profesionist i marrëdhënieve me publikun karakterizohet nga interesi i dyanshëm ndërmjet tyre: Profesionistët e marrëdhënieve me publikun kërkojnë të përcjellin mesazhet e tyre përmes medias, ndërsa nga ana tjetër media kërkon lajme të cilat të plotësojnë kritere të caktuara dhe t'i përcillen publikut, duke mbushur hapësirën e nevojshme për publikimin e gazetës, prandaj deklarata, komunikata, konferenca të këtyre organizatave dhe institucioneve, janë të pranishme në numrat e gazetave.

Littlejohn dhe të tjerë (2017:162-163), sugjerojnë që janë katër tipe marrëdhëniesh pushteti ndërmjet medias dhe burimeve të tjera:

- Pushtet i madh i burimeve dhe pushtet i madh i medias, të cilat përcaktojnë në mënyrë të barabartë axhendën mediatike
- Pushtet i madh i burimeve dhe pushtet i vogël i medias, burimet përcaktojnë axhendën e medias
- Pushtet i vogël i burimeve dhe pushtet i madh i mediave, mediat ndërtojnë vetë axhendën e tyre dhe mund të marginalizojë burimet
- Pushtet i vogël i burimeve dhe pushtet i vogël i mediave, të dyja janë të pafuqishme për të ndërtuar axhendën publike

Sipas Littlejohn&Foss (2009: 759), hulumtimet e fundit identifikojnë disa parime shtesë mbi marrëdhëniet e burimeve të medias, mesazhet strategjike dhe efektet e audiencës: Elitat politike ndihmojnë për të përcaktuar axhendën e ditës për

mbulimin e medias; Drejtuesit e medias (redaktorët dhe prodhuesit) marrin vendime rreth hapësirës dhe sasisë së mbulimit; Suksesi i mediave në të treguarit se çfarë idesh politike të mendosh gjithashtu ndikon në atë që mendojnë njerëzit; Burimet e mediave përdorin kornizimin mediatik për të shtrembëruar dhe thjeshtuar lajmet politike, Kornizimi i lajmeve rrit rëndësinë e ideve dhe aktorëve të caktuar politikë dhe në të njëjtën kohë zvogëlon, injoron ose dëmton njerëz të tjerë, çështje dhe politika.

2.3. Narrativa e tekstit

Narrativa është një koncept i vështirë për tu përcaktuar me anë të një përkufizimi, si rrjedhojë e përdorimeve të ndryshme, por ne sipas Genette, do e përkufizojmë si “ligjërim i folur ose i shkruar që merr përsipër tregimin e një ngjarjeje ose seri ngjarjesh” (1980: 25) dhe riprezantimin e saj/e tyre.

Sipas Richardson i cili mbështetet tek Martin:”Narrativa konsiderohet si një formë argëtimi kur studiohet si literaturë dhe është një fushë betejash kur aktualizohet në gazeta, biografi dhe histori” (2007:74).

Narrativa nuk është një koncept i ri i përpunuar vetëm në kohët e sotme, pasi ajo daton që me studimet e Aristotelit. Sipas tij narrativa përbëhet nga tre pjesë: fillimi, mesi dhe fundi. Midis këtyre fazave ekziston marrëdhënia e shkakësisë, e cila influencon këto etapa, në mënyrë që rezultati i secilës nga këto etapa lidhet me tjetrën. Studimi mbi strukturën narrative thekson që ajo duhet të përmbajë të paktën, një veprim dhe një vlerësim. Vlerësimi është elementi më i rëndësishëm i narrativës, sepse tregon për mënyrën se si gazetari dëshiron që historia të interpretohet, duke përdorur teknika të ndryshme të drejtëpërdrejta ose të nënkuptuara.

Për studimin e narrativës duhet të bëjmë një ndarje duke iu referuar këtyre elementëve: fabula, historia si dhe narrativa e tekstit. Fabula lidhet me ngjarjen ashtu si ajo ka ndodhur, përse i përket rrjedhës kronologjike të zhvillimit të ngjarjes. Ndryshe nga fabula, historia lidhet me mënyrën se si prezantohet fabula, duke mos iu përmbajtur karakteristikave të fabulës përse i përket rendit kronologjik, si dhe “duke i siguruar agjentëve shoqërorë të ngjarjes aktuale, tipare të dallueshme të cilat i transformojnë ato

në karaktere dhe duke e fokusuar ngjarjen në një këndvështrim të veçantë” (Fairclough, 2003: 83).

E njëjta gjë mund të transmetohet në narrativën e tekstit me ndryshime, përse i përket mediumit të përzgjedhur për ta transmetuar. Për këtë punim e rëndësishme është historia mbi lajmet e publikuara, gjatë periudhës së marrë në studim. Kur studiojmë lajmet, duhet të kemi parasysh që ndërtimi i tyre nuk është thjesht një raportim i fakteve, pasi kemi të bëjmë me një proces më të ndërlikuar.

Jo gjithçka që ndodh në ngjarje raportohet, pasi disa gjëra përfshihen dhe të tjera përjashtohen. Kjo nuk duhet të na drejtojë drejt premisë së gabuar, se narrativa e lajmeve është e njëjtë me narrativën e gjinive të tjera, të cilat mund të kenë më tepër liri për vetë natyrën specifike të tyre, përse i përket nocionit “të së vërtetës” në lidhje me historinë dhe ngjarjen aktuale. Narrativa e tekstit ka një qëllim referues, përse i përket mënyrës se si paraqet ngjarjet nga një këndvështrim i veçantë, si rezultat i qëllimeve ideologjike.

Studimi i lajmit nga ana funksionale nuk lidhet vetëm me informimin dhe zbavitjen pasi përkufizime të ndryshme shërbejnë për të kuptuar më mirë funksionet përse i përket qëllimeve të tyre, në raport me publikun. Sipas Hall dhe të tjerë (1978), roli i lajmeve është i rëndësishëm pasi formon opinionin publik, përforcon nocionet që lidhen me konsensusin dhe gjithashtu është përcaktues në vendosjen e axhendave.

Për studimin e strukturës së lajmit do të referohemi Van Dijk (1988, 1991), i cili në ndërtimin e kësaj skeme rendit disa elementë si titulli dhe koka, trupi i lajmit, sfondi, pasojat dhe komentet. Në një përshkrim të shkurtër të secilit prej tyre mund të kuptojmë më mirë strukturën e lajmit. Titulli dhe koka shërbejnë për të bërë një përmbledhje lakonike të informacionit në brendësi, duke shprehur pikat kryesore të tekstit. Trupi i lajmit përbëhet nga ngjarja kryesore, e cila zakonisht i referohet përzgjedhjes së bërë në funksion të rëndësisë apo kohës kur ngjarja ndodh, sipas kriterëve të vlerave të lajmit, si dhe pasojat e saj.

Informacioni që lidhet me sfondin, përse i përket ngjarjes, mund të kuptohet përmes përdorimit të kontekstit si dhe historisë. Një pikë e rëndësishme në këtë trajtim është përdorimi i një lloji të “veçantë pasojash”, i cili lidhet me opinionet e aktorëve kryesorë

të lajmeve. Kjo mund të përdoret nga gazetarët si një strategji, për të mos marrë pjesë përmes komenteve për të dhënë vlerësime subjektive, mbi ngjarjen për të cilën shkruhet.

Struktura e piramidës është një renditje e cila i kthen përgjigje pyetjeve kush, çfarë, pse, ku, dhe kur në mënyrë kronologjike. Në raportimet e lajmeve shpesh kjo strukturë përmbysset, duke dhënë pikën kulminante në fillim dhe më pas përdor paragrafë të tjerë sipas rëndësisë për t'iu përgjigjur pyetjeve. Piramida kokëposhtë ka një përdorim të gjerë nga agjensitë e lajmeve, si një strukturë, e cila tërheq menjëherë lexuesin.

Sipas Rugovës, “funksioni tematik i titullit është paraqitja e temës dhe e përmbledhjes së elementit kryesor të shkrimit ose më mirë të thuhet, i asaj që dërguesi e konsideron prioritet gjatë të kumtuarit”(2009:136). Në funksion të kësaj metode, ku elementët kryesorë të lajmit gjenden në fillim të tekstit, vetëkuptohet rëndësia e titullit dhe kokës, si përmbledhje e elementëve të trajtuar në lajm, pavarësisht mënyrës së përzgjedhur. Zëvendësimi i një teksti më të zgjeruar me një përmbledhje të këtij teksti në një hapësirë më të reduktuar, duke përcjellë në njëfarë mënyre të njëjtin mesazh realizohet përmes titullit dhe kokës së lajmit.

Përzgjedhja që bëhet për titullin dhe kokën ka efekte ideologjike, përse i takon perceptimeve të publikut në lidhje me ngjarjen. Në qoftë se i referohemi mënyrës së përdorur për të studiuar diferencën nga ana vizive, titulli dhe koka dallojnë nga pjesa tjetër e tekstit, përse i përket madhësisë së shkronjave dhe theksimit të tyre, si dhe përmbledhjes në funksion të pjesës informuese mbi ngjarjen.

Mënyra sesi kjo pjesë ndërtohet do të luajë rol dhe në mënyrën se si ngjarja do të trajtohet, zhvillohet në lajm. Në përzgjedhjen e titujve mund të përdorim strategji të ndryshme, sipas funksioneve ideologjike që mund të prodhojnë tituj të qartë, përmbledhës ose tituj të cilët janë më ambigë apo përmendës. Rëndësia e titujve është e madhe pasi publiku e merr mesazhin kryesisht përmes titujve dhe nëse titulli është me interes për ta, atëherë mund të kalojnë në lexim të pjesës tjetër të tekstit. Russ shpjegon që: “Titujt të të gjitha llojeve perceptohen më shumë sesa tekstet. Kush e shfleton gazetën, në fund ka lexuar dy herë më shumë tituj sesa artikuj” (2010:168).

Kjo mënyrë e të reagurit nga ana e publikut, shfrytëzohet nga gazetarët në përputhje me qëllimet e tyre pasi ata mund të vendosin të theksojnë pika jo të rëndësishme, apo e kundërta të zhvlerësojnë pika të rëndësishme, në funksion të ideologjisë. Titulli dhe koka shërbejnë për të prezantuar idetë që do të zhvillohen më pas në ‘trupin’ e strukturës së lajmit, ku fazat kryesore janë përpunimi, shkaqet dhe pasojat, kontekstualizimi e vlerësimi, si dhe atribucioni.

Lajmi nuk duhet të shikohet i shkëputur nga praktikat në të cilat ai prodhohet, duke patur parasysh se “stuktura gjenerike mbështetet në një numër vendimesh kulturore dhe ideologjike të marra nga individët të cilët bëjnë të mundur prodhimin e tij” (Toolan, 2001), duke filluar nga gazetarët si dhe personat që ndodhen në rangje hierarkike më të larta. Si efekt i një sërë arsyesh, lajmi mund të mos respektojë rendin kronologjik të ngjarjes. Hapësira që mund të jetë në gazetë për një lajm mund të kërkojë që një pjesë e lajmit të reduktohet, por gazetarët tregojnë kujdes që të mos humbasë kuptimi i ngjarjes.

Jo të gjitha ngjarjet që ndodhin do të kthehen në lajm, pasi kjo lidhet me një proces selektimi nga ana e gazetarëve në punën e tyre, duke patur si guidë kryesore vlerat dhe rëndësinë e lajmit.

Kategorizime të shumta janë bërë në lidhje me vlerat e lajmit, nga studiues të ndryshëm. Frekuenca e cila në fokus ka ngjarjen e ditës, intensiteti i ngjarjes, qartësia e ngjarjes, rrallësia e ngjarjes, referencat e elitës si individë apo si shtete janë disa nga vlerat e lajmit. Elementë të rëndësishëm për këtë studim janë referenca ndaj njerëzve të elitës, referenca ndaj personave (personalizimi) dhe negativiteti.

Në ‘modelin konsensual të shoqërisë’ arrihet një konsensus i mbështetur mbi vlerat e lajmit, origjina e të cilave “është tepër komplekse dhe e larmishme: Ajo përfshin vlerat e përgjithshme të shoqërisë si, konsensusin, hierarkinë, natyrën e burimit të informacionit dhe shpeshësinë e publikimit” (Fowler, 1991: 15), që kryesisht lidhen me vlerat kulturore si kuptimi, afërsia etj, si rezultat i interesit të përbashkët. Kjo është një praktikë e përdorur nga forcat politike, të cilat flasin shpeshherë dhe në emër të popullit, duke përdorur përemrin “ne”, ideologji e cila prezantohet në mjaft artikuj, në shtypin e shkruar.

Faktorët shoqërorë dhe ekonomikë që ndikojnë në për zgjedhjen e lajmit, lidhen me hierarkinë dhe theksimin e natyralitetit të saj, pasi gazeta bën për zgjedhje të tillë në bazë të interesave të veta. Në kuadër të kësaj logjike, burimet që monitorohen më shpesh janë ato të cilat kanë një status social, autoritet apo sukses. Kjo është një marrëdhënie dialektike pasi të dy grupet kanë nevojë për njëri-tjetrin, media ka nevojë për këtë kategori sepse është e rëndësishme në opinionin publik dhe anasjelltas kjo kategori ka nevojë që të përdorë median, për të bërë publike mesazhet.

Influenca e tyre është e rëndësishme në lidhje me përcaktimin e temave si burime kryesore, edhe pse media vendos këndvështrime edhe të burimeve të tjera më pak të rëndësishme, për të ruajtur ekuilibrin. Citimet e përdorura në lajmet e prezantuara në shtypin e shkruar nga këto burime, luajnë rol përforcues në lidhje me pushtetin e tyre. Por, para se të analizohen citimet është e rëndësishme që të ndalemi pak tek koncepti i intertekstualitetit. Asnjë tekst nuk ekziston i shkëputur apo i izoluar, prandaj tekstet duhet të kuptohen përmes bashkëveprimit me tekstet e tjera. Ky koncept i rëndësishëm për analizën kritike të ligjërimit sipas Fairclough, lidhet me dimensionin e lidhjeve të jashtme të teksteve, në lidhjet e tyre me ngjarjet shoqërore përmes analizës se si ata figurojnë në veprim, identifikim dhe riprezantim. "Lidhjet ndërmjet tekstit dhe teksteve të tjera të jashtme, si elementët e teksteve të tjera janë inkorporuar përmes intertekstualitetit, përmes teksteve të njerëzve të tjerë, si zërat e njerëzve të tjerë janë inkorporuar, si tekstet e tjera janë aluduar, supozuar..."(Fairclough, 2003:36), analizohen përmes dimensionit të lidhjeve të jashtme.

Në intertekstualitetin e jashtëm dallon lidhja që ka teksti me tekstet e tjera të prodhuara dhe me praktikën shoqërore. Vetëm në këtë mënyrë, përmes kontekstit, teksti mund të kuptohet plotësisht. Në të gjitha tekstet aktuale ka pjesë të teksteve të tjera të mëparshme.

Lajmet janë një zhanër, të cilat mbështeten tek riprodhimi i ngjarjes, i veprimeve dhe i opinionëve. Përveç punës së bërë nga shtypi për prodhimin e lajmit, përdorimin e

arkivave për ta realizuar atë, disa nga elementet e rëndësishme janë qëndrimet dhe deklaratat e pjesëmarrësve, aktorëve shoqërorë, të përfshirë në ngjarje.

Raportimi i opinionit të fjalimeve dhe të burimeve, mund të bëhet në forma të ndryshme, ku një ndër to është citimi i drejtëpërdrejtë, i cili mbështetet në përdorimin e fjalëve të cituara nga burimet në të njëjtën mënyrë pa ndryshime, por duke përdorur thonjëzat. Roli i gazetarit në këtë rast mbështetet tek fjalia treguese që përdor në funksion të këtij citimi, duke influencuar mënyrën se si lexuesi do ta interpretojë.

Mënyra e dytë është citimi strategjik, i cili shpesh përdoret për të treguar natyrën kundërshtuese të asaj çka thojnë burimet. Një mënyrë tjetër është citimi indirekt, i cili nuk përdor fjalët e thëna nga burimi në të njëjtën mënyrë, por i bën një përmbledhje, ku rëndësi të madhe merr folja e përzgjedhur nga ana e gazetarit, për të bërë përmbledhjen dhe që luan rol për interpretimin që do të bëjë publiku, si dhe citimi indirekt i transformuar.

Dy elementë të rëndësishëm duhen analizuar në këtë situatë. Së pari është lidhja mes citimit dhe asaj që është thënë në të vërtetë, e cila pavarësisht formës së përzgjedhur të citimit mund të jetë më shumë apo më pak i saktë se deklarata origjinale. Elementi i dytë i rëndësishëm është lidhja mes citimit dhe pjesës tjetër të tekstit, duke iu referuar individëve apo grupeve që kanë pushtet, për të formuar axhendën mediatike.

2.3.1. Leksiku

Fjalët e përdorura në tekstet e gazetave janë të rëndësishme gjatë analizës, pasi përmes tyre komunikohen mesazhet e një teksti, ata mbartin kuptim dhe nënkuptim, sidomos po ti referohemi emrave, mbiemrave, foljeve apo ndajfoljeve. Funkzioni kryesor i leksikut është mundësia e aftësisë së njerëzve për të emërtuar dhe përshkruar gjërat që ndodhin përreth tyre. Sipas Van Dijk: "Zgjedhja e një fjale në vend të një fjale tjetër për të shprehur pak a shumë të njëjtin kuptim ose për të paraqitur të njëjtin referent, mund të sinjalizojë opinione, emocione ose një pozitë të veçantë të folësit" (1991: 53).

Në ligjërimin gazetaresk ku gazetarët janë të pajisur me mundësitë për të përzgjedhur

leksikon, një faktor i rëndësishëm është ideologjia. Ideologjia shërben për të përzgjedhur leksikon në bazë të dëshirës për një riprezantim të grupeve, në mënyrë pozitive apo negative. Kjo na lejon të themi që leksiku nuk është neutral, pasi ai vjen përmes procesit të përzgjedhjes, që realizohet nga gazetari, si rezultat i ideologjisë.

Aktorët shoqërorë mund të emërtohen në mënyra të ndryshme në funksion të këndvështrimit nga gazetarët. Secili prej pjesëmarrësve i përket një grupi identitetesh, karakteristikash dhe rolesh përzgjedhja e të cilave nuk jep të njëjtin kuptim. Kjo përzgjedhje jep njëherësh karakteristikat e aktorëve shoqërorë me të cilat identifikohen dhe njëkohësisht lidhjen mes atij që prodhon ligjërimin dhe aktorit shoqëror të përfshirë në ligjërim.

Emërtimi nga ana e gazetarit do të thotë që ai do vendosë të theksojë përkatësinë e pjesëmarrësve, sipas një kategorie të caktuar shoqërore, duke hequr dorë nga një kategori tjetër edhe pse mund të jetë e saktë. Mundësia për të emërtuar në një mënyrë apo tjetër, përse i përket kategorizimit, lidhet me strategjitë të cilat emërtohen strategji referuese. Këto strategji mund të përdoren për qëllime të ndryshme shoqërore apo politike, në funksion të veprimit që luajnë brenda tekstit. “Ato jo vetëm projektojnë kuptimin dhe vlerat shoqërore mbi referencën, ata gjithashtu vendosin marrëdhënie koherence me mënyrën se si aktorët e tjerë socialë janë referuar dhe përfaqësuar“ (Richardson , 2007: 50).

Në funksion të strategjive referuese mund të përmendim punën e bërë nga Van Dijk, duke studiuar ideologjinë dhe mënyrat përmes të cilave realizohet ajo, të cilat shërbejnë si bazë për të kuptuar realizimin e zgjedhjeve të strategjive referuese. Van Dijk (1998), e klasifikon ideologjinë si një bazë e riprezantimit shoqëror (anëtarët e një grupi) si dhe një skemë për riprezantimin e dy grupeve shoqërore, ndarje e cila rezulton në klasifikimin e atyre që ndodhen brenda grupit dhe atyre që ndodhen jashtë grupit.

Në momentin e përzgjedhjes kemi të bëjmë me identifikimin e dy grupeve kryesore, ne dhe ata. Si rezultat i perceptimeve të njerëzve, në grupin e parë janë veprimet dhe rolet tona të cilat do të prezantohen pozitivisht përmes një strategjie të dukshme, ndërsa karakteristikat negative nuk theksohen, por kalojnë në plan të dytë. E njëjta logjikë, por me efekt të kundërt përdoret për grupin e dytë, i cili konsiderohet ndryshe nga ne, duke

u emërtuar ata. Për këtë grup do të theksohen karakteristikat negative dhe kalojnë në plan të dytë karakteristikat e tyre pozitive.

Sipas Chilton (2004:45) një ndër funksionet strategjike në komunikimin politik është legjitimimi dhe delegjitimimi: Komunikimi politik, përmes teknikave që fokusohen tek dëshirat dhe nevojat e votuesve, tek ideologjia përbashkuese mes aktorit politik dhe votuesve, tek roli i liderit dhe vetëprezantimi pozitiv, që shërbejnë për të legjitimuar pushtetin e aktorëve politikë. E kundërta e legjitimit, delegjitimimi i referohet palës tjetër, 'atyre', të cilët janë të huaj apo rivalë (politikë) përmes teknikave që theksojnë ndryshimet ndërmjet dy grupeve, pasi ata paraqiten negativisht.

Përveç strategjive referuese, që lidhen me përzgjedhjen e kategorizimit në raport me grupin identifikues, janë edhe strategjitë pohuese, të cilat mbështeten në zgjedhjen e fjalëve të përdorura në lidhje me pjesëmarrësit apo aktorët shoqërorë. Reisigl dhe Wodak i quajnë këto përshkrime një strategji pohuese e tekstit ose "procesi i vërtetë kyesor dhe rezultati i vlerësimit gjuhësor i cilësive për njerëzit, kafshët, objektet, ngjarjet, veprimet dhe fenomenet shoqërore." (2001:54) Përdorimet më të shpeshta të strategjive pohuese realizohen përmes referencave, attributeve, foljeve, emrave, mbiemrave, krahasimet, figurat retorike. Një funksion për të cilin mund të përdoren këto strategji është dhe përdorimi i tyre për të kritikuar.

2.4. Ligjërimi mediatik

Ligjërimi në shtypin e shkruar përmes analizës kritike të ligjërimit, analizohet nëpërmjet tre karakteristikave: në raport me shoqërinë duke qenë se kemi të bëjmë me një lidhje dialektike ndërmjet tyre, në raport me mënyrën e prodhimit të praktikave ligjërimore (profesionale) si dhe me vetë gjuhën. Shoqëria në sisteme kapitaliste është e ndarë në grupe sociale të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra, ndryshim i cili shoqërohet me probleme shoqërore.

Ligjërimi gazetaresk i trajton këto probleme shoqërore, duke prezantuar dhe riprezantuar veprimet apo opinionet e këtyre grupeve, të cilat kthehen në burime, përmes lajmeve apo zhanreve të tjera për një audiencë apo publik të medias. Analiza kritike e ligjërimit studion këto grupe të cilat kthehen në burime në raport krahasues me të tjerat, nga këndvështrimi i pabarazisë, pasi grupet që kanë më tepër pushtet

dominojnë, dhe si rrjedhojë ligjërimi mediatik luan rol në prodhimin dhe riprodhimin e dominimit.

Studiuesit që mbrojnë sistemin kapitalist theksojnë që palët nga shtresa të ndryshme që ndërveprojnë mes tyre, bazohen në një kontratë e cila është e lirë dhe që mund të ndërpritet. Studiuesit të cilët flasin për funksione përjashtuese në sisteme kapitaliste e kundërshtojnë, duke theksuar që kapitalizmi ka qenë gjithmonë shfrytëzues, ku klasa që përfiton mundohet ta mbajë të fshehtë esencën e asaj që qëndron në kapitalizëm, përmes mjeteve të caktuara.

Studiuesi Stuart Hall është një ndër emrat e spikatur të “Studimeve Kulturore” që u zhvillua në fund të viteve 1960. Hall bashkë me Hoggart dhe Williams, sollën një riformulim të konceptit “kulturë” pasi e zhvendosën fokusin nga studimi i vlerave kulturore për të kuptuar sa të mira janë, në një dimension të ri. Risia që sjellin është studimi i vlerave jo më për të kuptuar sa të mira janë, por në interes të kujt, pasi ata pranojnë duke huazuar nga trajtimi neomarksist i Gramscit që praktikën që serviren si natyrale nuk janë në të vërtetë të tilla, por ato janë të ndërtuara qëllimisht ashtu në përputhje me interesat e grupeve të fuqishme dhe se nuk mund të flitet për mesazhin që transmeton media, pa marrë në konsideratë forcat e pushtetit: Hall përdor termin hegjemoni kur flet për rolin kulturor të mediave, pasi influencohet nga trajtimi marksist i shoqërisë, duke e vlerësuar median si një mjet që ruan pozitën dominuese të atyre që kanë pushtet.

Mënyrat që përdoren për të arritur këtë objektiv janë, së pari paraqitja e lidhjeve ekzistuese shoqërore si natyrale dhe së dyti eliminimi i kundërshtimeve, përmes procesit të komunikimit. “Gjuha e përdorur në gazeta është një pjesë e rëndësishme në natyralizimin e pabarazisë dhe neutralizimin e kundërshtimit” (Richardson, 2007: 6).

Si fillim, duhet të përcaktojmë çfarë është teksti dhe konteksti, para se të studiojmë tekstin që ofrohet nga media në optikën e bashkëveprimit me kontekstin historik e shoqëror, për periudhën kohore të përzgjedhur: Teksti mund të jetë një madhësi e vogël sa një paragraf, mund të jetë sa disa paragrafë sëbashku apo edhe një vepër e tërë. Sipas Fairclough, “mund të themi se çdo shembull aktual i gjuhës në përdorim është një 'tekst'...” (2003:3).

Për studiuesit e ligjërimit, konteksti është rrethi i ngjarjeve apo rrethanave politike, historike dhe shoqërore, në të cilat zhvillohet ose përfshihet ngjarja për të cilën raportohet. Sipas Van Dijk "...Ne kemi nevojë për perceptimin e së tërës, të kontekstit kompleks në mënyrë që të dimë se si pushteti është i lidhur me tekstin dhe bisedën dhe më përgjithsisht se si ligjërimi riprodhon strukturat shoqërore". (2008, vii)

Nocioni i kontekstit influencon në qëndrimet e ndryshme dhe qasjet e përdorura gjatë analizës së të dhënave. Dallimi kryesor ndërmjet këtyre qasjeve është "gjerësia e konteksteve në të cilat konsiderohen shprehjet" (Gordon, 2009:192), apo thënë ndryshe dallimi ndërmjet asaj që përcaktojmë si kontekst, apo vlerësimi se sa kontekst duhet analizuar.

Pavarësisht qasjes, teksti dhe konteksti në bashkëveprim të pandashëm me njëri- tjetrin, na sjellin në mënyrë të pashmangshme të rëndësia e kuptimit dhe interpretimit të ngjarjes së raportuar nga teksti, qoftë ky mediatik apo i fushave të ndryshme. Interpretimi i lidhur ngushtë me kontekstin është çelës për çdo lloj analize ligjërimit.

2.4.1. Funkcionet e medias

Teoria e demokracisë liberale, e cila u zhvillua si antitezë e pushtetit autokratik, kishte si objektiv kryesor: "t'u garantonte individëve liri civile kundër sulmeve të shtetit" (Bobbio, 1987:10). Një sistem politik demokratik duhet të plotësojë disa kritere kryesore: ligjet, rregulla të shkruara mbi të cilat operon aktiviteti politik me të gjithë komponentët përbërës, e drejta e votës për anëtarët e shoqërisë si dhe një shkallë e mirë informimi për të ndihmuar në përzgjedhjen politike të qytetarit. Dinamikat e reja sollën ushtrimin e të drejtës së votës, edhe pse duhet theksuar që u fitua në kohë të ndryshme si rrjedhojë e dallimeve klasore, gjinore, racore etj. Sipas Bobbio-os kur individi ka të drejtën e votës, ai mund ta ushtrojë këtë të drejtë duke zgjedhur ndërmjet alternativave politike. Media është një ndër mjetet kryesore për t'i pajisur qytetarët me informacionet e duhura, pasi pavarësisht ndryshimeve kontekstuale kohore, "mas-media, si më 1791 ashtu edhe 200 vjet më vonë, do të dijë t'u sigurojë qytetarëve informacionin e duhur, për t'ia dalë mbanë në shoqërinë politike" (Wilkins&Patterson, 2007:196).

Për të kuptuar këtë rol të medias është e rëndësishme të përcaktojmë funksionet që kryen media në sisteme demokratike. Balle (2006), shpjegon që Jean Stoetzel në vitin 1951, përcakton edhe funksione të tjera të medias së shkruar përveç informimit. Ky konstatim me të cilin pajtohen edhe studiues të tjerë, thekson se funksionet e shtypit lidhen me rëndësinë e tij si mjet shoqërizimi duke ndihmuar në përfshirjen e individit brenda grupit të tij, si mjet argëtimi, projekcioni dhe identifikimi.

Gurevich & Blumler, janë dy studiues që kanë studiuar komunikimin politik, duke përfshirë edhe funksionet kryesore që duhet të kryejë media në shoqëri demokratike. Disa nga funksionet kryesore, sipas studiuesve janë:

- a) *Mbikqyrja dhe raportimi i zhvillimeve sociopolitike*
- b) *Përcaktimi i axhendës në mënyrë kuptimplotë referuar çështjeve kryesore të ditës*
- c) *Të shërbejnë si platforma për të bërë avokim*
- d) *Të shërbejë si vëzhgues i shoqërisë për ta bërë qeverinë të përgjegjshme ndaj të qeverisurve*
- e) *Të shërbejë si kanal për dialog ndërmjet këndvështrimeve dhe preferencave të ndryshme*
- f) *Të mbrojë të drejtën e qytetarit për t'u informuar dhe për t'u dëgjuar gjithashtu*
- g) *Të ruajë pavarësinë, integritetin dhe aftësinë të shërbejë audiencës*
- h) *Të shërbejë si nxitje për qytetarët për të mësuar, për të zgjedhur dhe për t'u përfshirë në vend që thjesht të ndjekin proceset politike*
- i) *Nxitja e barazisë midis të gjithë qytetarëve pavarësisht dallimeve ndërmjet tyre (1990:270).*

Funksionet e medias referuar një modeli ideal janë: Informimi, edukimi, denoncimi i ngjarjeve që mund të fshehin veprime joligjore të aktorëve politikë, (apo si njihet në gazetari funksioni “qen roje”) si dhe funksioni mbrojtës. Gazetat që dalin në treg si organe të pavarura ushtrojnë funksion mbrojtës, ndaj një aktori politik apo një force politike të caktuar, duke synuar bindjen e publikut pro tij/saj. Ky funksion përligjet vetëm nëse informacioni i publikuar plotëson disa kritere si kuptueshmëria, vërtetësia, etj. Një funksion i pestë i medias, është:

“Media duhet të sigurojë një platformë për diskutimin politik publik, për ta lehtësuar krijimin e “opinionit publik” dhe për t’ia ushqyer atë opinion sërish publikut, prej nga erdhi. Kjo duhet të përfshijë përgatitjen e hapësirës për shprehjen e mendimeve të ndryshme, pa të cilat nocioni i konsensusit demokratik do që i kotë” (Mcnaair 2009:33).

Studiuesit Gurevich & Blumler theksojnë që media duhet të analizohet në raport me faktorë ekonomikë, politikë etj, të cilët mund të ndikojnë mbi median, në përzgjedhjen e tematikave apo të këndvështrimeve të caktuara që vijnë nga njerëz me pushtet, duke i paraqitur si procese natyrale.

Ky përcaktim përlligjet edhe përmes studimit të etapave të gazetarisë politike, e cila shënon fillimet e saj në mesin e shekullit XIX, duke u shënjuar nga karakteristika që ndryshojnë nga parimet dhe standardet mbi të cilat perceptohet gazetaria në ditët e sotme. Gazetaria politike ndryshoi duke u përafuar me standardet gazetareske si objektiviteti, ndarja e fakteve nga opinionet dhe paanshmëria, si rrjedhje e një sërë faktorësh: Mbrojtja e lirisë së shtypit përmes ligjeve, rritja e alfabetizimit në nivelin shoqëror, rritja e interesit të pronarëve për të siguruar të ardhura ekonomike përmes tirazhit të shitjeve dhe reklamave, si dhe zhvillimeve në nivelin teknik.

Etapa e tretë e gazetarisë politike u identifikua me gërshetimin e ekspertizës kritike me objektivitetin, pasi ky i fundit ishte i pamjaftueshëm për të ndërtuar artikuj analitikë, në raport me funksionet që duhet të kryejë gazetaria. Zhvillimet e reja në raport me nevojën organizative për lajme, presioni për rritjen e tirazhit të shitjeve apo numrin e audiencës, konkurrenca, nevoja për të siguruar të ardhura përmes reklamave, ulja e interesit për çështje politike nga publiku, kanë influencuar negativisht në funksionet që duhet të kryejë media sipas ekspertizës kritike, duke iu referuar produktit mediatik ku një ndër tendencat problematike të etapës së tretë të gazetarisë politike, është “martesa e sforcuar mes ekspertizës dhe argëtimit” (Kuhn & Neveu, 2002: 83), e cila konkurrencën politike ndërmjet partive politike dhe aktorëve politikë e paraqet më tepër si “një garë kuajsh”.

2.4.2. Konfliktualiteti si logjikë e brendshme e mediave

Jo të gjitha ngjarjet që ndodhin do të kthehen në lajme, pasi “lajmi është rezultati përfundimtar i një procesi kompleks që fillon me një sistemim dhe selektim të ngjarjeve dhe temave sipas një kategorie të caktuar sociale” (Hall 1978:53), qasje e cila na orienton drejt studimit të vlerave të lajmit, për të kuptuar këtë proces kompleks. Një ndër studimet më të rëndësishme në raport me vlerat e lajmit është studimi i Galtung dhe Ruge (1965), mbi mbulimin e konflikteve ndërkombëtare në katër gazeta norvegjeze, ku klasifikohen 12 elementë që ndikojnë që ngjarjet të kthehen në lajme, si

psh., frekuenca e cila në fokus ka ngjarjen e ditës, intensiteti i ngjarjes, qartësia e ngjarjes, rrallësia e ngjarjes, referencat ndaj njerëzve të elitës apo ndaj shteteve elitare. Sipas Hall (1973), vlerat e lajmit janë pjesë e një mënyre të ndërtuar ideologjikisht mbi perceptimin e botës që: Favorizon dhe 'natyralizon' perspektivat e elitave të fuqishme.

Tre kriteret e fundit të listuara (por jo për nga rëndësia) në studimin e Galtung dhe Ruge (1965: 71) janë referimi ndaj njerëzve të elitave, personalizimi dhe negativiteti. Sipas Fowler:

“Fiksimi me individët dhe përdorimi i tyre nga mediat si simbole, shmangin diskutime serioze dhe shpjegime themelore të faktorëve social dhe ekonomik... Është mëse e qartë se personalizimi është një pikëpamje krijuese e ideologjisë...” (1991: 15-16).

Në lidhje me këtë, një dukuri e analizuar në media, nga studiuesit Rahat & Sheaffer është personalizimi i sjelljes nga media, që i referohet “një përqëndrimi më të lartë në politikat individuale dhe një fokus të zvogëluar ndaj partive” (*Brants & Voltmer, 2011:93 cituar nga Rahat & Sheaffer, 2007: 67*), duke i kushtuar vëmendje karakteristikave politike dhe aktiviteteve të politikanëve individualë. Ndërsa ajo që emërtohet private për studiuesit, "i referohet një përqëndrimi të medias në karakteristikat personale dhe jetën personale të kandidatëve individualë" (Po aty, fq. 68).

Në raport me listën e kriterëve, negativiti zë një vend thelbësor, sepse sa më negative të jetë ngjarja në pasojat e saj, aq më e mundshme është që të bëhet lajm. Edhe për Van Dijk (1988) një ndër vlerat kryesore të lajmeve është negativiteti, i cili mund të shpjegohet përmes termave sociologjik, konjitivë, apo psikoanalitik. Duke përmbledhur tre kriteret e mësipërme sipas Galtung dhe Ruge evidentohen “lajme të një natyre negative në lidhje me njerëzit e elitës- me fjalë të tjera lufta për pushtet dhe lajme të një natyre negative në lidhje me personat- me fjalë të tjera skandale” (1965:71).

Në një studim më të vonë të Harcup dhe O’Neill (2001) mbi vlerat e lajmit, elitat e pushtetit të prezantuara përmes historive që lidhen me individë, organizata apo institucione me pushtet si dhe lajmet negative me tone konfliktuale vazhdojnë të mbeten kritere të rëndësishme. Të njëjtin qëndrim ndajnë dhe studiuesit Blumler&Gurevich (1995), të cilët evidentojnë që në lajmet politike ka një rritje të fokusimit mbi strategjitë dhe garën politike, një rritje të negativitetit kundrejt

aktorëve politikë dhe politikës, konfliktualitetit dhe një rritje të fokusimit mbi liderët politikë.

Sipas studiuesit Jamieson (1992), konceptualizimi i lajmeve që fokusohen në fitoren apo humbjen e aktorëve politikë, në 'luftën dhe lojërat' politike, në stilin e kandidatit dhe në rëndësinë që i jepet sondazheve të opinionit publik, emërtohet: Kornizimi strategjik i lajmit. Për studiues kritikë të medias si Cappella&Jamieson, efektet e kornizimit strategjik të lajmeve nuk janë pozitive. Argumenti kryesor në studimin e tyre mbështetet në dallimin që sjell kornizimi strategjik i lajmeve në raport krahasues me kornizimin e çështjeve (që fokusohen tek problemet dhe tek zgjidhja e tyre) tek publiku, pasi theksohet që "korniza strategjike për lajmet politike aktivizon përgjigje cinike kundrejt politikanëve, politikave, qeverisë, fushatave, dhe formimit politik (1997:139), ndërsa "kornizimi i çështjeve, nga ana tjetër mund të shtypë reagimet cinike" (Po aty).

Media duhet të përcjellë informacionin e duhur në funksion të rolit informues të saj pasi sipas studiuesit Hansen:"Nevoja e votuesve është të jenë të informuar për aktorët politikë, vizionet, politikat, dhe pasojat e këtyre politikave" (2009: 9). Në studimin e tij ai bën një ndarje të artikujve duke përdorur dy kategori, së pari artikuj që përfshihen në gazetarinë e procesit dhe së dyti artikuj që përfshihen në gazetarinë e përmbajtjes. Sipas Hansen (2009), gazetaria e procesit përqëndrohet te taktikat politike, aleancat politike, manipulimet dhe beteja për pushtet në prapaskenë, ndërsa gazetaria e përmbajtjes përqëndrohet tek pasojat e vendimeve politike dhe tek dallimet politike dhe ideologjike. Aktorët politikë që performojnë në arenën politike, ndërmarrin vendime politike të cilat shpesh karakterizohen nga mungesa e transparencës për publikun. Media synon që fshehja e informacionit përmes manipulimit, të bëhet publike, prandaj gazetaria politike në përmbajtjen e saj fokusohet tek vetë procesi që zhvillohet mes aktorëve duke u përqëndruar në aleancat ndërmjet tyre, taktikat politike dhe në luftën për pushtet që nuk zhvillohet para publikut, por kjo nuk mund të shfuqizojë rëndësinë e gazetarisë së përmbajtjes. Sipas kritikëve të medias, Patterson&Wilkins(2009:207) në vend që të theksohet ngjarja, konflikti, gara mes aktorëve politikë, duhet përqëndrimi mbi çështje dhe perspektiva politike.

Aktorët politikë kërkojnë të arrijnë objektivat e tyre politike duke synuar dominimin e axhendës mediatike. Media përmes procesit të ndërmjetësimit mes aktorëve politikë dhe opinionit publik, ka për detyrë të njohë mirë problematikat që shqetësojnë publikun, axhendën e votuesve dhe t'i reflektojë ato në axhendën mediatike, duke informuar publikun mbi vendimet politike dhe pasojat e tyre, dallimet politike dhe ideologjike të forcave politike.

2.4.3. Gjuha mediatike

Sipas studiuesit Hall (1997:7), gjuha është mediumi i privilegjuar, ku prodhohet dhe shkëmbehet kuptimi, i cili mund të shpërndahet përmes aksesit tonë të përbashkët në gjuhë: Gjuha është e aftë ta kryejë këtë, sepse ajo operon si një sistem i përfaqësimit, duke përdorur shenja dhe simbole si tinguj, imazhe, fjalë të shkruara, nota, përmes të cilave përfaqësohen idetë, mendimet apo ndjenjat, prandaj përfaqësimi përmes gjuhës është thelbësor në procesin e prodhimit të kuptimit.

Disa nga supozimet kryesore në lidhje me gjuhën sipas Richardson (2007:10-14), janë: Gjuha është sociale, sepse ajo është prodhuar nga shoqëria dhe gjithashtu ajo ndihmon në përfaqësimin, prodhimin dhe riprodhimin e realitetit shoqëror. Gjuha në raport me identitetin që një individ kërkon të projektojë, mund të shpjegohet përmes shprehjeve, argumenteve, teksteve të përdorura nga individi që i prodhon në përputhje me identitetin që ai projekton: Prandaj në tekstet mediatike dhe politike është shumë e rëndësishme përgjigjja në raport me pyetjen kush e thotë, për të kaluar më pas në fazën tjetër, atë të interpretimit mbi atë që ai/ajo ka thënë, duke përfshirë dhe kontekstin në të cilin ndodh. Gjuha e përdorur është aktive dhe ka pushtet, dhe për këtë mund t'i referohemi gjuhës të përdorur në gazeta, e cila ka forcë që të formojë çështjet e agjendave dhe diskutimin publik, mund të rforcojë besimet, apo opinionet e njerëzve, duke pranuar si rrjedhojë, që gjuha në gazeta ka efekte shoqërore. Integrimi i dy supozimeve mbi karakterin shoqëror të gjuhës dhe forcës, pushtetit të saj, për Richardson shpie drejt një supozimi të ri që gjuha e përdorur është politike, duke hedhur poshtë argumentet që mbrojnë neutralitetin e gjuhës gazetareske.

Pjesa më e madhe e ngjarjeve që ndodhin, nuk kthehen në lajme, prandaj si rrjedhojë selektimi na jep një këndvështrim të pjesshëm, të asaj që ndodh, apo thënë ndryshe, të botës. Lajmi nuk është pasqyrim identik i ngjarjes që ka ndodhur në të vërtetë, pasi dallimet ndërmjet ngjarjes dhe lajmit vijnë si rrjedhojë e faktorëve shoqërorë, ekonomikë apo politikë, të cilët influencojnë që e njëjta ngjarje të prezantohet në mënyra të ndryshme, edhe pse ngjarja në të vërtetë është një.

Në ligjërimin mediatik hasim një sërë stilesh gjuhësore, të cilat bazuar te nënkodet e fshehura japin indirekt qëndrimet e ndryshme të mediave, ku “fjala stil si term i gjuhësisë shënon një varietet a variant të gjuhës, të lidhur me një sferë të caktuar përdorimi dhe që ka disa veçori kryesisht në nivelin e leksikut dhe të sintaksës” (Shkurtaj&Topalli, 2009: 225).

Fjala ka një ngarkesë të lartë kuptimore në përdorimin e saj publik të shkruar, pasi hyn në një lloj ndërveprimi shoqëror, prandaj në shkrimet mediatike gjatë periudhës së zgjedhjeve elektorale, ajo është një formë e lartë ndikimi politik mbi ndërgjegjen e njeriut, mbi bindjet dhe qëndrimet e tij politike, mbi vullnetin dhe ndjesitë e tij. Për këtë arsye fjala është një armë e fortë për të përcjellë interesat e një grupi të caktuar politik apo shoqëror, për të përcjellë edhe vetë qëndrimin që mban organi i shtypit apo gazetari, i cili e përdor atë.

Gjatë analizimit të teksteve të shkruar, një tipar tjetër i rëndësishëm, i cili përdoret gjithashtu si një trukim për të mos shprehur hapur qëndrimin, është toni. Sipas akademikut, Lloshi: “Karakteristika tërësore e tekstit, që shpreh qëndrimin e përgjithshëm të ligjëruesit ndaj objektit dhe ndaj marrësis, quhet ton stilistik...” (1999: 40).

Nuk ka një klasifikim të studiuar specifik për tonet stilistike, prandaj shpesh ndodh edhe ngatërrimi i tonit me stilin, por duke marrë parasysh përdorimin e tonit në shkrime e ligjërime të ndryshme, përdoren cilësime të tilla: ton solemn, familjar, ironik, formal, i përmbajtur, i ftohtë, fyes etj. Mediat synojnë që toni të përputhet me natyrën e temës mbi të cilën shkruajnë dhe me qëndrimin që kanë për të, me qëllim ndikimin ose dhënien e mesazhit lexuesit të tyre. Nga kjo kuptojmë që tonet e teksteve nuk mund të

jenë asnjëanëse, por gjithmonë përshkrohen nga një qëllim i shprehur me anë të tij si: Emocional dhe ngacmues, polemizues ose goditës.

Në thelb funksioni i ligjërimit mediatik është kumtues dhe ndikues, i cili sipas Lloshit përkufizohet në këtë mënyrë:

“Kumtimi këtu do të thotë të jepet informacion, pra të paraqiten fakte, ngjarje, të dhëna, njohuri nga politika, ekonomia, kultura etj, zakonisht të ditës, të kohëve të fundit. Ndërsa funksioni ndikues do të thotë që jo vetëm paraqiten mendime, qëndrime e vlerësime, por edhe synohet të ndikohet mbi mendimet, qëndrimet e vlerësimet e lexuesve, të ndryshohen ato në një drejtim të caktuar, të nguliten bindje politike, të nxiten reagime shoqërore e deri të përftohen te njerëzit paragjykime, shije e prirje sipas një orientimi të caktuar. Përgjithësisht funksionet shoqërore të kësaj veprimtarie janë informues dhe formues, organizues dhe propagandues, njohës dhe edukues” (1999: 216).

Shtypi i pavarur është shumë i rëndësishëm në jetën shoqërore të një vendi, pasi ai është një kronikë e gjallë e ngjarjeve që ndodhin ditë pas dite, është një arkivë e tërë historike, prandaj është e rëndësishme të zhvillohet në mënyrë sa më objektive dhe të pavarur. Shkrimi në një gazetë ka kohë të kufizuar, për tu marrë cilësisht me çdo detaj, kjo sjell ato që quhen shkrime që na duhen në mbështetje të qëndrimit tonë, duke ju shmangur shpesh herë edhe të vërtetës, për të sjellë vetëm copëza të lajmit, duke e shkëputur nga konteksti real. Ky truk përdoret gjerësisht me titujt, edhe si një formë marketingu për të tërhequr vëmendjen e lexuesit.

2.5. Ligjërimit politik

Në studimet tradicionale mbi politikën dhe në studimet e ligjërimit politik, është e vështirë që të japësh një definicion përfundimtar për politikën. Për Ruth Wodak politika përcaktohet, “si një luftë për të imponuar parimin legjitim të vizionit dhe ndarjes” (Wodak, 2009: 1), ndërsa për Chilton (2004), duhen trajtuar dy orientime kryesore, pasi: Nga njëra anë politika vlerësohet si një luftë për pushtet ndërmjet dy palëve kundërshtarë, konflikteve të interesit, betejës për dominim, që realizohet përmes teknikave të ndryshme të bindjes, argumentimit, kërcënimit, manipulimit etj. Nga ana tjetër, përplasjet në një shoqëri, konfliktet e interesit, mbrojtja e pushtetit dominues të një individi apo grupi, duhet të zgjidhen nga politika, përmes institucioneve të shtetit, partive politike, aktorëve politikë, grupeve të interesit, pa të cilat politika nuk ka kuptim. Në të dy rastet, është e nevojshme përfshirja e ligjërimit, sepse “politik

përfshin pajtimin e dallimeve përmes diskutimit dhe bindjes, prandaj komunikimi është thelbësor për politikën” (Chilton, 2004: 4 cituar nga Hague et al. 1998: 3-4).

Politikanët janë aktorët kryesorë në politikë, por jo të vetmit, pasi ata ndërveprojnë me marrësit e komunikimit politik, si publiku, qytetarët apo kategori të tjera, të cilët kthehen në pjesëmarrës në procesin politik: “Aktiviteti politik dhe procesi politik gjithashtu përfshijnë njerëz si qytetarë dhe votues, si anëtarë të grupeve të presionit, demonstrues dhe disidentë, e kështu me rradhë” (Verba, et al., 1993). Sipas Van Dijk (1997: 15), politika mund të përfshijë jo vetëm gjithë aktorët, ngjarjet, veprimet, ligjërimet, por edhe sistemet politike, ideologjitë dhe marrëdhëniet politike të tilla si pushteti, pabarazia, hegjemonia.

Pjesëmarrësit dhe veprimet e tyre nuk mund të veprojnë jokontekstualisht, sepse ligjërimi i tyre politik kontekstualizohet në ngjarje komunikuese, prandaj për studiuesit e ligjërimin si Van Dijk, është një detyrë themelore për njerëzimin dhe shkencat shoqërore “dhe për studimet e ligjërimin në veçanti, për të treguar se si varet me saktësi teksti dhe biseda jonë-dhe influencat-si kontekstet” (2008: xii), gjë që mund të ndikojë në ndryshimet ligjore apo vendimet politike.

Qasja që sugjerojnë studiuesit Fairclough&Fairclough, mbi studimin e ligjërimin politik, është që ligjërimi politik është një formë e argumentimit, që përfshin argumente në raport me mënyrat e veçanta të të vepruarit, duke përzgjedhur ndërmjet alternativave të ndryshme: “Politika është kryesisht për të bërë zgjedhje se si të veprohet në përgjigje të rrethanave dhe qëllimeve, ka të bëjë me zgjedhjen e politikave, dhe zgjedhje të tilla dhe veprimet që rrjedhin prej tyre bazohen në argumente praktike”(2012:1).

Reisigl&Wodak (2001) e përcaktojnë ligjërimin politik si një formë të veprimit politik, ku argumentimi është i rëndësishëm. Në të njëjtën linjë qëndron dhe Van Dijk (1997: 29), sipas të cilit, në ligjërimin politik strategjitë dhe strukturat e argumentimit, mund të organizojnë një diskutim politik, në të cilin qëndrimet e kundërta të të tjerëve sulmohen në mënyrë sistematike, ndërsa ata të grupit politik mbrohen. Për studiuesit Fairclough&Fairclough (2012), këto qasje nuk kanë analiza sistematike mbi argumentet, por kanë më tepër një referencë ndaj karakteristikave të veçanta të tyre, të fokusuar tek vetëprezantimi pozitiv dhe prezantimi negativ për tjetrin: Sipas “katrorit ideologjik-

politik” të Van Dijk (1997), riprezantimi “ne” dhe “ata” thekson veprimet tona të mira në krahasim me veprimet e tyre të këqia, prandaj nëse i referohemi temave të trajtuara në ligjërimin politik, për të kuptuar aktorët politikë, vendimet e tyre, mendimet e tyre mbi çështjet politike, mund të pranohet që edhe temat, referencat për politikanët dhe organizatat mund të përmbajnë vlerësime të polarizuara, “ne/ata”.

2.6. Partitë politike dhe funksionet e tyre

Partitë politike të para lindën si rrjedhojë e punës dhe profesionalizmit të individëve të caktuar, të cilët ishin kundër një pushteti absolut mbretëror. Objektivi kryesor ishte ndryshimi në një sistem, që aspironte për aplikimin e parlamentarizmit. Nëse i referohemi kontekstit historik të vendeve të ndryshme të themelimit të partive të para, sipas perceptimit bashkëkohor, mund të përmendim rastin e Anglisë, e cila njihet si djepi i demokracisë parlamentare, me dy parti kryesore. Partia “Tory” e cila më pas do të emërtohet “Partia Konservatore” është partia e parë e krijuar, e cila përbëhej nga shtresa e aristokracisë dhe përfaqësonte interesat e saj. Partia e dytë është “Vigët” e cila përbëhej nga industrialistët e rinj të kohës dhe liberalët, të cilët mbronin parlamentarizmin.

Për të dhënë një përkufizim mbi partitë politike, duke u nisur nga origjina e tyre, duhet të kemi të qartë ndarjen nëse do t’i perceptojmë si organizata që ndahen si rrjedhojë e ideologjisë mbi të cilën mbështeten, apo si organizata të cilat krijohen në funksion të një qëllimi që lidhet me pushtetin, duke iu referuar përcaktimit tashmë klasik të Weberit, ku partitë klasifikohen si organizata që objektiv kryesor kanë grumbullimin e votave, për të siguruar pushtet politik. Në këtë studim do t’i referohemi përkufizimeve, të cilat kanë të sintetizuar edhe konceptin e ideologjisë, të shprehur përmes programit, si më poshtë:

“Partitë politike paraqesin bashkimin e lirë të qytetarëve me qëndrime të njëjta, të cilët, për zgjidhjen e problemeve politike bëjnë propozime programore dhe paraqesin kandidatë për mandate në parlament dhe për poste qeveritare, me qëllim që pas zgjedhjeve të suksesshme të zbatojnë në praktikë programin e tyre”
(<http://shtetiweb.org/2012/09/04/cjane-partite-politike/>).

McNair i përkufizon partitë politike në këtë mënyrë:

“Kjo kategori aktorësh politikë përfshin pa asnjë dyshim, partitë e themeluara politike-bashkime individësh që ndajnë pak a shumë të njëjtat mendime dhe që mbliohen brenda

një strukturë të pranuar organizative dhe ideologjike për të ndjekur synime të përbashkëta” (2009:19).

Sipas përcaktimit të studiuesit Seiler:

“Partitë do t’i përkufizojmë si organizata që synojnë mobilizimin e individëve në një aksion kolektiv kundër të tjerëve, po kështu të mobilizuar, me qëllim që të arrijnë të vetëm ose në koalicion ushtrimin e funksioneve të qeverisë. Ky aksion kolektiv dhe ky synim për të drejtuar punët publike justifikohen nga një konceptim i veçantë i interesit të përbashkët” (Seiler, 2002: 23).

Në funksion të këtij përkufizimi evidentojmë tre momente kyesore, që lidhen me arsyen e kërkesës për pushtet duke ofruar një këndvështrim ndryshe, grupimi i cili kërkon të marrë pushtetin duke përdorur mjete kushtetuese dhe së treti thirrja që i bëhet njerëzve për tu përgjigjur pozitivisht kundrejt këtij grupimi.

Qasje të ndryshme kur studiojnë rolin e partive politike në raport me demokracinë përfaqësuese, theksojnë që partitë politike shpesh janë element pengues, “funksionimi i partive nuk është demokratik, por oligarkik dhe i personalizuar” (Seiler, 2002: 25). Pavarësisht këndvështrimeve në plan pozitiv apo negativ, në studimin e marrëdhënies parti politike-demokraci, duhet theksuar që asnjë sistem demokratik nuk mund të perceptohet pa partitë politike. Konteksti historik i vendeve me sistem autoritar tregon që edhe në këto rregjime, përsëri është përdorur imazhi që funksionon një sistem ku ka më shumë se një parti.

Disa nga kërkesat e domosdoshme për një parti politike janë: Strukturimi i organizatës në përputhje me ligjet dhe rregullat e vendit, anëtarësimi me vullnet të lirë, lista me kandidatët për deputetë, programi politik i cili i referohet tematikave dhe problematikave të ndryshme të jetës publike duke propozuar qasje për zgjidhjen e tyre etj.

Për të kuptuar rolin e partive politike duhet të ndalemi edhe tek funksionet (referuar Seiler, 2002) që ato kryejnë:

A) Partitë politike kanë nevojë për kapacitete njerëzore, proces i cili realizohet përmes anëtarëve ekzistues dhe rekrutimit të anëtarëve të rinj, nga ku do të përzgjidhen individët që do të mbajnë detyra politike apo që do vendosen në poste qeveritare.

B) Përmes programit politik partitë politike kryejnë funksionin programor, ku përfshirja e interesave dhe kërkesave të ndryshme, në një njësi përbashkuese synon të marrë aprovimin dhe pëlqimin e shumicës dhe t'i lejojë sistemit politik të jetë i legjitimuar dhe i stabilizuar.

C) Partitë politike ushtrojnë funksion koordinues dhe kontrollues mbi organet qeveritare, gjë e cila përfshihet tek funksioni i mësipërm në kuadër të legjitimim-stabilizimit, sepse partitë transmetojnë idenë që kontrolli që ato ushtrojnë, është një funksion kontrolli nga zgjedhësit e tyre, të cilët përfaqësohen nga partitë që tashmë kanë një pushtet të legjitimuar dhe të stabilizuar.

D) Partitë politike shërbejnë për integrimin shoqëror të individëve, duke përfutur grupe që bashkohen nga kërkesat dhe nevojat e tyre. Ky funksion i partive politike mund të perceptohet si rrjedhojë e grupeve të ndryshme në shoqëri të cilat kanë nevoja dhe kërkesa të ndryshme, që nuk mund të plotësohen pa praninë e partive politike, pasi ruajnë funksion stabilizues duke siguruar një sistem të përbashkët ku integrohen këto individë.

E) Funksioni i mësipërm arrihet përmes mbështetjes dhe mobilizimit të individëve në raport me përzgjedhjen mbi alternativat e ndryshme politike. Kjo na drejton një funksion tjetër të partive politike, funksioni i kundër-organizimit: Kundër-organizimi prezantohet duke i'u referuar politologut Laveau, i cili e përcakton këtë funksion duke u mbështetur në "pasojat pozitive që mund të sjellë kundërshtimi ndaj një sistemi për mbijetesën e vetë sistemit" (Seiler, 2002: 30), sepse vetëm në këtë mënyrë një sistem mund të funksionojë, prandaj roli i forcave opozitare është elementi i duhur, i cili lejon që të zhvillohet gara politike.

2.7. Ideologjia e majtë dhe e djathtë

E majta dhe e djathta janë terma të cilat morën kuptim me Revolucionin Francez në vitin 1789. Këto terma përcaktojnë ndryshimet ideologjike në kuptim dhe veprim të dy kampeve respektive, që me ngjizjen e tyre në fund të shekullit të XIX dhe në vazhdim. Nëse kërkojmë një shpjegim mbi termat e majtë/e djathtë, në fjalorin politik të Oksfordit (McLean & McMillan, 2011) shpjegohet se këto terma kanë lindur që me revolucionin francez, përmes qëndrimit të deputetëve në raport me sistemin politik. Deputetët e majtë

të pozicionuar në të majtë të Kryetarit të Asamblesë ishin kundra monarkisë dhe pro republikës, ndërsa të djathtët ishin kundra, duke ofruar si alternativë, vazhdimësinë e rregjimit. Që në këtë moment historik e majta u identifikua me një forcë që kërkonte ndryshime duke u etiketuar si më liberale, ndërsa e djathta ruajtjen e sistemit ekzistues, apo ndryshe, konservatore. Ndryshimet e ndodhura në kontekstin historik përmes ngjarjeve si rënia e murit të Berlinit, u shoqëruan me pikëpyetje të tilla nëse kishte kuptim, të vazhdohej me dikotominë e djathtë/e majtë.

Studiues të ndryshëm hodhën idenë, që me ndryshimet e ndodhura në vende të cilat kishin ndjekur një filozofi të majtë, nuk kishte më sens të diskutohej për konceptet e djathtë/ e majtë, sidomos duke iu referuar elementit kryesor të saj, ideologjisë. Një ndër këto studiues është edhe Sartre, sipas së cilit, e djathta dhe e majta përcaktohen, “dy kuti të zbrazëta” (Stewart, 2016), ndërsa për Francis Fukuyama (1992), fitorja e kapitalizmit mbi alternativën tjetër shërben për të përcaktuar sistemin demokratik liberal si ‘pikën përfundimtare të evolucionit ideologjik’.

Këndvështrimi i kundërt i Bobbios në raport me këtë është:

“...Pohimi i krizës së ideologjive është më se ideologjik. Le pastaj që ‘e majta’ dhe e ‘djathta’, nuk kanë të bëjnë vetëm me ideologjinë. T’i reduktosh në shprehje të kulluara të mendimit ideologjik do të thotë t’i hysh një thjeshtëmi të papërligjur, pse ato dy terma u referohen programeve të kundërta, që kanë të bëjnë me probleme, zgjidhja e të cilave i përket normalisht aksionit politik, pra tregojnë kontraste jo vetëm idesh, por edhe interesash e vlerësimesh për drejtimin që i duhet dhënë shoqërisë; këto kontraste ekzistojnë në çdo shoqëri e nuk kuptohet se si papritur mund të zhduken” (Bobbio, 1997: 9).

Sipas studiuesit dikotomitë e mëdha janë pjesë e secilës fushë, duke shfaqur tre karakteristika. Përshkruese pasi paraqesin përmbledhjen e dy anëve të konfliktit, vlerësuese duke iu referuar vlerave gjyquese pozitive apo negative për secilën palë dhe historike duke iu referuar etapave historike dhe ku mund të përfshihen dy karakteristikat e sipërpërmendura.

E majta dhe e djathta konsistojnë në një ndarje, e cila shoqërohet me karakteristikat përkatëse, në secilën kategori. Kjo ndarje mundëson zgjedhjen e individit në atë kategori ideologjike e cila është më afër kërkesave, dëshirave dhe nevojave të tij, premisë e cila na drejton drejt konkluzionit që ideologjia nuk mund të asocohet me emra individualë apo të përveçëm, pasi e tejkalon individin. Ideologjia nuk mund të kuptohet

pa një studim të së shkuarës dhe pa objektiva dhe vizion për të ardhmen. Giddens(2002: 303), pohon se e djathta karakterizohet me aristokracinë dhe konservatorizmin, ndërsa e majta përdoret për grupet radikale progresiste që priren drejt socializmit. Dallimet ndërmjet të majtës dhe të djathtës konsistojnë në barazinë sociale, në ndërhyrjen e shtetit në tregun e lirë, në mbështetjen dhe ndihmën për personat e paaftë për punë, në liberalizmin shoqëror për të majtën në raport me drejtësi sociale, treg i lirë, vetëmjaftueshmëri individuale, konservatorizëm shoqëror për të djathtën. Nëse i referohemi dikotomisë ideologjike e majtë/ e djathtë, duke patur në fokus karakteristikat e mësipërme, është lehtësisht i identifikueshëm target grupi mbështetës, për të majtët dhe të djathtët.

Ndër kriteret themeltare për të dalluar të majtën nga e djathta është:

“...Qëndrimi i ndryshëm që njerëzit, si qenie njerëzore përballë idealit të barazisë, i cili krahas atyre të lirisë e të paqes është një nga qëllimet e fundme që këta njerëz i vënë vetes, e për të cilët janë të gatshëm të ndeshen” (Bobbio, 1996:68).

Megjithëse kjo vlerë është e rëndësishme për ndarjen ideologjike e majtë dhe e djathtë, jo gjithmonë mund të pranohet, pasi sipas Bobbios influencojnë tre variabla që lidhen me pyetjet, mes kujt duhen rishpërndarë të mirat materiale dhe jomateriale, në çfarë duhen rishpërndarë, si dhe në bazë të cilit kriter, përgjigjet e së cilave prodhojnë modele të ndryshme barazimtare. Referuar traditës historike të së majtës dhe të djathtës, barazia është një ndër konceptet kryesore mbi të cilën u ndërtua ideologjia e majtë, ndryshe nga e djathta, për të cilën njerëzit janë më shumë të pabarabartë sesa të barabartë, sepse doktrina e djathtë është më e prirur të pranojë pabarazinë natyrore dhe pabarazinë shoqërore.

Nëse për barazinë bihet në dakordësi që i përket idelogjisë së majtë, kriteri tjetër themeltar është liria, e cila sipas Bobbios nuk është një koncept absolut sepse:

“Doktrina e lëvizjes libertare e autoritare ka edhe në të djathtë, edhe në të majtë, e kjo ndodh ngaqë kriteri i lirisë shërben për të përshkruar universin politik jo aq në lidhje me qëllimet, sesa në lidhje me mjetet, ose me metodat që duhen përdorur për t'i arritur këto qëllime: Ky kriter ka të bëjë kështu me pranimin ose me refuzimin e metodës demokratike, të kuptuar si një bashkësi rregullash që lejojnë të merren vendime kolektive nëpërmjet debatesh të lira e zgjedhjesh të lira, pa përdorimin e dhunës.(1996:75)

Sipas Confrancescos (Bobbio, 1996: 52), tradita është një ndër kriteret e përdorura për të dalluar të majtën nga e djathta, pasi tradita së bashku me variablat e saj, mund të kategorizohet më afër idelogjisë së djathtë, ndryshe nga e majta e cila identifikohet

përmes emancipimit, por jo në nivel antagonist. Referuar Confrancescos, evidentohen 6 kuptime të ndryshme për traditën:

- 1) Tradita si arketip
- 2) Tradita si përcaktim ideal i një epoke aksiale ose vendimtare në historinë e njerëzimit
- 3) Tradita si kujtesë historike
- 4) Tradita si besnikëri ndaj kombit
- 5) Tradita si të pasurit të njëjtit fat
- 6) Tradita si vetëdije historike

Të djathtët kërkojnë ruajtjen e traditës, ndërsa të majtët kërkojnë emancipimin në raport me pabarazitë që rrjedhin nga privilegjet përmes racës, shtresës apo klasës.

Evoluimi në kohë përta i përket kulturës e karakterizuar nga tipare materialiste, apo shtresat shoqërore ku vërehet një rritje e shtresës së mesme, janë disa nga faktorët shkakësorë që ndikojnë në sjelljen e partive politike për të kapërcyer diadën e majtë/e djathtë, duke marrë tipare më gjithëpërfshirëse, në funksion të përmbushjes së objektivave të tyre. Një ndër autorët që mbron këtë qasje është Daniel Bell (1960), i cili argumenton që ideologjitë e vjetra do të zëvendësohen nga ideologji të reja, të reflektuara në një sjellje politike pragmatiste.

Studiuesit që mbrojnë vazhdimësinë e dallimeve ideologjike ndërmjet të djathtës dhe të majtës, mund të argumentojnë në favor të qasjes së tyre, jo vetëm përmes së kaluarës por edhe përmes zhvillimeve të ngjarjeve të reja. Në studimin e dikotomisë e majtë/ e djathtë, edhe nëse nuk merret parasysh emërtimi, por kalohet tek problemet, përsëri kemi ndarje përta i përket atyre që klasifikohen si probleme, dhe mënyrës së përzgjedhur për t'i dhënë zgjidhje atyre, sipas këndvështrimit që ka përzgjedhur, secila palë. Perceptimi i sotëm mbi mënyrën e jetesës (si një element studimor) mund të studiohet nga këndvështrime të ndryshme, që përlligj vazhdimësinë ideologjike të kësaj dikotomie. E majta kërkon ndryshime, kërkon të drejta për grupe më të diskriminuara duke ruajtur tiparet e një ideologjie më liberale, ndërsa e djathta mbron stilin tradicional, duke qenë më pak e hapur ndaj ndryshimeve, apo më konservatore.

Studiuesi Roland Lami (2013:17-18), në punimin e tij i referohet punës së bërë nga Dalton, i cili fakton përmes të dhënave sociologjike të mbledhura në terren, që përmbajtja e ideologjive ka ndryshuar me zhvillimin e shoqërisë, por që ideologjitë vazhdojnë të ekzistojnë. Elaborimi i mëtejshëm i analizës së bërë nga Z. Lami me të cilin biem dakord, mbështetet në argument logjistik kur thekson paradoksin që pavarësisht studiuesve që kundërshtojnë apo vënë në pikëpyetje ideologjinë, nuk mund të ndërtohen analiza të programeve dhe sjelljes politike, pa iu referuar karakteristikave ideologjike.

2.7.1. Ideologjia e partive politike shqiptare

Ideologjia e një partie politike reflektohet në programin e saj, në përfshirjen e tematikave të caktuara dhe alternativat për zgjidhjen e tyre, në raport me interesat e target grupeve elektorale me të cilat identifikohet një parti, por në Shqipëri, partitë shfaqin karakteristika të tjera, pasi në vend që të theksohet diferenca përmes programeve dhe veprimeve institucionale qeverisëse nga parti e majtë apo e djathtë, kemi të bëjmë me të kundërtën, ngjashmërinë. Referuar kontekstit historik, partitë kryesore në Shqipëri kanë bërë kompromise në rrafshin ideologjik për hir të pushtetit, duke e kapërcyer ndarjen parti e majtë/ e djathtë. Për ta përlligjur këtë mund t'i referohemi qeverisjes së PD-së në vitet 1992-1997, periudhë e cila lidhet me nevojën e domosdoshme për të bërë reforma të thella, për ta nxjerrë vendin nga kolapsi ekonomik, por nëse do të studiojmë statusin e anëtarëve dhe mbështetësve të PD-së, mund të themi që identifikohet një përbërje heterogjene, përsa i përket grupeve dhe shtresave shoqërore nga pikëpamja ekonomike, sociale dhe kulturore. “Partia Demokratike”, u ndërtua jo mbi modelin e një ideologjie të një partie të djathtë, por si bashkim forcash të ndryshme kundër komunizmit.

Mandati qeverisës i PS-së pas vitit 1997 nuk linte hapësirë dhe nuk krijonte kushte për t'u udhëhequr nga një ideologji e majtë, pasi situata problematike në të cilën ndodhej Shqipëria, kërkonte patjetër stabilizimin makroekonomik, i cili u arrit përmes ndihmës së institucioneve ndërkombëtare, në zbatimin e reformave të domosdoshme për vendin por që nuk kishin një profil politik të majtë: “Ideologjia e së majtës u transformua duke kaluar nga stalinizmi drejt “socializmit utopik” dhe këtu kemi parasysh vitet 1991 – 1992, ndërsa duke filluar nga viti 1997, ajo shkon drejt një liberalizmi ekonomik dhe

shoqëror të spikatur” (Pëllumbi, 2006:33). Në mandatin e dytë vijues të PS-së dhe gjatë mandateve që rikthyen edhe njëherë të djathtën në pushtet, nga viti 2005-2013, partitë kryesore politike ishin të fokusuar në integrimin e Shqipërisë në organizma ndërkombëtare. Kjo u kthye në çështje primare dhe objektiv kryesor për partitë politike, prandaj rekomandimet e ndërkombëtarëve, ishin paradigmat mbi të cilat u ndërtuan programet qeverisëse dhe ligjërimet e aktorëve politikë si psh, lufta ndaj korrupsionit, e cila trumbetohej nga qeveria e majtë dhe më pas edhe nga ajo e djathtë, duke krijuar premisat për mbështetje të sistemit nga jashtë, por që largonte partitë nga boshti ideologjik përkatës.

Në raport me programet politike të partive politike, studiuesi Fuga shprehet: “Në programet e qeverive demokratike dhe asaj socialiste spikat një inkoherencë e theksuar ideologjike nga çështja në çështje, njëkohësisht, vihet re një dominim i mendimit pragmatist e tejet teknik” (2003).

Një kapërcim i tillë ideologjik shërben që partitë politike konkurrencën e tyre politike, ta ndërtojnë jo mbi programet dhe diferencat e dikotomisë e majtë/ e djathtë, pasi dy partitë rivale më shumë se përmes dallimeve, karakterizohen nga ngjashmëria. Ky faktor është më se i mjaftueshëm që të kuptojmë që mungesa e dallimeve ideologjike reflektohet edhe tek elektorati, pasi partitë nuk i drejtohen më target grupeve, interesat e të cilëve duhet të përfaqësojnë dhe mbrojnë sipas boshtit ideologjik, por elektoratit masiv, i cili është heterogjen, me objektivin e qartë, maksimizimin e votave, ndërsa elektorati nga ana tjetër i jep më përparësi partisë që ofron zgjidhje për interesat personale edhe pse në kuadër të një çoroditje politike, (duke kaluar shpesh në një militantizëm të theksuar), sesa marrëdhënies që duhet të krijohet në kushte normale ndërmjet këtij binomi.

2.7.2. Kultura politike konfliktuale

Në “Fjalorin Politik të Oksfordit” (McLean&McMillan, 2011: 284), termi kulturë politike përkufizohet si qëndrimet, bindjet dhe vlerat, në të cilat mbështetet veprimtaria e një sistemi politik të dhënë, duke përfshirë njohjen dhe aftësinë e shfrytëzimit të sistemit politik, ndjenjat emocionale pozitive dhe negative ndaj tij, si dhe gjykimet vlerësuese.

Termi kulturë politike u përdor për herë të parë nga politologu Gabriel Almond (1956: 391-409), sipas të cilit: Kultura politike nuk përkon me një sistem politik të dhënë apo me shoqërinë, pasi modelet e orientimit ndaj politikës shtrihen përmes kufijve të sistemit politik. Një aspekt i dytë i rëndësishëm për studiuesin është raporti kulturë politike-kulturë, duke shpjeguar që kultura politike nuk është e njëjta gjë si kultura e përgjithshme e një vendi dhe pse është e lidhur më këtë të fundit.

Kultura politike përbëhet nga zakonet, besimet, vlerat, ndjenjat të cilat ndërtojnë dhe rregullojnë sistemin politik, përmes dy elementëve kryesore idealeve politike dhe normave që përdoren për të bërë politikë. Nëse do të studiojmë kulturën politike në vendin tonë duke i'u referuar dy kategorizimeve kryesore, konsensuale dhe konfliktuale sipas studiuesit Lijphart (1999), mund të pranojmë, që kultura politike shqiptare është konfliktuale.

“Rrafshi konceptual i dihotomisë e majtë – e djathtë organizohet mbi paradigme të tipit: fitim – rishpërndarje, politika tregu – politika sociale, private – publike, barazi – individualizëm etj. Si izotopi e gjithë këtij boshti rezulton: e ardhme, zhvillim. Kurse rrafshi konceptual i dihotomisë komuniste – antikomuniste strukturohet mbi paradigma të tipit: kolaboracionist – antifashist, patriot – tradhtar, sigurimsa – të burgosur, dosje – transparencë etj. Si izotopi e këtij boshti rezulton: e shkuar, konflikt” (Gjokutaj, 2012:10.)

Kultura politike konsensuale i referohet konkurrencës për vlera të njëjta, kundrejt të cilave propozohen alternativa të ndryshme, ndërsa kultura politike konfliktuale karakterizohet jo më nga vlerat dhe alternativat e ndryshme të propozuara, por nga lufta për pushtet, e ndërtuar përmes antagonizmit.

Nëse i referohemi qasjes historike të pas viteve 1990, për të studiuar kulturën politike mund të pohojmë, që kultura politike konfliktuale ishte dominuese në Shqipëri. Një konkluzion i tillë përftohet nga studiues të ndryshëm vendas dhe te huaj si dhe organizma të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Partitë politike të identifikuara përmes liderëve përkatës, shfaqin një polarizim të tejskashëm që influencon në krijimin e një kulture politike konfliktuale. Gjurmimi i arsyeve për studiuesin Biberaj(1999), i referohet ndikimit të së kaluarës komuniste që ka krijuar një kulturë intolerance politike, ndërsa për Genc Rulin(2001), normat që rregullojnë aktivitetin politik janë dhunuar në mënyrë të përsëritur.

Studimi i parë sistematik për kulturën politike është studimi i Almond&Verba, të cilët studiuuan sistemet politike dhe demokracinë në pesë vende të ndryshme, përmes intervistave të qytetarëve, në lidhje me këndvështrimet e tyre mbi qeverisjen dhe jetën politike: Për studiuesit, “kultura qytetare është e bazuar në komunikim dhe bindje, një kulturë konsensusi dhe diversiteti, një kulturë që lejon ndryshimin, por që e moderon atë” (1963: 8). Sipas autorëve, transferimi i kulturës politike i demokracive perëndimore në vendet në zhvillim, has vështirësi si rrjedhojë e vetë natyrës së kulturës demokratike në vetvete: “Mënyrat në të cilat elitat politike marrin vendime, normat dhe qëndrimet e tyre..., si dhe të qytetarit të zakonshëm, lidhja e tij me qeverinë dhe me bashkëqytetarët e tij” (1963: 9), - janë komponentë të hollësishëm kulturorë.

Një ndër studiuesit kryesorë të procesit politik dhe fushatave zgjedhore, Preç Zogaj, në një ndër botimet e tij i referohet rolit të aktorëve politike në ngjarjet e vitit 1997, që shërben si tregues për të kuptuar që në Shqipëri mungon një kulturë politike e dialogut: Ligjërimi politik i mbështetur në konceptet e “pajtimit” dhe “bashkëpunimit” përpara zhvillimit të zgjedhjeve ndryshoi, sepse këto koncepte “avulluan si vesa e mëngjesit, humbën vlerën dhe kuptimin fillestar aq sa shkaktonin grimasa dhe ngërdheshje ironike si të ishin fjalë të pista” (2001: 60).

Rasti studimor mbi partitë politike në Poloni, si vend me ngjashmëri në raport me të kaluarën historike komuniste, shfaq karakteristika të ngjashme sepse:

“... Ne kemi një pluralizëm të skajshëm partiak me programe të paqarta partish dhe pa mbështetje popullore... pluralizmi i skajshëm partiak u bë shkas i personalizimit të konflikteve politike...Unë po e quaj atë një sistem të polarizuar, sepse disa parti aspirojnë ti asgjësojnë partitë e tjera dhe ti zhdukin nga skena politike” (Etzioni-Halevy, 2009: 252- 253).

Sipas teoricienes Mouffe (2005:20), ndryshe nga antagonizmi i cili ndërtohet përmes identifikimit të grupit tjetër si armiq, “agonizmi” është një lidhje ‘ne/ata’, ku partitë konfliktuale megjithëse pranojnë që nuk ka zgjidhje racionale të konflikteve, njohin ligjshmërinë e kundërshtarëve politikë. Sipas kësaj qasje, marrëdhënia ‘ne/ata’, nuk duhet të ndërtohet duke i identifikuar ‘ata’ si armiq por si kundërshtarë, që veprojnë brenda së njëjtës hapësirë politike, duke ndarë qëndrime të ndryshme që prodhojnë konflikt brenda hapësirës në të cilën veprojnë, por njëkohësisht duke i dhënë kuptim politikës, pasi shërben si një kategori vendimtare për politikën demokratike.

2.8. Personalizimi partiak në partitë shqiptare

Në studimet politike bihet në dakordësi që partitë politike janë njësia kryesore për lidhjen ndërmjet qytetarëve dhe vendimarrësve politikë, megjithatë edhe pse ky rol pranohet gjerësisht, ndryshimet shoqërore, zhvillimet teknologjike në fushën e komunikimit kanë influencuar që roli i partive politike të ulet dhe të rritet rëndësia e politikanëve si individë, proces i cili shfaqet përmes personalizimit të politikës. Sipas studiuesve Rahat &Sheafer, personalizimi politik është një proces në të cilin: “Pesha politike e aktorit individual në procesin politik rritet me kalimin e kohës, ndërkohë që ajo e grupit politik (partisë politike) bie” (Rahat&Sheafer, 2007:65). Në personalizimin politik mund të identifikohen tre lloje kryesore të personalizimit: Personalizimi institucional, mediatik, dhe personalizimi i sjelljes. Personalizimi institucional në nivel shtetëror do trajtohet si çështje më vete në kapitullin pasardhës, ndërsa në këtë çështje fokusi do bjerë mbi personalizimin partiak.

Në studimet politike bihet në dakordësi për disa parime mbi të cilat realizohet drejtimi i partisë si: “Nevoja për demokraci të brendshme, nevoja për delegimin e përgjegjësive, nevoja e drejtimit në ekip, nevoja për transparencë, ndarja dhe balanca midis strukturave, nevoja për ruajtjen e distancës nga shteti” (Krasniqi&Hackaj, 2014: 24).

Këto parime shërbejnë për forcimin e demokracisë brenda partive politike si dhe mënyrës konstruktive bashkëpunuese ndërmjet strukturave të saj, efektet pozitive të së cilës reflektohen për anëtarët e partisë, për elektoratin dhe për vetë sistemin e demokracisë, ndërsa e kundërta në raport me parimet e sipërmendura është mesazhi negativ, që i përcillet elektoratit e sidomos pasojat në raport me votuesit e lëkundur parë në një optikë më makro, si dhe vendosja në pikëpyetje e efijensës brenda partisë.

Funksionimi i demokracisë së brendshme, ka pasojat pozitive për vetë partinë, ku rritet probabiliteti të zgjidhen udhëheqës dhe liderë të aftë, për elektoratin dhe për vetë sistemin demokratik në tërësi, prandaj në këtë fazë është e natyrshme të shqyrtojmë se si performuan partitë politike në Shqipëri, në raport me demokracinë e brendshme. Nëse i referohemi statuteve të partive në Shqipëri, mund të pohojmë për një mirëfunksionim organizacional partiak, të karakterizuar nga liria e mendimit dhe e drejta e konkurrencës

dhe rivalitetit: “Ata premtuan se askush nuk do të përjashtohet për shkak të rivalitetit dhe të mendimit kundër...” (Krasniqi, 2006: 255).

Por kjo frymë demokratike brenda partisë në nivelin teorik, realisht në nivelin praktik, u shoqërua me problematika, pasi “pas 15 vjetësh, ende partitë politike nuk kanë arritur të sigurojnë standardet demokratike të funksionimit të tyre” (Po aty). Në këtë moment do të analizojmë disa faktorë, një ndër të cilët lidhet me kohëzgjatjen e mandatit të drejtuesit të partisë. Në fillim partitë politike kishin të përcaktuar një kohëzgjatje e cila nuk mund të tejkalonte dy mandate, por ky rregull u ndryshua duke eliminuar kufizimin kohor për kryetarin e partisë, pasi “ato u dhanë të drejtë për zgjedhje, në kohë të pakufizuar, kryetarëve të partive” (Krasniqi, 2006: 258).

Një pushtet i palimituar në kohë për kryetarët e partive politike, sjell pasoja në uljen e konkurrencës brenda partisë, rritjen e militantizmit dhe si konsekuencë zbehjen e meritokracisë. Fuqizimi i kryetarit këssoj manifestohet edhe në momentin e zgjedhjeve brenda partisë, ku përballë vendoset një kandidat, për të krijuar iluzionin e dy apo më shumë alternativave pavarësisht se fitorja e kryetarit ekzistues është e sigurtë. Nëse i referohemi kontekstit historik të partive politike kryesore, kur janë zhvilluar zgjedhjet për një post të tillë, kjo qasje legjitimohet duke përjashtuar dy raste: Rasti i parë konsiston në garën politike që zhvillohet për kryetar të PD-së, ndërmjet Berishës, Cekës dhe Hajdarit dhe rasti i dytë tek PS-ja ndërmjet Nanos dhe Majkos. Këto janë dy rastet e vetme, të një gare të mirëfilltë politike ndërmjet aktorëve politikë të së njëjtës parti, që me vendosjen e sistemit politik pluralist.

Mungesa e demokracisë së brendshme, lirisë së mendimit, konkurrencës në nivelin vleror, mënjanimi të mendimit ndryshe ndikuan në rritjen e militantizmit si dhe në besnikërinë ndaj klanit më të fortë brenda partisë dhe liderit të saj, duke u shndërruar në parti-lider sepse “ato janë më shumë parti të atyre që duan të jenë liderë, sesa parti me rrënjë të thella në shoqëri” (Etzioni-Halevy, 2009: 252).

Në ditët e sotme është bërë i natyrshëm etiketimi i partive politike me emrin e liderit, si Partia e Berishës, e Ramës, e Metës etj duke përligjur edhe përmes kësaj forme, personalizimin e partive politike nga liderët përkatës.

KAPITULLI III

Konteksti historik, mediatik dhe politik

3.1. Ndryshime ekonomike dhe shoqërore në vite

Transformimet ekonomike dhe shoqërore shfaqin karakteristikat e tyre në mandatin e parë qeverisës të djathtë, pasi transformimet që u zhvilluan gjatë qeverisë Nano dhe Bufi, para zgjedhjeve të vitit 1992, kishin një karakter që synonte të ruante statusquonë me zhvillime dhe reforma të ngadalta, pa zëvendësuar paradigmat bazike të ekonomisë apo strukturave të tjera shoqërore.

Gjendja në të cilën ndodhej Shqipëria, në fillim të mandatit qeverisës së djathtë paraqiste problematika serioze, pasi ekonomia ishte në kolaps, me një rënie drastike të prodhimit të brendshëm bruto (GDP), prodhimit industrial dhe bujqësor, rritjes së papunësisë dhe krizës në shëndetësi, prandaj qeveria shpalli një plan ekonomik afatmesëm “për të ndaluar tatëpjetën që kishte marrë prodhimi, për të frenuar inflacionin, për të balancuar buxhetin, për të ringjallur bujqësinë dhe për të siguruar lëndë të parë të domosdoshme që të rifillonin punën sektorët jetësorë të industrisë” (Biberaj, 2011: 259).

Dekreti i nxjerrë nga Ramiz Alia, si rezultat i kontekstit në fillim të lëvizjes antikomuniste për të qetësuar punëtorët u shfuqizua, pasi ky dekret i cili mbështetej në një pagesë prej 80% të pagës për punëtorët që nuk punonin, si rezultat i mbylljes së fabrikave kishte influencuar negativisht në ekonominë shqiptare. Reformat ekonomike të ndërmarra nën qeverisjen e PD-së, sollën përmirsim: “...U ul inflacioni në masën 3-4% dhe të ardhurat për frymë në vitin 1996 arritën në 820\$ nga 220 që ishin 5 vjet më parë” (Fevziu, 2012: 273).

Ndryshimi i sistemit politik, influençoi edhe në ndryshimin e strukturimit shoqëror, e cila fillimisht kishte trajtën e një shoqërie të padiferencuar, apo amorfe, ku shpërbërja e strukturave shoqërore konsiston në:

“Prishje ekuilibrash shoqërorë, zhvendosje të shpejta dhe të pakontrolluara demokratike...Ndryshime në mënyrën e jetës, ku u shpërbënë norma të caktuara jetese dhe shërbimi kolektiv...Lind kështu një shpejtësi e re shoqërore, ajo e sociales” (Fuga, 2008: 83).

Falimentimi i firmave piramidale në vitin 1997 solli pasoja negative në të gjitha parametrat ekonomikë, politikë dhe shoqërorë të vendit, ku protestat e popullit kundër qeverisë, tejkaluan pushtetin qeverisës, duke e detyruar qeverinë të bjerë.

Fitorja e PS-së në zgjedhjet e parakohshme të mbajtura në qershor 1997, nuk ishte e lehtë të menaxhohej, për një sërë arsyesh: Vrasja e Azem Hajdarit në shtator 1998 e cila u shoqërua me trazira, cënim institucionesh apo sikurse u emërtua ndryshe “grusht shteti”, përplasjet e brendshme në parti dhe në qeveri, janë tregues mbi vështirësinë e ndërmarrjes së reformave ekonomike për zhvillimin e vendit.

Gjatë këtij mandati qeverisës, nën drejtimin e Metës si kryeministër në vitin 1999, shënohet rritja ekonomike më e madhe, e dhjetëvjeçarit 1990-2000, në nivelin 13, 5%.

Periudha deri në vitet 2000 mund të konsiderohet si periudhë e rëndësishme e historikut shqiptar pasi është periudhë ndryshimesh dhe përmbyesjesh e modelit politik, ekonomik dhe shoqëror ekzistues, pasi siç shprehet studiuesi Fuga, përgjatë këtyre viteve përfundon, “etapa e parë e tranzicionit paskomunist ose periudha e tranzicionit institucional... Ndryshimet do të vazhdojnë për një kohë të gjatë, por institucionet demokratike gjithsesi janë hedhur” (2008:11).

Për periudhën 2001 dhe në vazhdim pavarësisht përpjekjeve për fokusin tek reformat ekonomike, vendimet politike në funksion të mbrojtjes së interesave personale, nuk krijuan kushtet e favorshme për zhvillimin e saj, edhe pse pati përmirësime. Mandati i parë qeverisës pas rikthimit në pushtet të PD-së u shoqërua me përpjekje, të cilat dhanë rezultat në rritjen ekonomike të vendit, si dhe në uljen e numrit të papunësisë.

Parë nga një këndvështrim makro, pavarësisht përmirësimeve, faktorët që influencojnë negativisht në zhvillimin ekonomik të vendit janë të ndryshëm por po listojmë disa që vijnë si rezultat i elementëve ekonomikë dhe politikë si: infrastrukturë e papërshtatshme, tarifa doganore të larta, orientim i tregut pa përfshirë teknologjinë, mungesë investimesh dhe reformash në plan afatgjatë, sistem politik problematik i bashkëshoqëruar me korrupsion apo mungesë kulture etj.

Përsa i përket shoqërisë studiuesi Wesolowski, i cili i referohet Polonisë si rast që përfaqëson dinamikat e Europës Lindore thekson “niveli i ulët i pjesëmarrjes së

qytetarëve në proceset transformuese është tipar i përbashkët i situatës në të gjitha vendet paskomuniste të Europës qendrore dhe lindore” (Etzioni-Halevy, 2009: 256). Konkluzion mëse i drejtë, pasi edhe në vendin tonë pjesëmarrja dhe qëndrimi i qytetarëve është pothuajse inekzistent në programet dhe zhvillimet politike e shoqërore.

Të gjitha këto zhvillime na japin tabllo të një tranzicioni të tejzgjatur, në të cilin formësohet dhe hedh bazat pushteti i katërt, ai i medias, i cili nuk mund të analizohet dhe kuptohet jashtë këtij konteksti.

3.2. Elitat dhe roli i tyre në shoqërinë shqiptare

Për të kuptuar rolin e elitave në shoqërinë shqiptare, do të drejtohem i qasjes historike: Etapat historike të marra në analizë i referohen republikës së parë në vitet 1920-1924, rregjimit të Zogut si republikë dhe më pas kalimi në monarki, Lufta e Dytë Botërore dhe pushtimi fashist, regjimi i Hoxhës për të përfunduar me periudhën e ndryshimeve pas viteve 90 dhe shembjen e komunizmit.

Në secilën nga këto periudha studiohet roli i elitave, duke evidentuar karakteristikat përkatëse: Përveç elementëve të tjerë influencues për të mundësuar krijimin e një shteti kombëtar shqiptar, elita në periudhën 1920-1924 nuk pati sukses, pasi kontributi i tyre në mjaft raste u fokusua tek interesat personale dhe pushteti: “Inteligjenca e atëhershme ishte një inteligjencë mësimdhënëse, me prirje ekzaltuese kombëtare, por së cilës i mungonte elementi udhëheqës me karakteristika komplekse politike e statiste” (Rama, 2006: 8).

Vitet nën udhëheqjen e Zogut na drejtojnë drejt një diferencimi elitar, shumë prej të cilëve u larguan në mërgim dhe më tepër u fokusuan tek lufta ndaj Zogut dhe asaj çfarë ai përfaqësonte, se sa tek interesat kombëtare. Kleri Katolik që përbëhej nga një shtresë elitare, ishte një entitet që karakteristika kryesore kishte autonominë dhe disidencën, edhe pse jo në mënyrë direkte, ndërsa intelektualët përfaqësues të jugut, edhe pse në kundërshti me Zogun nuk sollën ndryshime përse i përket strukturimit të shoqërisë, por kontribuan “në konsolidimin e nacionalizmit kulturor mbarëshqiptar” (Rama, 2006: 9), përse i përket traditave dhe vlerave mbi të cilat duhet të ngrihet shoqëria.

Periudha gjatë luftës së dytë botërore është një periudhë e cila karakterizohet nga dy kampe kryesore, ato që përkrahën sistemin dhe ato të cilët e kundërshtuan atë, por jo më aq e theksuar si më përpara, ndërsa ardhja e Partisë Komuniste në pushtet u shoqërua me vendosjen e një sistemi totalitar, ku u ndërmorën masa të ndryshme, shpeshherë ekstreme, në raport me shtresa të caktuara shoqërore, duke përfshirë edhe elitat e kohës, të cilat u zëvendësuan nga elita të reja. Elitat e reja”karakterizoheshin jo nga cilësia reale që ato ofronin, por nga besnikëria ndaj vijës së partisë, duke ushtruar propagandë... në dobi të legjitimitetit të pushtetit” (Godole, 2014:21).

Nëse do të përmblihdhnim shkurtimisht atë se çfarë paraqitëm deri tani, mund të arrijmë në konkluzionin, se deri në vitet 1990 elitat nuk kanë patur një traditë të suksesshme disidence politike, duke përfshirë edhe faktorët influencues në këtë qasje.

Një rol të rëndësishëm në zhvillimin e shoqërisë luajnë elitat politike që e përbëjnë atë. Në funksion të këtij argumenti, Wesolowski studion rastin e Polonisë në momentin kur po mbyllet një etapë dhe po fillon një tjetër, si rast që përfaqëson dinamikat e Europës Lindore, me fundin e komunizmit.

Ai merr në studim elitat politike të vendit, gjatë tranzicionit në ndërrimin e sistemeve politike. Pjesë e studimit janë elitat të cilat nënshkruajnë marrëveshje dhe kanë një ndikim të rëndësishëm, mes tyre elitën e vjetër e cila humb pushtetin dhe elitën e re që lidhet me sistemin e ri. Ndryshe nga vendet e tjera që paraqesin karakteristika më të qëndrueshme, në vendet e Europës Lindore, ndryshimi i sistemit politik influencon në ndryshimin rrënjësor të sistemit ekonomik referuar strukturës klasore si dhe elitave politike. E veçanta e elitave, është që nënshkrimi i një marrëveshje ndërmjet tyre, përkthehet në humbje të pushtetit dhe identitetit politik për elitat përfaqësuese të sistemit komunist. Ndërsa në Shqipëri “ky transformim ishte minimal dhe elitat ekzistuese vazhduan të mbeten në fuqi me gjithë kolapsin e rregjimit të vjetër”(Godole, 2014:21).

Ndryshimet që solli rënia e komunizmit, sollën dy komponentë të cilët në një shoqëri demokratike janë të rëndësishëm, media e cila nuk ishte më nën kontrollin e partisë-shtet, si dhe intelektualë të cilët kishin hapësira të reja për tu shfaqur dhe për tu shprehur.

Duke i'u referuar teorisë së komunikimit së përpunuar nga Katz dhe Lazarsfeld (1955), evidentojmë dy elementë, median dhe personin e mirëpërgatitur, i cili kthehet në lider të opinionit publik. Mesazhet që përcjell media, dekodifikohen, përpunohen nga këta liderë, të cilët ia transmetojnë më pas opinionit publik, aq sa sipas kësaj teorie, shpesh janë këta liderë të cilët shihen si më të besueshëm nga opinioni publik edhe se vetë media.

Në kontekstin shqiptar intelektualët të cilësuar si liderë të opinionit publik shfaqin tipare të tjera, duke qëndruar më afër medieeve se sa publikut, pasi pikërisht prej tyre arrijnë që të marrin përfitimet e të emërtuarit lider. Pa dashur të cënohet përgatitja apo shkalla e njohurisë dhe e kulturës së tyre, janë këta individë, të cilët janë pjesë e paneleve apo hapësirave në media në mënyrë sistematike, duke vënë në diskutim karakteristikat kryesore që një lider duhet të ketë, besueshmërinë dhe njohje të plotë mbi problematikat e trajtuara.

3.3. Personalizimi institucional

Një shtet nuk mund të performojë pa institucionet të cilat ngrihen në funksion të qëllimeve të caktuara si një “tërësi e normave dhe rregullave, ku bazohet organizimi dhe funksionimi i një shteti” (Kabo, 2006: 221). Dallimi thelbësor duke iu referuar këtij koncepti lidhet me marrëdhënien që krijohet në vende të ndryshme midis individit dhe institucionit, ku nga njëra anë janë vende të cilat performojnë sipas këtij roli dhe nga ana tjetër vende të cilat nuk e zbatojnë, por që drejtohen drejt personalizimit të institucionit.

Ky fenomen ndodh dhe është mjaft problematik edhe në vende ku rregullat ligjore janë të mirëpërcaktuara, të cilat operojnë “si shoqëri njerëzore që përpiqen të shndërrohen në shtet, përmes largimit nga pushteti i individit, për të mbërritur tek pushteti i zgjedhur, që funksionon me institucione ligjore” (Po aty).

Përsa i përket institucioneve, nën udhëheqjen e Berishës deri në ngjarjet e vitit 1997, studiuesi Rama paraqet panoramën si mëposhtë:

“Kështu shqiptarët nuk e aprovuan lëvizjen politike të Berishës për të anashkaluar Kuvendin Popullor, forumin vendimarrës e ligjvënës, ku Berisha nuk e kishte shumicën për me kaluar një Kushtetutë Presidenciale, që sipas opinionit të kundërshtarëve të tij, do ta fuqizonte atë pothuajse sa një diktator romak” (Rama, 2006: 45).

Sipas kësaj qasje, objektivi kryesor i Berishës ishte personalizimi i pushtetit, duke përdorur të gjitha mënyrat e mundshme, si ngritja e policisë së fshehtë si njësi paralele e asaj ekzistuese, ku vendimarrjen nuk e kishin institucionet ligjore, por ai vetë, strategji të tërthorta si arrestime, rrahje etj, pa harruar dhe mjetet e informimit televizionin dhe shtypin e shkruar.

Miratimi i ligjeve si, Ligji për Genocidin, (duke përdorur dosjet) eliminonte një numër të madh rivalësh për Berishën nga PS për zgjedhjet për president, ndryshimi i Ligjit Elektorale në shkurt të vitit 1996 synonte të dobësonte fuqinë e partive të vogla, ndërsa ndryshimi i kufijve të zonave elektorale u ndërtua në mënyrë të tillë që të favorizonte PD-në.

Institucionet nën drejtimin e qeverisë socialiste në vitet 1997-2005, nuk mund të themi se patën një zhvillim apo demokratizim në funksionimin e tyre, për vetë tensionet politike brenda forcës së majtë, por edhe jashtë saj. Z.Fatos Nano kryetari i Partisë Socialiste në ato vite, u emërua kryeministër nga Presidenti Mejdani, pas fitores në zgjedhjet e parlamentare të 29 qershorit '97, duke zëvendësuar Bashkim Finon, si Kryetar i Qeverisjes së Pajtimit Kombëtar. Kriza institucionale si rrjedhojë e mosmarrëveshjeve të brendshme në PS si dhe vrasja e Azem Hajdarit, një ndër themeluesit e PD-së, sollën zëvendësimin e kryeministrit Nano me një figurë tjetër socialiste Pandeli Majko. Mandati i dytë vijues qeverisës për të majtën rikthen Nanon për të tretën herë kryeministër, në vitin 2002, deri në zgjedhjet e ardhshme të cilat, fitohen nga kundërshtarët politikë. Duke parë ecurinë politike të kësaj periudhe, nuk mund të flitet për ndonjë ndryshim të rëndësishëm, në funksionimin e institucioneve, të cilat më së shumti ishin të fokusuar për të përballuar situata të jashtëzakonshme që përsëriteshin.

Institucionet nën drejtimin e qeverisë demokratike 2005-2013. Mandati i parë qeverisës pas rikthimit në pushtet të PD-së u shoqërua me përpjekje, të cilat dhanë rezultat në rritjen ekonomike të vendit, në uljen e numrit të papunësisë, në përmirsimin e infrastrukturës, në luftën kundër korrupsionit si dhe në zbatimin e reformave, ndërsa përsa i përket institucioneve nuk mund të thuhet e njëjta gjë. Përplasja e kryeministrit dhe kryetares së parlamentit, me presidentin Moisiu, pas refuzimit të tij të dekretimit të ligjeve të miratuara nga parlamenti dhe refuzimi për shkarkimin e kryeprokurorit

Sollaku, influencuan në marrëdhëniet mes institucioneve. “Berisha u bë subjekt i kritikave në rritje, nga brenda dhe jashtë vendit, për shkak të asaj që shihej si përpjekje e tij për të ushtruar kontroll mbi institucionet e pavarura” (Biberaj, 2011: 494).

Parë në këtë këndvështrim, mund të themi se kjo periudhë u karakterizua nga tendenca për personalizimin e institucioneve dhe vendosjen e një autoritarizmi personal. Duke iu referuar profesor Kabos (2006: 222), në Shqipëri problematika lidhet me vendosjen e individëve në pozita të caktuara drejtuese, të cilat nuk janë në raport të drejtë me njohuritë e tyre, formimin intelektual etj. Kjo shpie në përvetësimin e institucionit, i cili prodhon emërime apo politika të caktuara në emër të aleancave dhe interesave personale. Me zhvillimin e komunikimit dhe strategjive të përzgjedhura marketingu apo marrëdhëniesh me publikun, çdo kritikë ndaj personit interpretohet si kritikë ndaj institucionit.

Konteksti historik në Shqipëri lidhet me rregjime, të cilat kanë influencuar negativisht, që shoqëria shqiptare të veprojë në raport me kërkesën e saj kundrejt “autoritarizmit personal” i cili shfaqet si rrjedhojë e faktorëve të ndryshëm. Shkalla apo niveli i ulët kulturor i individëve që ndodhen në rangje hierarkike të larta, mungesa e vizioneve dhe një konceptualizim i varfër, i përforcuar dhe nga një vetëbesim që superon çdo element pengues në këtë proces.

“Fryma e bashkëpunimit, marrëveshjet dhe konsensusi ia ngushtojnë hapësirën autoritarizmit individual apo kolektiv, partiak apo shtetëror, propogandistik apo pushtetar. Por një klimë e tillë lyp kulturë dhe tolerancë, ndjenjë përgjegjësie dhe respektim të institucioneve. Por kur Kushtetuta, ligji themeltar, nuk është aprovuar me konsensus dhe hapur mohohet nga opozita e djeshme, kur politikat kombëtare të punës, pronës, pagesave, pensioneve, buxhetit shpesh të politikave të jashtme, rajonale apo më gjerë, nuk kanë gjetur unison mes forcave politike. Ja përse autoritarizmi është ende pjesë e realitetit politik dhe jetës së institucioneve në Shqipëri” (Kabo, 2006 : 224).

Gjatë viteve të post komunizmit në vendin tonë, në përgjithësi ka mbizotëruar e njëjta klimë dhe frymë nga të dyja forcat kryesore që kanë qenë në pushtet, si majtas dhe djathtas, përse u përket mënyrës së funksionimit të institucioneve. Kushdo që vihet në një post, si shpërblim partiak e shikon zyrën e institucionit si pronë private, ku ka të drejtë të heqë e të emërojë punonjës sipas dëshirës.

3.4. Zgjedhjet parlamentare në Shqipëri pas vitit 1990

Shqipëria doli nga një rregjim komunist, i cili zgjati pothuajse 50 vite, ku partia shtet kishte në dorë çdo pushtet të mundshëm. Rënia e simotrave të saj në vendet e tjera, u ndje edhe në Shqipëri, duke bërë të mundur lindjen e një lëvizje që aspironte për demokraci. Lëvizja studentore që u krijua dhe mbushi sheshet në një revoltë masive, ku i'u bashkua i gjithë populli, solli përmbyesjen e rregjimit komunist. Kjo përmbyesje e sistemit, ndryshe nga vendet e rajonit, në vendin tonë u zhvillua relativisht në mënyrë paqësore.

Zgjedhjet e vitit 1991

Këto ishin zgjedhjet e para pluraliste në vendin tonë, ku “Partia e Punës” kishte një opozitë reale të drejtuar nga dy partitë kryesore, “Partia Demokratike” dhe “Partia Republikane”. Problematikat në listat e votuesve, shfrytëzimi i medias shtetërore si burim i rëndësishëm nga qeveria, për influencimin e opinionit publik, kërcënimet dhe frikësimet që ushtroheshin mbi një popull të sapo dalë nga rregjimi më i egër totalitar, ishin disa nga arsyet që liderët e opozitës të deklarorin që më përpara se zgjedhjet nuk do të ishin të lira.

“Partia e Punës” siguroi fitoren përmes rolit që luajti ‘fshati’, pasi banorët në zona të tilla i dhanë një mbështetje absolute, duke siguruar 169 nga 250 vende në parlament. Arsyet e kësaj mbështetje përveç të tjerave, lidhen me strategjitë e përdorura nga qeveria në menaxhimin e informacionit të përcjellë, kundër opozitës dhe liderëve të tyre, përmes kontrollit të plotë të Radio Televizionit Shqiptar, si i vetmi televizion në vend dhe gazetave pro qeveritare.

Megjithë strategjitë e përdorura për të fituar zgjedhjet, vazhdimi i mandatit qeverisës rezultoi i pamundur për një sërë arsyesh, të cilat influencuan në dorëheqjen e qeverisë së Fatos Nanos dhe krijimin e një qeverie të përkohshme koalicioni, nën drejtimin e Ylli Bufit.

Zgjedhjet e parakohshme të vitit 1992

Qeveria e përkohshme e koalicionit e cila u krijua deri në zgjedhjet e ardhshme, nuk ishte e aftë të menaxhonte problemet me të cilat filloi të përballej vendi në atë periudhë,

si papunësia, kriza shoqërore, shkatërrimi i ekonomisë apo bindjen e opinionit publik, se qeveria po punonte për pasurimin e figurave politike, të cilët po përfitonin përmes korrupsionit apo privatizimit.

Dy nga figurat kryesore të Partisë Demokratike, Sali Berisha i cili ishte kryetar i partisë dhe Gramoz Pashko zëvendëskryeministër, nuk ishin në të njëjtën linjë përse i përket qëndrimit në raport me palën tjetër. Nëse Gramoz Pashko kishte një qëndrim më të butë, i cili u klasifikua si majtist brenda të djathtës, Sali Berisha përdori një strategji tjetër, e cila përmes bashkëpunimit me forca të tjera opozitare dhe sindikata, kërkonte me ngulm çrrënjosjen e komunizmit, si alternativa e vetme e duhur, për një demokraci të vërtetë.

“...Kërkonte shpërndarjen e Sigurimit, reforma të thella në Ministrinë e Punëve të Brendshme, gjyqin e ish-anëtarëve të Byrosë Politike, heqjen e të gjitha emblemave dhe simboleve të sundimit komunist dhe zhdëmtim të ish-të burgosurëve politikë” (Biberaj, 2011:175). I mbështetur nga ndërkombëtarët dhe nga anëtarët e Partisë Demokratike, Berisha fitoi të drejtën për të qëndruar kryetar i saj.

Pas një gare të zhvilluar për drejtimin e partisë, mbështetur nga sindikatat, si dhe nga populli, Sali Berisha në krye të opozitës, ia doli të fitonte zgjedhjet e vitit 1992, të cilat ishin më të rregullta dhe më të lira e demokratike, se ato të zhvilluara një vit më parë.

Pavarësisht përpjekjeve, ndërrimi i sistemit përtej dëshirës së madhe për demokraci, i gjeti shqiptarët të papërgatitur, duke përfshirë këtu dhe drejtuesit e asaj që lindi si opozitë e sistemit, përse i përket reformave politike, ekonomike dhe shoqërore, pasi mungesa e një tradite demokratike, trashëgimia nga e kaluara komuniste, mendësia në raport me zbatimin e ligjit, mungesa e një vizioni të qartë politik ishin vetëm disa nga problematikat e evidentuara të kohës.

Zgjedhjet 1996

Zgjedhjet parlamentare të zhvilluara në vitin 1996, që u fituan nga Partia Demokratike, duke i siguruar asaj mandatin e dytë qeverisës, u shoqëruan me incidente, me vjedhje votash, me votimin më shumë se një herë të të njëjtit person etj, prandaj PS u tërhoq nga gara dhe i quajti zgjedhjet të parregullta, duke kërkuar përsëritje votimi në zona ku

problematikat ishin më të mëdha. Rezultati prodhoi një numeracion të tillë: nga 140 vende që ishin në parlamentin shqiptarë, 122 vende ishin deputetë që përfaqësonin Partinë Demokratike, 10 vende ishin deputetë që përfaqësonin Partinë Socialiste dhe pjesa tjetër përfaqësuese vinte nga partitë e vogla.

Zgjedhjet e parakohshme të vitit 1997

Ngjarjet që pasuan në vitin 1997, ishin ngjarje të cilat erdhën si rezultat i një sërë faktorësh, por që shkakun kryesor e gjetën tek lekët e humbura në firmat piramidale, gjatë qeverisjes së Berishës. Sjellja politike e qeverisë, mungesa e besimit ndërmjet partive politike tek njëra-tjetra, pakënaqësia e Partisë Socialiste si e vetmja opozitë, e cila mezi priste që pasojat t'ia delegonte qeverisë, janë disa nga argumentet më të mira për të kuptuar situatën konfliktuale të atij momenti historik, e cila u shoqërua me pasoja të rënda për shoqërinë shqiptare.

Në një analizë të shkurtër të drejtuesve të dy partive politike kryesore kuptohen qëndrimet e tyre në një Shqipëri të shkatërruar, Berisha kërkon të mbajë pushtetin dhe të vetëzgjidhet president, ndërsa Fatos Nano i rreshtuar përkrah “kryengritësve” në jug të Shqipërisë, ofron mbështetje në emër të një luftë të drejtë për të, që zhvillohet në emër të demokracisë. *Zgjedhjet e parakohshme që u zhvilluan në vitin 1997*, si pasojë e situatës problematike, gati në kufijtë e një lufte civile, prodhuan një fitore të thellë të “Partisë Socialiste” me mbi 65% të votave të përgjithshme.

Zgjedhjet e vitit 2001

Zgjedhjet e mbajtura në vitin 2001, u fituan nga “Partia Socialiste”, e cila shfrytëzoi të gjitha mekanizmat për një rezultat të tillë, edhe pse në dëm të parimeve dhe rregullave demokratike. Forca e mandatit qeverisës e ndërthurur me presionin e ushtruar, si dhe mbështetja nga ndërkombëtarët, të cilët ishin kundër rikthimit të Berishës në pozitë, u përdorën për të siguruar mandatin vijues. “Zgjedhjet patën mangësi serioze: për të plotësuar procesin u deshën pesë raunde votimi. Partia Demokratike i akuzoi socialistët për manipulimin e zgjedhjeve” (Biberaj, 2011:486). Edhe këto zgjedhje ashtu si zgjedhjet e mëparshme u shoqëruan me akuza nga pala kundërshtare, për parregullsi dhe manipulim të votës së lirë.

Zgjedhjet e vitit 2005

Zgjedhjet e zhvilluara në vitin 2005 rikthyen sërish në krye të qeverisjes së vendit “Partinë Demokratike”, pas dy mandatesh nën qeverisjen e “Partisë Socialiste”. Mobilizimi i kësaj force politike përmes një fryme të re, e cila u reflektua në ndërtimin e imazhit të ri të partisë dhe të liderit të saj Sali Berishës (edhe në raport me ndërkombëtarët), pakënaqësia e popullit kundrejt qeverisjes socialiste, si dhe përçarjet e brendshme të “Partisë Socialiste”, ishin faktorët kryesorë që ndikuan në rezultatin e zgjedhjeve.

Në Partinë Demokratike u ngrit Komiteti i Orientimit të Politikave (KOP), i cili ishte një grup me përfaqësues nga shoqëria civile, që luajti një rol të rëndësishëm në ndërtimin e platformës elektorale për zgjedhjet e viti 2005, ku tematikat kryesore ishin punësimi, ekonomia, lufta kundër korrupsionit, si dhe politika e jashtme që përqëndrohej tek forcimi i marrëdhënieve me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Europian.

Zgjedhjet e vitit 2009

Zgjedhjet e vitit 2009, siguruan mandatin e dytë qeverisës për Partinë Demokratike, në bashkëpunim me forcat e tjera politike të koalicionit (nën emërtimin Aleanca për Ndryshim) dhe LSI-në, e cila erdhi si rrjedhojë e një vendimi që shkaktoi habi në opinionin publik, pasi Meta kishte qënë një ndër kritikët më të mëdhenj të Berishës. Para zhvillimit të fushatës zgjedhore, ai kishte kritikuar të dy liderët kryesorë, strategji të cilën e ndryshoi gjatë zhvillimit të fushatës me objektivin e qartë të krijimit të një koalicioni paszgjedhor me Partinë Socialiste, por refuzimi nga kryetari i opozitës Z.Rama, si dhe mungesa e numrit të domosdoshëm të deputetëve për krijimin e qeverisë nga Berisha, çuan në koalicionin PD-LSI.

“Partia Socialiste” me në krye liderin e saj Z. Rama kontestuan rezultatin zgjedhor, pasi e klasifikuan të parregullt dhe të manipuluar përmes formave të ndryshme si: Bojkotimi i parlamentit nga deputetët socialistë, organizmi i protestave dhe i grevës së urisë.

Zgjedhjet e vitit 2013

Zgjedhjet e vitit 2013 siguruan fitoren e koalicionit të majtë, ku përveç partive të tjera u bashkua edhe LSI, e cila rriti potencialin dhe rëndësinë e saj në arenën politike, por rriti njëkohësisht edhe pakënaqësitë e socialistëve, lidhur me lojën e saj politike.

Sipas rezultatit të certifikuar nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve për zgjedhjet elektorale, doli fitues koalicioni i majtë Aleanca për Shqipërinë Europiane, i cili do të përfaqësohej në Kuvendin e Shqipërisë me 83 mandate deputetësh. Ndërsa forca opozitare tashmë, koalicioni i djathtë Aleanca për Mirëqenie dhe Punësim do të përfaqësohej me 57 deputetë, e cila nuk shfaqti kontestime të mëdha në raport me rezultatin zgjedhor, siç ndodhi në zgjedhjet paraardhëse, përveç vonesës së shkaktuar nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, në certifikimin përfundimtarë të zgjedhjeve.

3.5. Vlerësimet e ndërkombëtarëve

Për vetë kontekstin dhe kushtet në të cilat është zhvilluar politika shqiptare, që pas ndryshimit të sistemit politik në fillim të viteve 1990, roli i ndërkombëtarëve si palë e tretë mbi forcat politike ka qenë gjithmonë i rëndësishëm dhe i vazhdueshëm përmes: bashkëpunimit, këshillimit apo dhe monitorimit.

Në zgjedhjet e 1996 zyra e OSBE-së, monitoruese e zgjedhjeve doli më një deklaratë të tillë:

“Megjithëse ligjshmëria e Kuvendit të ri të zgjedhur shqiptar nuk mund të vihet në dyshim, procesi elektoral kishte edhe disa veçori e incidente që e venë në pikëpyetje serioze kredibilitetin e procesit demokratik në këtë vend... Qeveria dhe të gjitha partitë e ndajnë njëllëj përgjegjësinë për të” (Rama, 2006:51 cituar nga <http://www.USSD-Rights/96/Albania96.html>)

Nisur nga ky vlerësim negativ për demokracinë dhe asparitat europiane, drejt të cilave tentohej të shkohej, vlerësimi për zgjedhjet e vitit 2009 dhe 2013, padyshim që tregon se procesi zgjedhor në Shqipëri ka ardhur duke u përmirësuar edhe pse mbetet ende punë për tu bërë. Për të pasur një panoramë konkrete të vlerësimeve që kanë bërë organizmat ndërkombëtare në këtë rast OSBE/ ODIHR-i, si organizmi kryesor në fushën e vëzhgimit të zgjedhjeve, do të paraqesim shkurtimisht pjesë nga raportet përfundimtare paszgjedhore.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2009 ka përmirësime përsa i përket kuadrit ligjor, i cili u miratua me konsensusin dhe dakordësinë e partive kryesore, apo rregjistrimi i zgjedhësve në rang kombëtar, duke i'u referuar rregjistrimit elektronik. Këto arritje u zbehën nga problematikat që shoqëruan procesin e votimit dhe të numërimit, gjë që u shoqërua me bllokimin e procesit të numërimit në zona të caktuara, por gjithsesi duhet theksuar se zgjedhjet e vitit 2009 përmbushën shumicën e standardeve të kërkuara nga ndërkombëtarët edhe pse u shoqëruan me problematika.

Një pikë e rëndësishme vëzhgimi e organizmave ndërkombëtarë gjatë zgjedhjeve, është edhe *media*, për të kuptuar se si i respekton ajo parimet e pavarësisë në përputhje edhe me legjisllacionin. Mediat kryesore perceptohen si media që shfaqin anshmëri, kryesisht në favor të njërës nga dy partitë kryesore, gjë që reflektohet edhe në cilësinë e ligjërimit mediatic përmes censurës, autocensurës, apo prezantimit të anshëm të ngjarjes, si rezultat i presioneve politike apo interesave të dyanshme të politikanëve dhe pronarëve të medias.

Monitorimi mbi median e shkruar (gazetat “Shqip”, “Panorama”, “Gazeta Shqiptare” dhe “55”) nga vëzhguesit e OSBE/ODIHR arriti në përfundime të tilla si:

“Në Shqipëri ka një larmi gazetash, shumica e të cilave shprehin preferencën e tyre për një parti të caktuar politike. Një gamë pluraliste gazetash shërben për t'i informuar votuesit rreth zgjedhjeve. Gazetat e monitoruara treguan një preferencë të konsiderueshme gjatë periudhës përpara fushatës në lidhje me pasqyrimin e PD-së dhe PS-së. Ndërkohë që të gjitha gazetat e monitoruara ia kushtuan PD-së pjesën më të madhe të hapësirës për lajmet, toni i pasqyrimin ndryshonte nga njëra gazetë tek tjetra. Të gjitha gazetat e monitoruara, përveç 55-ës treguan njëanshmëri në favor të PS-së” (Misioni i OSBE/ODIHR, 2009:19).

Zgjedhjet e vitit 2013 u cilësuan si zgjedhje konkurruese edhe pse polarizimi i skajshëm ndërmjet aktorëve politikë u reflektua në procesin zgjedhor. Në raport me performancën e medias, situata mbetet e ngjashme me atë të para katër viteve, ku ndikimi politik vazhdon të cënojë cilësinë editoriale, tashmë i legjitimuar përmes një vendimi nga KQZ, i cili detyron mediet të transmetojnë materiale të gatshme në edicionet informative, të përgatitura nga partitë politike. Përveç kohës së dhënë dy subjekteve kryesore politike e cila ishte më shumë nga sa duhej, elementë të tjerë të rëndësishëm sipas monitorimit të OSBE-së ishin edhe masat e munguara ndëshkuese nga organet kompetente për këtë gjë. Në raport me median e shkruar monitorimi mbi

shtypin e shkruar konkludon në anshmëri politike, “mediat e shkruara treguan njëfarë polarizimi, ku gazetatat “Shqip” dhe “Shqiptarja.com” kryesisht favorizonin opozitën ndërsa gazeta “Panorama” partinë qeverisëse në pushtet” (Misioni i OSBE/ODIHR, 2013:18).

Duke marrë parasysh raportimin nga ndërkombëtarët, por edhe duke e prekur çdo ditë këtë realitet, duhet thënë, se sfidat kryesore me të cilat duhet të përballlet sektori i medias përfshijnë dobësitë e kuadrit ligjor, forcimin e pavarësisë së saj, për shkak të ndërhyrjeve politike dhe ekonomike. Ndërvarësia në rritje ndërmjet trekëndëshit media, politika dhe biznesi, ka dëmtuar dhe vazhdon të dëmtojë pavarësinë e medias. Dy faktorë kryesorë janë mëse të mjaftueshëm për të kuptuar pozicionin e medias. Së pari, reklamat janë një ndër burimet kryesore monetare për një organ mediatik, prandaj nëse hapësira mediatike e blerë dominohet nga institucionet shtetërore, kjo na shpie drejt premisë që media nuk ka asnjë lloj interesi të çënojë diçka përmes së cilës siguron të ardhura. Së dyti, një përqindje e konsiderueshme e pronarëve të medieve që operojnë në Shqipëri janë biznesmenë që aktivitetin e tyre tregtar e kanë të shtrirë në fusha të ndryshme, prandaj më tepër se për të siguruar të ardhura përmes reklamës, shtypi i shkruar synon të mbrojë aktivitetet e tjera tregtare të pronarit dhe benefitet që rrjedhin si pasojë e një raporti të mirë media-politika.

Për të përmbledhur një opinion sesi e shohin ndërkombëtarët, situatën e medias në raport me zgjedhjet dhe sfidat për tu përballur në të ardhmen, po citojmë Aidan White, Drejtor i Rrjetit për Gazetarinë Etike, me qendër në Bruksel, në një intervistë dhënë për DW.

“Më e rëndësishme është që vetë media të marrë përsipër përgjegjësitë e veta... Të jenë të hapura dhe transparente ndaj çështjeve të pronësisë së medias dhe përkatësisë politike, ata duhet të shmangin rënien në kurth, duke u bërë zëri i marrëdhënieve publike të kompanive të biznesit.

Në fund të fundit gazetarët nuk mund të mbështeten tek shteti që t'u japë lirinë e shprehjes...Por, që media të luajë rolin e saj në demokraci ka rolin e vet edhe qeveria. Ajo duhet të krijojë një mjedis ligjor që të lejojë lirinë e shprehjes. Në Shqipëri janë shqetësuese kushtet e punës së gazetarëve, ata janë të paguar keq, të kërcënuar, ka autocensurë, nuk zbatohet si duhet kodi i punës, qeveria dhe komuniteti i medias duhet të fillojë të mendojnë që të drejtat e gazetarëve të zbatohen, përndryshe nuk mund të krijohet ajo lloj gazetarie që i duhet demokracisë dhe perspektivës europiane të Shqipërisë” (<http://www.dw.de/blerja-e-mediave-n%C3%AB-ballkan-nga-elitat-politike-antidemokratike-e-rrezikshme/a-16616212>).

Megjithë problemet që paraqitëm, po t'i referohemi raportimit të zgjedhjeve të vitit 1996, vërehet një përmirësim në rritje të situatës zgjedhore dhe raportimit të medias në përgjithësi. Në zgjedhjet e vitit 2009, pati kontestime të zgjedhjeve dhe parregullsi gjatë procesit, ndërsa në 2013 kjo nuk vihet re, përveç disa rasteve të pakonsiderueshme. Edhe situata mediatike ka një përmirësim, por më të ulët, prandaj ka ende sfida për të realizuar, për të ndjekur rekomandimet e ndërkombëtarve, të cilët luajnë një rol shumë të rëndësishëm dhe parimet e vetë medias, për një informim të lirë dhe demokratik.

3.6. Fazat e zhvillimit të medias në Shqipëri, pas viteve 1990

Historia e medias së shkruar, por edhe asaj audovizive, është e mbushur me periudha, ngjarje dhe data, që kanë lënë gjurmën e tyre në zhvillimin e saj, përmes fazave të caktuara:

Gazetat që botoheshin gjatë Rilindjes Europiane ishin reflektim i punës së individëve të caktuar, që mblidhnin informacionet dhe të rejtat e fundit. Botimi i gazetave në këtë periudhë i drejtohej një publiku kryesisht elitar, i cili kishte dëshirë dhe mundësi të informohej, mbi atë që ndodhte në qytet.

Më pas, gazetat morën një zhvillim të ri, pasi ligjërimi mediatik i tyre përbëhej nga karakteristika që zhvillonin shtypin politik. Ky lloj shtypi nisi të varet nga personat më të fuqishëm politikë dhe informimi mbështetej vetëm në shërbim të interesave të tyre politike, pa iu referuar parimit bazë të gazetarisë, paanshmërisë. Pas kësaj faze si rrjedhojë e një sërë faktorësh, filloi të ndihej nevoja për një publik më të gjerë, dhe jo vetëm një shtyp të politizuar, që i drejtohej një target grupi të caktuar, prandaj gazetaria zhvilloi objektivitetin, ndarjen e fakteve nga opinionet. Në këtë formë lindën mediat e shkruara të pavarura.

Këto etapa kryesore të zhvilluara në vendet e tjera në një kohë relativisht të gjatë, në Shqipëri, si rrjedhojë e kontekstit politik dhe ekonomik u kaluan në një hark kohor relativisht të shkurtër. Duke mos pasur kohën e nevojshme për ti kaluar hap pas hapi këto faza, shpesh do të shohim një çoroditje të shtypit të shkruar mediatik.

Zhvillimi i medias në Shqipëri pas 1990-ës, kalon në dy faza kryesore: Faza e parë që zhvillohet në vitet 1991-1998 dhe faza e dytë pas vitit 1998 dhe në vazhdim.

Arsyet e përcaktimit të këtyre fazave për studiuesit shqiptarë mbështeten në argumente që ndryshojnë, por që prodhojnë të njëjtin përcaktim fazash. Në librin “Media, politika dhe shoqëria” i Artan Fugës (2008), studiohen marrëdhëniet e krijuara mes medias dhe politikës për një periudhë të gjatë kohore, duke na dhënë një tablo të gjerë të historikut të shtypit shqiptar që në fillimet e pluralizmit. Përcaktimi i fazave të zhvillimit të sistemit të medias sipas qasjes, së studiuesit, është përmes rregullimit ligjor të shtypit. Siç e theksuam më lart ndryshimi i sistemit politik në Shqipëri u reflektua edhe në median e shkruar, pasi një numër i madh gazetash të reja u shfaqën në tregun mediatik shqiptar pas vitit 1990. Shndërrime të kësaj natyre, kërkojnë rregullime ligjore, prandaj u bënë edhe ndërhyrjet në funksion të përpjekjes për të vënë rregull në vitet 1993 dhe 1997. Në rastin e parë për ligjin e miratuar u përzgjedh si model ligji i shtetit të Vestfalisë, por specifika e tij ishte se nuk u përshtat me kontekstin shqiptar, ndërsa ligji i vitit 1997, që mbronte lirinë e shtypit, erdhi si rrjedhojë e kontekstit politik të kohës. Vitet 1997-1998 janë vitet më të vështira në kontekstin historik të Shqipërisë që pas ndryshimit të sistemit politik, që do të ndikonin negativisht edhe në sistemin mediatik në raport me profesionalizmin dhe cilësinë e informacionit.

Ndërsa për studiuesin Sami Neza, përcaktimi i zhvillimit të sistemit mediatik në dy faza, bëhet përmes ndryshimeve në pronësinë e medias: “Në të parën dominon pronësi partiake dhe inisiativa e gazetarëve për të ngritur media; ndërsa në të dytën dominon pronësia e bizneseve mbi median” (Nezaj, 2014:41). Faza e parë referuar pronësisë së gazetave, përbëhet nga: grupi i gazetave që janë në pronësi të partive politike, grupi i gazetave që janë në pronësi të gazetarëve-pronarë, grupi i gazetave që origjinën e tyre e kishin që nga sistemi komunist e që nuk arritën të mbijetonin gjatë si dhe grupi i gazetave me pronësi të huaj. Faza e dytë referuar pronësisë ndahet në tre grupe kryesore: grupi i parë i gazetave i financuar nga bizneset, grupi i dytë i gazetave në pronësi të gazetarëve dhe grupi i tretë në pronësi të partive politike.

Studimi i kontekstit politik duke iu referuar sistemit politik me të gjitha veçoritë e tij, në raport me sistemin mediatik, ka ndikuar në mënyrë të vazhdueshme, në gazetarinë e vendit tonë. Krahas këtij raporti, zhvillimi i sistemit mediatik në një dominim të pronësisë mediatike nga biznesi, është një faktor që duhet të vlerësohet për dinamikat që shfaq, të përfshira në çështjen në vijim.

3.7. Modelet e shtypit

Siebert et al.(1956) përcaktojnë katër modele, teori, në tipologjinë e sistemit të shtypit: modelin autoritar, liberal, sovjetik-totalitar dhe atë të përgjegjesisë shoqërore. Sistemi i parë i shtypit ndiqet nga modeli autoritar. Rivers dhe Schramm (1969) kanë shkruar se komunikimi modern lindi në 1450, në një shoqëri autoritariste. Karakteristika e këtij sistemi është raporti ndërmjet individit dhe shtetit, ku theksi vendoset në përparësinë që i jepet shtetit në raport me vlerat. Sipas kësaj logjike shtypi i përkiste personave që kishin funksione të rëndësishme si mbreti, Papa, apo persona të tjerë me pushtet. Në antitezë me këtë model është modeli liberal, sipas të cilit shtypi nuk është më një instrument në duart e shtetit por kryen funksion të kundërt me këtë, duke shërbyer si “qen roje”. Përmes këtij funksioni që kryen shtypi, janë njerëzit të cilët mund të ushtrojnë kontroll mbi shtetin. Modeli i përgjegjesisë shoqërore mund të klasifikohet si një variant i modifikuar i modelit liberal, i cili mund të përmblihet si më poshtë:

“... Pozicioni i pushtetit dhe monopolit të medias e detyron median të jetë shoqërisht e përgjegjshme, të shohë të gjitha anët dhe të bëjë një prezantim të drejtë dhe publiku duhet të ketë informacion të mjaftueshëm në mënyrë që të vendosë; dhe nëse media nuk e merr një përgjegjësi të tillë, mund të jetë e nevojshme për disa agjenci publike ta forcojnë atë ta bëjë” (Siebert et al, 1956: 3).

Modeli i katërt është modeli sovjetik-totalitar, i cili edhe pse ka ngjashmëri me modelin autoritar, dallon nga ai përmes disa veçorive në raport me median, përsëri duke iu referuar Siebert et al. media është:

“...Një mjet për të drejtuar pushtetin ashtu sikurse në sistemin autoritar. Por ndryshe nga sistemi autoritar, media nuk është pronë e askujt vetëm e shtetit. Hiqet motivi i përfitimit dhe koncepti i pozitives zëvendësohet me konceptin e lirisë negative... Shtypi amerikan nuk është në të vërtetë i lirë, thonë Sovjetikët, sepse është i kontrolluar nga biznesi dhe si i tillë nuk lejon të flitet për “të vërtetën” Marksiste”(1956:5).

Pavarësisht rolit dhe impaktit influencues që pati ky studim ndër vite, studiues të ndryshëm kanë shprehur rezerva në raport me përfaqësimin jo të plotë të medias së shkruar sipas klasifikimit të teorive të sistemit të shtypit të elaboruar nga Siebert et al. Hallin dhe Mancini(2004), ndërmarrin një analizë krahasuese të modelit të shtypit të shkruar, referuar studimit të medias në vende të Europës Perëndimore, SHBA dhe Kanada. Ata mbërrijnë në përfundimin e klasifikimit të këtyre mediave në tre modele: Modeli Mesdhetar i cili është pluralist dhe i polarizuar, Modeli Demokratik i cili është korporatist, i identifikuar në vendet e Europës Perëndimore si dhe Modeli Liberal i

Atlantikut Verior në vende si Anglia, Irlanda, SHBA, Kanada. Sipas autorëve klasifikimi i sistemit mediatik të një vendi i referohet katër karakteristikave kryesore:

“Zhvillimi i tregjeve mediatike që reflektohet në tirazhin e gazetave, i lartë apo i ulët; paralelizmi politik, natyra e marrëdhënies ndërmjet medias dhe partive politike; zhvillimi i gazetarisë profesionale si dhe nga niveli i ndërhyrjes së shtetit në sistemin mediatik.” (Hallin & Mancini, 2004:21).

Sipas autorëve, Modeli Mesdhetar karakterizohet nga tirazh i ulët i gazetave, orientim drejt publikut elitar dhe jo drejt masave, paralelizëm politik i fortë, nivel i ulët profesionalizmi dhe nivel i lartë i kontrollit të shtetit. Modeli Demokratik karakterizohet nga tirazh i lartë, orientim jo drejt publikut elitar por drejt masave, paralelizëm politik i mesëm, nivel i lartë profesionalizmi, nivel i lartë i kontrollit të shtetit me fokus kryesor shërbimin ndaj publikut. Modeli Liberal karakterizohet nga tirazh i mesëm i orientuar drejt masave, paralelizëm politik i dobët, nivel i lartë i profesionalizmit, kontroll i limituar i shtetit pasi tregu luan një rol më dominues se shteti.

Nëse në modelin e parë gazetaria është e orientuar drejt komenteve dhe rolit avokator të saj, në dy modelet e tjera, edhe pse komentet janë pjesë e ligjërimit gazetaresk, evidentohet një gazetari e dominuar nga profesionalizmi, me orientim drejt raportimit të informacionit.

Modelet teorike të mësipërme nuk mund të përdoren për sistemin mediatik shqiptar, pasi veçoritë kontekstuale ndryshojnë, prandaj Modeli Mesdhetar modifikohet në një model të përpunuar sipas studuesit Blum. “Blum shton disa dimensionet e tjera që mungojnë në modelet e mëparshme, si: kulturën politike, lirinë e shprehjes, pronësinë e medias, financimin e medias, partishmërinë e gazetarëve, kontrollin e shtetit mbi median, kulturën e medias dhe orientimin e saj” (Godole, 2014: 81).

Ky model i zhvilluar në “Modeli i klientelës europiano-jugor”(Po aty: 82) është më i përshtatshëm, për studimin e sistemit mediatik shqiptar.

3.7.1. Problematikat në shtypin shqiptar

Ligjërimit në shtypin e shkruar përmes analizës kritike të ligjërimit, analizohet mes të tjerash edhe në raport me mënyrën e prodhimit të praktikave ligjërimore (profesionale) si etika, objektiviteti, saktësia etj, pasi një reporter i mirë duhet të ketë disa cilësi, ku ndër më kryesoret është ”bindja e sinqertë për detyrimin që ka ndaj popullit për t’iu

afruar sa më shumë që është e mundur të vërtetës”(Raportimi dhe Shkrimi i Lajmeve,1991:34).

Studimi i etikës është një nga traditat më të hershme intelektuale i cili daton rreth 2500 vite më parë, që kur Sokrati shtron pyetjen mbi moralin: Çfarë është morali? Megjithëse ai nuk lë shënime, kjo traditë mendimi zgjerohet, në funksion të argumenteve në lidhje me moralin dhe etikën, nga Platoni, Aristoteli, doktrina kristiane, për të vazhduar me Kantin, i cili njihet si udhëheqësi mendimtar i Rilindjes në fushën e filozofisë mbi moralin, sepse etika është konsideruar gjithmonë si një degë e studimeve filozofike.

Duke përfshirë edhe studimet e sotme mbi etikën dalim në një argument, i cili flet për një pamundësi të skematizimit të etikës, pasi ajo është një realitet shumë kompleks. Gjithashtu vështirësia për vendimmarrje etike sot, qëndron tek përplasja mes traditave të ndryshme. Gazetarët mund të huazojnë një traditë, e cila mund të kundërshtohet nga një tjetër traditë. Utilitarizmi i Kantit mund të gjejë kundërshti me “të mesmen e artë” të Aristotelit. Dilemat etike shtohen në numër kur kemi përplasje ose shpërbërje të vlerave.

Ndryshimi i roleve dhe pozicioneve të individit në shoqëri, bëjnë që ai të përzgjedhë argumente të ndryshme për të ndërtuar këndvështrimin e tij, në lidhje me ngjarje të ndryshme. Ndryshe është argumenti i gazetarit në lidhje me një rast etik e ndryshe është argumenti i lexuesit, apo i pronarit të gazetës. Janë pikërisht këto elementë që edhe pse vështirësojnë vendimmarrjet etike, nxjerrin në pah nevojën e domosdoshme të etikës në gazetari dhe media.

Ligji i vitit 1997 është arena ligjore në të cilën mbështetet shtypi i shkruar: Shtypi është i lirë. Liria e shtypit mbrohet me ligj. Ligji siguron lirinë e shtypit, por për profesionistët e fushës është i nevojshëm miratimi i një ligji më të detajuar. Profesionistët e fushës, gazetarët, komisioni parlamentar i medias, aktorë të ndryshëm kanë parë të nevojshme miratimin e një ligji më të detajuar dhe jo kaq të përgjithshëm, por pavarësisht kësaj nuk ka pasur ndryshime. Në këtë kontekst me një kuadër ligjor që lejon një hapësirë të pafundme interpretimesh, media duhet të drejtohet drejt vetërregullimit të saj, apo thënë ndryshe drejt kodit të etikës.

Dy qasje kryesore evidentohen në raport me etikën, të cilat janë në kundërshti me njëra-tjetrën. Njëra thekson që mënyra e vetme që informacioni të ketë vlera etike është zbatimi i rregullave gazetareske, siç janë elementët dhe parimet e gazetarisë: “Gazetarët kanë të drejtë të marrin informacion, ta botojnë atë dhe ta kritikojnë. Informacioni duhet të jetë i saktë, i balancuar dhe i verifikuar”(Kodi i Etikës, 2006:4).

Ndërsa qasja tjetër, vlera të tilla i shikon vetëm në rrafshin teorik, pasi praktikisht zbatimi i rregullave gazetareske vështirësohet si rezultat i një sërë faktorësh si presioni i kohës, nevoja organizative për lajme, kultura politike, pronësia, komercializimi etj.

Ashtu siç shprehet edhe Randall:

“Pushteti i atyre që kontrollojnë gazetat buron pa dyshim nga fuqia e tyre ekonomike dhe në disa vende, nga ndikimi që ushtrojnë mbi burimet e rralla të shtypit dhe botimeve. Por shpesh ata nuk kanë pse ta përdorin pushtetin te gazetarët e veçantë, mjafton që vlerat e tyre të përthithen plotësisht nga kultura mbizotëruese e gazetarisë në një ose në disa lloj gazetash” (Randall, 2003:20).

Zhvillimi dhe liberalizimi i mediave pas vitit 1990, vuri në dukje nevojën për disa rregulla dhe standarde profesionale në etikën mediatike. Gjatë periudhës komuniste nuk njiheshin këto terma dhe ishin krejtësisht të panjohura, pasi siç shkruan edhe gazetari i njohur francez Claude-Jean Bertrand, “deontologjia mund të ekzistojë vetëm në demokraci”(2007).

Me vendosjen e sistemit komunist, të flasësh për etikën dhe parimet profesionale, është një mision i pamundur, pasi gazetaria u kthye në një organ të mirëfilltë propagande. Ndryshimi i sistemit politik do të ishte zanafilla, për krijimin e një kodi etik për median dhe punonjësit e saj, i cili u formua, me mbështetjen e Institutit të Medias në vitin 1996, por që funksionoi vetëm në nivel formal. Zhvillimi i medias së shkruar dhe asaj vizive me kalimin e viteve, sollën nevojën për përpunimin e një kodi të ri, i cili u themelua nga bashkëpunimi ndërmjet shoqatave të gazetarëve dhe Institutit të Medias, në vitin 2006. Problematika kryesore e këtij kodi mbetet zbatimi i tij në mediet tradicionale si dhe përfshirja e rregullave dhe parimeve gazetareske për mediet e reja.

Faktorët kryesorë influencues në moszbatimin e parimeve profesionale dhe rregullave, lidhen me presionet që vijnë nga politika apo interesat e dyanshme ndërmjet politikës

dhe medias, kushtet e punës për gazetarët, censura apo vetëcensura, frika për vendin e punës e cila për më tepër shpesh shoqërohet me vonesa pagash, mungesa e kontratave ligjore që penalizon gazetarët për të kërkuar të drejtën e tyre etj. Në një studim të Institutit Shqiptar të Medias, konkludohet që:

“Ndërhyrja e redaktorëve dhe sidomos e pronarëve, nënshtrimi ndaj interesave të tyre ekonomike dhe politike, situata e pakënaqshme materiale, shfrytëzimi i pushtetit mediatik për përfitime ekonomike dhe politike, si dhe një presion i madh për vetëcensurë përbëjnë aspektet më problematike të cilat identifikojnë gazetarët” (ISHM, 2006:7).

Nëse shqyrtohet transparenca e financimit të medias, ajo rezulton problematike përse i përket raportit që gjeneron mes të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat e një organi mediatik sigurohen përmes tirazhit të shitjeve për shtypin e shkruar dhe përmes reklamave. Tirazhi i shitjeve nuk mund të jetë i lartë për të gjitha gazetat, duke iu referuar numrit të madh të tyre në raport me numrin e popullsisë në Shqipëri apo konkurrencës që vjen nga mediet e tjera si televizioni, apo mediet e reja, si dhe të ardhurave që gjenerohen përmes reklamave, prandaj është e vështirë të perceptohet sukcesi i tyre ekonomik. Pavarësisht kësaj, në mënyrë paradoksale, sasia e gazetave që operojnë në tregun mediatik shqiptar ngelet e lartë, duke na drejtuar drejt premisë që duhet studiuar skema e pronësisë. “Në fund të viti 2012 numërohen 18 gazeta gjeneraliste të përditshme kombëtare... Afro 90% e tyre dominohen nga biznesi duke përkufizuar kështu edhe natyrën e pronësisë së mediave të shkruara në vend” (Nezaj, 2014: 47). Shumica e pronarëve, kanë paralelisht biznese të tjera si psh Kokëdhima apo Hasanbelliu, të cilët kanë në pronësi gazetat “Shekulli” dhe “Panorama”. Trinomi media-politikë-biznes influencon në procesin gazetaresk, pasi përmes anketimit të Institutit Shqiptar të medias, vërehet që në shumë përgjigje, gazetarët ”pretendojnë se në disa raste disa shkrime nuk botohen pasi ato prekin interesa të posaçme biznesi apo politike”(2006:7).

Sipas logjikës së mësipërme ku është e vështirë të flasim për një rentabilitet ekonomik të gazetave, vazhdimësia e organeve mediatike, mund të perceptohet më tepër sipas këtij raporti: Media shërben për të mbrojtur interesat e bizneseve të tjera të pronarëve përmes marrëdhënies media-politika, ndërsa bizneset e tjera sigurojnë mbijetesën e medias.

Gjatë fushatave elektorale, ku zhvillohet një garë e vërtetë ndërmjet aktorëve politikë, këto do të kërkojnë të maksimizojnë një mbulim mediatik pozitiv, i cili do të sigurohet

nga ndërhyrjet e pronarëve për të mbrojtur interesat e tyre ekonomike dhe politike, përmes censurës apo krijimit të një kulture mediatike e cila përveç të tjerave, zhvillon edhe autocensurën. Vështirësitë që karakterizojnë gazetarin shqiptar referuar mungesës së kontratave të punës, vonesave të pagave apo mosfunksionimit të shoqatave gazetareske në mbrojtje të profesionit, reflektohen në zhvillimin e autocensurës.

Organet e ndryshme mediatike janë në konkurrencë më njëra-tjetrën për të rritur tirazhin e shitjeve. Në një treg si ai shqiptar ku numri i gazetave është i madh, në raport me numrin e popullsisë, konkurrenca do të bëhet edhe me agresive. Ky raport disproporcional i ka të gjitha premiset të na drejtojë drejt fokusimit te tirazhi i shitjeve dhe jo drejt respektimit të parimeve gazetareske. Presioni përpara të cilit gjenden kryeredaktorët dhe drejtuesit e organeve mediatike influencon në ligjërimin mediatik në cilësinë e lajmit, përsëritjen e tij në pothuajse të gjitha gazetatat edhe kur rregullat dhe parimet gazetareske, thyhen haptazi. Kjo mënyrë komerciale e të bërit gazetari, sigurisht që dëmton cilësinë e lajmit, pasi largohet nga esencjalja drejt sensacionales.

Gazetarët nën presionin e kohës po i japin gjithnjë e më pak prioritet ligjërimin mediatik kualitativ, pasi detyrimi i tyre është të mbushin faqen e gazetës dhe pak rëndësi ka sesi mbushet. Mjafton të kapet norma e kërkuar nga redaktori i gazetës. Koha në dispozicion për shkrimin e një lajmi është aq e pamjaftueshme, sa nuk mund të ketë edhe cilësinë si udhërrëfyes.

Liria e fjalës, liria e shtypit është një ndër elementët më të rëndësishëm të një gazetarie cilësore. Faktorë influencues që ndikojnë në lirinë e fjalës mund të studiohen duke iu referuar aspektit ligjor, rolit të gazetarit, të pronarit të organit mediatik etj. Sipas Ballës, situata mediatike shfaq mjaft ngjashmëri në raport me vende të tjera të zhvilluara, përse i përket anshmërisë në lidhje me forca politike të caktuara, apo shkallën e vetëcensurimit nga ana e gazetarëve në raport me punëdhënësit e tyre. Referuar konstatimeve nga Curran dhe Seaton në vitin 1988, Balla thekson që: “Shtypi dhe industria e transmetimit ushtrojnë një fuqi tepër të madhe, por që bëhet çdo ditë e më tepër një fuqi e papërgjegjshme” (Balla, 2011: 33).

Në raport me përgjegjësinë që ka media për të përcjellë lajme që plotësojnë kriteret e duhura, Departamenti Amerikan i Shtetit në vitin 2007 theksoi: "... Politikanët dhe pronarët e medias panë se influencimi i opinionit publik, mund të kthehej në një mjet fitimprurës, më shumë sesa një detyrim ndaj shoqërisë" (Balla, 2011:35).

Në Shqipëri, kjo problematikë ka përmasa shqetësuese, pasi në vitin 2009, Shqipëria u klasifikua si vendi më i keq në Ballkan, përsa i takon lirisë së shtypit. Në vitin 2013, faktorë si anshmëria e mediave, mospërshtatje e klauzolave ligjore me standardet e duhura, apo sulme personale ndaj gazetarëve vazhdojnë të jenë prezente, duke cënuar lirinë e medias, edhe pse duhet theksuar që në këtë vit indeksi i lirisë së medias kishte përmirsim, krahasuar me vitin paraardhës. Liria e medias është një ndër elementët kryesorë, që përcakton sesa demokratik është një vend.

Këto problematika paraqesin një pjesë të tablosë që do të formohet e plotë në kapitullin e analizës, në lidhje me cilësinë e ligjërimit mediatic në shtypin e shkruar, gjatë fushatave zgjedhore të vitit 2009 dhe 2013.

3.8. Krijimi i partive politike në Shqipëri

Partitë politike në Shqipëri po ti referohemi kontekstit historik, sipas periudhave shfaqin dinamika të tilla si:

Periudha 1920-1923 ku evidentohen dy parti, Popullore dhe Përparimtare, të cilat ndryshonin në raport me përkufizimet dhe parimet e sotshme mbi partitë politike, gjendje e cila mbeti e njëjtë edhe pas shkrirjes së tyre në një parti, pasi "ato ishin bashkime individësh, pa struktura të zgjedhura dhe horizontale, pa anëtarësi të evidentuar dhe pa funksion kompakt elektoral dhe politik" (Krasniqi, 2006).

Periudhat që vijojnë më pas duke i'u referuar kontekstit historik, shfaqen problematike, pasi nuk lejohej nga ana ligjore ekzistenca e partive politike: Në vitet 1925-1939, ku Shqipëria fillimisht kishte statusin e republikës dhe më pas të monarkisë, u ndalua ekzistenca e tyre. E njëjta situatë vazhdoi gjatë pushtimit Italian, i cili pranonte vetëm Partinë Fashiste për arsye të kuptueshme, ndërsa në periudhën 1943-1944, që përkon me pushtimin gjerman, vepronin tre parti, por jo zyrtarisht, të cilat më shumë se parti për të

përfaqësuar interesat politike të mbështetësve të vet, ishin organizime njerëzish me funksione ushtarake.

Vendosja e sistemit komunist është një periudhë e cila ndaloi ekzistencën e partive të tjera politike, duke ekzistuar vetëm partia-shtet, e cila mbështetej në parime të tilla si centralizmi, disiplina e rreptë, uniteti dhe ku çdo mendim apo zë ndryshe ndaj vijës ideologjike të partisë dënohej jo vetëm me largimin nga partia, por edhe me pasoja të tjera, si burg, internim etj, pasi veprime të tilla u bënë pjesë e Kodit Penal, si vepra penale.

Vitet në të cilat veproi kjo parti brumosën ide që bien ndesh me parimin e demokracisë brenda partisë dhe sistemit politik: “PPSH është forca e vetme politike udhëheqëse e shtetit dhe e shoqërisë” dhe “ideologjia sunduese është marksizëm-leninizmi... në bazë të parimeve të tij zhvillohet gjithë rendi shoqëror socialist” (Krasniqi&Hackaj, 2014: 213).

Shembja e komunizmit shoqërohet me pranimin për herë të parë, në kuadrin ligjor të ekzistencës së partive politike në Shqipëri, të cilat duke respektuar parimet dhe nenet përkatëse kishin të drejtë të konkurronin brenda një sistemi demokratik konkurrues, për të arritur objektivat e veta. Numri i partive politike ka ardhur duke u rritur nëse e krahasojmë me periudhën në fillim të ndryshimit të sistemit, në të cilën vepronin dy parti. Kjo si rezultat i lindjes së partive politike të reja, apo të ndarjes së individëve të ndryshëm (zakonisht të pakënaqur) nga partitë ekzistuese, të cilët kanë formuar parti të reja.

Bazat ligjore mbi të cilën veprojnë partitë politike në Shqipëri, janë marrë kyesisht nga vende me sisteme demokratike dhe nuk paraqesin probleme. Problemet që lindin në kontekstin shqiptar vijnë nga mënyra se si këto ligje zbatohen, duke iu referuar kulturës në raport me zbatimin e ligjit, neneve dhe pikave të tyre, të cilat mund të kundërshtojnë apo të mos jenë në të njëjtën linjë me njëra-tjetrën, problematika në institucionet që kanë përgjegjësi për zbatimin e bazës ligjore etj. Zakonisht problemet e lindura marrin

zgjidhje ose brenda partisë, ose nga institucione që përfaqësojnë ligjin si gjykatat, duke përdorur rregulloret dhe statutet e partive politike.

3.8.1. Partitë kryesore në Shqipëri dhe liderët e tyre

Para se të analizojmë ligjërimin politik në median e shkruar gjatë fushatave zgjedhore të vitit 2009 dhe 2013, e shohim me rëndësi të hedhim një vështrim të përgjithshëm për të kuptuar historikun dhe zhvillimin e partive kryesore, ideologjinë e programeve të tyre, si dhe kush janë liderët me të cilët identifikohet secila parti. Partia Socialiste për Integrim edhe pse e krijuar më vonë, ka pasur një rol të rëndësishëm në zgjedhjet e viteve që përfshin ky studim, prandaj do të analizohet si forcë e tretë politike.

Partia Demokratike

Gazeta zyrtare është “ Rilindja Demokratike”.

Partia Demokratike është partia e parë e krijuar në sistemin pluralist shumëpartiak me 12 dhjetor 1990, pas përmbyesjes së rregjimit komunist. E iniciuar fillimisht si një lëvizje studentore ajo arriti të kthehej në partinë kryesore opozitare, e cila u legjitimua nga ana ligjore me 17 dhjetor të vitit 1990, nën drejtimin e Azem Hajdarit. Zëvendësuesi i Hajdarit, në shkurt të vitit 1991 është Sali Berisha, i cili qëndroi kryetar partie deri në vitin 2013. Dorëheqja e Berishës erdhi menjëherë pas humbjes që pësoi Partia Demokratike në zgjedhjet e qershorit të këtij viti.

Programi politik i kësaj partie, propozoi alternativa dhe koncepte të reja të orientuara drejt një modeli tipik të djathtë, i cili pati devijime gjatë mandatit të parë qeverisës të PD-së, si rrjedhojë e përshtatjes së saj me kërkesat dhe nevojat politike të kohës. Ndryshimin më të madh përse i përket programit politik kjo parti e bëri pas vitit 2000, duke shfaqur ngjashmëri me programin e Partisë Socialiste.

“Në programin politik 2005, 2009, 2013, nuk gjenden dallime thelbësore në vizionin politik për shtetin, për sistemin politik, për zgjedhjet, për traditat dhe vlerat, për raportet midis individit dhe shtetit ... Mungesa e dallimeve ka edukuar krijimin e një elektorati identik midis të majtës dhe të djathtës, i cili më shumë se identitetin politik, pëlqen dhe nxitet nga raportet personale me pushtetin politik”(Cituar nga: <http://politike.al/sq/programet-e-pd-nga-1990/>).

Sali Berisha lideri historik i PD-së, njihet si presidenti i parë i Shqipërisë i zgjedhur nga një parlament me zgjedhje të lira demokratike, në vitet 1992-1997. Sali Berisha ishte mjek kardiolog, profesor universiteti dhe kërkues shkencor, kur hyri në politikë si udhëheqës i opozitës anti- komuniste që filloi në vitin 1989.

Gjatë qeverisjes së tij, pas fitores së zgjedhjeve të para të lira në 1992, vendi u hap drejt perëndimit, përmes marrëveshjeve apo anëtarësimit në Këshillin e Europës në vitin 1995. Gjatë qeverisjes së tij u krijuan institucione të reja si Gjykata Kushtetuese dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë si dhe u përpiluan ligje të reja, të përshtatura me kontekstin. Pas periudhës së errët të vitit 1997, Berisha u detyrua të jepte dorëheqjen si president dhe shqiptarët iu drejtuan kutive të votimit, pasi u zhvilluan zgjedhje të parakohshme. Pas humbjes së dy mandateve radhazi, PD-ja e drejtuar nga Berisha bashkë me partitë e rreshtuara në koalicionin e krijuar, arrijnë të sigurojnë fitoren. Në vitet 2005- 2013 të qeverisjes së Partisë Demokratike kryesuar nga Berisha, Shqipëria u bë antare e Natos, u hoqën vizat me BE-n, mori rekomandimin për statusin e vendit kandidat dhe një sërë zhvillimesh të tjera.

Në skenën politike shqiptare, Berisha shfaqti karakteristika të një lideri karizmatik, duke u kthyer një ndër politikanët më të rëndësishëm të vendit. Ligjërimi politik i tij krijonte një efekt elektrizues mbi elektoratin, gjatë fushatave zgjedhore. Mënyra e menaxhimit të zgjedhjeve në vitin 1996, ishte një ndër faktorët pse Berisha u etiketua si një politikan me tipare autoritare. Zhvillimet e mëvonshme, viti 1997, fitorja e zgjedhjeve 2 herë rresht nga kundërshtarët politikë, ishin faktorë influencues që në zgjedhjet e vitit 2005, PD-ja garoi përmes një imazhi të ndryshuar dhe të përmirësuar të partisë, të politikave dhe të vetë liderit të saj.

Partia Socialiste

Gazeta zyrtare e saj është “ Zëri i Popullit”.

Partia e Punës së Shqipërisë pas një qeverisje gati 50 vjeçare, në vitin 1991 si rezultat i ndryshimeve politike, ndryshoi emër duke u emërtuar Partia Socialiste. Kjo parti arriti të fitonte zgjedhjet e para të vitit 1991, midis të tjerash edhe përmes ushtrimit të presionit

dhe përdorimit të medias sipas interesit personal, por nuk arriti të ushtronte mandatin qeverisës më shumë se një vit, pasi zgjedhjet e vitit 1992 nxorën fituese PD-në.

Partia Socialiste qëndroi në opozitë deri në zgjedhjet e vitit 1997, ku nën drejtimin e kryetarit Nano, fitoi të drejtën të qeveriste vendin për dy mandate. Humbja në zgjedhjet e vitit 2005, përveç faktorëve të tjerë është përforcuar dhe nga konfliktet e brendshme partiake, të cilat u shoqëruan me largimin e një grupi, që do të themelonte më pas, partinë “Lëvizja Socialiste për Integrim”. Humbja e zgjedhjeve u shoqërua me dorëheqjen e kryetarit të partisë dhe zëvendësimin e tij me Edi Ramën. Edi Rama vazhdon të jetë aktualisht kryetar i partisë, edhe pse në momente të caktuara është pretenduar dhe kërkuar dorëheqja e tij siç ishte rasti i zgjedhjeve të vitit 2009, ku PS-ja nën drejtimin e tij humbi përballë PD-së dhe koalicionit të saj.

Nëse do të shqyrtojmë sjelljen politike të kësaj force referuar programit politik të saj, mund të evidentojmë tre faza kyçe. Fillimisht ajo ishte në të njëjtën linjë me partinë e origjinës së saj, Partinë Komuniste, përse i përket doktrinës dhe ideologjisë. Faza e dytë karakterizohet nga një shkëputje dhe reformim brenda kësaj force, duke u përafëruar me një model të ri, tipik për partitë socialdemokrate. “Ajo vendosi konceptet e reja socialdemokrate në program, përcaktoi çështje identitare dhe krijoi një axhendë intensive mbrojtjeje për çështje e komunitete që lidhen me identitetin e saj të majtë” (Cituar nga: <http://politike.al/sq/programet-e-ps-nga-1991/>).

Faza e tretë shfaq tipare të një partie e cila largohet nga konceptet e mësipërme, duke u kthyer në një parti të ngjashme me rivalen e vet PD-në, e konkretizuar në një sjellje politike pragmatiste.

Lideri i parë i kësaj partie është Fatos Nano, i cili njëkohësisht ushtroi funksionin e kryeministrit në vitin 1991, gjatë Qeverisë së Tranzicionit, post të cilin e mbajti edhe pas zgjedhjeve të mbajtura po në këtë vit. Në pamundësi për të vijuar mandatin qeverisës për shkak të kontekstit, zgjedhjet e vitit 1992 nxorën fituese PD-në, e cila një vit më vonë vendosi arrestimin dhe burgosjen e Nanos, pasi u akuzua për korrupsion dhe abuzim detyre.

Fatos Nano rikthehet si kryeministër pas zgjedhjeve të vitit 1997 dhe detyrohet të japë dorëheqjen në vitin 1998, duke u rizgjedhur përsëri kryeministër në mandatin qeverisës 2001-2005. Gjatë kësaj periudhe, që nga themelimi i PS-së deri në vitin 2005 kur dha dorëheqjen, Nano është figura kryesore dhe lideri i kësaj force politike.

Nano u zëvendësua nga Edi Rama, i cili në vitin 2005 mori drejtimin e PS-së, pas një eksperience që zanafillën e ka që në lëvizjen demokratike të viteve 1990, për rrëzimin e komunizmit. Pasi qëndroi disa vite jashtë Shqipërisë, Rama u kthye dhe u vendos Ministër i Kulturës në vitin 1998. Një ndër elementët më të spikatur të Ramës është raporti i tij me mediet, rëndësinë e të cilave Rama e ka kuptuar qartë. Ai përcjell tek publiku mesazhet e tij përmes medias, duke e shfrytëzuar si një mjet komunikimi, e cila i shërben si platformë përveç të tjerash dhe për të zëvendësuar mungesën e të folurit në strukturat partiake të PS-së, për faktin e thjeshtë që konsiston në mosanëtarësimin e tij në këtë forcë politike deri në vitin 2003. Në vitin 2000 fitoi zgjedhjet lokale në Tiranë, post të cilin e mbajti për 11 vjet, pasi arriti të fitonte dhe në zgjedhjet e vitit 2003 dhe 2007. Lideri Rama shfaq një performancë atipike me modelin e zakonshëm të politikanit shqiptar, që në fillimet e tij, pasi është një kritikues i hershëm i partive politike shqiptare. Përmes ligjërimit të tij gjatë kohës që është në krye të Ministrisë së Kulturës, ai bën përgjegjës edhe shoqërinë shqiptare, e cila ia adreson politikanit të gjitha përgjegjësitë “Ka ardhur puna deri aty sa njerëzit shohin në fytyrën e çdo politikani grabitësin e bukës së përditshme, përgjegjësin e mjerimit ekonomik familjar, pengmbajtësin e një të ardhmeje të begatë”(Budini, 2008:26 cituar nga Klan, Nr.67, 1998).

Rama si kryetar partie, për të konsoliduar pozitat e tij si lider dhe të forcës politike që drejton, përzgjedh një strategji të re të shprehur përmes ligjërimit të tij. Nëse në fillimet e tij ai shprehej kundër partive politike, duke u identifikuar më shumë me artistin se me politikanin, tashmë gjërat ndryshojnë. Për të mbajtur statusin e fituar, Rama i drejtohet elaborimit dhe përdorimit të një konceptimi tjetër, që e emërton politika e re. Ai kërkon me këmbëngulje distancimin nga politika e vjetër duke u fokusuar tek politika e re. Studiuësja Budini i jep këtë përkufizim politikës së re: “Politika e Re, kjo njësi kuptimore e zbrazët mëton të jetë, pra gjithçka që politika e vjetër nuk mundet: zhvillim ekonomik, transparencë, integrim europian dhe kështu me rradhë”(Budini, 2008: 27).

Politika e re e Ramës mund të studiohet përmes reformimit që kërkon të bëjë brenda partisë si dhe në nivel më të gjerë duke iu drejtuar jo vetëm një elektorati të majtë, por edhe të djathtë, e përkufizuar përtej të majtës dhe të djathtës. Qëndrimi i tij në zgjedhjet e vitit 2009 ka si objektiv kryesor fitoren e PS-së, fitore e cila do të përforconte pozitat e tij në raport me Berishën si kundërshtar politik por dhe brenda së majtës në raport me Nanon si ish kryetar dhe Metën si kryetar i LSI-së.

Nëse në zgjedhjet e vitit 2009 refuzoi ftesën për bashkëpunim me LSI-në, në vitin 2013, koalicioni i krijuar PS-LSI rezultoi fitues.

Partia Lëvizja Socialiste për Integrim

Gazeta zyrtare është “Integrimi”.

Kjo parti u krijua në vitin 2004, si rrjedhojë e konflikteve dhe përplasjeve brenda PS-së, kohë kur drejtimin e partisë e kishte Fatos Nano. Të pakënaqurit brenda kësaj partie në raport me demokracinë e brendshme partiake, u larguan duke themeluar LSI-në, si një parti progresiste e të majtës dhe qendrës. Kryetar partie u zgjodh Ilir Meta, funksion i cili mbeti i pandryshuar për të, edhe në zgjedhjet e vitit 2012 dhe 2016. Përfshirja e kësaj partie, në analizën e këtij studimi, i referohet rolit të rëndësishëm që pati në krijimin e qeverisë në zgjedhjet e vitit 2009, përmes një koalicioni paszgjedhor me PD-në si dhe koalicionit parazgjedhor me PS-në, i cili rezultoi fitues në zgjedhjet e vitit 2013.

Nëse studiojmë programin politik të kësaj partie në fillimet e saja, mund të përligjim identitetin majtist të saj përmes tematikave të përfshira si dhe përmes qëndrimeve të anëtarëve të saj, të cilët ishin të zhgënjyer nga devijimi ideologjik i PS-së. Lëvizja politike e kësaj partie në zgjedhjet e vitit 2009, përmes një bashkëqeverisje me të djathtën dhe rikthimi tek e majta në mandatin qeverisës vijues është një tregues që LSI ka pësuar ndryshime. Ajo ashtu si dhe partitë kryesore PD dhe PS, mund të identifikohet më shumë si një parti pragmatiste, sesa një parti me ideologji të mirëpërcaktuar që reflekton vlerat e së majtës.

“Sloganet dhe premtimet e saj ofrojnë kryesisht përgjigje për atë që elektorati momental do, ndërkohë që mungojnë propozimet apo qëndrimet politike për problemet thelbësore

që bëjnë diferencën midis të majtës dhe të djathtës në Shqipëri” (Cituar nga: <http://politike.al/sq/programet-e-lsi-nga-2004/>).

Lideri i kësaj partie, është një politikan, i cili aktivitetin e tij politik e ka nisur herët, që në fillim të viteve 1990, si pjesëmarrës në lëvizjen studentore të dhjetorit. Angazhimet politike të Metës shprehen përmes statusit si deputet në Kuvendin e Shqipërisë që nga viti 1992 e në vijim si dhe kryeministër i Shqipërisë për një periudhë gati dyvjeçare, në vitet 1999-2001. “Meta kishte krijuar një profil të tijin në PS dhe që përplasur një herë me Nanon në vitin 1996. Ai ishte rikthyer në qeveri në ...moshën 29 vjeçare dhe 30 vjeç, me 28 tetor të 1999-ës u zgjodh kryeministër” (Fevziu, 2012:300). Pas fitores në zgjedhjet e vitit 2001, ai u rizgjodh kryeministër, por nuk arriti të qeveriste një mandat 4 vjeçar, pasi në vitin 2002 dha dorëheqjen. Shkaku kryesor ishte marrëdhënia konfliktuale ndërmjet kryeministrit Meta dhe kryetarit, liderit të PS-së Fatos Nano. “Unë vendosa të iki për t’i hapur rrugë krizës” (Fevziu, 2012:303), ishte deklarata e Metës, një ditë pas dorëheqjes.

“Gjithashtu, Ilir Meta ka shërbyer edhe si Zv.kryeministër dhe Ministër i Punëve të Jashtme gjatë periudhës korrik 2002 - korrik 2003, Zv.kryeministër dhe Ministër i Integritimit gjatë periudhës tetor 1998 - tetor 1999, si dhe Sekretar Shteti për Integritimin Europian në Ministrinë e Punëve të Jashtme mars - tetor 1998” (Cituar nga: https://sq.wikipedia.org/wiki/Ilir_Meta).

Në bashkëqeverisjen PS-LSI mori detyrën e Kryetarit të Parlamentit, ku një ndër karakteristikat kryesore të performancës së tij, ishte qetësia. Ilir Meta si lider kalon nga një qëndrim i ashpër dhe sfidues në fillimet e veta si kryetar partie, në një model që ruan ekuilibrat dhe është i pazëvendësueshëm në konfliktualitetin politik, përmes shprehjes së tij ‘me qetësi dhe dashuri’.

KAPITULLI IV

Analiza e ligjërimit politik në zgjedhjet e vitit 2009 dhe 2013

4.1. Ligjërimi politik, përmes fjalimeve, 2009

Fjalimet dhe strategjitë ligjërimore janë ndër elementët kryesorë të fushatës dhe propagandës, gjatë zgjedhjeve të përgjithshme. Liderët kryesorë dhe gjithë kandidatët e tjerë të partisë në garë janë në një linjë, duke përdorur një stil dhe qëndrim të caktuar në ligjërimit e tyre.

Imazhi i partisë, ideologjia e partisë, programi i qeverisë të gjitha këto nyja formësohen në sytë e publikut dhe elektoratit, pikërisht nëpërmjet fjalimeve. Gjithashtu personaliteti i liderit del më në pah, në bazë të ligjëratave, qëndrimit, tonit dhe çështjeve mbi të cilat fokusohet. Fjalimet janë dhe një matës i mirë, se deri në çfarë mase ushtrohet personalizimi institucional apo personalizimi partiak brenda një force politike. Më poshtë po paraqesim një pjesë të fjalimeve kryesore të partive, marrë nga gazetatat e tyre zyrtare, “Zëri i Popullit”, “Rilindja Demokratike” si dhe nga gazeta “55”.

4.1.1. Ligjërimi politik i majtë përmes fjalimeve, 2009

Në kampionimin e bërë rezulton që fjalimet e publikuara janë kryesisht të Ramës, dhe të figurave të tjera të së majtës, në hapjen e fushatës dhe deklaratat e Islamit në rolin e sekretarit për procesin zgjedhor të “Partisë Socialiste”. Përmes analizës numerike, janë përfshirë në studim: 11 fjalime të Ramës, 2 të Kastriot Islamit, 1 fjalim i Valentina Leskaj, 1 fjalim i Luiza Xhuvanit, 1 fjalim i Gramoz Ruçit, 1 fjalim i Lindita Nilollaj dhe 1 fjalim i Ben Blushit. Fjalimet janë marrë nga gazeta e saj zyrtare, pasi është organ mediatik i së majtës dhe lejon publikimin e tyre në mënyrë të vazhdueshme, duke i dhënë hapësirën e nevojshme.

Fjalim i Edi Ramës i mbajtur në Asamblenë e Partisë Socialiste, Zëri i Popullit, 9.5.2009, fq. 5.

*“Vijmë sot, në prag të zgjedhjeve, me një **program të ri**, me një vetëdije të re dhe me një vullnet të ri. Jo vetëm për ti fituar zgjedhjet e 28 qershorit, por edhe për ta kthyer fitoren në një instrument për **transformimin rrënjësor** të vendit tonë. Për ndarjen me politikën e vjetër të së shkuarës dhe më një proces të stërzgatur premtimesh të pambajtura, zullumesh të papërmbajtura dhe dështimesh që nuk mund të justifikohen. Jemi të gjithë*

*dëshmitarë të vështirësive të panumërta që kemi hasur për t'i dhënë Shqipërisë dhe shqiptarëve mundësinë e **zgjedhjeve të lira** dhe të ndershme, të standardeve të një vendi të NATO-s, të standardeve të një vendi që synon të ulet në tryezën e Bashkimit Europian, të standardeve të një vendi të denjë për **Europën** e viti 2009. Ne jemi këtu që së bashku dhe me të gjithë ata që duan **ndryshimin e madh**, të ndryshojmë rrjedhën e historisë, të ndryshojmë qeverisjen, duke ndryshuar politikën, të ndryshojmë gjithçka që në këtë vend nuk ka ndryshuar thjesht dhe vetëm për shkak të politikës”.*

Në këtë fjalim të Ramës, pikat kryesore janë, dërgimi i mesazhit të ndryshimit dhe mundësia që çdo qytetar të votojë lirisht. Së dyti, theksohet dallimi mes alternativës së ofruar nga koalicioni i majtë, fitorja e së cilës influencon në ndryshimin rrënjësor të Shqipërisë, krahasuar me alternativën e premtive të pambajtura të kundërshtarëve politikë.

Sipas Chilton (2004:45) funksionet strategjike në komunikimin politik mund të kategorizohen përmes “funsioneve shtrënguese”, të cilat kryesisht lidhen me burimin dhe pushtetin e dhënësit të informacionit, që në komunikimin e aktorëve politikë mund të shfaqen përmes ligjërimit, temave që përzgjidhen për t'u diskutuar, përcaktimit të marrëdhënieve përmes ligjërimit për veten dhe të tjerët, apo efekteve që prodhon një ligjërim tek të tjerët, gjë që vërehet në fjalimin politik të mësipërm, pasi Rama synon ‘ngacmimin’ e publikut në rrafshin emotiv.

Së treti, bie në sy mënyra se si e prezanton Rama anëtarësimin e Shqipërisë në NATO dhe aspiratat për t'u përfshirë në Bashkimin Europian, në një kohë kur kjo reklamohet nga Partia Demokratike si arritje e saj. Së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, theksimi i ndryshimit që propozon Rama, duke u shkëputur nga ata gjëra që kanë ndodhur gjatë 18 viteve.

Fjalim i Valentina Leskaj në parlament, Zëri i Popullit, 12.5.2009, fq .10.

Theksimi se ka dy standarde përsa i përket kohës së dhënë në parlament, ndërmjet pozitës dhe opozitës. Evidentimi se kjo bëhet pasi: “Për këtë mazhorancë më shumë se sa problemet dhe hallet e shqiptarëve ka **nepotizmi kryeministror dhe mbrojtja e familjes kryeministore.**” Tematikat e trajtuara në fjalimin e zonjës Leskaj janë mbi vrasjen e deputetit Xhindi, si dhe çështja e kartave të identitetit.

Fjalim i Edi Ramës në shpalljen zyrtare të koalicionit “Bashkimi për ndryshim” Zëri i Popullit, 13.5.2009, fq. 6.

“Ne jemi sot këtu kur një tjetër mandat i politikës së vjetër të së shkuarës po mbaron me verbërinë e saj përpara plagëve të vendit, shurdhërinë e saj përpara të vërtetave të njerëzve, cinizmin e saj përpara aspiratës tonë të përbashkët për një Shqipëri si gjithë Europa....ne jemi sot këtu sepse duam të jemi qytetarë të Europës pa kufi, me liri dhe të drejta të barabarta për të gjithë dhe si gjithë të tjerët. Ja pse është koha për t’u bashkuar, përtej kufijve të vjetër të partive dhe dasive të së shkuarës, përtej mërive dhe hasmërive, që politikanët e vjetër kanë nxitur dhe ushqyer kudo, gjithmonë, deri në fshatin më të largët, përtej interesave të oborreve familjare dhe klanore, që e kanë uzurpuar politikën për 18 vjet me rradhë dhe sot ndjehen njësoj të kërcënuar nga fuqia e ndryshimit që po vjen. Ndryshimi që unë dua nuk është një ndryshim i një kryeministri me një tjetër, i disa ministrave me të tjerë, për të vazhduar të njëjtin avaz të këtyre 18 vjetëve, gjatë të cilave pushteti në Shqipëri, është ndërruar disa herë në emër të së majtës dhe të së djathtës, por Shqipëria ka mbetur peng i po të njëjtave interesa, duke u lëkundur sa majtas djathtas, pa gjetur dot një ekuilibër mbi një shtet, që duhet tu shërbejë të gjithë shqiptarëve... Shqipëria nuk mund të vuaj plagë të tjera, për të përballuar oreksin e pashuajtshëm të familjes që na qeveris Ne do ta bëjmë Shqipërinë si gjithë Europa ”.

Përmes narrativës së tekstit, pika të rëndësishme në këtë fjalim janë: Bashkimi i koalicionit, diferencimi nga politikanët e vjetër dhe politikat e tyre të cilët janë përgjegjës, për mënyrën se si funksionojnë gjërat në vend, theksimi duke iu referuar kontekstit historik vetëm pas vitit 1990, ndryshe nga “Partia Demokratike”, që i referohet më shumë periudhës para vitit 1990.

Pjesë e fjalimit janë edhe problematikat si, papunësia për të rinjtë dhe prindërit, të moshuarit që nuk mund të paguajnë ilaçet, për familjet që nuk kanë të ardhura, problemi i analfabetizimit, plagë si ajo e Gërdecit, përgjegjëse e të cilave është familja që qeveris, gjë që do të ndryshojë me ardhjen e PS-së në pushtet, pasi objektivi kryesor është që Shqipëria të bëhet si Europa.

Nga konferenca për shtyp e Kastriot Islamit, sekretar për çështjet zgjedhore në Asamblenë Kombëtare, Zëri i Popullit, 16. 5. 2009, fq. 2.

Dy tematika trajtohen në këtë konferencë: Shkelja që kryetari i KQZ-së, Ristani ka bërë duke shkelur Kodin zgjedhor

“ Së pari ndryshe nga zonja Glover që pohoi se Shqipëria ka ndryshuar shumë krahasuar me vitin ’96, Berisha me kërkesën për largimin e saj vërtetoi, se ai jo vetëm nuk ka ndryshuar aspak, por me mentalitetin e tij të vjetër synon të manipulojë zgjedhjet e 2009 me të njëjtin model që aplikoi në vitin 1996, por me teknika më të sofistikatuara, duke kërkuar ti fshihet monitorimit ndërkombëtar. Ndërkohë që Berisha bëri një gafë politike e diplomatike me pasojë reagimin e fortë ndërkombëtar, zoti Ristani ka shkelur rëndë kodin zgjedhor, duke hedhur njëkohësisht një hap shumë të

gabuar në drejtim të delegjitimitit të KQZ dhe keq administrimit të procesit zgjedhor. Kjo sjellje ka çënuar shumë rëndë pavarësinë dhe funksionalitetin e KQZ, i cili ka një mision madhor e deri historik për të administruar për herë të parë në këtë vend anëtar të NATO zgjedhje në përputhje të plotë me standardet demokratike...bazuar në modelin e sjelljes partiake të kryetarit Ristani të vendosur tërësisht nën ndikimin personal të Berishës, veprimtaria e KQZ ka filluar të kompromentohet rëndë nga një sërë vendimesh tërësisht me natyrë partiake e antiligjore, të cilat janë një ogur i keq për administrimin e zgjedhjeve... Mungesa e vullnetit të qeverisë dhe veprimet e saj selektive kanë vënë në rrezik pajisjen e votuesve me letërnjoftim”.

Reagimi i Islamit, përmes funksionit që kryen si sekretar për çështjet zgjedhore në “Asamblenë Kombëtare”, vjen si përgjigje ndaj letrës që Ristani ka dërguar në emër të KQZ-së, ndaj misionit të ODIHR-it. Përmes deklaratës theksohet pozicioni i njëanshëm i Ristanit edhe pse është në krye të një institucioni të rëndësishëm si KQZ-ja, si rezultat i ndikimit partiak dhe personal të Berishës. Tematika e dytë shënjestron qeverinë e cila përmes veprimeve të saj, rrezikon ecurinë e procesit zgjedhor, si rrjedhojë e problematikave të pajisjes së votuesve me letërnjoftim.

Fjalim i Edi Ramës i mbajtur në konferencën kombëtare të PS, Zëri i Popullit, 17.5.2009, fq. 2.

“Është koha që ndryshimi të ndodhë jo për të ndryshuar qeveritë, por për të ndryshuar mënyrën se si Shqipëria qeveriset.... 28 qershori do të jetë fillimi i fundit të kësaj përpëlitje 18 vjeçare. Kjo politikë e vjetër flet për suksese të papara kurrë më parë, për ekonominë që rritet si askund në botë, për Shqipërinë ku të gjithë duhet të ndjehen të lumtur. Ndërkohë s’kalon ditë pa u dëgjuar bataretë e sharjeve e të shpifjeve ndaj kujtdo që thotë se kjo Shqipëri s’mund të vazhdojë të jetë pa shtet të të gjithëve, pa abetare për të gjithë fëmijët, pa kujdes shëndetësor për të gjithë të sëmurët, pa mbështetje për të gjithë bujqit e fermerët, pa mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët e saj, kudo ku jetojnë në qytet a fshat, në veri a në jug, në fushë apo në mal... madje pikërisht sepse nuk e di detyrën e tij, kryeministri ynë i ndjekur nga kori i oborrtarëve të paaftë, kapardiset, duke treguar rrugët kombëtare që shtrojnë kompanitë private me paratë e taksapaguesve shqiptarë, ndërkohë që nuk bën asgjë për standardet e këtyre rrugëve. Të cilat masakrohen dhe kthehen në rrugë vdekjeprurëse jashtë çdo standardi europian, për shkak të ndërtimeve kuturu në të dy anët e tyre, sepse qeveria e Sali Berishës nuk e di dhe nuk e bën detyrën e mbrotjes së territorit dhe të tokës bujqësore...Keni parë rrugë si këto që ndërtohen nën Sali Berishën... Historie të re, që kërkon zemër e kurajë për të parë larg, aty ku panë të parët tanë, që na lanë amanetin e Shqipërisë zonjë dhe aty ku na çojnë këmbët e brishta të ëndrrave të fëmijëve tanë...”.

Rama i drejtohet të gjitha shtresave sociale, duke patur në fokus ndikimin sa më të gjerë dhe gjithëpërfshirës të elektoratit, pa dallim gjinie, krahine, etj. Arritjet e prezantuara nga “Partia Demokratike”, gjatë mandatit qeverisës, negativizohen plotësisht, pasi Rama përdor ligjërim negativ në raport me funksionin e Berishës si kryeministër. Dy alternativat sipas Ramës janë alternativa e vjetër e Berishës dhe alternativa e re që propozon ai.

Sërish, sipas Chilton (2004:45), një ndër funksionet strategjike në komunikimin politik është 'legjitimimi dhe delegjitimimi', përmes teknikave që fokusohen tek dëshirat dhe nevojat e votuesve, tek ideologjia përbashkuese mes aktorit politik dhe votuesve, tek roli i liderit dhe vetëprezantimi pozitiv, që shërben për të legjitimuar pushtetin politik. E kundërta e legjitimit, delegjitimimi i referohet palës tjetër, atyre, të cilët janë të huaj apo rivalë (politikë) përmes teknikave që theksojnë ndryshimet ndërmjet dy grupeve, pasi ata paraqiten negativisht: Teknikat e përdorura në ligjërimin politik të Ramës, përmes fjalimit të mësipërm, synojnë funksionin strategjik të legjitimit të tij dhe partisë së tij, si dhe delegjitimimin e rivalit politik dhe qeverisë së tij.

Fjalimi i Edi Ramës në zonën e Bregut të Lumit, nga Zëri i Popullit, 19. 5. 2009, fq. 3.

*“...Do të kenë mundësi të shohin një **transformim** që është po aq i paimagjinueshëm sa ç'ishite transformimi i Tiranës në tërë këto vite ku ne e nisëm vërtet nga zero”*

Për të bindur elektoratin që të votojë majtas, Rama përdor funksionin e tij si kryebashkiak, përmes arritjeve të bëra në bashkinë e Tiranës.

Fjalimi i Edi Ramës në Durrës, nga Zëri i Popullit, 22. 5. 2009, fq. 5.

*“Aq më tepër tani që një fushatë mes së **shkuarës** dhe të **ardhmes**, një betejë mes së nesërme dhe të djeshme po fillon, e cila nuk duhet të mbetet në duart e po atyre njerëzve që prej 18 vitesh flasin pa pushim dhe pa pushim bëjnë të kundërtën e asaj që thonë... Përpara 30 vjetësh në plazhin e Durrësit ne dëgjonim në radio të vogla që mezi i kapnin valët, këngë të huaja. Këngë të huaja që në atë kohë konsideroheshin si diçka aspak e hijshme... Unë dua t'iu them se politika është në dorën tonë. Ne mund ta kthejmë politikën në një instrument për të bërë të mundura sot gjëra që duken të pamundura”.*

Rama distancohet nga politika 18 vjeçare, duke e parë alternativën e vet si diçka të re. Në fjalimet e PD, kjo pjesë hyrëse e fjalimeve, zëvendësohet me arritjet e bëra.

Bie në sy gjuha e përdorur për periudhën komuniste, pasi ky fakt nuk konsideroj vetëm diçka aspak e hijshme, por përbënte një krim politik, duke u dënuar nga kodi penal me burg.

Qëllimisht është shmangur nga fjalimet e tij periudha komuniste, për të treguar që nuk ekziston më një lidhje organike mes saj dhe “Partisë Socialiste”, kjo për të tërhequr rreth vetes edhe të pakënaqurit e së djathtës apo shtresën e ish të persekutuarve. Pra, është një stil ligjërimor i studiuar mirë. Përdoret një ligjërim ku theksohet përemri ne, bashkimi me popullin, i cili prodhon efekte ideologjike.

Fjalimi i Edi Ramës me emigrantët shqiptarë në Greqi, Zëri i Popullit, 22. 5. 2009, fq. 5.

*“Katër vjet më parë **Sali Berisha** premtoi liberalizimin e vizave dhe ja ku jemi sot në fund të mandatit të tij dhe në **prag të fundit të karrierës së tij politike**, ky premtim ngelet i pambajtur”.*

Kundërshtari politik akuzohet nga lideri i së majtës, për premtime të pambajtura gjatë mandatit qeverisës, duke e fokusuar trajtimin e kësaj problematike jo tek puna e qeverisë, por tek premtimi i Berishës.

Nga konferenca e Islamit me statusin sekretar për çështjet zgjedhore në PS, Zëri i popullit, 28. 5. 2009, f. 5

“...Përgjigjja e një kërkesë të drejtuar prej nesh prej shumë kohësh është krejtësisht e paplotë dhe e pasaktë, e nxituar dhe në disa raste abuzive”.

Mënyra se si është përgjigjur Ministria e Brendshme, në lidhje me procesin e kartave të identitetit shihet shqetësuese nga ana e PS-së. Kjo forcë ka kërkuar listën e votuesve me pasaportë, pa pasaportë dhe ata që kanë aplikuar dhe kanë marrë në dorë letërnjoftimin. Tematika kryesore është akuza kundrejt ministrisë, që nuk ka sjelljen e duhur të një institucioni.

Fjalimi i Edi Ramës në hapjen e fushatës në qytetin Studenti, Zëri i popullit, 29. 5. 2009, fq. 2.

*“Në sytë e mi, Shqipëria e librave të historisë, e luftërave për identitet dhe pavarësi, e poemave romantike dhe e letrave të ndaluara, shqipëria e heronjve të luftës dhe e martirëve të diktaturës, Shqipëria e lagjes ku linda, e shkollës ku mësova të shkruaj emrin e saj, e shokëve të fëmijërisë, e dashurisë së parë, Shqipëria me det e anije arratije, Shqipëria e ëndërruar si gjithë Europa që më nxori në rrugë për të **rrëzuar komunizmin** dhe më futi në politikë për të ngritur ura **drejt Europës**... Kjo bindje dhe nevojë e kudondodhur për ndryshim më ka shtyrë në rrugën e **politikës së re**... Kjo bindje dhe nevojë jetike për ndryshim më ka çuar **përtej të majtës dhe të djathtës**... Më kërkon mua i gjori **kryeplak i politikës së vjetër** që të iki nga detyra e kryetarit të Bashkisë pa i pyetur ata që dy vjet më parë më zgjodhën për të tretën herë me rradhë dhe që para dy vjetësh i dhanë shuplakën e tretë rradhazi Sali Berishës për akuzat, shpifjet e fyerjet e tij kutërbuese, të cilat prej tetë vjetësh ndosin mjedisin tonë qytetar e politik... Për Sali **Berishën qëllimi i vetëm është pushteti i tij**, politika është një tregti gënjeshtresh dhe kontrata me qytetarët është një tallje cinike sa shpërthimi i Gërdecit... Për një Shqipëri ku akuzat e pavërteta ndaj tjetrit për qëllime politike, shpifjet për tjetrin për përfitime politike, fyerja e tjetrit dhe e njerëzve të tij të dashur për hir të politikës, t'ia lenë vendin ballafaqimit të ideve, debatit të pikëpamjeve të kundërshtisë së argumentave, si në të gjithë **Evropën** ku ne do ta integrojmë Shqipërinë”.*

Rama ndërton një ligjërim politik mbështetur në strategjinë e politikës së re, që distancohet nga politika e vjetër, duke patur si karakteristikë të saj gjithëpërfshirjen, përtej diferencave politike. “Politika e Re, kjo njësi kuptimore e zbrazët mëton të jetë, pra gjithçka që politika e vjetër nuk mundet: Zhvillim ekonomik, transparencë, integrim europian dhe kështu me rradhë”(Budini, 2008: 27).

Flet për objektivat, të cilat janë pika kryesore në programin e partisë në këto zgjedhje, (duke theksuar) për një Shqipëri si gjithë Europa. Jep mesazhin se alternativa e tij është europiane, larg shpifjeve dhe sulmeve, por me forcën e argumentit dhe programit, pasi kërkon të jap imazhin e një lideri europian, ndërkohë që në retorikën politike të tij, sulmet politike nuk janë të pakta. Sulmet ndaj kundërshtarit politik janë të fokusuara jo tek “Partia Demokratike”, por te lideri i saj, tek Berisha.

Fjalimi i Luiza Xhuvanit në hapjen e fushatës në qytetin Studenti, Zëri i popullit, 29. 5. 2009, fq. 5.

*“Edi Rama interesohet më shumë për njerëzit që përfaqëson se për politikën. Kjo vjen për shkak të **shpirtit të artistit** që gjendet brenda tij... Ai futi frymën e një jete të re në një qytet që ishte lënë në harresë për një kohë shumë të gjatë kioskike”.*

Në ligjërimin politik të kandidatës për deputete, Luiza Xhuvani, ndërtimi i indentitetit të Ramës bëhet, duke përdorur strategjinë e emërtimit të grupit, që e bën të jetë një politikan që është më afër njerëzve se politikës.

Në raport me arritjet e tij si kryebashkiak, pavarësisht se prezantohen si të suksesshme nga Rama dhe kandidatët për deputetë të PS-së, nëse i referohemi debatit publik të asaj kohe, lidhur me faktin se kujt i takon arritja e prishjes së kioskave në kryeqytet, do të hasim se vendimi për prishjen e tyre i takon Ilir Metës, i cili firmosi i pari këtë nismë, por edhe mbështetjes së qeverisë në këtë plan aksion të përbashkët. Përveç kësaj, betonizimi i qytetit dhe dhënia e lejeve të ndërtimit pa kriterë nga Rama, janë akuza të vazhdueshme të PD-së, gjatë zhvillimit të fushatës zgjedhore, por këto pika nuk përmenden në fjalimet e të majtës, pasi sipas funksioneve strategjike të komunikimit politik, aktorët politikë përzgjedhin informacionet që i prezantojnë publikut, duke përjashtuar informacione në nivelin sasior dhe cilësor, pasi mund të kenë ndikim negativ tek opinioni publik.

Fjalimi i Gramoz Ruçit në hapjen e fushatës në qytetin Studenti, Zëri i popullit, 29. 5. 2009, fq. 5.

*“Politika e vjetër i ktheu shpinën qytetarëve shqiptarë, politika e re i vë ata në rradhë të parë. **Edi Rama prezanton shpresën... ndryshimin që na duhet dhe e meritojmë**”.*

Gramoz Ruçi në hapjen e fushatës në qytetin Studenti, përmend dështimet e Berishës në shëndetësi, në reduktimin e papunësisë, në përfshirjen e familjarëve të tij në ngjarje si ajo e Gërdecit, dhe në antagonizëm me Berishën është lideri Rama, i cili përfaqëson shpresën për shqiptarët.

Kush është politika e re dhe e vjetër së cilës i referohet Z. Ruçi? Po të shohim funksionet që ka mbajtur gjatë përfshirjes së tij në politikë, del se në vitin 1985, Ruçi filloi karrierën e tij politike në radhët e regjimit komunist. “Ai u emërua Sekretar i parë i Partisë së Punës i rrethit të Tepelenës në vitin 1988, dhe në vitin 1990 ai u emërua Ministër i Brendshëm”(Cituar nga https://sq.wikipedia.org/wiki/Gramoz_Ru%C3%A7i). Në këtë kuptim del e paqartë se cila është politika e re dhe e vjetër, së cilës i referohet Z. Ruçi.

Fjalimi i Lindita Nikollaj në hapjen e fushatës në qytetin Studenti, Zëri i popullit, 29. 5. 2009, fq. 5.

*“Ndaj për të mirën time, për të mirën e fëmijëve tanë dhe për të mirën e grave në të gjithë vendin unë votoj Partinë Socialiste, unë votoj **Edi Ramën**”.*

Strategjitë e përdorura në ligjërimin politik të kandidatës për deputete, Lindita Nikolla, synojnë ndikimin e elektoratit për t’i ofruar mbështetje liderit të partisë së saj, pasi ai kategorizohet si lideri i duhur, për të ardhmen e Shqipërisë.

Fjalimi i Ben Blushit në hapjen e fushatës në qytetin Studenti, Zëri i popullit, 29. 5. 2009, fq. 5.

*“Ne jemi mbledhur sot për t’u nisur drejt **Europës** dhe ata që na vonuan nuk mund të na pengojnë më... Dua të kujtoj fjalët e mikut tim Edi Rama, i cili në vitin 1990 thoshte se komunizmi na skuqi si rusë, na zverdhi si kinezë dhe na nxiu si shqiptarë”.*

Ndryshe nga figurat e tjera politike Blushi nuk i drejtohet Berishës, por flet për sistemin qeverisës gjatë periudhës 19 vjeçare, i cili ka qenë faktor për një Shqipëri larg Europës. Përmend pjesëmarjen e tij në lëvizjen e parë studentore, aspiratat e atëhershme dhe realitetin e sotëm.

Fjalimi i Edi Ramës në Kombinat, Zëri i Popullit, 3. 6. 2009, fq. 3.

“Ta çlirojmë Tiranën nga varësia e një kryeministri, që prej katër vjetësh na tregon se s’ka vizion të ri, s’ka ide të reja, s’ka qytetari të re europiane për t’i ofruar Tiranës...Tre herë e ka marrë përgjigjen nga populli i kryeqytetit për gjuhën e tij të ulët...”.

Ligjërimi politik i përdorur i referohet sulmeve politike ndaj liderit dhe kryeministrit Berisha dhe jo ndaj “Partisë Demokratike”, apo qeverisë. Ky stil ligjërimor dominon në ligjërimin politik të majtë gjatë fushatës zgjedhore, pasi kritikën drejtuar Berishës për personalizim institucionesh janë të vazhdueshme në fjalimet politike të të majtëve.

Fjalimi i Ramës në Krujë, Fushë- Krujë, Zëri i Popullit, 9. 6. 2009, fq. 2.

Në këtë fjalim, Rama e bën hapjen me një thënie që ia kanë përmendur, që Berisha duhet të shkojë në Bajram Curri, ndërsa përmendet dhe figura tjetër Skënderbeu, duke e lidhur me përkatësinë gjeografike. Përgjigjja e Ramës është strategjike tek pjesa kur nuk është dakord me diferencime të tilla pasi figurat historike, “janë njëkohësisht një arsye për tu bashkuar, që të gjithë, nën të njëjtin flamur, për të njëjtat ideale që nuk vjetërohen kurrë dhe me ide të reja drejt një Evrope..” Ne të gjithë së bashku, është togfjalëshi që dominon, duke dashur të heq ndasitë krahinore dhe politike.

Fjalimi i Edi Ramës në 18 vjetorin e themelimit të PS, Zëri i Popullit, 13. 6. 2009, fq. 2.

Retorika e këtij fjalimi, mbështetet në imazhin e partisë, historikun dhe transformimin e saj për të qënë një shprehje e shoqërisë, ku bën dallimin me forcën tjetër politike, e cila nuk e reflekton këtë. Flet për kandidatët duke theksuar se, “në parlamentin e ri do të ketë 20% gra. Do të ketë një grup parlamentar që do të ketë 20% juristë dhe 27% pedagogë dhe arsimitarë”. Tregon dallimin midis partisë së djathtë dhe partisë së majtë, përse i takon kryesimit të listave të kandidatëve, duke i kthyer përgjigje Berishës, se atij nuk i duhet një karrige deputeti pas zgjedhjeve, pasi do të ketë një detyrë tjetër ku nënkuptohet ajo e kryeministrit dhe tregon që në krye të listës është Vasilika Hysi, e cila

vjen nga rradhët e shoqërisë civile. “...Dhe është një tjetër shprehje e asaj që “Partia Socialiste”, sot është një fuqi që përfaqëson shumë më tepër se sa vetveten”.

Fjalimi i Edi Ramës në mbylljen e fushatës elektorale në Tiranë, Zëri i Popullit, 27. 6. 2009, fq. 2.

“36 orë nga sot, ne do të kemi në dorë jo një votë për të ndërruar një qeveri me një tjetër, por të drejtën për të ndërruar faqen e historisë me votën tonë... Kjo nuk është beteja e shqiptarëve të majtë dhe shqiptarëve të djathtë. Kjo është beteja e Shqipërisë me varfërinë që nuk është e majtë dhe as e djathtë... Mes nesh dhe së ardhmes qëndron kryeplaku i politikës së vjetër, Sali Berisha dhe një soj i vjetër oborrtarësh të pushtetit të familjes së tij, që i dhanë kësaj fushate agresivitetin primitiv të atyre që pushtetin e humbur në zemrat e njerëzve, duan ta mbajnë duke u futur njerëzve frikën në zemër”.

Stili ligjërimit i përdorur karakterizohet nga një ton që synon të ketë funksion ndikues tek elektorati, përmes identifikimit të shkakut, ku e keqja e madhe dhe që pengon të ardhmen, është Berisha.

Në ligjërimit politik të majtë gjatë fushatës zgjedhore aktorët politikë të së majtës, përdorin argumente duke i'u referuar strategjive të legjitimitetit dhe delegjitimitetit. Legjitimiteti ndërtohet përmes tre komponentëve: Imazhi i partisë, imazhi i kandidatëve për deputetë si dhe imazhi i liderit. Imazhi i partisë që kërkon të reflektojë gjatë fushatës është ndryshimi. Risia nën drejtimin e tij konsiston në shkëputjen nga partia e dikurshme, nga e cila ka edhe rrënjët e krijimit, dhe nga konteksti 18 vjeçar i një keqpërdorimi pushteti, duke trumbetuar ardhjen e një partie të re me program të ri.

Imazhi i kandidatëve është një tjetër pikë e përmendur, duke theksuar përqindjet e fushave se nga vijnë kandidatët, për të treguar integritetin dhe intelektin e tyre. Një ndër problematikat e politikës shqiptare janë listat me kandidatët për deputetë, ku gjinia femërore nuk ka pasur përfaqësimin e duhur, prandaj në fjalimet politike të Ramës, midis elementëve të tjerë të përzgjedhur, theksohet edhe respektimi i barazisë gjinore në këtë garë.

Imazhi i liderit kryesor të “Partisë Socialiste”, ndërtohet më së shumti duke përmendur arritjet e tij si kryebashkiak i kryeqytetit. Në renditjen e arritjeve dhe duke theksuar ndryshim e madh që ka pësuar Tirana nën udhëheqjen e tij, bëhet një analogji se kjo do të ndodhë nëse vjen Rama në pushtet, një ndryshim i ri dhe mendësi europiane. Këto paraqiten në funksion të ndryshimit përmes një programi të mirëndërtuar (edhe pse nuk

është paraqitur në mënyrë fizike), por i cili propagandohet dhe arrin të realizojë një fushatë reale.

Një tjetër element që vërehet, është personalizimi i partisë me emrin e liderit. Nëse themi voto “Partinë Socialiste”, kemi thënë voto Edi Ramën. Kjo shërben për të dhënë mesazhe brenda dhe jashtë partisë dhe njëkohësisht marrjen përsipër të përgjegjësisë së suksesit dhe dështimit, nga vetë lideri. Figurat e tjera politike përforcojnë imazhin pozitiv të liderit, ndërsa Islami me funksionin që ka përcjell edhe shqetësimet e partisë, në lidhje me procesin zgjedhor.

4.1.2 Ligjërimi politik i djathtë përmes fjalimeve, 2009

Në përzgjedhjen e ligjërimit politik gjatë fushatës zgjedhore të kësaj partie, i jemi referuar gazetës së saj “Rilindja Demokratike”, si një organ i cili ka përcjellë fjalimet politike të PD-së. Dihet që gazetatat partiake mbështesin dhe pasqyrojnë vetëm anën pozitive të partisë që mbështesin, duke nxjerr në pah të metat e krahut tjetër, përmes publikimit të fjalimeve, prandaj për këtë arsye kemi marrë gazetën e secilit krah në këtë pjesë të analizës.

Në kampionimin e bërë rezulton që fjalimet e publikuara janë kryesisht të Berishës, dhe të figurave të tjera të së djathtës, si kryetarja e kuvendit, Jozefina Topalli. Përmes analizës numerike, janë përfshirë në studim: 7 fjalime të Berishës, 4 të Jozefina Topallit dhe 2 fjalime të Astrit Patozit. Fjalimet janë marrë nga gazeta e saj zyrtare, pasi është organ mediatik i së djathtës dhe lejon publikimin e tyre në mënyrë të vazhdueshme, por duke qenë se analiza sasiore e fjalimeve ndërmjet të majtës dhe të djathtës, prodhonte një disekuilibër sasior, përmes të njëjtës metodë janë përfshirë fjalime edhe nga gazeta”55”.

Fjalimi i Jozefina Topallit në Asamblenë Parlamentare të Natos, “Rilindja Demokratike”, 27. 05. 2009, fq. 4.

Përshkrimi i historikut të Shqipërisë, sjell traditën si kujtesë historike, duke iu referuar vlerave pozitive, tolerancës fetare, dhe besimit në vlerat e perëndimit. Në kohë të krizës globale Shqipëria, vazhdon të ketë rritje ekonomike. Për të ndikuar mbi elektoratin,

gjatë fjalimit të zonjës Topalli, listohen arritjet e qeverisë si: Modernizimi i infrastrukturës, në ekonomi reforma të një revolucioni fiskal, përgjysmimi i taksave, aplikimi i taksës së sheshtë, dyfishimi i rrogave dhe pensioneve, lufta ndaj evazionit fiskal, taksat elektronike, doganat elektronike, rritja e turizmit, të cilat janë argumente të mira për të ndikuar tek elektorati. Programi i qeverisë dhe mazhorancës së djathtë ishte një sukses i plotë përse i përket luftës së korrupsionit.

Referimi në mënyrë të vazhdueshme ndaj institucioneve të rëndësishme ndërkombëtare: “Banka Botërore, nëpërmjet raportit të saj prestigjioz “Doing Business” e rreshtoi Shqipërinë ndër dhjetë ekonomitë më reformatore të botës, duke i dhënë asaj vendin e dytë për 4 nga 10 kategoritë e vlerësuara”. Ky stil ligjërimor i përzgjedhur synon të ndikojë në opinion publik, për vetë kontekstin politik dhe ekonomik të Shqipërisë, ku ndërkombëtarët mbesin referenca të rëndësishme në krijimin favorizues apo disfavorizues të opinionit publik, kundrejt partive politike.

Objektivi: “Por një mur tjetër duhet të shembim, së bashku me vendet mike. Murin e Shengenit”. Ky është fokusi i politikës së jashtme.

Për vetë kontekstin se ku mbahet ky fjalim nuk kemi përdorimin e një ligjërimi politik, që përfshin kundërshtarët politikë.

Fjalimi i Jozefina Topallit në takimin e forumit të gruas në Partinë Demokratike, “Rilindja Demokratike”, 29. 05. 2009, fq. 4.

*“Kodi ynë i AND-së është dashuria, kodi ynë i AND-së është dhembshuria.... Jemi shtyllat e familjes, jemi shtyllat e kombit, jemi shtyllat e vendit... Por unë sot nga kjo nisje e fushatës, të cilën e filloni ju gratë, zonjat, ju demokrate dhe unë e përsëris njëmijë herë: **burrat mund të jenë të majtë të djathtë, por nënat janë demokrate dhe vetëm demokrate..** Unë dua të jem mbështetësja juaj, dua të jem avokatja juaj” Hajdeni të vazhdojmë të ndryshojmë Shqipërinë! **Shqipëria po ndryshon**”.*

Strategjitë ligjërimore mbi të cilat ndërtohet fjalimi, synojnë të ndikojnë përmes emocioneve, që shkaktohen nga përzgjedhja leksikore, e cila përforcohet përmes sloganit, “Shqipëria po ndryshon”.

Fjalim i Sali Berishës i mbajtur në inaugurimin e tunelit të Kalimashit, gazeta “55”, 1.6.2009, f.3

“Sot ne përjetuam këtu realizimin e njëres prej ëndrrave më të bukura të shqiptarëve, përjetuam shembjen, jo të një muri, por të një mali, përjetuam shembjen, jo të një muri

por të pamundësisë...Sot ne vendosëm se nuk ka male, nuk ka pengesa, nuk ka asgjë që mund ta ndajë, jo vetëm shpirtërisht por as fizikisht këtë **komb**. Tuneli është një vepër e kushtueshme, por dua të theksoj se për një **komb** dhe njerëz kohëhumbur siç jemi ne, çmimi i kohës është çmimi i të gjitha çmimeve, ndaj dhe ky tunel kushton shumë më pak, se sa koha e kalimtarëve nëpër të, në një vit të vetëm... Ne ju mbetemi mirënjohës juve. Ju do të jeni pjesë e historisë sonë, e përpjekjes sonë për zhvillim dhe **modernitet**... Dua të falendëroj Parlamentin për mbështetjen e madhe që i dha projektit, të falendëroj miqtë e mi kudo në botë të cilët, **më kanë inkurajuar shumë për realizimin e këtij projekti të madh**. Unë do ta mbyll fjalën time me një zotim, se pas këtij tuneli dhe këtij korridor **qeveria ime** nuk do të lerë mal pa shembur, nuk do të lerë asgjë pa bërë, në mënyrë që shqiptarëve t'ua japim Shqipërinë në pëllëmbë të dorës”.

Sipas Confrancescos (Bobbio, 1997), tradita është një ndër kriteret e përdorura për të dalluar të majtën nga e djathta, pasi tradita së bashku me variablat e saj, mund të kategorizohet si një ndër elementët që i përshtaten idelogjisë së djathtë, ndryshe nga e majta e cila identifikohet përmes emancipimit, megjithatë në ligjërimin politik të Berishës përfshihet dhe emancipimi, përmes përpjekjes për zhvillim dhe modernitet.

Në këtë ligjërim, tradita evidentohet përmes tre kuptimeve: Tradita si besnikëri ndaj kombit, tradita si kujtesë historike si dhe tradita si përcaktim ideal i një epoke aksiale, ose vendimtare, në historinë e njerëzimit. Legjitimimi i Berishës në fjalimin e tij politik ndërtohet përmes një retorike që thekson rolin e pazëvendësueshëm të tij, për këtë projekt të ndërmarrë nga qeveria, e cila kategorizohet, nga ai si: ‘Qeveria ime’.

Fjalim i Berishës i mbajtur në ceremoninë e hapjes zyrtare të fushatës të PD-së në Tiranë, 2.6.2009, f.3 “55”

“Së pari ju përshëndes vëllazërisht ju, në këtë shesh, të gjithë qytetarët shqiptarë, kudo që ndodhen sot, u shpreh mirënjohjen më të thellë qytetarëve të kryeqytetit të cilët me besimin e tyre, katër vjet më parë, bënë që Tirana sot të jetë kryeqyteti i Shqipërisë anëtare e Natos. Tirana, sot të jetë aplikante për anëtare e plotë në Bashkimin Europian, Tirana sot të jetë kryeqyteti i vendit me rezultatet ndër më të shkëlqyerat për **klimën e biznesit**, Tirana sot të jetë në startin e madh të fitores së re, fitores së 28 qershorit, **Tiranës Europiane, Shqipërisë Europiane**. Sot ne nisim startin e madh për fitoren e dytë, fitoren, e cila do të ketë si motër 22 marsin e vitit '92. Fitoren e cila do të ketë për mision ëndrrën e madhe **europiane** të tiransëve, të mbarë shqiptarëve. Tirana **europiane** do të ndërtojë Shqipërinë **europiane**, si të jetë Tirana do të jetë Shqipëria. Katër vitet që vijnë janë vitet e projektit tonë të madh, projekt me të cilin qytetarët shqiptarë, qytetarët e Tiranës, njëjloj si ata të **vendeve europiane** do të kenë rrugët, autostradat, transportin, e standardeve më të mira. **Tirana europiane dhe Shqipëria europiane** do të jetë Tirana e qytetarit dhe Shqipëria e qytetarit, me 24 orë ujë në mbarë vendin, me shkollat më të mira, me shërbimin shëndetësor dinjitoz për një **qytetar europian**. **Tirana europiane** do të jetë Tirana e punës, e biznesit, e progresit, e zhvillimit, e pasurimit, e begatisë. Në Tiranë dhe në mbarë Shqipërinë do të krijojmë së bashku **160 mijë vende pune të reja**. Tirana do të jetë në katër vite kryeqyteti me unazën më moderne dhe më të re në **Evropë**, i unazës së madhe dhe korridoreve të saj. **Tirana europiane, Shqipëria europiane** do të jetë kryeqyteti i vendit, qytetarët e pensionistët të cilët do të paguhen edhe më mirë se ata të 6 vendeve anëtare të BE-së. **Tirana**

*europiane do të jetë Tirana e lirive, do të jetë Tirana e prestigjitetit dhe e dinjitetit të këtij kombi. Në katër vite, ne së bashku, këtu në Tiranë, ku ne e nisëm udhëtimin tonë të lirisë, do të shndërrojmë në realitet ëndrrën tonë të bukur, Tirana gati nuse për anëtare të **Bashkimit Europian**. Së bashku me 28 qershor të rikthejmë lavdinë tonë elektorale, 22 marsin e vitit '92. Fitore”*

Në këtë fjalim politik të liderit Berisha, fjala më dominuese sikundër mund të evidentohet gjatë leximit të tekstit, është fjala ‘europiane’ (përkatesisht 14 herë), e cila përdoret për të ndikuar mbi opinionin publik, pasi tradita e përdorur si kujtesë historike në raport me kontekstin politik të pas viteve 1990, (ku PD luajti rolin kryesor si forcë opozitare kundrejt sistemit komunist) Europa ishte gjithçka çfarë shqiptarët kishin ëndërruar. Në këtë linjë, ky term që merr kuptim përmes kontekstit politik, ekonomik, shoqëror, përdoret nga PD-ja dhe aktorët e saj si njësi kuptimore që përfshin zhvillim, ekonomi të mirë, shërbime shëndetësore, vende të reja pune, ‘gjithçka si në Europë’.

Fjalimi i Astrit Patozi i mbajtur në Vlorë, “Rilindja Demokratike”, 4. 6. 2009, fq. 7.

*“**Qeveria Berisha** investoi mbi 500 milion euro për Vlorën dhe banorët e saj, duke hyrë në histori si administrata që ka bërë më shumë se kushdo tjetër në historinë e Shqipërisë për vlonjatët dhe banorët e tjerë të këtij qarku. Vetëm për bashkinë e Vlorës kjo qeveri ka akorduar 4 herë më shumë fonde se katër vitet e fundit të pushtetit të Partisë Socialiste... Përfundimi i rrugëve të pambaruara, uji i pijshëm në çdo fshat, do të punojmë më fort për Shqipërinë Europiane. Prandaj ne do të fitojmë në Vlorë, ne do të fitojmë në të gjithë Shqipërinë... Ne u themi sot kundërshtarëve tanë politikë që të dalin nga skutat dhe vrimat ku e kanë zhvendosur fushatën, në ndjekje të Edi **Ramës**, kryetarit të tyre të lodhur dhe të kapitulluar. Ai ka gjetur si shpëtim që të sigurojë kokën e vet në vendstrehimin e Bashkisë”.*

Strukturimi i fjalimit politik të Z. Patozi, mbështetet në theksimin e arritjeve gjatë këtij mandati qeverisës, në objektivat e mandatit të ardhshëm si dhe në akuzat për kundërshtarët politikë. Arritjet si: 70 milion euro investime, 250 km rrugë të ndërtuara, ujësjellësa, kanalizime, ndërtimi i shkollave dhe vepra të tjera publike janë vepra të qeverisë e cila personalizohet, duke u emërtuar qeveria Berisha. Objektivi kryesor është fitorja e zgjedhjeve në Vlorë dhe në gjithë Shqipërinë, e cila do të shoqërohet me punë konkrete për një Shqipëri Europiane. Sulmet ndaj kundërshtarëve politikë, fokusohen tek kryetari dhe lideri i së majtës, i cili etiketohet si i lodhur dhe i kapitulluar.

Fjalimi i Jozefina Topallit në takim me forumin e gruas në Korçë, ‘Rilindja Demokratike’, 7. 6. 2009, fq. 4.

*“...Po të shikoni historinë tonë dhe po të kthemi pas, ora ka qenë e ndalur gati njëmijë vjet. Dhe çfarë ka ndodhur pas kësaj? Pas kësaj janë shtuar vetëm 18 vjet. **Vetëm 18 vjet dhe Shqipëria po ndryshon**. Vetëm gjatë këtyre katër viteve të fundit ajo është*

transformuar totalisht... e thjeshtë shumë e thjeshtë, sepse ata vidhnin, vidhnin dhe vetëm vidhnin ”.

Ky është një nga fragmentet e fjalimit ku rreshtohen arritjet e realizuara nga qeveria. Për kundërshtarët politikë shprehet se janë pengesë për çdo reformë, ndërsa objektivat janë për, Shqipërinë në Europë.

Fjalimi i Jozefina Topallit në Shkodër, “Rilindja Demokratike”, 13. 06. 2009, fq. 11.

*“Ata nuk besonin se Shkodra mund të bëhej. Në fakt ata këtë dëshironin, por ne shkodranët kemi besuar çdo ditë, çdo orë, çdo minutë, çdo sekondë dhe bashkë kemi ndryshuar Shkodrën, bashkë kemi ndryshuar Shqipërinë, bashkë kemi realizuar ëndrrën më të madhe që prindërit tanë, **baballarët e kombit** donin për vendin tonë, për Shqipërinë: **Shqipëria në Nato**, Shqipëria candidate për status ”... 28 qershori do të jetë një ditë e jashtëzakonshme. Fitorja do të jetë më e madhe se '92-shi”.*

Në fjalimin e saj drejtuar qytetarëve të Shkodrës, zonja Topalli përdor në mënyrë të vazhdueshme kontekstin historik të qytetit në raport konfliktual me sistemin komunist, përmes traditës si kujtesë historike, duke theksuar se ne shkodranët ia dolëm të realizonim ndryshimet, të cilat vërtetohen përmes arritjeve si investime, shkolla, etj.

Konteksti përta i përket zgjedhjeve në vendet e tjera jashtë Shqipërisë, të cilat u fituan nga qendra e djathtë, përdoret për të përlligjur ngjyrën që përfaqëson “Partia Demokratike”, ideologjinë e saj, për të treguar dominancën dhe mbështetjen e gjerë të partive të djathta në popujt fqinjë, si një shembull që duhet ndjekur, me objektiv kthimin e Shkodrës në një Vjenë të vogël, si dhe Shqipërisë në një Zvicër të vogël. Ndikimi i opinionit publik synohet përmes referimit tek tradita dhe tek konteksti politik ndërkombëtar.

Fjalim i Berishës në Divjakë, gazeta “55”, 11.6.2009, f.3.

“Yes, we will win the race. We will win the race. We are going to win the race. Dua të shpreh sot kënaqësinë time më të madhe që takohemi sot në këtë shesh si qytetarë të Divjakës dhe të Shqipërisë anëtare të NATO-s. Kurrë më krenarë dhe më ballëllartë nuk jemi takuar me njëri-tjetrin se sot.

*Dëshiroj të shpreh kënaqësinë time që në këto katër vite, ne ia dolëm t’i faktojmë njëri-tjetrit, t’i faktojmë miqve tanë kudo në botë që me mundin dhe djersën tonë ne kemi ndryshuar Divjakën dhe po ndryshojmë Shqipërinë. Ne ia dolëm që në katër vjet të bëjmë **rritjen më të madhe të rrogave dhe pensioneve** se çdo vend tjetër në **Evropë**... **Unë** ju garantoj ju se **turizmi** është dhe do të mbetet përparësia e të gjitha përparësive zhvillimore të mandatit të dytë të qeverisë time.*

*Por një njeri, i cili duket se nuk ka as **gramin e fundit të moralit politik dhe njerëzor** do të bojkotojë zgjedhjet... **Ti, Edi Rama** tregon se ke mbetur në **komplekset e lustraxhiut të bustit**, ke mbetur në labirintet e atyre për të cilët vota ishte plumb për armikun. Po të jap afat 24 orë dhe nesër, në qoftë se do, të ndryshojmë ligjin dhe vihu në krye të*

*listës.... 28 qershori është dita e ëndrrës sonë **europiane**, është dita e projektit tonë **europian**, është dita e të ardhmes tonë **europiane**”.*

Një ndër funksionet e ligjërimit politik të Berishës në këtë fjalim, është legjitimimi i partisë dhe qeverisë së djathtë, përmes arritjeve dhe sukseve politike të qeverisë nën drejtimin e Berishës dhe delegjitimimi i Ramës, përmes kategorizimit si: Lustraxhi busti.

Fjalim i Berishës në Tiranë, gazeta”55”, 15.6.2009, f.3.

*“Socialistë të Tiranës dhe mbarë Shqipërisë, mendoni për një moment se çfarë ju lidh ju me Edi Ramën. Asgjë nuk ju bashkon. Ai nuk ju do ju, ai do 99-shat e tij, me të cilët bën pazaret e fëlliqura të lejeve të ndërtimit. Kurse me **Sali Berishën** ju lidh **projekti europian**, ju lidhin rrogat e pensionet më të larta...Ju lidh besimi i madh që ka **Europa tek Sali Berisha** dhe tek PD-ja”.*

Një ndër funksionet e ligjërimit politik të Berishës në këtë fjalim, është ngacmimi në rrafshin emocional i publikut, duke ia atribuar kundërshtarit politik përdorimin e një leksiku me konotacion negativ si shpellarë dhe çëçenë, ndërsa funksioni tjetër i ligjërimit politik është delegjitimimi i tij, përmes kategorizimit si piktor i dështuar. Delegjitimimi i Ramës ndërtohet edhe përmes akuzave të cilat e kategorizojnë Ramën si një lider, që nuk përfaqëson të majtët por kriminelë dhe hajdutë me të cilët bën pazare, në antitezë me Berishën, i cili është promotori kryesor i zhvillimit të Shqipërisë, i rritjes së pagave dhe pensioneve, sipas modelit të: “Shqipërisë Europiane”.

Fjalim i Berishës në Tropojë, gazeta “55”, 16.6.2009, f.3.

*“Para pak javësh këtu erdhi Kryetari i PS-së, i cili në fakt është njëqind herë më i lidhur me **99-shat e lejeve të ndërtimit**, se sa me socialistët e Shqipërisë... Ajo që të kërkoj është kjo, që para se ti drejtohesh qytetarëve të Tropojës, socialistëve të Tropojës për votën duhet të heqësh çelësin e artë të bashkisë që vendose mbi gjoksin e himnizuesit të masakrave serbe mbi vëllezërit në Kosovë...Respekti i **Sali Berishës** për ta (për qytetarët), është me dhjetëra herë më i madh se respekti i **Edi Ramës**”*

Retorika e Berishës kundrejt delegjitimitit të Ramës, ndërtohet nëpërmjet traditës si kujtesë historike, duke synuar ndikimin e opinionit publik në rrafshin emotiv, përmes luftës së Kosovës dhe dekorimit të këngëtarit serb, nga ai. Delegjitimimi i Ramës, ndërtohet edhe përmes akuzave të cilat e kategorizojnë Ramën si një lider që nuk përfaqëson të majtët por përfaqëson individë të tjerë me të cilët e lidhin interesa ekonomike, pasi përmend lejet e ndërtimit gjatë ushtrimit të mandatit të Ramës si kryebashkiak, të cilat nuk janë në përputhje me ligjet dhe drejtësinë shqiptare, por me interesat e ngushta dhe përfitimet e Ramës.

Fjalim i Astrit Patozit në Sarandë, gazeta "55", 21.6.2009, f.3.

"Dhe sot ne jemi mbledhur kaq shumë në këtë shesh për t'i premtuar kryeministrit të Shqipërisë dhe liderit të ndryshimit, Sali Berisha, se Saranda do ketë pjesën e vet të rëndësishme në hartën blu të fitores së 28 qershorit...Nga ky shesh ne ftojme të gjithë sarandjotët që të përbuzin dhe refuzojnë ofertën e Edi Ramës. Modeli dhe lista e tij janë një përzierje e zullumeve të qeverive socialiste me korrupsionin, unikal në botë, të lejeve të ndërtimit, në bashkinë e Tiranës"

Fjalimi politik ndërtohet përmes krahasimit të dy liderëve Berishës dhe Ramës, që përfaqësojnë dy modele antagonistë, sepse nëse Berishës i atribuohen cilësi të tilla si lideri i ndryshimit, Rama si kryebashkiak përfaqëson një model dhe ofertë që duhet refuzuar, për shkak të abuzimeve me lejet e ndërtimit dhe listës së tij në përzgjedhjen e kandidatëve për deputetë. Strategjitë ligjërimore të përdorura në këtë fjalim, nuk reflektojnë përplasje partish në nivel vleror, pasi alternativa tjetër kundërshtarë identifikohet përmes Ramës dhe jo si parti e majtë.

Fjalimi i Sali Berishës në inagurimin e rrugës Rrëshen–Kalimash, Rilindja Demokratike 26. 6. 2009, fq. 13.

"...Koka e falur nuk pritet, i'a mbathe, u dorëzove ...Unë jam Sali Berisha mjek kardiolog, studiues i apasionuar, profesor i një universiteti. Në emër të dinjitetit, vendosa të përballem... Në emër të tyre vendosa të shkoj në kërkim të dinjitetit të kërkuar... Me dhjetëra e mijëra njerëz, në këtë sallë e Shqipëri dolëm në rrugët e Tiranës dhe themeluan Partinë Demokratike, përmbysëm diktaturën më të egër në Europë... Mos mendoni ju se tërhiqet Sali Berisha, jo dhe jo. Sali Berisha nuk do të mposhtet asnjëherë se asgjë nuk do të mposhtë të drejtën tuaj për të qenë pjesë e Europës".

Në fjalimin e Berishës në inagurimin e rrugës Rrëshen-Kalimash, përdoret referimi tek vlerat e popullit shqiptar, duke iu drejtuar kontekstit historik, për liri dhe dinjitet kombëtar. Krahas kësaj, Berisha përmend arritjet e qeverisë si: revolucioni fiskal, dyfishimi i pagave për mjekët, infermierët, mësuesit, 6000 km rrugë të ndërtuara, shkolla, interneti në shkolla etj. Korridori është themeli infrastrukturor i Shqipërisë moderne.

Ligjërimi politik i tij në raport me kundërshtarët politikë, merr forma antagonistë përmes sjelljes së tij në raport me liderin e Partisë Socialiste, të cilin e vlerëson humbës, pasi u dorëzua. Në raport krahasues prezanton veten, duku përdorur grupin e referencës si mjek, studiues dhe profesor, i cili bashkë me qytetarët, arritën të përmbysin sistemin komunist.

Fjalim i Berishës në Tiranë, gazeta “55”, 27.6.2009, f.3.

Në fjalimin e tij përmbyllës të fushatës zgjedhore të mbajtur në Tiranë, Berisha synon ndikimin e elektoratit në mënyrë gjithëpërfshirëse: Ai së pari përcjell sigurinë e fitores për elektoratin e djathtë, më pas i drejtohet të gjithëve pa dallime bindjesh politike se emëruesi i përbashkët është projekti europian, i cili ofrohet nga PD-ja, duke synuar më tepër ndikimin mbi elektoratin gri. Për të përforcuar mesazhin e tij, ai rendit arritjet politike të qeverisë së tij: “Ne arrestuam dhe luftuam me qindra e qindra banda, shembëm sistemin e kleptokracisë, qeveria u bë kampione në luftën kundër korrupsionit”, si dhe referon objektivat e vendosura për mandatin e dytë qeverisës.

Në ligjërimin politik të djathtë gjatë fushatës zgjedhore aktorët politikë të së djathtës, përdorin strategjinë e legjitimitimit dhe delegjitimitimit. Legjitimimi ndërtohet përmes këtyre komponentëve: Imazhi i qeverisë dhe i partisë, imazhi i kandidatëve për deputetë si dhe imazhi i liderit.

Fjalimet e aktorëve politikë të “Partisë Demokratike” dhe vetë liderit, janë të fokusuara më së tepërmi, në renditjen e arritjeve gjatë qeverisjes së tyre: Nën slloganin ‘Shqipëria po ndryshon’ trumbetojnë suksesin e realizuar në përmbushje të premtime të dhëna, ku spikat hyrja e Shqipërisë në NATO, e cila është një tjetër tematikë, që paraqitet si një sukses i jashtëzakonshëm dhe është kryefjala gjatë gjithë fushatës.

Në ligjërimin politik të djathtë gjatë fushatës zgjedhore, vërehet një qasje drejt kontekstit historik para vitit 1990, pra periudhës së komunizmit, duke synuar ndikimin e elektoratit, përmes rolit primar të PD-së, në rrëzimin e këtij sistemi. Ndryshe nga kundërshtarët e tyre, që e bëjnë krahasimin me 18 vjetët e sistemit politik pluralist, duke sjellë herë pas here në fjalime periudhën e sakrificës së rilindasve, strategjia e përzgjedhur nga PD-ja, bëhet për të mbajtur ende në elektoratin e tyre shtresën e të përndjekurve politikë dhe antikomunistëve.

Imazhi i partisë dhe i qeverisë, përforcohet përmes sukseseve të arritura, reformave që kanë ndërmarrë, si dhe përmes objektivave që i kanë vënë vetes në vazhdim të një mandati të dytë, duke i ofruar shqiptarëve: “Shqipërinë Europiane”. Ky togfjalësh i përdorur sa majtas dhe djathtas, është një tepri e përdorur që të sjell ndërmend zhvillimin e ngjarjeve të vitit 1990, edhe pse kanë kaluar 18 vjet nga ajo kohë.

Propaganda në lidhje me aspiratat që dëshirojnë shqiptarët përdoret nga të dyja partitë, për të dhënë një imazh sa më europian.

Në fjalimet e “Partisë Demokratike”, ashtu si dhe në fjalimet e “Partisë Socialiste”, spikat imazhi i liderit i cili njihësohet me partinë, prandaj herë-herë fushata merr përmasat e një arene gladiatorësh, ku janë liderët ata që duhet të fitojnë betejën dhe jo programi dhe ideologjia që përcjell secila parti. Edhe për listën e kandidatëve, bëhet një prezantim me superlativa, ku secila parti pretendon se ka zgjedhur emrat më të kualifikuar dhe më profesionalë, se pala tjetër.

4.2. Analizë e ligjërimit politik në raport me ideologjinë e majtë/e djathtë, 2009

Dallimet ndërmjet të majtës dhe të djathtës konsistojnë në barazinë sociale, në ndërhyrjen e shtetit në tregun e lirë, në mbështetjen dhe ndihmën për personat e paafhtë për punë, në liberalizmin shoqëror për të majtën në raport me drejtësi sociale, treg i lirë, vetëmjaftueshmëri individuale, konservatorizëm shoqëror për të djathtën. E majta kërkon ndryshime, kërkon të drejta për grupe më të diskriminuara duke ruajtur tiparet e një ideologjie më liberale, ndërsa e djathta mbron stilin tradicional, duke qenë më pak e hapur ndaj ndryshimeve, apo më konservatore.

Leksiku i përdorur nga PS, fjalët kyç	Leksiku i përdorur nga PD, fjalët kyç
<i>program të ri</i>	<i>rritjen më të madhe të rrogave dhe pensioneve</i>
<i>transformimin rrënjësor</i>	<i>korupsioni</i>
<i>zgjedhje të lira, liri dhe të drejta të barabarta</i>	<i>nënat janë demokrate dhe vetëm demokrate</i>
<i>i politikës së vjetër të së shkuarës</i>	<i>komb</i>
<i>për një Shqipëri si gjithë Europa</i>	<i>Shqipëria në Nato</i>
<i>ndryshimin e madh</i>	<i>fitore</i>
<i>politikë e vjetër –politikë e re</i>	<i>taksa e sheshtë</i>
<i>përtej të majtës dhe të djathtës</i>	<i>Tiranës Europiane, Shqipërisë Europiane</i>
	<i>Shqipëria po ndryshon</i>

--	--

Një ndër kriteret themeltare për diadën e ‘majtë/e djathtë’ është barazia, variablat e së cilës pavarësisht se mund të prodhojnë modele të ndryshme barazimtare, përsëri nuk e zbehin rëndësinë e këtij kriteri, pasi referuar traditës historike të së majtës dhe të djathtës, barazia është një ndër konceptet kryesore mbi të cilën u ndërtua ideologjia e majtë, ndryshe nga e djathta, për të cilën njerëzit janë më shumë të pabarabartë sesa të barabartë, sepse doktrina e djathtë është më e prirur të pranojë pabarazinë natyrore dhe pabarazinë shoqërore.

Një ndër elementët e vetëm të përfshirë në ligjërimin politik, që shërben si kriter ndarës mbi ideologjinë e majtë dhe të djathtë, është qëndrimi i ndryshëm që mbajnë partitë politike me mënyrën e taksimit, ku e djathta është pro taksës së sheshtë, ndërsa e majta pro taksës progresive, por që nuk shfaq tipare dominuese në raport me elementët e tjerë të ligjërimin politik, gjatë zhvillimit të fushatës.

Kriteri i barazisë më shumë se oferta dhe zgjidhje përmes përgjigjeve, që shoqërojnë variablat me të cilat identifikohet, i referohet akuzave politike të PS-së kundrejt rivalëve politikë, pasi sipas tyre, Shqipëria s’mund të vazhdojë të jetë pa shtet të të gjithëve, pa abetare për të gjithë fëmijët, pa kujdes shëndetësor për të gjithë të sëmurët, pa mbështetje për të gjithë bujqit e fermerët, pa mundësi të barabarta.

Nëse për barazinë bihet në dakordësi që i përket ideologjisë së majtë, kriteri tjetër themeltar është liria, e cila sipas Bobbios nuk është një koncept absolut sepse:

“Doktrina e lëvizjes libertare e autoritare ka edhe në të djathtë, edhe në të majtë, e kjo ndodh ngaqë kriteri i lirisë shërben për të përshkruar universin politik jo aq në lidhje me qëllimet, sesa në lidhje me mjetet, ose me metodat që duhen përdorur për t’i arritur këto qëllime: Ky kriter ka të bëjë kështu me pranimin ose me refuzimin e metodës demokratike, të kuptuar si një bashkësi rregullash që lejojnë të merren vendime kolektive nëpërmjet debatesh të lira e zgjedhjesh të lira, pa përdorimin e dhunës (1996:75).

Liria është një kriter i cili përdoret në ligjërimin politik të majtë dhe të djathtë, në bazë të strategjive të përzgjedhura nga partitë politike: E majta kërkon zgjedhje të lira, liri dhe të drejta të barabarta, ndërsa e djathta e artikulon në mënyrë të vazhdueshme, për të

ndikuar mbi opinionin publik, pasi në kontekstin historik politik shqiptar, liria si vlerë është asociuar me të djathtën shqiptare.

Sipas Confrancescos (Bobbio, 1996: 52), tradita është një ndër kriteret e përdorura për të dalluar të majtën nga e djathta, pasi tradita së bashku me variablat e saj, mund të kategorizohet si një ndër konceptet që i përshtaten idelogjisë së djathtë, ndryshe nga e majta e cila identifikohet përmes emancipimit, por jo në nivel antagonist, pasi tradita dhe emancipimi përcaktohen pozitivisht: Të djathtët kërkojnë ruajtjen e traditës, ndërsa të majtët kërkojnë emancipimin në raport me pabarazitë, që rrjedhin nga privilegjet përmes racës, shtresës apo klasës.

Në ligjërimin politik të aktorëve politikë, hasen elementë që trajtojnë traditën dhe emancipimin nga të dy krahët politikë, duke iu larguar mendësisë së djathtë për ruajtjen e traditës dhe mendësisë së majtë për emancipimin në raport me pabarazitë që rrjedhin nga privilegjet e ndryshme, pasi në ligjërimin politik të Ramës përfshihen idealet që nuk vjetërohen kurrë, si dhe në të njëjtën kohë transformimi dhe ndryshimi rrënjësor, ndërsa në ligjërimin politik të Berishës, përfshihen tradita përmes variablave të ndryshme, si dhe ndryshimi, i artikuluar në mënyrë të vazhdueshme nga ai.

Ideologjia e një partie politike reflektohet në programin e saj, në përfshirjen e tematikave të caktuara dhe alternativat për zgjidhjen e tyre, në raport me interesat e target grupeve elektorale me të cilat identifikohet një parti, por në Shqipëri, partitë shfaqin karakteristika të tjera, pasi në vend që të theksohet diferenca përmes programeve dhe veprimeve institucionale qeverisëse nga parti e majtë apo e djathtë, kemi të bëjmë me të kundërtën, ngjashmërinë.

Për të majtën disa nga elementët e programit janë arsimiti, mjedisi, bujqësia, energjia, çështjet sociale, shëndetësia, infrastruktura, turizmi ndërsa për të djathtën, vlerat e mëposhtme si: Arsimiti, shëndetësia, punësimi, infrastruktura, turizmi, të cilat janë pothuajse tërësisht të ngjashme. Trajtimi dhe përfshirja e një elementi në programin politik, të dy forcave politike rivale është e kuptueshme, pasi partitë politike për zgjidhjen e problemeve politike bëjnë propozime programore, për t'i zbatuar më pas në praktikë. Problematika referuar mungesës së dallimeve për zgjidhjen e problemeve, sipas diadës e majtë/e djathtë është e dukshme në ligjërimin politik të aktorëve politik, në raport me drejtimin që i duhet dhënë shoqërisë, pasi nuk gjenden dallime thelbësore

për barazinë sociale në raport me drejtësinë sociale, ndërhyrjen e tregut në raport me tregun e lirë, për traditat, apo për raportet mes individit dhe shtetit.

Sipas shoqatës “Transparency International Albania”: “Publiku është njohur në mënyrë sipërfaqësore me programet elektorale” (Panorama, 10.6.2009, f.10), konkluzion që legjitimohet tërësisht përmes studimit të ligjërimit politik, edhe pse në intervistat e dhëna gjatë zhvillimit të fushatës zgjedhore, liderët politikë reklamojnë programet e tyre si programet më të arrira, edhe pse këto të fundit mbeten në kufijtë e virtuales. Në ligjërimit politik, e djathta, i referohet: Arritjeve të qeverisë gjatë mandatit 2005-2009 për të legjitimuar premtimet elektorale, si elementë të përfshirë në programin e PD-së, me 24 orë ujë në mbarë vendin, me shkollat më të mira, me shërbimin shëndetësor dinjitoz, me krijimin e 160 mijë vende pune, etj, të “Shqipërisë Europiane”. Në këtë linjë, ky term që merr kuptim përmes kontekstit politik, ekonomik, shoqëror, përdoret nga PD-ja dhe aktorët e saj si njësi kuptimore që përfshin zhvillim, ekonomi të mirë, shërbime shëndetësore, vende të reja pune, ‘gjithçka si në Europë’, ndërsa e majta përmes njësave kuptimore ‘politika e re’ dhe ‘përtej të majtës dhe të djathtës’ synon legjitimimin e premtive elektorale dhe delegjitimimin e kundërshtarëve politikë. Sjellja politike e Ramës në raport me ‘politikën përtej së majtës dhe të djathtës’ përputhet me qasjen e Daniel Bell (1960), i cili argumenton që ideologjitë e vjetra do të zëvendësohen nga ideologji të reja, të reflektuara në një sjellje politike pragmatiste.

Integrimi i Shqipërisë në organizma ndërkombëtarë, u kthye në çështje primare dhe objektiv kryesor për partitë politike, prandaj rekomandimet e ndërkombëtarëve, ishin paradigmat mbi të cilat u ndërtuan ligjërimet e aktorëve politikë dhe programet politike, dhe jo ideologjitë përkatëse. Roli i ndërkombëtarëve në kontekstin historik dhe politik shqiptar për vetë problematikat që e shoqërojnë atë është i pazëvendësueshëm, sepse duke qëndruar si një palë (me pushtet) mbi palët, forcat politike synojnë të krijojnë mbështetje nga jashtë: Kjo mbështetje shërben si shkak për të kërkuar miratimin dhe legjitimimin e veprimeve politike të partisë apo të qeverisë, nga opinioni publik, si pasojë, prandaj lufta ndaj korrupsionit, një ndër kushtet kryesore të ndërkombëtarëve ndaj politikës shqiptare, trumbetohet nga qeveria, si arritja më e madhe e qeverisë së djathtë dhe njëkohësisht, si dështimi më i madh nga opozita. Për të njëjtat arsye, ligjërimi politik i majtë dhe i djathtë dominohet nga slogane si, “Shqipërinë si gjithë

Europa”, “Shqipërinë Europiane”, duke synuar ndikimin e opinionit publik, por që largon partitë nga boshti ideologjik përkatës.

Analiza e ligjërimit politik përmes fjalimeve politike, në raport me ideologjinë e majtë/e djathtë, konsiston në një mungesë të dallimeve ideologjike, mbi të cilat duhet të ndërtohet diada e majtë/ e djathtë: Në mungesë të dallimeve ideologjike, që reflektohen në mungesë të debatit politik ndërmjet politikave të majta dhe të djathta, politika do të devijojë nga ajo çfarë normalisht duhet të trajtojë, duke marrë tiparet e një kulture politike konfliktuale, sepse në vend të debatit politik përmes diadës e majtë-e djathtë, prodhohet një ligjërimit politik (përmes riprezantimit “ne/ata”) i ndërtuar mbi baza morali, ku theksohet antagonizmi politik ‘mik-armik’, që ndërtohet përmes vlerave të moralit, duke përdorur fjalorin e moralitetit.

4. 3. Ligjërimit politik, “ne dhe ata”, 2009

Sipas studiuesit Van Dijk (1998), ideologjia e cila shërben si një bazë e riprezantimit shoqëror, mund të studiohet përmes strategjive referuese të përdorura, përmes të cilave theksohen dallimet ndërmjet dy grupeve: ‘Ne dhe ata’. Në grupin e parë përfshihen veprimet dhe rolet e vetë grupit të cilat prezantohen pozitivisht, ndërsa në grupin e dytë përfshihen veprimet dhe rolet e atyre që nuk përfshihen brenda grupit, duke u cilësuar ‘ata’, në një prezantim negativ.

Studimi i ligjërimit politik, në fushatën elektorale të vitit 2009 në këtë pikë të analizës, është ndërtuar sipas këtij kategorizimi, duke evidentuar dallimet ndërmjet grupeve ‘ne-ata’, sipas aktorëve politikë të PS-së dhe PD-së.

Tabelë ne dhe ata, ligjërimit politik përmes fjalimeve të aktorëve politikë të PS, 2009.

Ne	Ata
Kjo bindje dhe nevojë e kudondodhur për ndryshim më ka shtyrë në rrugën e politikës së re...Kjo bindje dhe nevojë jetike për ndryshim më ka çuar përtej të	Për këtë mazhorancë më shumë se sa problemet dhe hallet e shqiptarëve ka rëndësi nepotizmi kryeministrotor dhe

majtës dhe të djathtës	mbrojtja e familjes kryeministore
Program të ri, me një vetëdije të re dhe me një vullnet të ri	Shqipëria nuk mund të vuaj plagë të tjera, për të përballuar oreksin e pashuajtshëm të familjes që na qeveris
Ne do ta bëjmë Shqipërinë si gjithë Europa	Berisha bëri një gafë politike e diplomatike... Zoti Ristani ka shkelur rëndë Kodin zgjedhor, duke hedhur njëkohësisht një hap shumë të gabuar në drejtim të delegjitimitit të KQZ dhe keqadministrimit të procesit zgjedhor
Për ndarjen me politikën e vjetër të së shkuarës dhe më një proces të stërzgatur premtimesh të pambajtura, zullumesh të papërbajtura dhe dështimesh që nuk mund të justifikohen	Mungesa e vullnetit të qeverisë dhe veprimet e saj selektive kanë vënë në rrezik pajisjen e votuesve me letërnjoftim
Një transformim që është po aq i paimagjinueshëm sa ç'ishte transformimi i Tiranës në tërë këto vite ku ne e nisëm vërtet nga zero	Kryeministri ynë i ndjekur nga kori i oborrtarëve të paaftë
Ne mund ta kthejmë politikën në një instrument për të bërë të mundura gjëra që sot duken të pamundura	Alternativa e vjetër e Berishës
Shqipëria e ëndërruar si gjithë Europa që më nxori në rrugë për të rrëzuar	... Ja ku jemi sot në fund të mandatit të tij (Berishës) dhe në prag të fundit të

komunizmin dhe më futi në politikë për të ngritur ura drejt Europës...	karrierës së tij politike...
Politika e re i vë ata në rradhë të parë. Edi Rama prezanton shpresën... Ndryshimin që na duhet dhe e meritojmë	Politika e vjetër i ktheu shpinën qytetarëve shqiptarë
Ne jemi mbledhur sot për t'u nisur drejt Europës dhe ata që na vonuan nuk mund të na pengojnë më	Ta çlirojmë Tiranën nga varësia e një kryeministri, që prej katër vjetësh na tregon se s'ka vizion të ri, s'ka ide të reja, s'ka qytetari të re europiane për ti ofruar Tiranës
Edi Rama prezanton shpresën, ndryshimin që na duhet	Kryeplaku i politikës së vjetër, Sali Berisha dhe një soj i vjetër oborrtarësh të pushtetit të familjes së tij
Politika e re	Për Sali Berishën qëllimi i tij i vetëm është pushteti i tij
Përtej së majtës dhe të djathtës	I gjori kryeplak i politikës së vjetër

Tabelë ne dhe ata, ligjërimi politik përmes fjalimeve të aktorëve politikë të PD, 2009.

Ne	Ata
Respekti i Berishës për qytetarët është me dhjetëra herë më i madh se respekti i Ramës	Rama është 100 herë më i lidhur me 99-shat e lejeve të ndërtimit sesa me socialistët
Unë jam Sali berisha mjek kardiolog, studiues i apasionuar, profesor i një	Edi Rama një Enver i dytë

universiteti	
Me dhjetëra e mijëra njerëz, në këtë sallë e Shqipëri dolëm në rrugët e Tiranës dhe themeluan PD-në, përmbysëm diktaturën më të egër në Europë	Pengesë për çdo reformë. E thjeshtë shumë e thjeshtë, sepse ata vidhnin, vidhnin dhe vetëm vidhnin
Sali Berisha nuk do të mposhtet asnjëherë se asgjë nuk do të mposhtë të drejtën tuaj për të qenë pjesë e Europës	Kryetarit të tyre të lodhur dhe të kapitulluar
Me Sali Berishën ju lidh projekti european... Ju lidh besimi i madh që ka Europa tek Sali Berisha...	Por një njeri (për Ramën) i cili duket se nuk ka as gram e fundit të moralit politik dhe njerëzor
...Për t'i premtuar kryeministrit dhe liderit të ndryshimit, Sali Berisha	Ti, Edi Rama tregon se ke mbetur në komplekset e lustraxhiut të bustit
Objektiv i politikës së jashtme përfshirja në Shengen	Tani kryetari i PS-së shkon si mjeran...
Burrat mund të jenë të majtë të djathtë, por nënat janë demokrate dhe vetëm demokrate	Ne u themi sot kundërshtarëve tanë politikë që të dalin nga skutat dhe vrimat ku e kanë zhvendosur fushatën, në ndjekje të Edi Ramës. Ai ka gjetur si shpëtim që të sigurojë kokën e vet në vendstrehimin e Bashkisë
Përmbysëm diktaturën më të egër Europë	Ata nuk besonin se Shkodra mund të bëhej. Në fakt ata këtë dëshironin
Vetëm 18 vjet dhe Shqipëria po ndryshon. Vetëm gjatë këtyre katër viteve të fundit	Në krahun e Ramës qëndrojnë të gjithë ata që kanë ikur nga unë. Problemi më madhor dhe historik i së majtës është

ajo është transformuar totalisht	moskandidimi i Ramës
Shqipëria Europiane	... Ajo e goditi Edin, pikërisht në pikën e tij më të dobët, në këtë çështjen e të shkuarës së tij dhe lidhjeve familjare me krimet e komunizmit.
Hajdeni të vazhdojmë të ndryshojmë Shqipërinë! Shqipëria po ndryshon!	Festën e zgjedhjeve të 28 qershorit nuk mund ta prishë, njeriu që ka prishur familjen e tij politike

Marrëdhënia ne/ata, ndërtohet përmes identifikimit të grupit tjetër si armiq dhe jo si kundërshtarë politik që veprojnë brenda së njëjtës hapësirë politike, duke ndarë qëndrime të ndryshme që prodhojnë konflikt brenda hapësirës në të cilën veprojnë, por njëkohësisht duke i dhënë kuptim politikës: Trajtimi i politikave demokratike, ndërmjet kundërshtarëve politik, zëvendësohet me antagonizmin politik ‘mik-armik’, që ndërtohet përmes vlerave të moralit, duke përdorur fjalorin e moralitetit. Antagonizmi politik ndërmjet partive politike, ndërtohet kryesisht përmes Berishës dhe Ramës:

“Teksa ligjërimit negativ në formën e kritikave për arritjet dhe punën e qeverisë dhe të opozitës janë të domosdoshme në një shoqëri të lirë dhe demokratike, ai përbën problem kur nuk është konstruktiv, por personal, agresiv dhe emocional. Ky studim tregon se 45% e ligjërimit të secilit prej këtyre aktorëve politikë në periudhën e studiuar e që i kushtohet tjetrit i përkasin pikërisht kësaj kategorie të dytë: ato janë fyerje të drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta personale karakteri, akuza pa bazë dhe krahasim apo asocim i kundërshtarit me tipare politike të së kaluarës ose figura politike botërore me imazh negativ”(www.academia.edu/2411311/raporti_i_ligjërimit_politik_në_Shqipëri).

Delegjtimimi i grupit ‘armik’ përveç strategjive referuese, që lidhen me përzgjedhjen e kategorizimit në raport me grupin identifikues, ndërtohet edhe përmes strategjive pohuese, të cilat mbështeten në zgjedhjen e fjalëve të përdorura në lidhje me pjesëmarrësit apo aktorët shoqërorë. Në ligjërimit politik të majtë kundrejt të djathtëve, grupi ‘ata’, kategorizohet kryesisht përmes këtyre kategorive: *Familjes kryeministore, familja që qeveris, kryeplaku, kryeministri, oborrtarë*. Vlerësimi gjuhësor i cilësive të tyre ndërtohet përmes attributeve, mbiemrave apo figurave retorike si psh, *alternativa e*

vjetër e Berishës, politika e vjetër e Berishës, mungesa e një vizioni të ri për kryeministrin, familja që qeveris dhe kori i oborrtarëve të paaftë, i gjori kryeplak i politikës së vjetër.

Në ligjërimin politik të djathtë kundrejt të majtëve, grupi 'ata', kategorizohet kryesisht përmes këtyre kategorive: *Kryetari, grupi i 99-shave, kundërshtar politik, familja.* Vlerësimi gjuhësor i cilësive të tyre ndërtohet përmes attributeve, mbiemrave apo figurave retorike si psh, *kryetari i tyre i lodhur e i kapitulluar, nuk ka as grammin e fundit të moralit politik e njerëzor, lustraxhi busti, njeriu që ka prishur familjen e tij politike, Edi Rama një Enver i dytë.*

Ligjërimi politik dominohet nga liderët përkatës, në raport me drejtimin e partisë për Ramën dhe drejtimin e partisë dhe të qeverisë për Berishën. Ligjërimi politik i vetë liderëve por dhe i aktorëve të tjerë politikë sipas partive përkatëse, legjitimon zëvendësimin e PS-së me Ramën dhe të PD-së me Berishën, pasi sipas burimeve të përdorura nga PS-ja dhe PD-ja, 'Edi Rama prezanton shpresën, ndryshimin e duhur' dhe 'Berisha liderin e ndryshimit'.

Nëse në ligjërimin politik personalizimi partiak ndërtohet përmes një stili ligjërimor të natyrshëm, të pranuar si brenda partisë ashtu dhe nga kundërshtarët politikë, të njëjtën karakteristikë shfaq edhe personalizimi institucional. Legjitimimi i personalizimit institucional ndërtohet përmes një ligjërimi ku theksohet personalizimi i qeverisë, nga të dy krahët politikë, por me funksion ndikues të kundërt, pasi e djathta thekson arritjet e qeverisë Berisha, ndërsa e majta dështimet e qeverisë Berisha.

4.4. Ligjërimi politik, përmes fjalimeve, 2013

Në këtë çështje, do analizohen fjalimet dhe strategjitë ligjërimore të përdorura, sepse janë ndër elementët kryesorë të fushatës dhe propagandës, gjatë zgjedhjeve të përgjithshme. Aktorët politikë, si liderët dhe kandidatët për deputetë performojnë sipas strategjive të caktuara në ligjërimet e tyre. Imazhi i partisë, ideologjia e partisë, programi i qeverisë, roli i liderit, (të gjitha këto nyja të rëndësishme dhe gjatë fushatës zgjedhore paraardhëse), formësohen në sytë e publikut dhe elektoratit, pikërisht nëpërmjet fjalimeve. Fjalimet janë dhe një matës i mirë, për të kuptuar se deri në çfarë mase ushtrohet personalizimi institucional apo personalizimi partiak brenda një force

politike. Më poshtë po paraqesim një pjesë të fjalimeve kryesore të partive, marrë nga gazetat e tyre zyrtare, “Zëri i Popullit”, “Rilindja Demokratike” si dhe nga gazeta “55”.

4.4.1.Ligjërimi politik i majtë përmes fjalimeve, 2013

Në kampionimin e bërë rezulton që fjalimet e publikuara janë kryesisht të liderit të PS-së dhe konkretisht 21 fjalime të Ramës dhe 1 fjalim i kandidatit për deputet Pandeli Majkos. Fjalimet janë marrë nga gazeta e saj zyrtare, pasi është organ mediatik i së majtës dhe lejon publikimin e tyre në mënyrë të vazhdueshme, duke i dhënë hapësirën e nevojshme.

Ashtu si në çështjen 4.1, kjo pjesë e ligjërimit është e rëndësishme, për të parë më konkretisht sesi ka funksionuar në këtë fushatë zgjedhore, ligjërimi politik. Këtu do të shohim më qartë mënyrën sesi paraqiten programet dhe ideologjitë e partive, sulmet personale të liderëve, konfliktualitetin politik, sulmet personale të liderëve, tonet e përgjithshme që ka marrë zhvillimi i kësaj fushate zgjedhore, nëpërmjet fjalimeve të ndryshme.

Fjalimi i Ramës në mbledhjen e grupit parlamentar, “Zëri i Popullit”, 1. 05. 2013, fq. 3- 4.

”Kemi rezistuar përmes pengesash të pafundme, sfidash të panumërta, ballafaqimesh të rënda, me një kundërshtar primitiv dhe gjakatar, i cili i ka humbur dy dekada Shqipërisë dhe sot i rri vendit mbi kokë, si një kërcënim për t’ia humbur edhe një dekadë të tretë, ndërkohë që ditët e pushtetit të tij janë të numëruara...kemi humbur njerëz, si të ishim në një fushë luftime me një armik, jo në një vend pluralist përballë një kundërshtari politik... Rivalitetet e brendshme, nganjëherë të kthyer në deformime të imazhit të kësaj familjeje të madhe politike, e cila për nga shkalla e lirisë dhe vetëdijes së çdo individi është e pakrahasueshme me nivelin e mungesës së lirisë dhe vetëdijes qytetare, që e ka kthyer partinë e kundërshtarit në një oxhak familjar dhe klanor... Sot është dita për t’ju thënë të gjithëve, nëse ka ndodhur dhe me siguri ka ndodhur, që pa dashje të kem gabuar edhe unë, me këdo prej jush, në rrugën e vështirë e plot mundime që kemi përshkuar deri këtu...Ne jemi këtu si e vetmja forcë dhe e vetmja mundësi për ta ndryshuar rrënjësisht këtë imazh... Tetë vjet janë plotësisht të mjaftueshme për të kuptuar se Partia Demokratike, kështu e katandisur në një parti familjare dhe klanore, nuk mund të bëjë asgjë më shumë sesa t’i çojë shqiptarët më teposhtë në rrugën e një rrënim të vazhdueshëm...U kanë dalë përpara disa individë që janë klientët e partisë familjare të Saliut...Jemi të gjithë të vetëdijshëm, çfarë përfaqëson gulçima e përditshme në tribuna e kryeministrit, çfarë përfaqëson degjenerimi i fjalorit të kryetares të Kuvendit në mes të parlamentit..Nuk janë të gatshëm të përballojnë të shkuarën e tyre... Hijet e 4 të varrëve të 21 Janarit. Hijet e 26 të varrëve të Gërdecit... Ne jemi këtu për ti shërbyer këtij populli dhe për ta bërë këtë me dinjitet... Këto janë zgjedhjet më të rëndësishme që Shqipëria ka pasur, pas atyre të vitit 1992... Këto zgjedhje do të vendosin nëse Shqipëria do të rilindë apo do të vazhdojë në të tatëpjetën e rrënim të mëtejshëm, nëse do të ketë punësim real apo rritje të mëtejshme të papunësisë, shkatërrim të biznesit apo rimëkëmbje të tij dhe të ekonomisë, taksa që

*mbysin të varfrit, fermerët dhe shtresën e mesme apo taksim të ndershëm, që kush fiton më pak të paguaje më pak... Shërbime publike sipas xhepit apo sipas nevojës, fshat të braktisur në kufijtë e mbijetesës apo rilindje të fshatit, rritje të mëtejshme të krimit apo shtet që garanton siguri për individin dhe për **pronën**; një Shqipëri të izoluar nga bota demokratike, që është sëkëlldi për çdo qytetar, apo një **Shqipëri Europiane** që bën krenar çdo shqiptar”.*

Në ligjërimin politik të Z. Rama, dallohet qartë gjuha agresive e përdorur në akuzat e bëra, ndaj kundërshtarit politik, liderit të së djathtës, i cili bëhet përgjegjës për shndërrimin e “Partisë Demokratike”, në një parti familjare, të përbërë nga klane brenda partisë dhe ngjarjeve të rënda, ku humbën jetë njerëzish. Përmes strategjive të përdorura në ligjërimin e tij, përcjell një imazh negativ të “Partisë Demokratike”, nën drejtimin e Berishës dhe njëkohësisht përforcon imazhin pozitiv të “Partisë Socialiste”, duke e etiketuar si një frymë besimi për njerëzit, si një e ardhme e sigurt.

Një element i rëndësishëm i përdorur qëllimisht është populli dhe paprekshmëria e zgjedhjeve duke synuar ndikimin e opinionit publik.

Alternativat e ofruara sipas programit të PS-së, do të jenë jetësore për vendin, ndërsa alternativa kundërshtarë klasifikohet si alternativa e rrënimit dhe shkatërrimit. Në fjalimin e tij Rama bën dallimin mes kopjes dhe origjinalit, pasi thekson që kryeministri po kopjon programin e Rilindjes, një program për të cilin kanë punuar dhe bashkëpunuar me grupet e interesit, komunitetet, shoqërinë civile, për të ndërtuar një program qeverisës.

Imazhi i partisë ndërtohet përmes referimit tek grupi i rilindjes, si një grup që krahas profileve të konsoliduara përbëhet dhe nga profile të reja, që së bashku marrin përsipër përgjegjësitë e nevojshme në raport me elektoratin.

Fjalimi i Ramës në Tiranë, në Njësinë Bashkiake Nr 1, “Zëri i Popullit”, 1. 5. 2013. Fq. 6

Përveç fjalimit të Ramës, paraqitet edhe nisma ‘Këndi i Fjalës’ e cila do të shtrihet edhe në njësitë e tjera bashkiake në Tiranë, ku kërkon përfshirjen e qytetarëve në komunikim përmes pyetjeve. Ky objektivi do të realizohet pasi: “Të gjithë deputetët e PS do të jenë kudo nëpër lagje për të bërë këto takime duke emancipuar më tutje politikën”.

Paraqitja e programit: “... E shkruam **programin** pas një procesi shumë të gjatë, të panjohur më parë në historinë e politikës shqiptare, qysh nga 5 Nëntori i 2011 në Kongresin e

Partisë Socialiste, ku u miratua drafti i parë i programit për një Rilindje Shqiptare. Vazhduam të shkojmë qytet më qytet, fshat më fshat, të takojmë drejtëpërdrejtë dhe hapur komunitete, grupe interesi....Një instrument qeverisës që nesër me votën e shqiptarëve në qeverisjen e vendit ne të realizojmë gjithçka që është shkruar me shumë kujdes në programin tonë të Rilindjes... 5 mijë sipërmarrës të mëdhenj dhe të vegjël i kemi takuar mbyllur, sepse dihet që ekspozimi i tyre nuk është diçka që kalon kollaj në këtë vend të keq-qeverisur dhe të mbajtur nën kthetrat e një terrori psikologjik, sidomos ndaj sipërmarrjes... Një parti e lindur nga ëndrrat dhe shpresat e mëdha të njerëzve në fillim dhe e katandisur sot në një parti familjare...Të mos i japë asnjë votë pushtetit që e ka shkaktuar këtë dramë...Për këta që qeverisin me vota të vjedhura”.

Në këtë fjalim të Ramës, theksi vihet mbi programin e Rilindjes, mbi hartimin e tij mbështetur në shqetësimet dhe problemet e qytetarëve, sipërmarrësve të mëdhenj dhe të vegjël mbi të cilët ushtrohet terror psikologjik, nga alternativa kundërshtarë. Legjitimimi i PS-së dhe delegjitimimi ndërtohen përmes programit të PS-së, i hartuar si rrjedhojë e kontekstit politik dhe pasojave që vijnë nga qeverisja e djathtë.

Sipas Ramës, “Partia Demokratike” ka humbur identitetin e saj, pasi është kthyer në një parti familjare, prandaj ai kërkon nga populli të mos votojë një parti, që qeveris në mënyrën më të keqe të mundshme.

Në këtë fjalim bën edhe dallimin mes tij dhe kryeministrit, ku ai i thotë njerëzve që mund të pyesin dhe të flasin për çfarë interesi të kenë, ndryshe nga kryeministri që shfrytëzon administratën për të krijuar idenë që “Partia Demokratike”, ka një mbështetje të madhe në elektorat.

Fjalimi i Ramës në prezantimin e kandidatëve Musa Ulqini dhe Mimoza Hafizi, “Zëri i Popullit”, 2. 5. 2013, fq. 3.

*“...Zgjedhja të qëndrojmë në Partinë Socialiste dhe jo me mlllef, por me arsytet e veta mu kundërvu **mu** publikisht brenda forumit të partisë pa shkelur asnjëherë etikën... Në këtë familje politike **ne** jemi të gjithë bashkë. Jemi të gjithë të gatshëm të bëjmë betejën tonë të përbashkët. Po ashtu të përballojmë me dinjitetin më të madh dhe betejat tona të brendshme”.*

Legjitimimi i PS-së ndërtohet përmes imazhit të kandidatëve dhe të forcës politike të majtë, ku duke prezantuar Musa Ulqinin thekson se pavarësisht ndarjes në këndvështrime me Ramën, duke iu referuar zgjedhjes në listën jo të sigurtë të vitit 2009, Ulqini vazhdoi të kontribuojë në “Partinë Socialiste”, në komunitetin e tij.

Përmes këtij diskuri ndërton edhe imazhin pozitiv të partisë, si një familje politike, e cila është e përbashkuar në betejën elektorale, duke kapërcyer pakënaqësitë e

brendshme partiake. Me anë të këtij fjalimi, kërkohet të vihet në vëmendje fuqia e Ramës si kryetar i partisë dhe imazhi i tij si një lider bashkëkohor, që e pranon mendimin ndryshe. Kjo për të goditur imazhin e partisë rivale, si e ngurtë dhe pa demokraci të brendshme.

Fjalimi i Ramës, “Zëri i Popullit”, 7. 5. 2013, fq. 3.

*”... Në katër vjet kontribuan në rezistencën opozitare, në përgatitjen e alternativës sonë për Rilindjen, në ballafaqimin parlamentar, në komunikimin me komunitetin, dhe për hir të rikonfigurimit të domosdoshëm nuk do të jenë të përfshirë në Skuadrën tonë Kombëtare, por janë treguar plotësisht të gatshëm, që të përfshihen në këtë **betejë**, duke qenë vija e parë e mbështetjes... Ne jemi një skuadër dhe që përfshirja apo mospërfshirja jonë në këtë skuadër lidhet me ide të përbashkëta, lidhet me pasionin e përbashkët politik, lidhet me vullnetin për t’i çuar gjërat përpara dhe nuk lidhet me numrin në renditje... Partia Socialiste ka lindur si një parti e **transformimit**. Ka lindur si një forcë që transformimin e Shqipërisë e sheh duke kaluar përmes transformimit të vazhdueshëm të vetvetes...Skuadra jonë përfaqësuese vazhdon në traditën e harmonizimit të gjeneratave, vazhdon nën procesin e zëvendësimit të qetë dhe të matur të brezave që i lënë stafetën njëri- tjetrit pa krijuar asnjë çarje dhe asnjë thyerje”.*

Përmes narrativës së tekstit, pika të rëndësishme në këtë fjalim, janë falënderimet që bën Rama kundrejt deputetëve, që nuk janë përfshirë në listat e kandidatëve për deputetë, por që vazhdojnë të jenë njëloj, pjesë e skuadrës së Rilindjes. Përmes këtij ligjërimi, ndërtohet imazhi i “Partisë Socialiste”, e cila përbëhet nga anëtarë që prioritet nuk kanë interesat personale, por vullnetin dhe dëshirën për projektin e përbashkët politik, duke pranuar zëvendësimin me ‘tjetrin’, si një proces natyral dhe transformues brenda partisë.

Fjalimi i Ramës në Shkodër, “Zëri i Popullit”, 11. 5. 2013, fq. 3.

*“Për ti dhënë fund **rrënim**it të mëtejshëm... 23 qershori është dita që Shkodra të bëjë atë që ka bërë gjithmonë kur Shqipërisë i ka ardhur në majë të hundës; të japë një votë për **Rilindjen** dhe jo për **rrënimin**... Është rruga e përbashkët që vazhdon si betejë me injorancën, si betejë me varfërinë, si betejë me papunësinë, si betejë me **mungesën e lirisë** që këtu në Shkodër është bërë asfiksuese... Askujt më shumë se sa shkodranëve të mençur dhe rebelë nuk u takon më shumë që më 23 qershor me votë ta **rilindin Partinë Demokratike**, duke e çuar në **opozitë**...Shkodranët që i hodhën lakun në fyt asaj skulpturës së Stalinit duhet të hedhin votën kundër rregjimit të ri të Tiranës... Për tu gjendur 20 e ca vjet më vonë përballë një tjetër **regjimi të një kanakari të Ramiz Alisë**, i cili edhe sot e kësaj dite flet për të djathtën, por nuk ka asgjë të përbashkët me të djathtën.. Flet për **lirinë**, por është kundërshtari më i madh i lirisë.. Pa larguar Saliun nga puna nuk ka vende të reja pune..Pa larguar Saliun nga puna nuk do të ketë punë për mijëra e mijëra shqiptarë të talentuar që synojnë të bëhen të pasur nëpërmjet **lirisë së rrugës së konkurrencës**, por që në mes të rrugës gjejnë **postëbllloqet e klientelës së oborrit të pushtetit**... Ndërkohë që Shkodra duhet të marrë përsipër që ta largojë përgjithmonë nga kreu i këtij vendi **komunistin e fundit dhe pafundësisht të pandreqshëm, që ka marrë peng Shqipërinë** dhe që mban peng Shkodrën me thikën e një dasie që duhet të marrë fund”.*

Një ligjërim politik i mbështetur në një antagonizëm të theksuar ndërmjet dy alternativave politike, midis së mirës dhe së keqes, midis rilindjes dhe rrënimit. Rrënimi, e keqja më e madhe është Berisha, të cilin e kategorizon si kanakarin e Ramiz Alisë, prandaj nuk duhet të votohet për të.

Strategji e këtij ligjërimi është përdorimi i kontekstit historik të qytetit, në funksion të përmbushjes së objektivave të vendosura, duke e kategorizuar kundërshtarin si komunist, ndërsa veten, si nip i këtij qyteti. Sipas Chilton (2004:45), funksionet strategjike në komunikimin politik mund të kategorizohen përmes “funsioneve shtrënguese”, të cilat kryesisht lidhen me burimin dhe pushtetin e dhënësit të informacionit, që në komunikimin e aktorëve politikë mund të shfaqen përmes ligjërimin, temave që përzgjidhen për t’u diskutuar, përcaktimit të marrëdhënieve përmes ligjërimin për veten dhe të tjerët, apo efekteve që prodhon një ligjërim tek të tjerët, gjë që vërehet në fjalimin politik të mësipërm, pasi Rama synon ‘ngacmimin’ e publikut në rrafshin emotiv.

Fjalimi i Ramës në Lezhë, “Zëri i Popullit”, 15. 5. 2013, fq. 3- 4.

*“..Asnjë njeri i zakonshëm nuk duhet të harrojë për asnjë çast se sot ne socialistet dhe progresistët jemi të gjithë të bashkuar në Aleancën për **Shqipërinë Europiane**... Me një **program** për ta rilindur Shqipërinë... Për ta rivendosur demokracinë dhe për ta ribashkuar Shqipërinë me **Europën**... E pra me ikjen e atij tradhtari sot Partia Socialiste është më e pastër, më e fortë...Nuk ka mëkat më të madh se sa të përpiqesh t’i tërheqësh zvarrë me bukën e gojës siç ka katër vjet që i tërheq Sali Berisha ose siç kujton se do i tërheqë Gjovalin Kadeli...Do të triumfojmë mbi këtë rregjim të varfërisë, mbi këtë rregjim të papunësisë... **Ne nuk e e hoqëm Enver Hoxhën dhe rregjimin e tij për të mbajtur në kurriz 25 vjet një mikro Enver Hoxha**... Ne jemi të vetëdijshëm që edhe për shkak të tradhtarëve, nga të cilët tani besoj jemi çliruar, kemi shpëtuar, vota këtu në këtë qark, sidomos në këtë rreth është shitur”.*

Këtë fjalim të mbajtur në qytetin e Lezhës, Rama e hap me një prezantim pozitiv të “Aleancës për Shqipërinë Europiane”.

Përdor një ligjërim negativ drejtuar deputetit Gjovalin Kadeli, i cili ka fituar si kandidat i “Partisë Socialiste” dhe më pas është larguar në krahun tjetër politik. Imazhi që përpiqet të japë përgjatë ligjëtimeve të veta, si një lider që ushqen demokracinë e brendshme të partisë dhe mendimin ndryshe, zbehet në këtë etiketim të atyre që ikin, duke i quajtur tradhtarë: Përmes ligjërimin negativ kundrejt Berishës dhe Kadelit, ai thekson përmirsimin e imazhit të PS-së, duke i’u referuar ikjes së pjesës joproductive, e

cila ka influencuar edhe në rezultatin zgjedhor përmes një ndër fenomeneve më shqetësuese në kontekstin politik, shitblerjes së votës.

Fjalimi i Ramës në Korçë, “Zëri i Popullit”, 17. 5. 2013, fq. 3.

*“Jam shumë krenar që Korçës i kemi sjellë këtë **skuadër** dhe ndërkohë më vjen shumë keq që **Saliu** nuk ka gjetur asgjë më të mirë për Korçën se sa oficerin e Gërdecit dhe kryehetuesin e veshit... Vetëm një kryeministër që po numëron ditët e fundit të **pushtetit të tij familjar**, i cili është një pushtet i vjedhur... Dhe të cilit shqiptarët me 23 qershor do ti japin ndëshkimin e merituar”*

Ligjërimi politik i Ramës ndërtohet përmes antagonizmit, referuar listave të kandidatëve për deputetë, pasi theksohet dallimi mes alternativës së ofruar nga e majta, përmes skuadrës së Rilindjes, fitorja e së cilës influencon në ndryshimin rrënjësor të Shqipërisë, krahasuar me alternativën e kundërshtarëve politikë.

Fjalimi i Ramës në Vlorë, “Zëri i Popullit”, 19. 5. 2013, fq. 2.

*“Ju siguroj se vendimi për të vendosur emrin tim këtu në Vlorë nuk ka qenë për t’ia bërë vetes më të lehtë, por për të marrë përsipër përgjegjësinë e jashtëzakonshme të përfaqësimit të kryeqytetit të **historisë** dhe të **pavarësisë** së shqiptarëve... Qysh nga viti 2003 deri në vitin 2013, ky qytet dhe ky qark janë financuar shumë më pak se qytete dhe qarqe të tjera, dhe vetë qyteti i Vlorës ka marrë më pak fonde se Kamza... Se votat e tyre i merrte pavarësisht se punonte apo s’punonte për Vlorën.. **Saliu e la Vlorën jashtë rrjetit të rrugëve që tha se ndërtoi**... Sepse e sheh si vendin ku nuk do të gjejë kurrë mbështetje dhe ku sa herë të votohet aq herë do të ndëshkohet dhe aq herë do të largohet po të jetë për Vlorën.... Ne do të ndërtojmë Korridorin e Katër... Nuk do të lejojmë më të vihet një tullë pa leje”.*

Akuzat ndaj kundërshtarëve politikë lidhen me financimet e pakta të qeverisë së djathtë, në raport krahasues me qytetet e tjera, por dhe të qeverisë së mëparshme të majtë, pasi ajo ishte e bindur në mbështetjen e elektoratit vlonjat.

Sipas funksioneve strategjike të komunikimit politik legjitimitimit dhe delegjitimitimit, Rama legjitimon pushtetin politik përmes teknikave që fokusohen tek dëshirat dhe nevojat e votuesve, tek ideologjia përbashkuese mes së majtës dhe votuesve, tek roli i liderit dhe vetëprezantimi pozitiv, që shërben për të legjitimuar pushtetin politik. E kundërta e legjitimitimit, delegjitimitimi i referohet palës tjetër, ‘atyre’, rivalëve politikë të identifikuar përmes Berishës: Teknikat e përdorura në ligjërimin politik të Ramës, përmes fjalimit të mësipërm, synojnë funksionin strategjik të legjitimitimit të tij dhe partisë së tij, si dhe delegjitimitimin e rivalit politik dhe qeverisë së tij.

Në ligjërim specifikohen objektivat e programit të tij në lidhje me qytetin e Vlorës, ku përfshihet turizmi elitari, rindërtimi i Sheshit të Flamurit etj, ndërsa për alternativën tjetër theksohet konteksti historik i vitit 1997, duke iu referuar “goditjes” politike që i dha Vlora, qeverisë së asaj kohe.

Fjalimi i Ramës në ditën e dytë të Konventës së Partisë, “Zëri Popullit”, 21. 5. 2013, fq. 3.

*“...Kjo është një betejë mes **Shqipërisë së shkuar dhe Shqipërisë së ardhshme**. Kjo është një betejë mes dy botësh. Mes botës së një politike që është e gjitha e përqëndruar tek **gjakimi për pushtet** dhe botës së një politike që kërkon të shkëputet për t’u bashkuar me atë botë ku **politika** është me njerëzit dhe për njerëzit”.*

Në fjalën e tij ndihet një luftë ekstremesh, kundërshtari shihet si ana e keqe e medaljes, si gjakatar, si shkak dhe fajtori, për të gjitha problemet që ekzistojnë në shoqëri dhe ekonomi. Stili ligjërimor i përdorur karakterizohet nga një ton që synon të ketë funksion ndikues tek elektorati, përmes identifikimit të shkakut, ku e keqja e madhe dhe që pengon të ardhmen, është Berisha.

Fjalimi i Ramës në Tiranë, “Zëri i Popullit”, 24. 5. 2013, fq. 3- 4.

*“Pas rënies së **komunizmit**, sistemit që Tirona e tironëve nuk e deshi kurrë dua tu them të gjithë tironëve dhe tiranasve, atyre që e kanë trashëguar shpirtin e **vetëpunësimit** nga të parët dhe atyre që erdhën dhe e ndërtuan shpirtin e vetëpunësimit këtu me përmbyshjen e komunizmit...Ta heqim **taksën** e biznesit të vogël, ta përgjysmojmë tatimin mbi fitimin... Do të rimarrim projektin tonë të **Tiranës Europiane**... E ra **Sala** prej fiku, e ra si top llastiku, jarinani nani hopa e ç’është kjo rrugë me gropa, jarinani nani hopa e Sala ra te gropa”.*

Tradita si kujtesë historike gërshetohet me strategjinë e ‘shkrirjes’ së vetes me komunitetin, përmes përdorimit të një gjuhe që identifikohet me tiranasit e vjetër. Nga e pjesshmja kalon tek e tëra, për të qenë sa më gjithë përfshirës, pasi dihet që përbërja e Tiranës është shumë heterogjene përsa i përket origjinës së banorëve që jetojnë aty. Gjatë fjalimit u vunë re edhe nota spektakli, të cilat janë elemente të qëllimshme për të ndikuar pozitivisht në psikologjinë e elektoratit. Pas kësaj me nota sarkazme thotë që kryeministri, për çdo problematikë, e ka zgjidhjen tek fokusimi i ndërtimit të rrugës, në një kohë kur rrugët kanë filluar të mbushen me gropa.

Fjalimi i Pandeli Majkos në Tiranë, “Zëri i Popullit”, 24. 5. 2013, fq. 5.

*“Në Tiranë fillon Shqipëria dhe shqiptaria që po troket në shekullin e ri drejt **familjes sonë europiane**. Brenda Tiranës sot rritet një popullsi nga jugu në veri, duke forcuar*

unitetin e kombit shqiptar...Pas 23 qershorit, do të sjellim në qeverisjen e vendit një djalë që lindi dhe rriti Tirana. Ai është kryeministri i ardhshëm.”

Strategjitë ligjërimore mbi të cilat ndërtohet fjalimi, synojnë të ndikojnë përmes emocioneve, që shkaktohen nga përzgjedhja leksikore sipas një ideologjie përbashkuese, e cila përforcohet përmes sloganit, ‘të familjes europiane’.

Fjalimi i Ramës në qarkun e Elbasanit, “Zëri Popullit”, 28. 5. 2013, fq. 3.

*“...E pra me krenarinë për Partinë Socialiste që Elbasanit i ka vënë në dispozicion një skuadër të nivelit më të lartë që politika shqiptare mund të prodhojë...Ku sot ju rri si një re e zezë mbi kokë, një monopol mbi duhanin. Një monopol që ne do ta shkallmojmë, siç do të shkallmojmë të gjitha monopolet në Shqipëri për ti hapur rrugë konkurrencës së lirë ... **Rrënim** nga të katër anët! **Gropa dhe braktisje**... Ky është realiteti”*

Një ndër elementët kryesorë të fjalimeve të Ramës në raport me strategjinë e legjitimitimit është: Fokusimi tek grupi i kandidatëve për deputetë të PS-së, të cilët vlerësohen si kandidatët më të mirë që mund të prodhojë politika shqiptare, ndryshe nga kundërshtarët politikë.

Fjalimi i Ramës në Devoll, “Zëri i Popullit”, 29. 5. 2013, fq. 3.

*“Është koha që **Saliu** ta heqi antiplumbin, ta shpërndajë edhe atë **çetën** e 200 rojeve, të shkojë tek fëmijët e fëmijëve dhe ta bëjë **gjyshin** për këtë pjesë që i ka mbetur, se Shqipërisë nuk i duhet një **gjysh me antiplumb**, i duhet një Rilindje, i duhet **skuadra kombëtare** e Partisë Socialiste”.*

Një fjalim i mbështetur tërësisht në ligjërime negativ ndaj Sali Berishës, duke synuar ndikimin e opinionit publik përmes strategjisë krahasimore ndërmjet skuadrës kombëtare të Rilindjes, e cila është gjithëpërfshirëse dhe përfaqësuese në raport me kundërshtarin politik, por jo përmes skuadrës së rivalëve politikë, por përmes delegjitimitimit të Berishës, si individ: Kategoria identifikuese e përzgjedhur për të prezantuar Berishën është përmes statusit të tij si gjysh, me qëllimin e qartë, ndikimin e opinionit publik, në raport me cilësitë që e shoqërojnë këtë kategori. Kundërshtari politik sulmohet nga lideri i së majtës edhe për masat e marra në raport me sigurinë fizike të Berishës, përmes elementëve të tillë si, çeta me 200 roje dhe jeleku antiplumb.

Fjalimi i Ramës në Bushat, “Zëri i Popullit”, 31. 5. 2013, fq. 3.

*“Ju po i jepni një mesazh shumë të qartë Saliut, Jozefinës dhe gjithë **partisë familjare** siç është katandisur sot Partia Demokratike...Në këto territore që deri dje kanë qenë besnikërisht me Partinë Demokratike, hegjemonia e tyre ka marrë fund dhe pushteti i tyre do të marrë votën e ndëshkimit për një **rrënim** të vazhdueshëm...Ne nuk kemi shtet”.*

Delegjitimimi i Partisë Demokratike ndërtohet përmes figurës së Berishës dhe Topallit, dy ndër figurat kryesore të partisë, të cilët e kanë kthyer partinë në një parti familjare, larg funksioneve që duhet të kryejë një parti politike. Në raport me institucionet, me qeverinë Rama përdor një gjuhë të ashpër politike, pasi mohon ekzistencën e shtetit dhe përmes një ideologjie përbashkuese me popullin thekson se qeveria e ardhshme e majtë, do të punojë për popullin dhe do të jetë e popullit.

Fjalimi i Ramës në Kukës, “Zëri i Popullit”, 7. 6. 2013, fq. 3.

*“Çfarë është ky **sharlatan** ...Që u thotë njerëzve që Edi Rama nuk e do Kukësin?...Ne nuk jemi këtu për të ndarë, por për të **bashkuar**, sepse jug e veri është një Shqipëri...Kukësi nuk ia ka borxh as flamurit pa bisht as **katragjyshit** me antiplumb...Duke votuar 29- tën do të çlironi edhe katragjyshin me antiplumb, do të shkojë në shtëpi dhe atje në shtëpi t’ia tregojë përrallat mbesave dhe nipërve..”.*

Legjitimimi dhe delegjitimimi ndërtohen përmes dështimeve të qeverisë dhe premtimeve se çfarë do të bëjë Rilindja, gjatë mandatit fitues. Hedh akuza ndaj Berishës dhe Flamur Nokës që është në krye të Ministrisë së Brendshme, përmes një ligjërimi që mbështetet në unifikimin e shqiptarëve nga veriu në jug, duke synuar ndikimin e një elektorati, që referuar kontekstit historik ka votuar gjithmonë djathtas.

Fjalimi i Ramës në Bulqizë, “Zëri i Popullit”, 13. 6. 2013, fq. 3.

*Flet për gjendjen e vështirë në të cilën ndodhen qytetarët në Bulqizë, përgjegjës për të cilën janë: “Bajraktarët lokalë ..**Bajraktarët** e Tiranës, ata që nga kjo pasuri kombëtare përfitojnë pjesën e tyre, përmes lidhjeve me **grupe kriminale dhe mafioze** që i kanë hyrë kësaj pasurie, duke i bërë këtij vendi atë që asnjë pushtues nuk do t’ia bënte kurrë”.*

Fjalimi i mbajtur në Bulqizë, ndërtohet përmes një retorike sulmuese ndaj të djathtës, e cila emërtohet si ‘çeta e rrënimit’, në raport me përfitimet dhe abuzimet e saja kundrejt popullit të Bulqizës dhe pasurisë nëntokësore të saj.

\Fjalimi i Ramës në Lushnje, “Zëri i Popullit”, 14. 6. 2013, fq. 3.

Falënderon qytetarët për pritjen, që i rezervuan. Flet për votën që do të jepet me 23 qershor: “Mes botës rrënuese të Saliut dhe të partisë së tij familjare dhe botës së rilindur të skuadrës sonë kombëtare, të programit tonë për Rilindjen”.

Gjuha politike e përdorur përmes strategjisë delegjtimuese është e ashpër për të djathtën shqiptare, e cila identifikohet përmes liderit të saj, sepse sipas Ramës ajo është kthyer në një parti familjare. Oferta dhe modeli i PS-së në kontrast me liderin Berisha, thekson rilindjen përmes një skuadre kombëtare dhe përmes një programi të mirëstudiuar. Sipas Ramës, ‘Rilindje’ ofrohet nga e majta, rrënim nga e djathta, e cila i atribuohet Berishës, pasi ai qëndron në krye të rrënimit.

Fjalimi i Ramës në Laç, “Zëri i Popullit”, 15. 6. 2013, fq. 3.

*“Ju e dini se çfarë ndryshimi i madh është kur ikën **katragjyshi** dhe kur gjenerata e re merr në dorë fatet e komunitetit. Ju e keni shijuar çlirimin që vjen prej largimit të asaj çete që kudo ku shkel **rrënon**, kudo ku ndalon rrënon, kudo ku rri rrënon”.*

Ligjërimi politik i Ramës, ndërtohet në mënyrë të vazhdueshme përmes sulmeve politike që i adresohen Berishës, duke e kategorizuar përmes moshës së tij dhe cilësive karakteristike të kësaj kategorie në raport me brezin e ri, si dhe përmes foljes rrënon, përsëritja e së cilës synon ndikimin e elektoratit.

Fjalimi i Ramës në Librazhd, “Zëri i Popullit”, 18. 6. 2013, fq. 3.

*“...Për të dëgjuar fjalët e dëshpëruara të një njeriu të dëshpëruar, që është tanimë në të tatëpjetën e dëshpërimit...Jo në rrugën që ofron Saliu, sepse përpara me Saliun do të thotë mbrapa, larg, thellë drejt rrënimit...Nuk ka mundësi të tretë për një **malukat** të lodhur”.*

Pasi bën një prezantim pozitiv për kandidatët për deputetë të PS-së dhe Taulant Ballën, ligjërimi dominohet nga stili ligjërimesor i përdorur në raport me Berishën, për të patur një funksion ndikues tek elektorati, sepse ai kategorizohet si një njeri i dëshpëruar, me të cilin Shqipëria nuk mund të zhvillohet, por vetëm të rrënohet.

Fjalimi i Ramës në Korçë, “Zëri i Popullit”, 18. 6. 2013, fq. 3.

*Përsëri shohim ligjërime negativ kundrejt Berishës: “Nuk ka faj i gjori **plak**...Nga Rilindja do të përfitojë edhe **katragjyshi**, se do të çlirohet nga antiplumbi dhe do të ketë një shans për tu bërë një plak normal”.*

I vë në dukje se ka ves përgjimin, që nga “koha e vjetër, koha e luftës me shfaqjet e huaja”. Tregon që e ka kthyer dhe shndërruar “Partinë Demokratike”: “Po e bitis si

bajraktari i një shtëpie ku partia është bërë familje, familja është bërë shtet dhe shteti është bërë leckë”.

Fjalimi i Ramës në Kamëz, “Zëri i Popullit”, 19. 6. 2013, fq. 3- 4.

Rama i ka dhënë rëndësi gjatë gjithë fushatës komunikimit me njerëzit, përmes ndërtimit të dialogut pyetje-përgjigje. Në mënyrë simbolike firmos kontratë me qytetarët, për të përmbyllur procesin e legalizimeve, ku përdor një ligjërim negativ kundrejt Berishës, i cili nuk e ka kryer këtë proces, por e ka shfrytëzuar duke theksuar edhe dasitë. “Ka çerek shekulli që ky burrë është bërë kalorës i kësaj dasie, ka çerek shekulli që përpiqet t’iu mbajë të ndarë nga pjesa tjetër...”

“Sa herë takon komunitetet e **veriut** ju thotë se Edi Rama ju ka quajtur shpellarë”. Këtë Rama nuk e pranon dhe thotë që sikur të dalë një herë e vetme, që e ka përdorur një term të tillë, ai tërhiqet nga politika: “Në Shqipëri ka vetëm një **shpellar** dhe ai quhet **Sali Berisha**...Unë jam ai që bëri Tiranën dhe do ta bëj edhe Kamzën”.

Fjalimi i Ramës në Kavajë, “Zëri i Popullit”, 20. 6. 2013, fq. 3.

*“Sekretari i Partisë së Punës, Sali Berisha është bashkuar me punistin Kastriot Islami, kurse unë jam bashkuar me djalin tuaj, një nga protagonistët e lëvizjes së dhjetorit, Parid Carën. Pra, gjërat kanë shkuar në vendin e tyre, ata të së **shkuarës** janë së bashku. Ne të së **ardhmes** jemi së bashku”.*

Leksiku i përzgjedhur për të kategorizuar Berishën dhe Islamin si ‘sekretar i partisë’ dhe ‘punist’, vjen përmes një strategjie që përdoret nga e djathta, në mënyrë dominante, kundrejt PS-së dhe liderit të saj, për vetë konotacionin negativ të saj, në raport me kontekstin historik dhe politik shqiptar. Rama përmes një retorike të mirëstudiuar i drejtohet elektoratit, duke evidentuar dallimin mes grupit të Berishës që përfaqëson të shkuarën dhe skuadrës së tij që përfaqëson të ardhmen.

Fjalimi i Ramës në Tiranë, “Zëri i Popullit”, 21. 6. 2013, fq. 3- 4.

*“Unë ju zotohem se me votën tuaj për rilindjen, ju kryeqytetasit pavarësisht prejardhjeve krahinore, pavarësisht përkatësive partiake, pavarësisht përkatësive fetare, pavarësisht moshës dhe gjinisë do të keni në krah një qeveri që hallet tuaja do ti bëjë të vetat, problemet tuaja do ti ketë të vetat dhe unë do të jem pranë jush në çdo përpjekje për t’i zgjidhur hallet dhe problemet...Sepse rilindja nuk po vjen vetëm, **rilindjen** po e sillni ju, një popull i tërë në kërkim të së **ardhmes**, sepse dallimi mes nesh dhe atyre është shumë i qartë, pas **katragjyshit** nuk ka asgjë, pas meje është **Skudra Kombëtare e Rilindjes**.”*

Rama ndërton një ligjërim politik mbështetur në strategjinë e politikës së re, që ofrohet përmes ‘Rilindjes’, e cila distancohet nga politika e vjetër, duke patur si karakteristikë të saj gjithëpërfshirjen, në raport me dallimet politike, krahinore, fetare, gjinore etj. ‘Politika e Re’ dhe ‘Rilindja’, përdoren si njësi kuptimore që ofrojnë zgjidhjen e të gjitha problematikave të shkaktuara nga qeverisja e djathtë, përmes skuadrës kombëtare që drejtohet nga Rama. Në strategjitë legjitimuese dhe delegjitimuese, funksioni ndikues ndërtohet edhe përmes traditës si kujtesë historike, duke iu referuar një periudhe të rëndësishme në kontekstin historik shqiptar, periudhës së “Rilindjes shqiptare”.

Në ligjërimin politik të majtë gjatë fushatës zgjedhore, 2013, aktorët politikë të së majtës, përdorin strategjinë e legjitimitit dhe delegjitimitit, ashtu si në fushatën paraardhëse të vitit 2009. Legjitimimi ndërtohet përmes tre komponentëve: Imazhi i partisë, imazhi i kandidatëve për deputetë si dhe imazhi i liderit. Imazhi i partisë që kërkon të reflektojë gjatë fushatës është ndryshimi. Risia nën drejtimin e tij konsiston në shkëputjen nga partia e dikurshme, duke theksuar ardhjen e një partie të re me program të ri. Imazhi i partisë përforcohet duke vënë në dukje programin e detajuar prej gati 1000 faqesh, i realizuar nga takimet në çdo vend si dhe nga nisma ‘Këndi i fjalës’ që do të realizohet gjatë fushatës elektorale. Në ndryshim me fushatën e vitit 2009, ku programi ishte pothuajse më shumë virtual sesa konkret, në vitin 2013 “Partia Socialiste” paraqet një program më serioz. Duke sulmuar partinë në pushtet për të metat dhe dobësitë gjatë qeverisjes, për drejtimin e partisë etj, i jep vlerësime superiore imazhit të “Partisë Socialiste” në gjithë rrugëtimin dhe transformimin e vetvetes si parti, duke e cilësuar këtë si një arritje dhe një element të fortë drejt fitores.

Imazhi i kandidatëve është një tjetër pikë e rëndësishme: Kandidatët i prezanton si një skuadër fituese, si skuadrën e ndryshimit, si skuadrën më të mirë. Këtu di të përfshijë bukur edhe meritat e veta si lider, duke pohuar se e pranon mendimin ndryshe dhe është i gëzuar që në skuadrën e tij janë të pranishëm edhe ata kandidatët, të cilët e kanë kundërshtuar dhe kanë mendim ndryshe, duke transmetuar kështu një parti me demokraci të brendshme të shëndetshme.

Imazhi i liderit kryesor të “Partisë Socialiste”, Një nga ndryshimet e dukshme është qëndrimi i liderit. Nëse në vitin 2009 ishte më i qetë gjatë fushatës, me një stil sfidues i vetëm kundër të gjithëve, duke hyrë i vetëm në garë, me bashkimin me “Lëvizjen

Socialiste për Integrim”, në vitin 2013, ka një rritje të besimit në frymën e fitores. Përmes ligjërimit politik paraqitet një lider i mobilizuar, i cili qëndron në krye të skuadrës së tij, duke u zotuar të çlirojë Shqipërinë nga gjakatarët dhe tiranët, sepse mohon çdo arritje që mund të kenë pasur kundërshtarët gjatë dy mandatave qeverisëse.

Një tjetër element që vërehet, është strategjia e përdorur në raport me personalizimin partiak, sepse nëse në vitin 2009, partia identifikohet përmes liderit (nëse themi voto “Partinë Socialiste”, kemi thënë voto Edi Ramën), personalizimi partiak në ligjërimit politik të vitit 2013, synon të përcjellë një imazh më të zbutur të personalizimit partiak, përmes fokusimit tek ‘skuadra kombëtare e rilindjes’. Megjithatë, pavarësisht imazhit që kërkon të përcjellë, roli i Ramës brenda partisë së tij, referuar ligjërimit politik të tij, mbetet po aq i rëndësishëm sa në vitin 2009.

4.4.2 Ligjërimit politik i djathtë përmes fjalimeve, 2013

Në përzgjedhjen e ligjërimit politik gjatë fushatës zgjedhore të kësaj partie, i kemi referuar gazetës së saj “Rilindja Demokratike”, si një organ i cili ka përcjellë fjalimet politike të PD-së dhe gazetës “55”, për të njëjtat arsye, si në vitin 2009. Përmes analizës numerike, janë përfshirë në studim: 12 fjalime të Berishës, 2 të Jozefina Topallit, 2 fjalime të Astrit Patozit, 1 fjalim i Genc Rulit, 1 fjalim i Ridvan Bodes, 1 fjalim i Aldo Bumçit, 1 fjalim i Lulzim Bashës dhe 1 fjalim i Majlinda Bregut.

Fjalimi i Sali Berishës i mbajtur në konventën për barazi gjinore, “Rilindja Demokratike”, 4. 5. 2013, fq. 2.

*“Ne së bashku, vitet që shkuan, në meritën e përfaqësuesve tuaja në politikë, kemi vendosur disa nga **ligjet** më të mira që ekzistojnë në mbështetjen tuaj, por katër vitet që vijnë do të bëjmë gjithçka që roli lider i grave të rritet në çdo hallkë, në çdo segment të shoqërisë dhe politikës shqiptare...Më 23 Qershor, si gjithnjë fitorja është në duart tuaja, **fitorja** është vepra juaj. Nga zgjedhjet e para pluraliste e deri më sot, fitorja e Partisë Demokratike ka pasur vetëm një emër, i cili ka qenë – grua, zonjë, vajzë, zonjushë.”*

Theksohen arritjet e femrës në Shqipëri, në profesione të ndryshme si dhe ngushtimi i hendekut për barazi gjinore, si rezultat i qeverisjes së djathtë. Tregohet se çfarë është bërë dhe çfarë duhet bërë akoma më shumë. Funkcioni ndikues realizohet përmes, bashkimit ‘ne dhe ju’, në funksion të përfitimeve që do të kenë gratë.

Fjalimi i Sali Berishës në hapjen e fushatës elektorale në Tiranë, “Rilindja Demokratike”, 14. 5. 2013, fq. 2.

*“Këta burra dhe gra që keni sot para, forcat politike të koalicionit, të **punësimit, mirëqënies dhe integritit**, në asnjë ditë, në asnjë orë, asnjë vit nuk i lejuan kurrë vetes të ngrihen, të shkelmojnë e kundërshtojnë këtë vokacion. Në të gjithë morinë e kundërshtimeve, debateve, ata kanë qenë dhe mbeten demokratë të pamposhtur të këtij vokacioni... Këta burra dhe gra janë deputetët e qytetarit dhe ju garantoj se në axhendën e tyre, në përpjekjet e tyre do të kenë para së gjithash e mbi të gjitha, punësimin tuaj, krijimin e vendeve të punës, rritjen e rrogave tuaja... Katër vitet që do të vijnë janë vitet e projekteve gjigande për Shqipërinë e shqiptarët. Sot filloi kaskada e Devollit, së shpejti TAP-i, kaskada e Vjosës dhe dhjetëra dhe dhjetëra vepra të tjera të mëdha... Alternativa tjetër ka treguar se nuk është shkëputur nga trashëgimia e saj, nga ajo **trashëgimi** që bëri gjithçka për ta vendosur **kombin** jashtë hapësirës perëndimore. Në 20 vite, ajo alternativë bëri gjithçka për të bllokuar integrimin në Këshillin e Europës, bëri gjithçka për të bllokuar Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit, bëri gjithçka për të bllokuar antarësimin në Aleancën e Atlantikut të Veriut, bëri gjithçka për t’ju lënë juve pa viza, për të mos lëvizur **të lirë në Europë**. Ajo alternativë bëri gjithçka për të privuar shqiptarët nga pasaporta e shkëlqyer e statusit të vendit kandidat. Sot ajo alternativë, me cinizmin më ekstrem e quan veten **Aleanca e Shqipërisë Europiane**... Përballet qëndrimi ynë, i cili ka në thelb dhe synon liritë tuaja, besim të pakufishëm tek iniciativa juaj e lirë, tek pasuria e saj...Alternativa tjetër është alternativë e besimit tek **diktati shtetëror, tek diktati qeveritar, e taksave të larta, e ngushtimit të hapësirave të iniciativës së lirë**... “Çfarë bën zoti Rama? Sa qeverisi Tiranën i dy e trefishoi taksat, tani kalon nga një qytet në një tjetër si hije e **Nastradin**it dhe ju thotë shqiptarëve se do të heqë taksat.”*

Fjala hapëse përfshin atributet që i jepen Tiranës, si zemra e kombit, truri i tij, Tirana blu. Prezantimi i koalicionit më të gjerë, në historinë politike të pluralizmit shqiptar. Referimi tek perëndimi, si vlerë e rëndësishme dhe ky vokacion përmbushet përmes koalicionit të djathtë, duke theksuar arritjet dhe objektivat dhe duke atashuar kundërshtarit politik me komunizmin, në funksion të strategjive legjitimuese dhe delegjitimuese. Trashëgimia këtu nënkupton lidhjen me “Partinë e Punës së Shqipërisë”, e cila nuk mund të konceptohet më në Europë, dhe pastaj tregohen pengesat që opozita ka bërë për Shqipërinë dhe në fund emërtimi Europiane, e cila në zgjedhjet e vitit 2009, është përdorur fuqishëm nga “Partia Demokratike”. Po të shohim tek fjalimet e “Partisë Socialiste”, është e njëjta akuzë edhe nga ana e tyre. Në drejtim të kundërshtarit theksohet edhe ndarja mes dy filozofive, mes asaj të djathtë dhe asaj të majtë.

Fjalimi i Berishës në Berat, “Rilindja Demokratike”, 19. 5. 2013, fq. 3.

*“Ndaj dhe në filozofinë tonë, ne e kemi respektin e **lirive** tuaja, sigurinë e lirive tuaja, mbështetjen e lirisë suaj të lëvizjes, përparësinë më të madhe... Të shpallësh se nuk ka armiq që i kanë bërë Beratit ato që i ka bërë kjo qeveri, do të thotë të udhëtosh në autobus me xhama të zinjë e të mos shohësh asgjë përreth, përveç parave të autobusit ku je ndryrë”.*

Ligjërimi politik ndërtohet përmes prezantimit të arritjeve gjatë qeverisjes: Përgjysmimi i taksave të biznesit të vogël, ulja 10% e tatim fitimit, e cila si rrjedhojë dyfishoi bizneset, dyfishoi punësimin, subvencionime për fermerët, mbështetje për bujqësinë, rritje investimeve të huaja, ndërtimin e Shqipërisë turistike.

Objektivat e synuara janë rritja e investimeve të huaja në shifra më të mëdha, rritja e turizimit, trefishimi i subvencioneve. Për kundërshtarin politik ngrihen akuza, që nuk njih mirë konceptet bazë të ekonomisë, duke e lidhur me tematikën e faljes së gjobave. Rama ka deklaruar se do të falë gjobat e atyre që janë gjobitur nga marsi e në vazhdim, ndërsa Berisha i drejtohet me një pyetje që lidhet me arsyen pse nuk do të falë ata para marsit, apo se i deklaroi armiq klase?

Kur një gjë e tillë është propozuar nga Berisha, Rama nuk e ka pranuar, prandaj i bën ftesë që të marrë pjesë dhe ta votojnë në parlament, ligjin e amnistisë. I drejtohet Ramës për të ndërtuar një fushatë më alternative, projekte, rrugë, ura, shkolla, të cilat nënkuptohet që “Partia Demokratike” i ka realizuar dhe do vazhdojë t’i realizojë, si dhe i flet për konceptin e lirisë.

Fjalimi i Astrit Patozit në Vlorë, “Rilindja Demokratike”, 21. 05. 2013, fq. 19.

Rëndësia e votës në Vlorë për të ndaluar modelin Rama- Kokëdhima: “Që sistemi i tyre i beton-përfutimit, i cili u aplikua për 11 vjet rresht, pa mëshirë, në Tiranë, të pushtojë fillimisht Vlorën dhe prej këtu të përhapet pastaj në të gjithë Shqipërinë.”

Një ligjërim i ngritur kryesisht përmes delegjitimitimit të kundërshtarit politik, referuar dëmit që i ka sjellë Rama vendit: Pengoi procesin për marrjen e statusit kandidat, investimeve dhe projekteve që do të vinin si rezultat i kësaj, ka bllokuar Gjykatën Administrative, nuk e bëri asnjëherë planin rregullues të Tiranës, dyfishoi taksat për bizneset në Tiranë, ka premtuar konkurrencë, por kur ishte kryetar bashkie të gjitha tenderat fitoheshin nga Kokëdhima, sepse ai ishte miku dhe ortaku.

Fjalimi i Genc Rulit në Gjirokastrë, “Rilindja Demokratike”, 21. 05. 2013, fq. 19.

Përveç arritjeve si rezultat i punës së bërë, ndalet tek Rama, i cili paraqitet si njeriu që ka vetëm një plan, ”si ta zhbëjë me fjalë gjithçka ne kemi arritur të krijojmë dhe ta fusë vendin në një tunel të errët, pa fund e pa krye. Sepse ndërkohë që ne ndërtojmë tunele, në malet më të vështira të Shqipërisë, Edi Rama ka ngecur në tunelin e sajësive, në tunelin e shpifjeve dhe gënjeshtrove”.

Prezantohen arritjet që ka bërë “Partia Demokratike” gjatë 2 mandateve, dhe krahasimi i tyre kur ishte “Partia Socialiste” në qeveri, kur nuk u bënë as 20 km rrugë, kur nuk u ndërtua asnjë shkollë. Liria si koncept i rëndësishëm, përmendet në mënyrë të vazhdueshme, pothuaj në të gjitha fjalimet e analizuara, vlerë që qëndron në ideologjinë e “Partisë Demokratike”.

Fjalim i Sali Berishës në Kuçovë, gazeta “55”, 25.5.2013, f.3

Në fjalimin e mbajtur në Kuçovë, Berisha rendit arritjet e qeverisë në dyfishimin e rrogave dhe pensioneve, dyfishimin e biznesit të vogël si dhe investimet e bëra në këtë qark dhe objektivat e vendosura për mandatin e ardhshëm, dhe më pas i drejtohet Ramës:

*“Ke ngritur në autobusin mavi një **bandë** dhe e krahason atë me **rilindësit**. Do tu paraqesësh Beratit ti, Fidelin. Mos lëndo shqiptarët. Çfarë e lidh Kokëdhimën me Naim Frashërin, Tom Doshin apo Ndre Mjedën? Këtë emërtim mund ta bësh vetëm ti për shkak të **trashëgimisë sate, etërit tuaj urrenin rilindjen**. Ti kërkon ti poshtërosh për së vdekuri ata”.*

Sipas Confrancescos, (Bobbio, 1997) tradita është një ndër kriteret e përdorura për të dalluar të majtën nga e djathta, pasi tradita së bashku me variablat e saj, mund të kategorizohet si një ndër konceptet që i përshtaten ideologjisë së djathtë, ndryshe nga e majta e cila identifikohet përmes emancipimit, por nëse disa nga kriteret e përcaktuara që shërbejnë për të theksuar ndarjen ndërmjet ideologjisë së majtë dhe të djathtë karakterizohen nga antagonizmi, në këtë rast tradita dhe emancipimi nuk reflektojnë këtë gjë. Pavarësisht 6 kuptimeve të ndryshme që merr tradita, sipas Confrancescos, në këtë ligjërim evidentohet tradita si kujtesë historike, duke synuar të influencojë tek publiku përmes trinomit: Komunizëm-bandë- rilindje.

Fjalim i Sali Berishës në Dibër, gazeta “55”, 25.5.2013, f.3

Në fjalimin e mbajtur në Dibër, Berisha rendit arritjet e qeverisë për qarkun e Dibrës, në ndërtimin e 500 km rrugë, ndërtimin e 80 sistemeve ujësjellës dhe kanalizime, 92 shkolla dhe kopshte, investimin e 1 miliard lekëve, në shëndetësi ndërtimin e 80 objekteve etj. Pas arritjeve, ai fokusohet tek objektivat e vendosura për mandatin e ardhshëm dhe më pas i drejtohet Ramës:

*“...Por nga ky shesh më lejoni t’i çoj një mesazh **shokut Rama**, i cili erdhi në Peshkopi përçarës, sepse platforma e tij është vetëm **përçarja**. Ju tha juve këtu se Berisha ju ka injoruar, se ai nuk pyet për Peshkopinë. Dibranët **socialistë e demokratë** nuk mund të*

pajtohen me ty, sepse ti shkelmon me papërgjegjshmërinë më të madhe mbi aspiratat e tyre europiane”

Një ndër funksionet e ligjërimit politik të Berishës në këtë fjalim, është ngacmimi në rrafshin emocional i publikut, duke i atribuar kundërshtarit politik, përdorimin e një leksiku me konotacion negativ, pasi vjen nga terminologjia komuniste, (shoku Rama), ndërsa funksioni tjetër i ligjërimit politik është delegjitimimi i tij, përmes kategorizimit si lider i një partie, përkrahësit e së cilës nuk mund të pajtohen me sjelljen e Ramës.

Fjalimi i Berishës në Konventën e Partisë Demokratike për “Shqipërinë e zhvilluar”, “Rilindja Demokratike”, 26. 5. 2013, fq. 2.

*“Mjeran! I shkretë, i padijshëm nga punët shtetërore. Ke qënë kryetar Bashkie o **piktor i dështuar**...Duke parë se je realisht i sëmurë nga rrugët, unë jam **mjek** dhe e kam të thjeshtë ta kuptoj se të ka zënë dromofobia. Ti në autobus, unë do të shtroj rrugët...Dhe kjo jo se Shqipëria ishte e varfër, por sepse ajo dergjej në kthetrat e **shokëve socialistë**... Shoku i autobusit”*

Retorika e përdorur thekson arritjet të cilat i referohen: Një Shqipërie të zhvilluar si vepër e reformave të thella, arsimimin, infrastrukturën, shkolla, ujësjellës dhe impiante ujore. Renditen një sërë projektesh të realizuara dhe që presin të realizohen ose janë në përfundim e sipër. Pikat kyçe për mandatin 2013-2017: Krijimi i 250 mijë vende pune të reja, 6 miliardë dollarë investime të huaja, trefishimi i granteve dhe mbështetja për fermerët, arritja e numrit 7 milionë në vit turistë në Shqipëri, 5 vjet pa taksa në teknologjinë e High Tech dhe industrisë së makinave, marrja e statusit të vendit kandidat, hapja e negociatave dhe integrimi në Bashkimin Europian.

Drejtuar kundërshtarëve politikë, sërishq evidentohet, përdorimi i qëllimshëm i termave që lidhen me Partinë e Punës.

Fjalimi i Ridvan Bodes në Konventën e Partisë Demokratike për “Shqipërinë e zhvilluar”, “Rilindja Demokratike”, 26. 5. 2013, fq. 8.

Legjitimimi i së djathtës ndërtohet përmes arritjeve të qeverisë si: Prodhimi i Brendshëm Bruto i rritur 8 herë më shumë se mesatarja e rajonit, investimet e huaja 2 herë më të larta se mesatarja e rajonit, 2 herë më të larta se investimet e huaja që kanë qënë gjatë qeverisjes socialiste, indeksi i mirëqënies është rritur me 12.9%, por pavarësisht këtyre arritjeve, theksohet se do bëhet, akoma më shumë.

Delegjitimimi kundrejt kundërshtarëve politikë: “Ne dimë me siguri një gjë, që Rama si kryetar bashkie ishte një **taksoman** dhe rritës serial taksash... Kjo do të thotë që ai

është **armik i punësimit**”, ndërtohet përmes funksionit të Ramës si kryetar bashkie dhe sjelljes së tij në bazë të këtij funksioni.

Fjalimi i Astrit Patozit në Konventën e Partisë Demokratike për “Shqipërinë e zhvilluar”, Rilindja Demokratike, 26. 5. 2013, fq. 8.

Përveç arritjeve, i referohet dhe vlerësimeve të marra për fusha të ndryshme nga vende dhe institucione ndërkombëtare, si:

*“Kombet e Bashkuara e kanë quajtur Shqipërinë si një vend me zhvillim të lartë njerëzor. Organizata Botërore e Shëndetësisë thotë se ne kemi ulur vdekshmërinë e nënave, nga 23 në 100.000 gra në vitin 2004, në 5.8 që është sot. Revista News Week e ka renditur Shqipërinë si një ndër 100 vendet më të mira në botë..Të një koalicioni dhe një lideri, të **Sali Berishës**, që po punon fort për ta çuar Shqipërinë përpara”.*

Ligjërimi politik ndërtohet përmes referimit ndaj ndërkombëtarëve dhe institucioneve të tyre, si mënyra më e mirë e legjitimitit, të politikave të ndërmarra nga qeveria e djathtë. Kjo përzgjedhje, vjen si rrjedhojë e impaktit influencues të të huajve, në perceptimin e opinionit publik, si rrjedhojë e kontekstit historik dhe politik shqiptar.

Fjalimi i Jozefina Topallit në Konventën e Partisë Demokratike për “Shqipërinë e zhvilluar”, “Rilindja Demokratike”, 26. 5. 2013, fq. 9.

*“**Forumi Ekonomik Botëror** e ka renditur Shqipërinë të 9- ën në botë në klasifikimin e vendeve më të mira për të hapur një **biznes**...Kjo është arsyeja që **Sali Berisha** dhe Partia Demokratike kanë një plan real dhe konkret për krijimin e **250.000** mijë vendeve të reja **pune** gjatë katër viteve të ardhshme.”*

Fjalimi i Topallit shfaq ngjashmëri me fjalimin paraardhës, përse i përket elementëve që përzgjidhen për t’u theksuar në raport me progresin që ka bërë Shqipëria, përmes qeverisjes së djathtë, e legjitimuar dhe përmes përdorimit të Forumit Ekonomik Botëror.

Fjalimi i Aldo Bumçit në Konventën e Partisë Demokratike për “Shqipërinë e zhvilluar”, Rilindja Demokratike, 26. 5. 2013, fq. 9.

*“E duam Shqipërinë si gjithë **Europa**....Partia Demokratike kishte vizionin për t’iu bashkuar vlerave perëndimore, për ta çliruar Shqipërinë nga mankthi i izolimit...**Sali Berisha**, Partia Demokratike dhe shqiptarët bënë një zgjedhje: Ne zgjodhëm NATO- n dhe bashkë me miqtë tanë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, këtë ëndërr e bëmë realitet.”*

Nëse strategjia legjitimuese ndërtohet përmes vlerave të Sali Berishës dhe PD-së, në raport me politikën e jashtme, delegjitimimi i kundërshtarëve politikë ndërtohet përmes

veprimeve politike të Ramës, i cili bëhet përgjegjës, për mosvotimin e tre ligjeve, bllokimin e 38 milion euro investime dhe 1200 bursa për rininë shqiptare.

Tradita si kujtesë historike, lidhet me përdorimin e vitit 1992, si periudhë e rëndësishme në kontekstin historik shqiptar dhe rolit të PD-së, prandaj Bumçi përmes tonit të përdorur, synon ndikimin e publikut përmes retorikës së përdorur, ku thekson se shqiptarët kanë rilindur në vitin 1992 dhe se kanë zgjedhur Europën.

Fjalimi i Lulzim Bashës në Konventën e Partisë Demokratike për “Shqipërinë e zhvilluar”, “Rilindja Demokratike”, 26. 5. 2013, fq. 11.

Modeli i ndjekur nga Rama sipas Bashës, referuar funksionit të tij si kryebashkiak, është: “Unë dhe miqtë e mi jemi të parët”. Bën krahasim mes premtimeve aktuale të Ramës dhe punës së bërë nga ai duke përmendur legalizimet, taksat dhe punën që realisht ka bërë për Tiranën.

“Të gjithë e keni dëgjuar ish-kryetarin që të flasë këto ditë për Tiranën **Europiane** që na la pas. Ose ai ka një koncept të ndryshëm nga **ne** për **Europën**, ose e ka thënë siç bën rëndom sa për të kaluar radhën”. Nëse kundërshtari politik delegjitimohet nga pasardhësi përmes funksionit të ish-kryebashkiakut, në raport me punën që ai ka bërë, legjitimimi ndërtohet përmes përemrit ‘ne’, si reflektim i ideologjisë përbashkuese mes popullit dhe të djathtës, në raport me vizionin europian.

Fjalimi i Majlinda Bregut në Konventën e Partisë Demokratike për “Shqipërinë e zhvilluar”, “Rilindja Demokratike”, 26. 5. 2013, fq. 11.

Përgjegjësia për bllokimin e tre ligjeve bie mbi Ramën. “Sigurisht asnjë përfitim s’do të ishte bllokuar nëse s’do të na kishte rënë për hise një lider opozite kaq antishqiptar”.

Fjalimi i Bregut fokusohet më tepër mbi strategjinë e delegjitimimit, sesa të legjitimimit, sepse përdor një gjuhë të ashpër politike kundrejt liderit të opozitës, mbi mosveprimet dhe veprimet e Ramës, përmend dhe krahasime me anëtarët e komitetit qëndror gjatë diktaturës, të cilët ishin diktatorë, por “ agresivë dhe halldupë politikë si ti, zor se mund të ketë pasë e të ketë të dytë në këtë vend”.

Strategjia delegjitimuese përforcohet përmes kostove që ka sjellë mosvotimi i tre ligjeve, të vendosura si kusht nga ndërkombëtarët, përgjegjës i së cilës është Rama i cili kategorizohet si ‘një lider opozite antishqiptar’.

Fjalim i Jozefina Topallit në Shkodër, gazeta "55", 28.5.2013, f.3

*"... Kur të votoni numrin 44 dhe emrin e Sali Berishës në fletën e votimit, ju duhet ta dini se **qeveria e tij** ka ndërtuar 900 km rrugë në këtë qark. Ne kemi investuar kudo! Ai (Edi Rama) sulmon rrugët dhe i quan qorrsokak. Sulmon NATO-n dhe i thotë natë. **Ai, njeriu që nuk njeh familjen e vet, sulmon familjet tona.** Vjen në Shkodër dhe ju thotë se 'çfarë ju duhet juve gjyshi, baba, axha apo daja? Taman ata që janë vrarë, janë pushkatuar, janë dergjur burgjeve nga etërit e tij biologjikë dhe ideologjikë. Jo mor shoku rilindas!"*

Lideri dhe kryeministri Berisha është pjesë e fjalimit politik të z. Topalli përmes ftesës që i drejton elektoratit, duke i paraqitur si argument investimet e ndërmarra gjatë mandatit qeverisës të PD-së, të shprehura përmes mbiemrit pronor, 'qeveria e tij'. Delegjitimimi i Ramës dhe legjitimimi i forcës politike të djathtë, ndërtohet përmes kujtesës historike, duke sjellë në vëmendje krimet politike gjatë sistemit komunist, me autorët e të cilave atashohet Rama, si trashëgimtar i tyre.

Fjalim i Sali Berishës në Shkodër, gazeta "55", 28.5.2013, f.3

Në fjalimin e mbajtur në Shkodër, Berisha rendit arritjet e qeverisë për këtë qark përsa i përket infrastrukturës, ndërtimin e shkollave, investime etj, dhe kërkon në Shkodër mandatin e tetë, në raport me kandidatët për deputetë të kësaj force politike. Kërkesën e tij e përforcon duke krahasuar arritjet e qeverisë me alternativën tjetër:

*"Kampi tjetër po shëtit në rrugët e Shqipërisë, në **bunkerin e vet mavi**, në autobusin mavi. Zoti Rama, këtu nga Shkodra, meriton përgjigjen e çdo shqiptari. Të krahasosh Sami Frashërin, Pashko Vasën, Fillip Shirokën, Naim Frashërin me **bandën e bllokmenëve të rinj** në autobusin mavi ke fyer çdo shqiptar, ke fyer rëndë baballarët e gjyshërit e tyre dhe ndëshkim i madh të prët me 23 qershor, Zoti Rama, ty nuk të vjen mirë kur unë të përmend **aktet mizore të etërve të tu**, por si mund ta shpjegoj, thua jua qytetarëve, kur ti deklaron sot se NATO është natë, je i **sëmurë psikik** apo i biri i të atit?"*

Kategorizimi negativ kundrejt Ramës, përmes strategjive të përdorura nga Berisha, ndërtohet përmes përdorimit të një leksiku, që shoqërohet me konotacion negativ në kujtesën historike të shqiptarëve si: Bunkerin e vet mavi, bandën e bllokmenëve të rinj, apo aktet mizore të etërve të tu, duke i'u referuar trashëgimisë biologjike dhe ideologjike.

Fjalim i Sali Berishës në Kamzë, gazeta "55", 31.5.2013, f.3

Në fjalimin e mbajtur në Kamzë, Berisha rendit arritjet e qeverisë, objektivat e vendosura për mandatin e ardhshëm dhe kërkon votëbesimin e qytetarëve përmes delegjitimitimit të Ramës:

*“...Alternativa jonë frymëzohet nga ju, bazohet tek besimi i pakufishëm i juaji, **iniciativa juaj e lirë**. Këto vite kemi ndryshuar Shqipërinë. Ju jeni këtu nga çdo zonë e vendit. Alternativa tjetër është etiketimi juaj njëherë **shpellarë, herë tjetër çeçenë**. Urdhëro zoti Rama, këta burra dhe që janë këtu nga të 4 anët e dheut kanë ndërtuar me supet dhe shpirtrat e tyre vila e shtëpi të bukura, qytetin e 6 më të madh në Shqipëri. Po ju çfarë keni bërë? Je **një piktor i dështuar** që latë Tiranën me **250 km rrugë të pasfaltuara**, bëtë gjithçka që këto burra dhe gra të mos lëviznin me viza, mbajte peng statusin...”*

Një ndër funksionet e ligjërimit politik të Berishës në këtë fjalim, është ngacmimi në rrafshin emocional i publikut, duke i atribuar kundërshtarit politik përdorimin e një leksiku me konotacion negative, si shpellarë dhe çeçenë, ndërsa funksioni tjetër i ligjërimit politik është delegjitimimi i tij, përmes kategorizimit si, piktor i dështuar.

Fjalim i Sali Berishës në Pogradec, gazeta “55”, 3.6.2013, f.2

Në fjalimin e mbajtur në Pogradec, Berisha rendit arritjet e qeverisë për Pogradecin europian, pas arritjeve, ai fokusohet tek objektivat e vendosura për mandatin e ardhshëm ku një ndër premtimet kryesore të artikuluar, gjatë zhvillimit të fushatës zgjedhore 2013 është punësimi, pasi do të krijohen 250 mijë vende pune. Më pas ai analizon platformën e partisë rivale, përmes fokusimit tek lideri i saj, platforma e të cilit përbëhet nga tre shtylla:

*“Në shtyllën e parë është **ofendimi ndaj qytetarëve**. Në një vend i quan **inJORANTË**, në një vend i quan **nxënësit dele**, në një vend tjetër **policët bagëti**, në tjetrin qytetarët i quan **robër**. Shtylla e dytë e programit të tij ka nxjerrë krye këto ditë në mënyrën më të shkëlqyer. Çfarë po deklaroi këto ditë? Po deklaroi se do t’ia ulë **taksat 95%** të shqiptarëve dhe paratë do t’ua marrë **5%** të shqiptarëve. Shoku autobusit mavi mësoje se është a-ja e çdo ekonomie të lirë, e doktrinës së ekonomisë së lirë. Ekonomia e një vendi të lirë nuk rritet kurrë nga lart-poshtë. Ekonominë e një vendi e rrit klasa e mesme e vendit...Jo ai 5% që urren ti. Kolona e tretë e programit të tij janë **sharjet, shpifjet dhe trillimet ndaj Sali Berishës**. ”*

Retorika e përdorur në këtë fjalim të Berishës, përmes analizës së shtyllës së parë të platformës së kundërshtarit politik ka si objektiv funksionin ndikues tek opinioni publik, përmes pjesës emocionale, ndërsa mënyra e taksimit e artikuluar nga Berisha, është një ndër kriteret që dallon ideologjinë e majtë nga ideologjia e djathtë: Për të djathtën mënyra më e mirë është taksa e sheshtë, ndërsa për të majtën është taksa progresive, e cila konsiston në tarifa tatimore më të larta për të ardhura më të larta, duke u kthyer një ndër kriteret e vetëm, në përputhje me ideologjinë e majtë dhe të djathtë, gjatë zhvillimit të fushatës zgjedhore.

Fjalim i Sali Berishës në Delvinë, gazeta “55”, 10.6.2013, f.2

*“Alternativa tjetër bazohet kryekëput në **mashttrimin, shpifjen dhe trillimin**...Të kujtoj këtu që gënjeshtria është dobësia më e madhe e burrit, është **mungesë karakteri**. I nderuar **shoku mavi**, ka një njeri që rri në krahun tënd, që ka zaptuar Himarën me gradaçela dhe ka zënë detin, ai është Koço Kokëdhima. Le të lëmë mënjane sharjet e tij ordinere dhe të padenja...”*

Delegjitimimi ndërtohet përmes mohimit të alternativës tjetër dhe liderit të saj, i cili akuzohet si gënjeshtar dhe përmes përzgjedhjes leksikore, me të cilën përfaqësohet, e cila është pjesë e terminologjisë komuniste: “Shoku mavi”, duke synuar ndikimin e opinionit publik.

Fjalim i Sali Berishës në Laç, gazeta “55”, 11.6.2013, f.2

*“Prej 3 javësh merret me nipërit dhe mbesat e mia dhe **Sali Berishën-gjyshi** i tyre. Çdo vit njeriut ia jep Zoti, por më të bekuara janë ato kur ai jeton si gjysh. Këtë e ka të qartë kushdo, përveç atij që ka patur vitet e rinisë **pa rini** dhe vitet e burrërisë **pa burrëri**. Ai deklaron se Sali Berisha është lodhur. Gjithë jetën time kam punuar jo më pak se 16 orë në ditë, por nga të gjitha lodhjet, këto të viteve të fundit, krijojnë kënaqësinë më të madhe, sepse unë tani lodhem për **shqiptarët**”.*

Strategjitë e përdorura prodhojnë një ligjërim krahasimtar përmes liderëve dhe jo përmes partive politike, sepse Berisha synon të riprezantojë Ramën negativisht në rrafshin njerëzor, ndërsa veten pozitivisht në rrafshin njerëzor dhe profesional.

Fjalim i Sali Berishës në Durrës, gazeta “55”, 15.6.2013, f.2

*“Alternativa tjetër është **alternativa e nxirjes** së çdo gjëje që ju gra dhe burra fisnikë keni arritur me mundin dhe djersën e punës tuaj... Modeli tjetër është modeli i një njeriu që 270 ditë në vit nuk shkelte në zyrën e punë. Është modeli i një **njeriu të dështuar**, modeli i një **burri aventurier** që ndahet dhe bashkohet me gra sa herë vijnë zgjedhjet për qëllime elektorale.”*

Berisha alternativën tjetër e identifikon me liderin e saj, përmes sjelljes politike dhe morale të Ramës, duke përdorur një gjuhë të ashpër politike kategorizuese si: Njeriu i dështuar dhe burri aventurier.

Në ligjërimin politik të djathtë gjatë fushatës zgjedhore 2013, aktorët politikë të së djathtës, përdorin strategjinë e legjitimitit dhe delegjitimitit. Legjitimimi ndërtohet përmes këtyre komponentëve: Imazhi i qeverisë dhe i partisë, imazhi i kandidatëve për deputetë si dhe imazhi i liderit.

Imazhi i partisë paraqitet nëpërmjet arritjeve të qeverisë, të cilat përsëriten pothuaj në të gjitha fjalimet e liderit të partisë dhe gjithë eksponentëve të tjerë. Një tipar që theksohet

është identifikimi i imazhit të partisë përmes kontekstit historik, si partia që përmbysi sistemin diktatorial, duke përsëritur sloganin e vitit 1990, e duam Shqipërinë si gjithë Europa. Imazhi i partisë synon të ndërtohet dhe përmes programit, edhe pse gjatë 2013, pati edhe akuza nga “Partia Socialiste”, se i kishin vjedhur programin që u ishte dashur dy vjet ta përpilonin. Në fakt në të dyja fushatat vihet re se programet e tyre përbëhen pothuajse nga të njëjtat pika dhe objektiva.

Kandidatët e përzgjedhur paraqiten si armata më e mirë, e cila ka bërë dhe do vazhdojë të bëjë një punë të jashtëzakonshme, sepse secila parti pretendon se ka zgjedhur emrat më të kualifikuar dhe më profesionalë, se pala tjetër. Si një strategji elektorale përdoren citime dhe vlerësime të ndërkombëtarëve, për arritjet e qeverisë dhe ngritjen e indeksit të mirëqënies ekonomike të vendit në këtë periudhë.

Ashtu si në fushatën paraardhëse, edhe në këtë fushatë, në ligjërimin politik, spikat imazhi i liderit i cili njehsohet me partinë, duke zbehur rolin dhe funksionet që duhet të kryejnë partitë politike: Beteja politike prezantohet si një betejë mes liderësh dhe jo përmes programit dhe ideologjisë sipas dallesës e majtë/ e djathtë.

4.5. Analizë e ligjërimin politik në raport me ideologjinë e majtë/e djathtë, 2013

Dallimet ndërmjet të majtës dhe të djathtës janë ezauruar në nivel teorik krahasuar më të dhëna empirike gjatë analizës së ligjërimin politik në raport me ideologjinë e majtë/e djathtë, në fushatën zgjedhore, të vitit 2009. Për të evituar një përsëritje teorike të dallimeve mes së majtës dhe të djathtës, po sintetizojmë një përmbledhje të fjalëve kryesore të përdorura në ligjërimin politik, gjatë zgjedhjeve të vitit 2013, për të krahasuar të dhënat empirike me teorike.

Leksiku i përdorur nga PS, fjalët kyç	Leksiku i përdorur nga PD, fjalët kyç
<i>Rilindje</i> <i>transformimin rrënjësor, punësim dhe shëndetësi</i> <i>falas</i>	<i>rritjen më të madhe të rrogave dhe pensioneve</i> <i>punësimi, mirqëmia dhe integrimi</i> <i>liri</i>

<i>liri</i>	<i>komb</i>
<i>komb</i>	<i>Shqipëria në Nato</i>
<i>i politikës së vjetër të së shkuarës</i>	<i>Të lirë në Europë</i>
<i>për një Shqipëri si gjithë Europa</i>	<i>Tiranës Europiane, Shqipërisë Europiane</i>
	<i>taksa e sheshtë</i>
<i>taksa progresive</i>	<i>biznese</i>
<i>biznese</i>	<i>familja</i>
<i>familja</i>	

Fjalët kryesore të shkëputura nga fjalimet e “Partisë Socialiste” dhe “Partisë Demokratike”, reflektojnë një ligjërim politik të ngjashëm me vitin 2009. Gjatë vitit 2013, pati edhe akuza nga “Partia Socialiste” se i kishin vjedhur programin që u ishte dashur dy vjet ta përpilonin. Në fakt në të dyja fushatat vihet re se programet e tyre përbëhen pothuajse nga të njëjtat pika dhe objektiva. Në këtë pikë të analizës, elementi më dallues ndërmjet të majtës dhe të djathtës, është mënyra e taksimit: Një ndër elementët e vetëm të përrshirë në ligjërimin politik, që shërben si kriter ndarës mbi ideologjinë e majtë dhe të djathtë është qëndrimi i ndryshëm që mbajnë partitë politike me mënyrën e taksimit, ku e djathta është pro taksës së sheshtë, ndërsa e majta pro taksës progresive.

Kriteri i barazisë, si një element i ideologjisë së majtë, i përforcuar përmes mënyrës së taksimit që kërkon të vendosë PS-ja, tejkalon qëllimin për të cilin është krijuar, si një kriter themeltar për diadën e majtë/ e djathtë, duke u kthyer në një instrument që legjitimon delegjitimimin e kundërshtarëve politikë, në raport me vendimet politike dhe abuzimet e tyre, përse i përket mënyrës së taksimit. Në ligjërimin politik të së djathtës, mbrohet taksa e sheshtë dhe delegjitimohet taksa progresive e së majtës, referuar kontekstit historik përmes figurave të Karl Marx-it dhe Spiro Kolekës.

Liria është një kriter i cili përdoret në ligjërimin politik të majtë dhe të djathtë, në bazë të strategjive të përzgjedhura nga partitë politike: E majta kërkon lirinë për të gjithë ata që ndihen të kërcënuar nga qeverisja e djathtë, liri dhe të drejta të barabarta, ndërsa e djathta e artikulon lirinë, në mënyrë të vazhdueshme, për të ndikuar mbi opinionin publik, pasi në kontekstin historik politik shqiptar, liria është asociuar me të djathtën shqiptare.

Nëse të djathtët kërkojnë ruajtjen e traditës dhe të majtët emancipimin, në ligjërimin politik të aktorëve politikë, hasen elementë që trajtojnë traditën dhe emancipimin nga të dy krahët politikë, duke iu larguar mendësisë së djathtë për ruajtjen e traditës dhe mendësisë së majtë për emancipimin në raport me pabarazitë që rrjedhin nga privilegjet e ndryshme: Pasi në ligjërimin politik të Ramës, përfshihen idealet e Rilindjes si periudhë e rëndësishme e Shqipërisë, si dhe në të njëjtën kohë transformimi dhe ndryshimi rrënjësor, ndërsa në ligjërimin politik të Berishës përfshihen tradita përmes variablave të ndryshme si dhe ndryshimi, i artikuluar në mënyrë të vazhdueshme nga ai.

Ideologjia e një partie politike reflektohet në programin e saj, në përfshirjen e tematikave të caktuara dhe alternativat për zgjidhjen e tyre, pasi përmes programit politik partitë politike kryejnë funksionin programor, ku përfshirja e interesave dhe kërkesave të ndryshme, në një njësi përbashkuese synon të marrë aprovimin dhe pëlqimin e shumicës dhe t'i lejojë sistemit politik të jetë i legjitimuar dhe i stabilizuar. Por në fushatën zgjedhore të vitit 2013, partitë drejtohen drejt një sjellje politike pragmatiste, sepse në vend që të theksohet diferenca përmes programeve, kemi të bëjmë me të kundërtën, ngjashmërinë.

Për të majtën dhe të djathtën disa nga pikat e programit janë arsimi, bujqësia, punësimi, turizmi, zgjidhja e të cilave, nuk ndërtohet përmes boshtit ideologjik e majtë/ e djathtë, por përmes legjitimitimit politik të secilës parti për veten, dhe delegjitimitimin deri në nihilizëm për tjetrin.

Në ligjërimin politik, e djathta, i referohet: Arritjeve të qeverisë gjatë mandatit 2009-2013 për të legjitimuar premtimet elektorale si elementë të përfshirë në programin e PD-së ku theksohet, përgjysmimi i taksave të biznesit të vogël, ulja 10% e tatim fitimit, e cila si rrjedhojë dyfishoi bizneset, dyfishoi punësimin, subvencionime për fermerët, mbështetje për bujqësinë, rritje të investimeve të huaja, ndërtimin e Shqipërisë turistike,

për një “Shqipëri Europiane” ndërsa e majta përmes “Rilindjes” kërkon të shpëtojë vendin nga kriza, thekson lirinë e konkurrencës, që hap rrugën për investime dhe për punësim, që nxjerr arsimin nga kriza, për një “Shqipëri Europiane” duke iu drejtuar të gjithë atyre, që duhen ‘shpëtuar’ nga qeverisja e Berishës, pa dallim bindjesh politike.

Për të njëjtat arsye si në zgjedhjet e vitit 2009, roli i ndërkombëtarëve mbetet i rëndësishëm për partitë politike, të cilat synojnë të krijojnë mbështetje nga jashtë, mbështetje e cila shërben për të kërkuar miratimin dhe legjitimimin e veprimeve politike të partisë apo të qeverisë, nga opinioni publik. Ligjërimi politik i majtë dhe i djathtë dominohet nga slogane si, “Shqipërinë si gjithë Europa”, “Shqipërinë Europiane”, duke synuar ndikimin e opinionit publik, por që nuk transmeton vlerat themeltare, të diadës e majtë/e djathtë.

“Në programin politik 2005, 2009, 2013, nuk gjenden dallime thelbësore në vizionin politik për shtetin, për sistemin politik, për zgjedhjet, për traditat dhe vlerat, për raportet midis individit dhe shtetit ... Mungesa e dallimeve ka edukuar krijimin e një elektorati identik midis të majtës dhe të djathtës, i cili më shumë se identitetin politik, pëlqen dhe nxitet nga raportet personale me pushtetin politik”(Cituar nga: <http://politike.al/sq/programet-e-pd-nga-1990/>).

Analiza e ligjërimit politik përmes fjalimeve politike, në raport me ideologjinë e majtë/e djathtë, konsiston në një mungesë të dallimeve ideologjike, mbi të cilat duhet të ndërtohet diada e majtë/ e djathtë, prandaj kultura politike e cila përbëhet nga zakonet, besimet, vlerat, ndjenjat të cilat ndërtojnë dhe rregullojnë sistemin politik, përmes dy elementëve kryesore idealeve politike dhe normave që përdoren për të bërë politikë, do marrë tiparet e një kulture politike konfliktuale, sepse në vend të debatit politik përmes diadës e majtë-e djathtë, prodhohet një ligjërim politik (përmes riprezantimit “ne/ata”) i ndërtuar mbi baza morali, ku theksohet antagonizmi politik ‘mik-armik’, që ndërtohet përmes vlerave të moralit, duke përdorur fjalorin e moralitetit.

4. 6. Ligjërimi politik, “ne dhe ata”, 2013

Analiza përmes strategjisë, ‘ne-ata’, përdoret për të kuptuar dallimet ndërmjet dy grupeve kryesore politike që janë në garë për të fituar zgjedhjet. Secili grup prezanton pozitivisht veten përmes legjitimitit të veprimeve dhe roleve dhe delegjitimon grupin tjetër, ‘ata’.

Studimi i ligjëritimit politik, në fushatën elektorale të vitit 2013, është ndërtuar sipas këtij kategorizimi, duke evidentuar dallimet ndërmjet grupeve ‘ne-ata’, sipas aktorëve politikë të PS-së dhe PD-së.

Tabelë ne dhe ata, ligjëritimi politik përmes fjalimeve të aktorëve politikë të PS, 2013

Ne	Ata
Kemi rezistuar përmes pengesash të pafundme, sfidash të panumërta, ballafaqimesh të rënda	Me një kundërshtar primitiv dhe gjakatar, i cili i ka humbur dy dekada Shqipërisë dhe sot i rri vendit mbi kokë, si një kërcënim për t’ia humbur edhe një dekadë të tretë, ndërkohë që ditët e pushtetit të tij janë të numëruara
Ne jemi këtu si e vetmja forcë dhe e vetmja mundësi për ta ndryshuar rrënjësisht këtë imazh, duke iu referuar imazhit të Shqipërisë që nuk arrin të bëjë zgjedhje të lira të ndershme, rrotacion paqësor, imazhi i përkeqësuar i Shqipërisë në katër vitet e fundit	Tetë vjet janë plotësisht të mjaftueshme për të kuptuar se Partia Demokratike, kështu e katandisur në një parti familjare dhe klanore, nuk mund të bëjë asgjë më shumë sesa t’i çojë shqiptarët më teposhtë në rrugën e një rrënimi të vazhdueshëm Partia familjare e Saliut
Ne jemi këtu për ti shërbyer këtij populli dhe për ta bërë këtë me dinjitet	Jemi të gjithë të vetëdijshëm çfarë përfaqëson gulçima e përditshme në tribuna e kryeministrit, çfarë përfaqëson degjenerimi i fjalorit të kryetares të Kuvendit në mes të parlamentit...Nuk janë të gatshëm të përballojnë të shkuarën e tyre...
Një Shqipëri Europiane që bën krenar çdo	Të tatëpjetën e rrënitimit të metejshëm...

shqiptar	Një Shqipëri të izoluar nga bota demokratike, që është sëkëlldi për çdo qytetar
Në këtë grup janë janë zhvilluar dhe konsoliduar profile të reja, krahas profileve të konsoliduara në vite të tëra jetë parlamentare	...Kështu e katandisur në një parti familjare dhe klanore
Të gjithë deputetët e Partisë Socialiste do të jenë kudo nëpër lagje për të bërë këto takime, duke emancipuar më tutje politikën	Një parti e lindur nga ëndrrat dhe shpresat e mëdha të njerëzve në fillim dhe e katandisur sot në një parti familjare
Ne jemi një skuadër dhe që përfshirja apo mospërfshirja jonë në këtë skuadër lidhet me ide të përbashkëta, lidhet me pasionin e përbashkët politik, lidhet me vullnetin për t'i çuar gjërat përpara dhe nuk lidhet me numrin në renditje... Partia Socialiste ka lindur si një parti e transformimit	Kundërshtar primitiv dhe gjakatar
Rilindje	Rrënim
Asnjë njeri i zakonshëm nuk duhet të harrojë për asnjë çast se sot ne socialistët dhe progresistët jemi të gjithë të bashkuar në Aleancën për Shqipërinë Europiane..., me një program për ta rilindur Shqipërinë..., për ta rivendosur demokracinë dhe për ta ribashkuar Shqipërinë me Europën Jam shumë krenar që Korçës i kemi sjellë	Kanakarit të Ramiz Alisë, i cili edhe sot e kësaj dite flet për të djathtën, por nuk ka asgjë të përbashkët me të djathtën... flet për lirinë, por është kundërshtari më i madh i lirisë Saliu nuk ka gjetur asgjë më të mirë për Korçën se sa oficerin e Gërdecit

këtë skuadër	
Sheshet tona mbushen nga lumi i qytetarëve që kërkojnë ndryshimin dhe Rilindjen	Ndërkohë që sheshet e Saliut mbushen nga turmat e robërve që ne duhet ti çlirojmë në 23 qershor
Sot ne socialistët dhe progresistët jemi të gjithë të bashkuar në Aleancën për Shqipërinë Europiane..., me një program për ta rilindur Shqipërinë..., për ta rivendosur demokracinë dhe për ta ribashkuar Shqipërinë me Europën.	Jo në rrugën që ofron Saliu, sepse përpara me Saliun do të thotë mbrapa, larg, thellë drejt rrënimit..., nuk ka mundësi të tretë për një malukat të lodhur
Ne nuk e e hoqëm Enver Hoxhën dhe rregjimin e tij për të mbajtur në kurriz 25 vjet një mikro Enver Hoxha	Bajraktarët lokalë ...bajraktarët e Tiranës, ata që nga kjo pasuri kombëtare përfitojnë pjesën e tyre, përmes lidhjeve me grupe kriminale dhe mafioze që i kanë hyrë kësaj pasurie duke i bërë këtij vendi atë që asnjë pushtues nuk do t'ia bënte kurrë
Një politikë që kërkon të shkëputet për t'u bashkuar me atë botë ku politika është me njerëzit dhe për njerëzit	Një politikë që është e gjitha e përqëndruar te gjakimi për pushtet
Ne nuk kemi shtet	Është koha që Saliu ta heqi antiplumbin, ta shpërndajë edhe atë çetën e 200 rojeve, të shkojë tek fëmijët e fëmijëve dhe ta bëjë gjyshin për këtë pjesë që i ka mbetur, se

	Shqipërisë nuk i duhet një gjysh me antiplumb
Ne nuk jemi këtu për të ndarë, por për të bashkuar, sepse jug e veri është një Shqipëri	Çfarë është ky sharlatan ...Që u thotë njerëzve që Edi Rama nuk e do Kukësin
Botës së rilindur të skuadrës sonë kombëtare, të programit tonë për Rilindjen	Po e bitis si bajraktari i një shtëpie ku partia është bërë familje, familja është bërë shtet dhe shteti është bërë leckë
Pas meje është Skuadra Kombëtare e Rilindjes	Çeta e rrënimit
Unë jam bashkuar me djalin tuaj, një nga protagonistët e lëvizjes së dhjetorit, Parid Carën... Ne të së ardhmes jemi bashkë	Sekretari i Partisë së Punës, Sali Berisha është bashkuar me punistin Kastriot Islami. Ata të së shkuarës janë së bashku

Tabelë ne dhe ata, ligjërimi politik përmes fjalimeve të aktorëve politikë të PD, 2013

Ne	Ata
Ne së bashku, vitet që shkuan, në meritën e përfaqësuesve tuaja në politikë, kemi vendosur disa nga ligjet më të mira që ekzistojnë në mbështetjen tuaj	Alternativa tjetër ka treguar se nuk është shkëputur nga trashëgimia e saj, nga ajo trashëgimi që bëri gjithçka për ta vendosur kombin jashtë hapësirës perëndimore....
Këta burra dhe gra janë deputetët e qytetarit dhe ju garantoj se në axhendën e	Çfarë bën zoti Rama? Sa qeverisi Tiranën trefishoi taksat, tani kalon nga një qytet në

tyre, në përpjekjet e tyre do të kenë para së gjithash e mbi të gjitha, punësimin tuaj, krijimin e vendeve të punës, rritjen e rrogave tuaja	një tjetër si hije e Nastradinit dhe ju thotë shqiptarëve se do të heqë taksat
Qëndrimi ynë, i cili ka në thelb dhe synon liritë tuaja, besim të pakufishëm tek iniciativa juaj e lirë, tek pasuria e saj	Këtë emërtim mund ta bësh vetëm ti për shkak të trashëgimisë sate, etërit tuaj urrenin Rilindjen
Kur të votoni numrin 44 dhe emrin e Sali Berishës në fletën e votimit, ju duhet ta dini se qeveria e tij ka ndërtuar 900 km rrugë	Me bandën e bllokmenëve të rinj në autobusin mavi ke fyer çdo shqiptar
Në filozofinë tonë, ne e kemi respektin e lirive tuaja, sigurinë e lirive tuaja, mbështetjen e lirisë suaj të lëvizjes, përparësinë më të madhe	Si ta zhbëjë me fjalë, gjithçka ne kemi arritur të krijojmë dhe ta fusë vendin në një tunel të errët, pa fund a pa krye. Edi Rama ka ngecur në tunelin e sajësave, në tunelin e shpifjeve dhe gënjeshtrove
Duke parë se je realisht i sëmurë nga rrugët, unë jam mjek dhe e kam të thjeshtë ta kuptoj se të ka zënë dromofobia. Ti në autobus, unë do të shtroj rrugët	Mjerran! I shkretë, i padijshëm nga punët shtetërore. Ke qënë kryetar Bashkie o piktor i dështuar
Lideri i ndryshimit (për Berishën)	Njeri i dështuar (për Ramën)
Ne i themi atij se shqiptarët rilindën në	Ai, njeriu që nuk njeh familjen e vet,

vitin '92 dhe se zgjodhën Europën	sulmon familjet tona
Kjo është arsyeja që Sali Berisha dhe Partia Demokratike kanë një plan real dhe konkret për krijimin e 250.000 vendeve të reja pune gjatë katër viteve të ardhshme	Të gjithë e keni dëgjuar ish- kryetarin që të flasë këto ditë për Tiranën Europiane që na la pas. Ose ai ka një koncept të ndryshëm nga ne për Evropën, ose e ka thënë siç bën rëndom sa për të kaluar radhën
Të një koalicioni dhe një lideri, të Sali Berishës, që po punon fort për ta çuar Shqipërinë përpara	Burri aventurier që ndahet dhe bashkohet me gra sa herë vijnë zgjedhjet për qëllime elektorale

Marrëdhënia ne/ata, ndërtohet përmes identifikimit të grupit tjetër si armiq dhe jo si kundërshtarë politikë, sepse trajtimi i politikave demokratike, ndërmjet kundërshtarëve politikë, zëvendësohet me antagonizmin politik ‘mik-armik’, (të dominuar nga Berisha dhe Rama), që ndërtohet përmes vlerave të moralit, duke përdorur fjalorin e moralitetit.

Delegjitimimi i grupit ‘armik’ përveç strategjive referuese, që lidhen me përzgjedhjen e kategorizimit në raport me grupin identifikues, ndërtohet edhe përmes strategjive pohuese, që sipas Reisigl dhe Wodak, përcaktohen si “procesi i vërtetë kyesor dhe rezultati i vlerësimit gjuhësor i cilësive për njerëzit, kafshët, objektet, ngjarjet, veprimet dhe fenomenet shoqërore“ (2001:54), të cilat mbështeten në zgjedhjen e fjalëve të përdorura në lidhje me pjesëmarrësit apo aktorët shoqërorë. Në ligjërimin politik të majtë kundrejt të djathtëve, grupi ‘ata’, kategorizohet kryesisht përmes këtyre kategorive: *Kundërshtarë, komunisti, gjysh, çeta, kalorës, kryeministër, familja që qeveris, shpellari*. Vlerësimi gjuhësor i cilësive të tyre ndërtohet përmes attributeve, mbiemrave apo figurave retorike si psh, *kundërshtarë primitiv dhe gjakatar, kanakari i Ramiz Alisë, komunisti i fundit, mikro Enver Hoxha, gjysh me antiplumb, çeta e rrënimt, kalorës i dasisë*.

Në ligjërimin politik të djathtë kundrejt të majtëve, grupi ‘ata’, kategorizohet kryesisht përmes këtyre kategorive: *Trashëgimtar, piktor, njeri, shoku, lider, burri*. Vlerësimi gjuhësor i cilësive të tyre ndërtohet përmes attributeve, mbiemrave apo figurave retorike si psh, *trashëgimtari i komunizmit, piktor i dështuar, njeriu i dështuar, shoku mavi, lider antishqiptar, burri aventurier* që ndahet dhe bashkohet me gra sa herë vijnë zgjedhjet, për qëllime elektorale. Nga sa renditëm është e qartë se konkurrenca është në nivele shumë të ulëta dhe dominon *konfliktualja dhe personalizimi*.

Ligjërimi politik dominohet nga liderët përkatës, në raport me drejtimin e partisë për Ramën dhe drejtimin e partisë dhe të qeverisë për Berishën. Ligjërimi politik i vetë liderëve por dhe i aktorëve të tjerë politikë, legjitimon zëvendësimin e PS-së me Ramën dhe të PD-së me Berishën, pasi sipas burimeve të përdorura nga PS-ja dhe PD-ja, ‘Pas Edi Ramës është Skuadra Kombëtare e Rilindjes’ dhe ‘Berisha lideri i ndryshimit’. Personalizimi institucional shfaq ngjashmëri me personalizimin partiak, përmes një ligjërimi ku theksohet personalizimi i qeverisë, nga të dy krahët politikë, por me funksion ndikues të kundërt, pasi e djathta thekson arritjet e qeverisë Berisha, ndërsa e majta dështimet e qeverisë Berisha, me një gjuhë të ashpër politike.

Partitë politike për të paraqitur një “alternativë ndryshe” mbështeten tek strategjia e rrezikut që vjen nga kundërshtari politik, ku për të djathtën, mënyra më e përdorur është përmes së kaluarës historike, duke e atashuar kundërshtarin e sotëm me komunistin e djeshëm, ndërsa për të majtën përdorimi i një ligjërimi, që mund të etiketohet si antiberishizëm.

Nëse ligjërimi politik do mbështetej në kriteret themeltare të diadës e majtë/ e djathtë, si dhe në një kulturë politike më konsensuale, ligjërimi politik gjatë fushatave zgjedhore nuk do të ndërtohej mbi paradigma të tipit: *E shkuar-e ardhme, rilindje-rrënim, skuadra kombëtare e Rilindjes-çeta e rrënimit, komunist-antikomunist, piktor-mjek*.

KAPITULLI V

Analiza e ligjërimit mediatik në zgjedhjet e vitit 2009 dhe 2013

Në kapitujt e mëparshëm u trajtuan nga ana teorike specifika të ligjërimit mediatik si proces në vetvete, duke u bazuar në kontekstin historik, shoqëror, ekonomik dhe politik në të cilën ndodhin ngjarjet. Për të ilustruar nga ana praktike dhe për një analizë më konkrete, do të marrim në shqyrtim shkrimet reale në gazeta e përzgjedhura të shtypit të shkruar gjatë procesit të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2009. Janë analizuar 60 kryeartikuj, 30 në gazetën “Panorama” dhe 30 tek “Gazeta Shqiptare”, duke ndërtuar fillimisht kategoritë tematikore të përfuara përmes tematikave të identifikuara gjatë periudhës së marrë në studim dhe më pas është studiuar narrativa e tekstit. Sipas së njëjtës logjikë është bërë studimi i 339 artikujve tek gazeta “Panorama” për periudhën maj-qershor 2009.

Gjatë procesit të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2013, janë analizuar 90 kryeartikuj, 30 në gazetën “Panorama”, 30 tek “Gazeta Shqiptare”, dhe 30 tek “Shekulli” duke ndërtuar fillimisht kategoritë tematikore të përfuara përmes tematikave të identifikuara gjatë periudhës së marrë në studim dhe më pas është studiuar narrativa e tekstit. Sipas së njëjtës logjikë është bërë studimi i 399 artikujve tek gazeta “Panorama” për periudhën maj-qershor 2009. Studimi i 256 artikujve tek gazeta “Shekulli” në fushatën zgjedhore 2013, ka si objektiv identifikimin e burimeve kryesore të cilët kanë pushtetin për të përcaktuar axhendën mediatike në raport me aktorët e tjerë politikë.

5.1. Ligjërimit mediatik përmes kryeartikujve, “Gazeta Shqiptare”, 2009

Në varësi të tematikave të trajtuara janë përfshirë 25 kryeartikuj nga 30 kryeartikuj në total, ndërsa për pjesën tjetër studimi mbyllet me identifikimin e tematikave të cilat nuk përkojnë me qëllimet dhe objektivat e këtij punimi. Kategoritë tematikore të përfuara nga analiza janë tematikat mbi: procesin zgjedhor, institucionet, incidentet dhe fushatën zgjedhore.

Kryeartikuj, “Gazeta Shqiptare”, 2009

Kryeartikuj që klasifikohen të rëndësishëm për studim të mëtejshëm	Kryeartikuj që klasifikohen jo të rëndësishëm për studim të mëtejshëm
<ul style="list-style-type: none"> • 8 kryeartikuj mbi procesin zgjedhor • 7 kryeartikuj mbi institucionet • 3 kryeartikuj mbi incidentet • 7 kryeartikuj mbi fushatën 	<ul style="list-style-type: none"> • 5 kryeartikuj

Proces zgjedhor

Numrin më të madh të kryeartikujve në të majtë të tabelës, e zë **tematika e procesit zgjedhor**: Procesi i pajisjes së qytetarëve me kartat e identitetit është një proces që shoqërohet me tone konfliktuale ndërmjet qeverisë dhe opozitës. Akuzat nga PS-ja për mashtrim kundrejt të dhënave që bëhen publike nga Ministria e Brendshme të cilat nuk korrespondojnë me njëra-tjetrën, shoqërohen edhe me kushtet që kjo parti vendos për të marrë pjesë në zgjedhje. Shtyrja apo jo e zgjedhjeve për shkak të problemeve, që prodhohen, përmes pajisjes së qytetarëve me kartat e identitetit, është një tematikë e artikuluar në mënyrë të vazhdueshme në ligjërimit politik dhe mediatik, duke përfshirë edhe qëndrimet e ndërkombëtarëve.

Në kryeartikullin e publikuar me 31 maj, narrativa e tekstit i referohet kritikave në raport me punën e qeverisë përse i përket procesit zgjedhor, si dhe qëndrimit të socialistëve, të cilët shprehen për dështimin e qeverisë me procesin e pajisjes së qytetarëve me kartat e identitetit. Së dyti, krahasohet sjellja e BE-së në raport me takimet dhe kontrollin e qeverisë në 2005 (socialistët) dhe 2009 (demokratët), pasi për zgjedhjet e vitit 2005 janë zhvilluar tre takime të përbashkëta dhe janë dërguar në Bruksel raporte për situatën parazgjedhore çdo tre muaj, ndërsa në vitin 2009, është zhvilluar vetëm një takim për Drejtësinë, duke theksuar që raportimi për infrastrukturën zgjedhore nuk është në interes të qeverisë. Qeveria shqiptare atashohet me Berishën, pasi titulli i përzgjedhur nga gazeta është:”Zgjedhjet, BE më pak kontroll Berishës” (Tanushi, D. 31.5.2009 f.1)

Në kryeartikullin e publikuar me 1 qershor, procesi zgjedhor etiketohet problematik përmes dy qëndrimeve të kundërta, ndërmjet “Ministrisë së Brendshme” dhe kërkesave të opozitës. Titulli i përzgjedhur për këtë kryeartikull bën përgjegjës institucionin qeveritar që refuzon të japë informacionin e kërkuar nga PS, duke paraqitur vetëm dy nga 5 listat e kërkuara, të justifikuara përmes ruajtjes së konfidencialitetit: “Ministria e Brendshme refuzon të japë listat për personat me pasaportë. Alarm për zgjedhjet, **qeveria fsheh të dhënat** për kartat Skadon sot ultimatum i PS-së: Rrezikohet procesi” (1.6.2009, f. 2-3). Nëse i referohemi leksikut të përdorur si: **refuzon, fsheh të dhënat, alarm, rrezikohet** është lehtësisht e kuptueshme që përgjegjësia bie mbi qeverinë në raport me ecurinë e procesit zgjedhor.

Historia mbështetet në kërkesën dhe denocimin e PS-së, në raport me çfarë fshehu dhe çfarë informacionesh dha Ministria, duke përdorur si burim parësor Kastriot Islamin, sekretar për çështjet zgjedhore të PS-së: Pyetjes së ngritur, pse qeveria fsheh emrat e votuesve me pasaportë, i jepet përgjigje përmes hipotezave të PS-së që konsistojnë në akuzat drejtuar qeverisë për pajisjen me pasaporta të personave të dyshimtë, që mund të influencojnë negativisht në rezultatin zgjedhor, “që në këmbim të ‘shpërblimeve’ të dyshimta, mund të ndihmojnë atë që të sigurojë mandatin e dytë qeverisë” (Po aty), prandaj historia e përdorur në narrativën e tekstit i referohet mungesës së transparencës nga qeveria, mungesë e cila mund të përlligjë hipotezat e PS-së.

Në kryeartikullin e datës 4 qershor, si burim parësor përdoret raporti i “Monitorimit të Lëvizjes Europiane” në Shqipëri, financuar nga “Ambasada e Shteteve të Bashkuara”, në Tiranë. Procesit zgjedhor i cili shoqërohet me akuza politike ndërmjet të majtës dhe të djathtës, përlligjet në këtë artikull në favor të së majtës. Denoncimi në mënyrë të vazhdueshme nga e majta për parregullsi të procesit, legjitimohet përmes përfundimeve të përfutuara, që marrin më tepër vlerë kur SHBA përdoret si burim: “Projekti i sponsorizuar nga SHBA: Të gjithë qytetarët të kenë të drejtën e votës Po paguhet bakshish SHBA: **Zgjedhjet në rrezik**” (Blushi, T. 4.6.2009, f. 2).

Narrativa zhvillohet përmes propozimit: Që aktorët politikë duhet të gjejnë një zgjidhje për qytetarët në mënyrë që të mos i mohohet e drejta e votës, identifikimin e

problemeve që shoqërojnë procesin, si dhe zhvillimin e një infrastrukturë lehtësuese për personat e moshuar apo të tjerë. Denoncimi i bakshisheve është një tjetër e dhënë, e përftuar përmes intervistave të kryera: “Një e dhënë tronditëse që serviret për herë të parë është se nga intervistat e kryera, qytetarët dëshmojnë se ka persona të cilët paguajnë nën dorë një shumë prej 200 lekësh për t’u favorizuar edhe për pasojë rradha nuk respektohet” (Po aty). Funksioni i ligjërimit mediatik në këtë artikull, mund të pohojmë që është kumtues, pasi: Jep informacion, të dhëna dhe fakte të mbledhura përmes këtij projekti, por edhe synon të ndikojë mbi opinionin publik në raport me zgjedhjet, mbi parregullsitë që shoqërojnë procesin zgjedhor.

Në po të njëjtën linjë në raport me ecurinë e procesit zgjedhor është edhe kryeartikulli i datës 5 qershor. Denoncimi mbi gënjeshtat e qeverisë lidhet me numrin e letërnjoftime elektronike të prodhuara, që nuk përputhet me të dhënat që ka paraqitur ajo më përpara, si dhe me qëndrimin e PS-së që mbron tezën e shtyrjes së zgjedhjeve: “Kartat, **qeveria gënjen** BE. PS: Të shtyhen zgjedhjet” (Blushi, T. 5.6.2009, f. 1).

Në ligjërimit gazetaresk, ideologjia shërben për të përzgjedhur leksikon në bazë të dëshirës për një riprezantim pozitiv apo negativ të grupeve: Leksiku i përdorur në ligjërimit në këtë kryeartikull referuar fjalëve ‘gënjen dhe mashtrimi i rradhës për qeverinë’, përzgjidhet me qëllim, pasi synon të ndikojë mbi lexuesin duke përdorur një ton goditës mbi qeverinë.

Edhe kryeartikulli i datës 6 qershor, që në krye të rradhës trajton zgjedhjet, të cilat etiketohen si zgjedhje kaotike. Përmes kërkesës nga SHBA dhe KiE kërkohet ndërhyrja e qeverisë: “Zgjedhjet në **kaos** SHBA dhe KiE: Qeveria të garantojë kartat, bllokohet KQZ” (Blushi, T. 6.6.2009, f.1). Gjatë narrativës së tekstit, pasqyrohet qëndrimi i SHBA, ku theksohet se askush nuk duhet të pengohet për të votuar si dhe KQZ duhet të informohet nga qeveria për problemet e evidentuara, denoncimi i PS-së për Partinë Agrare Ambientaliste, e cila nuk ka respektuar kuotat e 30% të përfaqësimit të grave në disa qytete dhe si rrjedhojë ka penguar KQZ-në, pasi mban peng prodhimin e 3145748 fletëve të votimit, reagimi i kreut të KQZ-së, i cili bën përgjegjës “Kolegjin Zgjedhor”, për vonesën e prodhimit të fletëve të votimit. Në paragrafin e parë të këtij kryeartikulli ligjërimit mediatik ndërtohet përmes përdorimit të qeverisë amerikane si burim, për të theksuar problematikën kryesore, që shoqëron procesin zgjedhor, pamundësinë për të

votuar për një kategori zgjedhësish të cilët nuk janë të pajisur me mjetet e duhura identifikuese:”Në prag të zgjedhjeve parlamentare, qeveria amerikane përmes trupit diplomatik të akredituar në Tiranë **jep alarmin** se një kategori e konsiderueshme zgjedhësish rrezikojnë të mos votojnë” (Po aty, f.3).

Në kryeartikullin e datës 20 qershor, trajtohet përfshirja e kandidatëve për deputetë të cilët kanë një të kaluar problematike: “9 ditë para zgjedhjeve, lista e kandidatëve e pakontrolluar, **deputetë spiunë në lista Meksi: Janë në krye të PD**. Topalli: Është Ndoka” (20.6.2009, f.1), është titulli i përzgjedhur për këtë kryeartikull. Sikurse kemi cituar më herët, sipas Rugovës “funksioni tematik i titullit është paraqitja e temës dhe e përmbledhjes së elementit kryesor të shkrimit ose më mirë të thuhet, i asaj që dërguesi e konsideron prioritet gjatë të kumtuarit” (2009:136), prandaj në këtë rast elementi kryesor është ndasia ndërmjet krerëve të së djathtës, të cilët kanë bërë akuza kundrejt njëri-tjetrit, për kandidim të bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit. Në funksion të kësaj metode, ku elementët kryesorë të lajmit gjenden në fillim të tekstit, vetëkuptohet rëndësia e titullit dhe kokës, pasi përzgjedhja që bëhet për titullin dhe kokën ka efekte ideologjike, përsa i takon perceptimeve të publikut në lidhje me ngjarjen.

Artikulli zhvillohet përmes një narrative, që përfshin prononcimin e Jozefina Topallit e cila thotë, që “Presidenti i Republikës nuk e firmosi asnjëherë atë ligj. Unë po punoj në Komisionin e Venecias për ta bërë të mundur” (Po aty, f 6), deklaratën e Nard Ndokës “Shpifjet e Topallit do t’i çojmë në Prokurori” (Po aty), si dhe qëndrimin e Aleksandër Meksit, me funksionin kryetar i partisë “Poli i Lirisë”, i cili ia atribuon kandidaturat problematike partive kryesore, ndryshe nga sa paraqitet në titull, ku kandidaturat problematike i adresohen vetëm PD-së.

Në kryeartikullin e publikuar me 22 qershor, trajtohet lista e kandidatëve për deputetë që nuk përmbushin kriteret e duhura, sipas “Koalicionit për Parlament të Pastër”, e drejtuar nga ish- presidenti Alfred Moisiu. “Koalicioni për Parlament të Pastër”, ka publikuar një listë ku përfshihen kandidatë për deputetë, të cilët janë klasifikuar si të papërshtatshëm për të qenë në Kuvend: “Ish- presidenti Moisiu publikon 21 emrat’ e papërshtatshëm” për Kuvendin” (Çollaku, A. 22.6. 2009, f.2).

Institucionet

Tematika që trajton insitucionet dhe punën e tyre në kryeartikullin e datës 29 maj, i referohet raportit të organizatës botërore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, “Amnesty International”. Një ndër ngjarjet e shumëdiskutuara është tragjedia e Gërdecit, e cila u shoqërua me humbje jete dhe që u bë pjesë e ligjërimit politik përmes akuzave dhe kundërakuzave nga dy krahët politikë.

“Raporti, Gërdeci një korrupsion shtetëror. Konstatimi: Vërehen përpjekje për të mos gjykuar drejt dosjen e Gërdecit dhe për të mos ndëshkuar personat përgjegjës, Tregti e paligjshme armësh. Në hetim edhe ata që vlerësuan dëmet nga shpërthimi” (Blushi, T. 29.5.2009, f. 1).

Historia e këtij artikulli prezantohet përmes ngjarjes së Gërdecit, e cila pasqyron përfshirjen e qeverisë në afëra korruptive, përmes dimensionit social dhe ekonomik në studimin e dhunës në familje që ka ardhur duke u rritur, si dhe në nivelin e papunësisë i cili vazhdon të mbetet e lartë.

Kryeartikulli i datës 2 qershor, mbështetet në vendimin e KQZ-së për të çrregjistruar PPSH nga fleta e votimit, pasi ka bërë shkelje ligjore duke fallsifikuar firmat: “Zgjedhjet, KQZ nuk rregjistron komunistët Del fallsifikimi i pare. Fillimisht Arben Ristani kërkon të zyrtarizojë PPSH në zgjedhje, por tërhiqet nga presioni i PS” (2.6.2009, f.1). Historia ndërtohet përmes denoncimit të PS për këtë çështje, reagimit të Ristanit i cili thekson që nuk është detyrë e këtij institucioni verifikimi nëse dokumenti është i fallsifikuar apo jo, qëndrimin të sekretarit për çështjet ligjore të PS-së Fatmir Xhafaj, i cili akuzon KQZ-në, duke e etiketuar si një përpjekje e së djathtës për të dëmtuar të majtën. ”Por fill pas këtij qëndrimi, KQZ-ja u detyrua të mblidhej sërish e të vendoste me shumicë votash përjashtimin e PPSH-së nga zgjedhjet për Kuvendin e ri” (po aty, f. 5), vendim i cili ka ardhur jo nga gatishmëria e KQZ-së si institucion për të marrë masa, por nga qëndrimi i mbajtur nga aktorë të PS-së.

Kryeartikulli zhvillohet edhe përmes këkesës së KQZ-së, drejtuar ministrit Nishani për informacion, në lidhje me kartat e identitetit, si dhe evidentohet përsëri gënjeshtria e qeverisë në raportin për BE-në:” Raporti, **qeveria gënjeu për numrin e kartave** Ministria vazhdon të fshehë të dhënat” (Tanushi, D. 2.6.2009, f.3), përdoret edhe deklarata e Nishanit për të mbështetur informacionin kontradiktor të përgjigjes dhënë po nga ai.

Kryeartikulli i datës 7 qershor përmes gjuhës mediatike të përdorur, synon ndikimin e publikut, përmes përdorimit të një toni që nuk është në favor të qeverisë, por përkundrazi ‘e godet’ atë. Titulli i përzgjedhur synon efektet ideologjike, përsa i takon perceptimeve të publikut: “Çfarë ka ndodhur në qeverisjen e djathtë gjatë 4 viteve? **Skandalet e Berishës ngriu Ngjelën, shk..... për Ballën, seks për Pangon. Përgjimet shkatërrojnë qeverinë, korrupsioni deri në nivele ministrore**” (7.6.2009, f.1).

Narrativa e përdorur në këtë artikull përmes historisë, reflekton punën që bën gazeta, në raport me: Qeverisjen duke theksuar përfshirjen e familjes kryeministore në afëra korruptive, skandale të dhunës verbale të kryeministrit, skandale seksuale, presione të hapura, marrëdhënie institucionale të shkatërruara, të cilat nuk janë bërë publike në spotet e qeverisë.

Nëse në shumicën e artikujve përdoren forma të ndryshme të citimit, përmes të cilave përftohen ide mbi pasojat e ngjarjes që zakonisht vijnë përmes opinionëve të aktorëve kryesorë që shërbejnë si burime, në këtë rast gazetari nuk ka ndjekur këtë strategji, pasi listohen një sërë problematikash që nga prishja e shitjes së kontratës Altelecom, sharjet me fjalorin e papërshtatshëm të kryeministrit në Kuvend, ngjarja e Gërdecit, skandali seksual i ministrit si dhe marrëveshja sekrete me Greqinë për vijën bregdetare.

Nëse i referohemi tematikave dhe mënyrës se si ato zhvillohen, kjo analizë në pasqyrimin e problematikave në këtë mandat të qeverisë është e mire, pasi bën një përmbledhje të atyre gjërave që kanë ndodhur gjatë 4 vjetëve, jo thjesht duke iu referuar një deklaratë, intervistë, apo vendimi por duke bërë një punë hulumtuese mbi punën e qeverisë. Nga ana tjetër kufizimet e kësaj analize mund të jenë disa, sepse nuk janë studiuar premtimet elektorale të vitit 2005 dhe se sa janë realizuar, duke përfshirë edhe ekspertë të fushës përkatëse si ekonomistë, juristë etj, për të vlerësuar nëse janë realizuar premtimet apo jo, gjë që reflektohet në përjashtimin e çdo arritjeje qeveritare, ashtu si dhe në dimensionin etik, ku evidentohen thyerje etike në raport me leksikun e përzgjedhur në ligjërimin mediatik.

Në kryeartikullin e datës 11 qershor, gazeta përmes një pune hulumtuese denoncon qeverinë për presionin që i ka bërë firmës ndërtuese, për të përfunduar rrugën Durrës-

Kukës para datës 30 qershor, edhe pse kjo gjë shoqërohet me rrezikun e shembjes së tunelit. Titulli i përzgjedhur: “Përfundon para 30 qershorit tit Rruga Durrës-Kukës Firma: Përrurimi para zgjedhjeve rrezikon shembjen e tunelit” (Blushi, T. 11.6.2009, f.1).

Duke përdorur si burim parësor Bernard Falconnat i kompanisë “Egis” (firmës franceze që është marrë me dizenjimin teknik të tunelit), korrespondencën e tij me kompaninë zbatuese E&M e boton në mënyrë ekskluzive Gazeta Shqiptare, ku theksohet se parashikohen shkatërime të paparashikueshme.

“Gazeta Shqiptare” në tematikën që trajton institucionet, sjell informacione përmes një gazetarie hulumtuese mbi veprimet dhe vendimet e qeverisë, pasi kryeartikulli i datës 15 qershor, i referohet vendimit të qeverisë për shpenzimin e 10 milionë eurove për karburantin e përdorur gjatë fushatës: “Fushata, qeveria blen 10 mln euro karburante APP-ja tenderon 1 miliardë e 240 milionë të reja pa tvsh, për furnizimin e mjeteve të qeverisë me naftë dhe benzinë” (Blushi, T. 15.6.2009, f.1).

Ngjarja që kthehet në lajm vjen përmes dokumentacionit të tenderit që ka arritur të sigurojë gazeta duke denoncuar që: **“Qeveria shpenzon taksat e shtetit shqiptar në mënyrën më abuzive të mundshme”** (Po aty). Hipoteza kryesore e ngritur përmes ligjërimit mediatik është që kjo sasi shume e madhe do përdoret edhe nga militantët e PD-së.

Raporti i publikuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit për vitin 2009 ku vlerësohet Shqipëria dhe puna e bërë nga qeveria është përzgjedhur si artikulli kryesor në datën 17 qershor: **“SHBA: Shqipëria, venburim prostitucioni dhe lypjeje Trafiku, qeveria nuk përmbushi standardet, s’ka hetime për zyrtarët që mbështesin trafikun”** (17.6.2009, f.1).

Në kryeartikullin e datës 18 qershor, trajtohet debati mes anëtarëve të PS dhe PD në KQZ, përmes një historie ku paraqitet kërkesa e përfaqësuesve të PS, si dhe prononcimet e përfaqësuesve të PD-së dhe kreut të KQZ-së, Ristanit. **“PS në alarm: PD përdor kandidatë qeveritarë”** (Blushi, T.18.6.2009, f.1).

Titulli i përzgjedhur për kryeartikullin e datës 27 qershor konsiston në përzgjedhjen e një historie narrative, që e fokuson ngjarjen në një këndvështrim të veçantë, përmes pafuqisë së institucioneve, që donimohen nga Berisha në raport me përcaktimin e vendit ku do mbahet mitingu i PS-së. “Mitingu i PS, **Sali Berisha ndalon Ramën me policë**” (27.6.2009, f.1), është një titull që e paraqet ngjarjen si një përplasje mes Berishës dhe Ramës, duke sfumuar rolin e institucioneve dhe partive të cilat zëvendësohen me liderët përkatës, përmes personalizimit institucional dhe partiak.

Incidente

Tematika e incidenteve trajtohet në tre kryeartikuj, në të cilët kornizimi mediatik i përdorur favorizon të majtën. Kryeartikulli i datës 3 qershor i referohet djegies së zyrës elektorale të PS-së në Durrës si dhe rrahjes së kryetarit të PS-së: “Incidentet e para; Prishen posterat e Ramës në Durrës, Në Shijak digjet zyra elektorale e PS. Rrihet kryetari i PS. Kryeplaku i PD e masakron për parullën e shkruar në mur” (3.6.2009, f.1). Titulli me përmbajtjen e artikullit ndryshojnë në raport me perceptimin e incidentit, pasi në titull është rënduar ngjarja në raport me atë që shkruhet në përmbajtje. Riprezantimi që i bëhet ngjarjes së dytë mbështetet në kategorizimin partiak, përmes një gjuhe sensacionale si: Kryeplaku i PD e **masakron** për parullën e shkruar në mur; Dhunohet barbarisht kryetari i PS-së së një fshati në Korçë; Më pas janë përdorur edhe mjete rrethanore për të lënë shenjë tek trupat e dy të majtëve...e cila ka **përgjakur dy socialistët**. Përdorimi i strategjive referuese është përdorur me qëllim sepse strategjitë referuese jo vetëm projektojnë kuptimin dhe vlerat shoqërore mbi referencën, por gjithashtu vendosin marrëdhënie koherence me mënyrën se si aktorët e tjerë përfaqësohen.

Incidenti i ndodhur në datën 13 qershor, trajtohet përmes kategorizimit partiak, por edhe përmes vlerësimit që i bëhet nga burimet e përdorura nga gazeta:

“Vritet militant i PD. **Sherr banal** në Qerret të Durrësit, humb jetën 32-vjeçari Artan Zeka, baba i tre fëmijëve, vritet militanti i PD. Vrasësi: Nuk grisa flamur, u rraha pa shkak në sy të gruas” (Korriku, A. 13. 6. 2009, f. 2-3).

Përveç versioneve të policisë, përdoren edhe intervista nga e shoqja dhe e ëma e vrasësit ku theksohet se në të vërtetë autori i ngjarjes ishte pa parti: “Skënderin po ma rrihnin, ai është pa parti” (Xhaja, G. 13.6.2009, f.3).

Vrasja e kreut demokristian të Shkodrës trajtohet në kryeartikullin e datës 19 qershor, përmes përzgjedhjes së një titulli të tillë: “10 ditë para zgjedhjeve mina me telekomandë i merr jetën në Shkodër Aleks Kekës, baba i tre fëmijëve.Vritet kreu demokristian Ndoka: Ekzekutim politik, **Topalli është monstër**” (Shllaku, B. 19.6.2009, f.1). Konfliktet politike mes aktorëve politikë bëhen pjesë e ligjërimit mediatik, duke u përzgjedhur në këtë rast, si titull kryesor nga gazeta, për të ndikuar në opinionin publik.

Fushatë

Tematika e dytë më e rëndësishme e trajtuar në kryeartikuj në aspektin sasior, është fushata zgjedhore. Kryeartikujt trajtojnë fushatën zgjedhore duke iu referuar fillimisht përplasjes verbale të dy liderëve kryesorë Berishës dhe Ramës:

*“Acarohen tonet e fushatës, kryeministri akuza nga Librazhdi, Kreu i PS përgjigjet nga veriu. Zgjedhjet, **Berisha fyen Ramën**: Ke mbledhur zhul. Përgjigjet kryesocialisti nga Shkodra: Ai është enveristi i djeshëm dhe demokratikasi i sotëm” (Draçini, R. 10.6.2009 f.1).*

Raportimi i opinionit të fjalimeve dhe të burimeve, mund të bëhet në forma të ndryshme, ku një ndër to është citimi i drejtëpërdrejtë, i cili mbështetet në përdorimin e fjalëve të cituara nga burimet në të njëjtën mënyrë pa ndryshime, por duke përdorur thonjëzat. Roli i gazetarit në këtë rast mbështetet tek fjalia treguese që përdor në funksion të këtij citimi dhe konkretisht tek fjalia “Berisha fyen Ramën”, duke influencuar mënyrën se si lexuesi do ta interpretojë.

Kryeartikulli i datës 12 qershor, i referohet qëndrimit të dy liderëve për të tërhequr kandidatët për deputetë i cili ka si shkak mosdakordësinë për emrat e të ftuarve në studio televizive, ndërsa kryeartikulli i datës 24 qershor i referohet mitingjeve të fundit të partive politike, duke përcjellë informacione mbi kohën kur do të organizohen, si dhe për grupet dhe këngëtarët që i shoqërojnë partitë.

Në raport me burimet e përdorura në kryeartikujt që trajtojnë tematikën e fushatës zgjedhore, vihet re një disbalancë ndërmjet dy forcave kryesore politike. Në një total

prej 7 kryeartikujsh vërehet një dominim i së majtës pasi në tre kryeartikuj si burim parësor përdoret Rama, në dy kryeartikuj përdoren emra të njohur të PS-së si Servet Pëllumbi dhe Dritëro Agolli.

Rama përdoret si burim parësor kur i kthen përgjigje Berishës duke e etiketuar si “Enverist të djeshëm” (Draçini, R. 10.6.2009 f.1), si dhe në kryeartikullin e datës 14 qershor, i cili ndërtohet përmes një narrative që i referohet promovimit të librit të Ramës ku trajtohen letrat nga USA kur Gregu ishte i sëmurë, korrespondenca me mbesën e tij etj, për të ndikuar në opinionin publik përmes emocioneve. Kryeartikulli i datës 23 qershor i referohet ligjërimit politik të Ramës përmes intervistës dhënë për News 24: “Çdo bëj unë kryeministër? Flet Edi Rama: Do marr 71 deputete, do bëj **ndryshimin historik**” (23.6.2009, f.1. marrë nga intervista dhënë për emisionin “5 pyetjet nga Babaramo”).

Në dy kryeartikuj në të cilët përdoren si burime emra të njohur të PS-së, si Servet Pëllumbi, Fatmir Xhafaj dhe Dritëro Agolli, trajtohen refuzimi i të majtëve kundrejt ftesës së LSI-së për bashkëpunim me PS-në, e cila vlerësohet “e vonuar” nga Pëllumbi, bllokimi i mitingut të PS-së si dhe intervista e Agollit: “Agolli: Rama Kryeministër. Bllokohet Mitingu i PS: Konfrontohet me PD” (26.6. 2009, f.1). Nëse studiohet ligjërimit i burimeve njëri është në favor të Ramës kryeministër ndërsa tjetri në disfavor të Berishës: “Policia ndërhyr me urdhër politik; Urdhëri politik vjen nga Berisha” (Poaty, f.3), edhe në rastet kur Rama nuk përdoret si burim parësor, janë burimet e tjera që i sigurojnë një mbulim mediatik favorizues, ndryshe nga ç’ndodh me Berishën.

Në një sintezë përmbledhëse theksojmë që, “Gazeta Shqiptare” jo thjesht transmeton përmes raporteve deklaratave, intervistave, vendimeve por edhe prodhon informacion, duke përdorur gazetari hulumtuese, si për shembull kryeartikujt e datës 7, 11 dhe 15 qershor. Ligjërimit mediatik referuar kornizimit mediatik si “ideja qëndrore organizuese për përmbajtjen e lajmeve, e cila e vendos atë në një kontekst dhe i jep asaj qenësi duke përdorur përzgjedhjen, theksimin, përjashtimin dhe përpunimin” (Griffin&al, 2015:375), na ndihmon të kuptojmë që media jo vetëm ka në dorë të përzgjedhë mbi çfarë do të shkruajë, por edhe mënyrën që do të përzgjedhë për të specifikuar karakteristikat kryesore, në mënyrë të atillë që çështja të përkufizohet në mënyrën që do gazeta, duke shfaqur anshmëri politike pro forcës së majtë, PS-së. Narrativa e studiuar

përmes historisë favorizon këtë parti politike dhe liderin e saj Edi Ramën, pasi historia lidhet me mënyrën se si prezantohet fabula, duke mos iu përmbajtur karakteristikave të fabulës përse i përket rendit kronologjik, si dhe “duke i siguruar agjentëve shoqërorë të ngjarjes aktuale, tipare të dallueshme të cilat i transformojnë ato në karaktere dhe duke e fokusuar ngjarjen në një këndvështrim të veçantë” (Fairclough, 2003: 83).

Si burime parësore dominojnë emra të njohur të PS-së, duke filluar që nga lideri i saj si dhe figura të tjera politike që i japin zë problemeve që shoqërojnë procesin zgjedhor, veprimtarinë e institucioneve ku nuk mungojnë akuzat për autoritarizëm dhe personalizim të tyre, apo dhe në rastin e incidenteve ndërsa kur përdoren si burime parësore emra të së djathtës, synohet të evidentohet konflikti ndërmjet tyre, gjë që vërehet dhe tek tematikat që trajtojnë fushatën, duke përdorur të njëjtën strategji. Në të shumtën e herëve burimet dytësore që vijnë nga e djathta nuk influencojnë në tonin që i jepet artitujve, pasi gazeta synon që toni të përputhet me natyrën e temës mbi të cilën shkruan, si dhe me qëndrimin që ka për të, me qëllim ndikimin ose dhënien e mesazhit lexuesit të tyre.

Në ligjërimin gazetaresk ku gazetarët janë të pajisur me mundësitë për të përzgjedhur leksikun, një faktor i rëndësishëm është ideologjia. Ideologjia shërben për të përzgjedhur leksikun në bazë të dëshirës për një riprezantim të grupeve, në mënyrë pozitive apo negative. Kjo na lejon të themi që leksiku nuk është neutral, pasi ai vjen përmes procesit të përzgjedhjes, që realizohet nga gazetari, si rezultat i ideologjisë. Leksiku i përdorur kundrejt PD-së dhe liderit të saj, konsiston në një riprezantim negativ të këtij grupi.

5.2. Ligjërimi mediatik përmes kryeartikujve, gazeta “Panorama”, 2009

Në varësi të tematikave të trajtuara janë përfshirë 16 kryeartikuj nga 30 kryeartikuj në total, ndërsa për pjesën tjetër studimi mbyllet me identifikimin e tematikave të cilat nuk përkojnë me qëllimet dhe objektivat e këtij punimi. Kategoritë tematikore të përfuara nga analiza janë tematikat mbi: Procesin zgjedhor, institucionet, sondazhet, incidentet dhe fushatën zgjedhore.

Kryeartikujt tek “Panorama”, 2009

Kryeartikuj që klasifikohen të rëndësishëm për studim të mëtejshëm	Kryeartikuj që klasifikohen jo të rëndësishëm për studim të mëtejshëm
<ul style="list-style-type: none"> • 6 kryeartikuj mbi procesin zgjedhor • 2 kryeartikuj mbi institucionet • 2 kryeartikuj mbi sondazhet • 1 kryeartikull, incident me pasojë vdekjen e një personi • 5 kryeartikuj mbi fushatën nga ku: 2 kryeartikuj mbi sjelljen politike dhe strategjitë politike të aktorëve politikë; 1 intervistë e A. Meksit; 1 kryeartikull, festë e PS për 18 vjetorin e krijimit të saj • 1 kryeartikull mbi inaugurimin e rrugës Durrës-Kukës 	<ul style="list-style-type: none"> • 5 kryeartikuj që përfshihen tek kronika e zezë dhe tek aktualiteti • 2 kryeartikuj, intervista mbi vrasjen e F. Xhindit • 6 kryeartikuj me tematikë ekonomike nga ku: 4 kryeartikuj mbi legalizimet • 2 kryeartikuj mbi pagat dhe pensionet • 1 kryeartikull mbi vendimin e BE-së për heqjen e vizave në rajon

Sikurse shihet edhe përmes tabelës numrin më të madh të kryeartikujve në të majtë të tabelës, e zë **tematika e procesit zgjedhor**: Procesi i pajisjes së qytetarëve me kartat e identitetit është një proces që shoqërohet me tone konfliktuale ndërmjet qeverisë dhe opozitës. Akuzat nga PS-ja për mashtrim kundrejt të dhënave që bëhen publike nga “Ministria e Brendshme”, shoqërohen edhe me kushtet që kjo parti vendos për të marrë pjesë në zgjedhje. Shtyrja apo jo e zgjedhjeve, për shkak të problemeve që prodhohen përmes pajisjes së qytetarëve me kartat e identitetit, është një tematikë e artikuluar në mënyrë të vazhdueshme në ligjërimin politik dhe mediatik, duke përfshirë edhe qëndrimet e ndërkombëtarëve.

Në kryeartikullin e datës 30 maj, përmes intervistës për gazetën kreu i KQZ-së, z. Ristani, ka shpjeguar përgatitjet për zgjedhjet e 28 qershorit, skemën e transmetimit direkt me kamera të numërimit të votave, miratimin e fletës së re të votimit në datën e

zgjedhjeve si dhe qëndrimin e tij në raport me përfaqësuesen e OSBE-së znj. Glover: “Konflikti me Glover jashtë KQZ, negociova sepse çënohej besimi tek zgjedhjet” (Hoti, B. 30.5.2009, f.1), prononcimi i kreut të KQZ-së dhe shpjegimi i arsyes vjen si rrjedhojë e akuzave të vazhdueshme nga opozita për përfshirje politike të institucioneve shqiptare, që favorizojnë të djathtën.

Në kryeartikullin e datës 1 qershor debati mes dy partive kryesore konkretizohet me kërkesën e sekretarit të PS-së z. Islami, i cili në letrën drejtuar “Ministrit të Brendshme”, kërkon plotësimin e tre kushteve në mënyrë që opozita të përfshihet në zgjedhje, PS kërkon listën e votuesve me pasaportë, listën e aplikuesve për karta identiteti si dhe të atyre që i kanë marrë letërnjoftimet elektronike. Nëse Islami shërben si burim parësor, Nishani shërben si burim dytësor përmes informacionit zyrtar që përcjell: “Kanë aplikuar 1.149.211 votues dhe ata pa pasaportë do marrin karta deri në 15 qershor” (Hoti, B. 1.6.2009, f.4). Për vetë kontekstin politik problematik, tek misioni ndërkombëtar i OSBE-ODIHR bëhet depozitimi i përplasjeve ndërmjet PS-së dhe qeverisë.

Kryeartikulli i datës 5 qershor, jep një tablo të qartë të situatës konfliktuale ndërmjet dy partive kryesore dhe kontekstit politik problematik, në të cilin zhvillohen zgjedhjet e vitit 2009. Problemet me listat e zgjedhësve, pajisja me kartat e identitetit, kërkesat e PS-së dhe 3 kallëzime penale në prokurori janë pikat kyçe të këtij artikulli, në të cilin shërbejnë si burime Fatmir Xhafaj me funksionin e sekretarit ligjor të PS-së dhe Berisha përmes botimit të një interviste dhënë për emisionin “Opinion”, ku thekson se “zgjedhjet s’ shtyhen, Rama nuk pranon të garojë” (5.6.2009 Fq.4). Në po këtë artikull publikohet dhe programi PD-së që mbështetet në premtimin për lëvizjen e lirë, pa viza, në punësim, në përmirsimin e infrastrukturës dhe energjisë, në rritjen e pagave dhe pensioneve, në investimet dhe ngritjen e pensioneve në fshat si dhe shëndetësinë e arsimit si prioritetet kryesore të kësaj force politike.

Kryeartikulli i datës 6 qershor, trajton qëndrimin e ambasadorit të SHBA-së i cili përmes një konference për shtyp, evidenton faktin që ka akoma probleme me pajisjen me kartat e identitetit, por që vendimi nëse zgjedhjet duhen shtyrë apo jo, duhet të merret nga vetë forcat politike. Titujt e përzgjedhur për këtë kryeartikull: “Kartat,

Withers: Shtyrja e zgjedhjeve në dorë të partive; Me rëndësi kritike që qytetarët pa karta dhe pasaporta të votojnë (6.6.2009, f.2).

Në datën 15 qershor, gazeta për zgjedh si kryeartikull denoncimin e bërë publik nga një qytetare përmes një letre drejtuar Berishës ku shkruhet se “në hipotekën e Tiranës më kërkuan 10 mijë euro” (Mahmutaj, F. 15.6.2009, f.11). Si burim parësor është përdorur qytetarja Antonela Hoxhallari e cila akuzon për ryshfet dy punonjëse të hipotekës së Tiranës.

Në datën 23 qershor, gazeta për zgjedh si artikullin më të rëndësishëm të saj padinë ligjore të kandidatit të PS-së Asllan Dogjani, për përfshirjen e tij në listën e deputetëve të padenjë të publikuar nga “Koalicioni për Parlament të Pastër”, nën drejtimin e ish presidentit Moisiu: “Dogjani kërkoj 5 milionë lekë dëmshpërblim” (Shkëmbi, A. 23.6.2009, f. 2).

Institucionet

Dy kryeartikuj trajtojnë vendimet e marra nga KQZ, një ndër **institucionet** më të rëndësishme për mbarëvajtjen dhe zhvillimin optimal të procesit zgjedhor: Kryeartikulli i datës 2 qershor mbështetet në vendimin e KQZ-së për të çrregjistruar PPSH nga fleta e votimit, pasi ka bërë shkelje ligjore duke fallsifikuar firmat. Përmes këtij kryeartikulli bëhet publike që marrëdhënia mes PS-së dhe PPSH-së e cila mbështetet nga familjarë të Enver Hoxhës, është konfliktuale, sepse PS denoncon ngjarjen ndërsa kreu i PPSH shprehet: “Do bëjmë fushatë kundër Edi Ramës, ai ka ide fashiste” (Hoti, B. 2.6.2009, f.1). Nëse për këtë vendim bihet në dakordësi ndërmjet anëtarëve të KQZ-së, debatet për numrin e numëruesve të votave ndërmjet përfaqësuesve të PS dhe PD, marrin nota akuzuese në mënyrë të ndërsjellë. Kreu i KQZ-së përdoret si burim parësor duke akuzuar palën tjetër se synon të mos marrë pjesë në numërimin e votave dhe bllokimin e zgjedhjeve. Narrativa e përdorur mbështetet në prononcimin e anëtarëve të KQZ-së si Genc Gjoncaj, Dëshira Subashi dhe Klement Zguri përmes publikimit të qëndrimeve të tyre dhe argumenteve të përdorura nga secili. Kryeartikulli datës 27 qershor, mbështetet në vendimin e KQZ-së për mënyrën që do përdoret për ndarjen e mandateve të deputetëve, midis koalicioneve kundërshtarë dhe midis partive brenda të njëjtit koalicion.

Sondazhe

Sondazhet, kërkimi eksperimental si dhe sjellja në votim janë metoda për të matur efektet e komunikimit politik edhe pse nuk janë të përsosura, pasi secila prej tyre ka kufizimet përkatëse, për këtë studim interes paraqet metoda e parë. Sondazhet në rastin më të mirë që do të thotë që janë përgatitur në mënyrë serioze nga institucione të specializuara, duke respektuar rregullat e përfaqësimit dhe kritere të caktuara për formulimin e pyetjeve, përsëri kanë marzhin e gabimit.

Një element i rëndësishëm kur studiohet kjo metodë është roli i saj nga matës i opinionit publik, në një faktor që bëhet pjesë e mjedisit politik, pasi mund të ndikojë sjelljen e elektoratit, në veçanti elektoratit të lëkundur, përmes rezultateve të përfuara. Ky target grup është më i pavendosur në zgjedhjen individuale, prandaj ka më tepër mundësi të ndikohet nga rezultatet e sondazheve, që publikohen nga media, por të dhënat e sondazheve nuk influencojnë vetëm këtë target, pasi ato mund të influencojnë edhe vetë partitë politike, për të llogaritur lëvizjet e duhura politike në funksion të përmbushjes së objektivave të vendosura.

Dy kryeartikuj i rezervohen sondazheve, përkatësisht në datat 8 dhe 17 qershor: Në kryeartikullin e datës 8 qershor, publikohet rezultati i sondazhit i bërë nga dy shoqata me financimin e USAID-it dhe britanikëve që nxjerr fituese PD-në, me një diferencë prej 9 pikësh pasi”për nivel kombëtar 43% e të anketuarve pohojnë se do të votojnë për PD dhe 34% për PS” (Hoti, B.8.6.2009, f.4). Në lidhje me rezultatin jepet edhe qëndrimi i Spiropalit si përfaqësuese e PS-së, duke shërbyer si burim dytësor, e cila ngre akuza mbi përfshirjen e shoqatave shqiptare në favor të PD-së: “Njerëzit duhet ta mësojnë se sondazhi i sotëm është realizuar nga dy OJQ shqiptare drejtëpërdrejtë të lidhura me pushtetin e Sali Berishës” (Po aty). Megjithë ekuilibrin e përdorur nga gazeta, në funksion të publikimit edhe të deklaratës së përfaqësueses së PS-së, titulli që tërheq vëmendjen e publikut është në favor të PD-së: “Sondazhi për majin, PD 9 pikë para PS” (Po aty, f.1).

Me 17 qershor rezultatet e sondazhit italian tregojnë që PD fiton si parti por e majta krijon qeverinë duke përfshirë LSI-në si faktor kyç në krijimin e qeverisë së re: “PD parti e parë por e majta krijon qeverinë” (Shkëmbi, A. 17.6.2009, f.6).

Incidente

Me 19 qershor, vrasjes së kreut lokal të Malësisë së Madhe të Partisë Demokristiane, i jepen ngjyra politike, sepse akuzat drejtohen drejt kryetares së kuvendit Jozefina Topalli, nga kreu demokristian Nard Ndoka, i cili akuzon rivalen e vet politike për përdorimin e një fjalori që ka shërbyer si zanafillë për ngjarjen, ndërsa kjo e fundit shprehet se do të ketë “hetim të plotë dhe të paanshëm” (Dervishi, F. & Dibra, R. 19.6.2009, f.1). Përveç historisë që zhvillohet përmes përshkrimit të ngjarjes, gazeta ka realizuar edhe një intervistë me babain e viktimës i cili shprehet se: “Meqë ngjarja ndodhi tani, në mes të fushatës, mendojmë se mund të ketë lidhje me politikën” (f.3). Në raste të tilla, forcat politike përdorin strategji që këto ngjarje t’i përdorin për të drejtuar akuza kundër partisë në qeveri, duke përfshirë edhe institucionet, ashtu sikurse ndodh edhe me këtë ngjarje, pasi PS ngre akuza ndaj policisë.

Fushata zgjedhore

Gjatë periudhës së marrë në studim në gazetë, botohen 5 kryeartikuj mbi fushatën nga ku: 2 kryeartikuj mbi sjelljen politike dhe strategjitë politike të aktorëve politikë; 1 intervistë e A. Meksit; 1 kryeartikull mbi festën e PS për 18 vjetorin e krijimit të saj dhe 1 kryeartikull mbi inaugurimin e rrugës Durrës-Kukës. Nga këto kryeartikuj gazeta zhvillon një narrativë që mbështetet në dallimet dhe përplasjet brenda së njëjtës forcë politike, si në rastin kur publikon intervistën e Aleksandër Meksit dhënë për ‘Top Story’ ku theksohet se koalicioni me PD-në mund të bëhet ”pa Berishën kryeministër” (7.6.2009, f. 6), apo kur publikon kryeartikullin mbi festën e 18 vjetorit të krijimit të PS-së, ku theksohet mungesa e themeluesve të kësaj partie: “Festa e PS, mungojnë themeluesit, Nano, Meidani, Pëllumbi e Agolli nuk ishin të pranishëm” (13.6.2009 f 5 Aristir Lumezi). Ftesa që kreu i LSI-së i drejton të gjithë liderëve aktuale apo të mëparshëm që kanë kontribuar në spektrin e majtë klasifikohet si artikulli më i rëndësishëm i datës 21 qershor, “Meta: Të largojmë së bashku Berishën. Fton në tryezë Ramën, Nanon, Meidanin, Pëllumbin, Gjinushin e Milon” (Hoti, B. 21.6.2009, f.3).

Kryeartikulli i publikuar me 20 qershor, trajton një tematikë shumë të rëndësishme për fushatën zgjedhore dhe mënyrën se si zhvillohet ajo në kontekstin shqiptar, pasi pas negociatave të vazhdueshme nga Dhoma Amerikane e Tregtisë, për të realizuar një

debat mbi ekonominë ndërmjet Ramës dhe Berishës, përsëri ishte e pamundur, sepse dy liderët fillimisht pranuan dhe më pas u tërhoqën, duke vazhduar traditën e mospërballjes së një kryeministri me kandidatët për kryeministër, gjatë fushatave zgjedhore. “... Ky refuzim nënvizon faktin se dy liderët e dy partive të mëdha politike nuk janë gati të takohen dhe të ulen në të njëjtën tryezë në publik, si dhe të flasin me vetëbesim për planet e tyre të ardhshme për Shqipërinë” (Shkëmbi, A. 20.6.2009, f.4).

Qeveritë shqiptare shpesh kanë përshpejtuar ritmet e punës, për të përfutur një inaugurim i cili merr ngjyresa politike përmes përdorimit të flamujve, sloganeve apo simboleve të partive politike, gjë që vërehet dhe në këtë kryeartikull: Kryeartikulli i datës 26 qershor, i referohet ceremonisë së mbajtur, për përfundimin e punimeve në njërin krah të rrugës Durrës- Kukës, nga kryeministri Berisha dhe homologu i tij Erdogan: “Por gjatë fjalimit kryeministri Berisha shfrytëzoi pjesëmarrjen e qytetarëve, ku nuk mungonin **as flamujt e PD-së**, të rendiste disa nga arritjet e qeverisë në katër vjet” (Shkëmbi, A. 26.6.2009, f. 6). Në kontekstin politik shqiptar, investimet e ndërmarra nga qeveritë gjatë mandateve qeverisëse, janë përdorur në mënyrë të vazhdueshme gjatë fushatave zgjedhore, në favor të partive politike përkatëse për të synuar një mandat qeveritar pasardhës, prandaj gazeta ka përzgjedhur që përmes kornizimit mediatic, ta theksojë këtë element.

Në një sintezë përmbledhëse mund të konkludojmë, që në gazetën “Panorama” gjatë periudhës së marrë në studim dominon një ligjërim që vjen më tepër nga: intervistat, deklaratat, vendimet, denoncimet sesa nga një gazetari hulumtues. Në ligjërimin mediatic të kësaj gazete, mungojnë kryeartikuj analizues në raport me punën e qeverisë, vendimet politike të saj gjatë mandatit qeverisës, apo studime se sa qeveria ka mbajtur premtimet e dhëna në fushatën paraardhëse, gjatë ushtrimit të mandatit të saj.

Informacioni që lidhet me sfondin, përta i përket ngjarjes, mund të kuptohet përmes përdorimit të kontekstit si dhe historisë. Një pikë e rëndësishme në këtë trajtim është përdorimi i një lloji të “veçantë pasojash”, i cili lidhet me opinionet e aktorëve kryesorë të lajmeve. Kjo mund të përdoret nga gazetarët si një strategji, për të mos marrë pjesë përmes komenteve për të dhënë vlerësime subjektive, mbi ngjarjen për të cilën shkruhet, gjë që është e dukshme gjatë analizës së kryeartikujve.

Ligjërimi mediatik në studimin e kryeartikujve për periudhën e marrë në studim ruan një ekuilibër ndërmjet përdorimit të burimeve, ku si burime parësore dhe dytësore shërbejnë aktorë politikë nga të dy krahët, nga spektri i djathtë dhe i majtë.

5.3. Ligjërimi mediatik përmes kryeartikujve, gazeta “Panorama”, 2013

Në varësi të tematikave të trajtuara janë përfshirë 13 kryeartikuj nga 30 kryeartikuj në total, ndërsa për pjesën tjetër studimi mbyllet me identifikimin e tematikave të cilat nuk përkojnë me qëllimet dhe objektivat e këtij punimi. Kategoritë tematikore të përfutuara nga analiza janë tematikat mbi: procesin zgjedhor, incidentet, fushatën zgjedhore dhe 2 kryeartikuj mbi investigimin e të ardhurave të Ramës.

Kryeartikujt, “Panorama” 2013

Kryeartikuj që klasifikohen të rëndësishëm për studim të mëtejshëm	Kryeartikuj që klasifikohen jo të rëndësishëm për studim të mëtejshëm
<ul style="list-style-type: none"> • 2 kryeartikuj mbi procesin zgjedhor • 2 kryeartikuj mbi incidentet • 7 kryeartikuj mbi fushatën • 2 kryeartikuj mbi investigimin e të ardhurave të Ramës 	<ul style="list-style-type: none"> • 17 kryeartikuj

Incidente

Gazeta “Panorama” përzgjedh për kryeartikull ngjarjen kundrejt drejtuesit të PD-së në Kukës, i cili ka mbetur i plagosur:”...Atentat me 30 **plumba drejtuesit të PD** në Kukës. I plagosuri, vëllai i drejtorit të SHKB në Ministrinë e Brendshme. Kthehej në shtëpi pas fushatës, merr 4 plumba në trup” (24. 5. 2013, f. 7). Historia përmes narrativës së tekstit, paraqitet përmes kategorizimit partiak si dhe hetimit i cili vijon. Nëse përdorim metodën krahasuese, në kryeartikullin e datës 24 maj, gazeta “Shekulli”, i referohet ngjarjes që ka shkaktuar dëme materiale në shtëpinë dhe biznesin e kryetarit të PS-së në Prezë, Lavdi Kajmaku. Përmes intervistës së dhënë për gazetën, viktima akuzon se kjo ngjarje ka prapavijë politike.

Kryeartikulli i datës 3 qershor, trajton ngjarjen kundrejt kryetarit të PD-së në Vlorë si dhe kandidat për deputet në zgjedhjet e vitit 2013: “Shtëpia e Kollozit Shpërthimi në pallat u filmua nga kamerat” (Biraku, Q. 3.6. 2013, f.11). Historia përshkruhet përmes informacioneve mbi dëmet materiale si rrjedhojë e eksplozivit, prononcimit të Kollozit për të cilin ngjarja ka prapavijë politike. I ashpër është dhe reagimi i nënkryetarit të PD-së Astrit Patozi i cili shprehet: “Ju bëjmë thirrje kryetarëve tanë politikë të heqin dorë nga përdorimi i **falangave të krimit ndaj Partisë Demokratike**, pasi do të marrin përgjigjen e merituar” (Po aty). Përveç deklaratave të Kollozit dhe Patozit, jepet dhe qëndrimi i PS-së “PS dhe kandidatët e saj distancohen prerë dhe e konsiderojnë këtë veprim një akt vandal dhe të papranueshëm...” (Po aty). Gazeta përdor si burime dy aktorët politikë të djathtë, por për të balancuar dhe ekuilibruar artikullin jepet dhe deklarata e PS-së.

Proces zgjedhor

Në kryeartikullin e datës 25 qershor në gazetën “Panorama”, trajtohet tematika e procesit zgjedhor në funksion të problematikës të përfshirjes së drejtorëve të institucioneve në fushatë, sipas akuzave të bëra nga lideri i së majtës, Rama. Përmes intervistës dhënë për gazetën, i jepet hapësirë drejtoreshës së akuzuar të shprehë qëndrimin e saj: “Flet drejtoresha: Biseda në telefon, si më kërcënoi Edi Rama” Intervista/ Rrëfimi i drejtoreshës së “Ismail Qemalit” për telefonatën me kreun e PS. Zbardhen dy sms-të në celularë”(25. 5. 2013, f. 2). Në këtë artikull si burim parësor përdoret drejtoresha e shkollës Ismail Qemali, pas mesazheve që Rama i ka dërguar, të cilat ajo i etiketon, kërcënuese.

Në kryeartikullin e datës 30 maj, si burim parësor përdoret Jonathan Moore, drejtor për Europën Jugore dhe Qëndrore në Departamentin e Shtetit të SHBA-së kundrejt pyetjeve nga gazetarë shqiptarë si Nano, Çili, Shkullaku, Minxoz, Ilva Tare, Mero Baze, etj. “Kontestimi i zgjedhjeve me dhunë, përplasje me SHBA Zbardhet biseda e mbyllur e Moore me gazetarët: Qeveria dhe opozita larg kompromisit për KQZ, Kolegji Zgjedhor do të luajë rolin e tij” (30.5.2013, f. 6-7-8). Ndërkombëtarët janë burime me vlerë në ligjërimin mediatik, për vetë kontekstin politik shqiptar.

Fushata zgjedhore

Kategoria tematike që dominon në ligjërimin mediatik për periudhën maj-qershor 2013, në gazetën “Panorama”, është fushata zgjedhore: Intervista e Metës, Ngjelës, e Ramës, e Majkos, e Berishës, festa e PS-së si dhe 146 mitingjet dhe takimet e Berishës dhe Ramës, përzgjidhen si tematikat më të rëndësishme, në ligjërimin mediatik, të kësaj kategorie.

Kryeartikulli i datës 29 maj, i referohet intervistës së kreut të LSI-së, Ilir Metës dhënë në emisionin “5 pyetje nga Babaramo” në A1 Report. “Meta: S’ka pakt për Ramën Kryeministër Ish- Kryeministri: Nuk bëhet fjalë për qeverinë e këtij apo atij, por për një qeveri të të gjithëve” (29.5.2013, f. 3). Intervista dominohet nga pyetje që në fokus kanë, kush do të jetë kryeministër, a është rënë dakord për këtë gjë, pasi në ligjërimin politik të pasqyruar dhe në ligjërimin mediatik ka pasur reagime të ndryshme, nga aktorë politikë të PS-së dhe LSI-së për këtë tematikë. Në përgjigjet që jep, Meta thekson që e rëndësishme është një qeveri gjithëpërfshirëse dhe jo kush do të jetë kryeministri në koalicionin PS-LSI. Një tematikë e tillë, e cila klasifikohet si gazetari procesi, është trajtuar në mënyrë të vazhdueshme në ligjërimin mediatik, duke marrë shkas nga deklarata dhe kundërdeklarata të aktorëve politikë, të përfshirë në këto forca politike.

Kryeartikulli i datës 4 qershor, trajton marrëveshjen politike mes PS-së dhe Spartak Ngjelës, i cili kërkon të jetë Ministër Drejtësie, në qeverinë e ardhshme. “Pakti me Ramën. Ngjela, në qeverinë e PS si Ministër Drejtësie. Kreu i PS: Për kontributet në opozitë”(4.6.2013, f.1).

Historia prezantohet përmes kërkesës që rrjedh nga marrëveshja politike mes Ngjelës dhe PS-së, qëndrimit të Ramës i cili pohon kërkesën e Ngjelës përmes argumentimit që lidhet me qëndrimin opozitar të Ngjelës, kundrejt qeverisë së djathtë. Kundërshtitë që vijnë përmes ligjërimin politik të mediatizuar nga Arben Malaj (kandidat për deputet, i pavarur) i cili shprehet se “qeveritë me miq, të dështuara” (po aty, f.2) dhe Petro Koçi: Ai është ekstrem i djathtë (po aty, f.3) bëhen pjesë e ligjërimin mediatik për të ndikuar mbi opinionin publik. Burimet e përdorura shërbejnë që opinionin publik të informohet rreth marrëveshjeve politike, të cilat konsistojnë në ndarjen e pushtetit.

Kryeartikulli datës 9 qershor, i referohet betejës politike për fitoren e zgjedhjeve, duke përpiluar një bilanc mbi takimet elektorale të dy liderëve kryesorë, Berishës dhe Ramës, qarqet të cilat klasifikohen “të nxehta”, pasi janë të rëndësishme për përcaktimin e fitores së zgjedhjeve

Në kryeartikullin e datës 12 qershor, trajtohet si tematikë mungesa e organizimit të festës të PS-së në 22 vjetorin e krijimit të saj. “Shtyhet ditëlindja, Nano: ‘Festa’ e fundit e Ramës në PS” (12.6.2013, f.1). Duke iu referuar edhe njëherë rëndësisë së titullit të një lajmi, të shpjeguar në kapitullin teorik, është legjitime të shprehemi që titulli i përzgjedhur në këtë kryeartikull synon të ndikojë mbi opinionin publik, përmes ligjërimit të ish-kryetarit të PS-së, Fatos Nanos, i cili përdoret si burim. Në një analizë krahasuese mes gazetave për të njëjtën ngjarje, ndryshe nga “Panorama”, për të njëjtën ngjarje “Gazeta Shqiptare” përzgjedh një burim tjetër, Servet Pëllumbin, i cili i uron socialistëve, fitore.

Kryeartikujt e datës 18 dhe 19 qershor, kanë si burime kryesore Ramën dhe Majkon të cilët përmes ligjërimit politik trajtojnë problematika të ndryshme. Problematikë me interes është politizimi i administratës, e artikuluar nga Majko: “Majko: Administrata do ndryshohet, është politike...Do të doja ta shihja Malajn në Kuvend” (19.6.2013, f.5). Titulli i përzgjedhur nga gazeta, përsa i përket Malaj, nuk ka vetëm funksion informues por edhe ndikues, pasi Malaj është një ish-deputet i PS-së, që në zgjedhjet e vitit 2013, kandidon si kandidat i pavarur. Në takimet elektorale të PS-së në rrethin ku kandidon Malaj, është kërkuar haptazi nga lideri i PS-së Rama, që asnjë votë nuk duhet të shkojë për të, gjë e cila u reflektua në zhvillimin e replikave të ndërsjella.

Tre ditë para datës së zgjedhjeve, burimi kryesor në kryeartikullin e datës 20 qershor është Berisha. ”Berisha: S’e përjashtoj qeverisjen me LSI-në Kryeministri flet për rezultatin: Koalicioni ynë do fitojë. Rama s’do t’i njohë zgjedhjet, do tërheqë komisionerët e Fierit” (20.6.2013, f.5). Përzgjedhja burimore si dhe theksimi i elementëve që sigurojnë elektoratin e djathtë për fitore, synojnë të ndikojnë mbi opinionin publik.

Gazetari investiguese mbi të ardhurat e Ramës

Kryeartikujt e datës 7 dhe 10 qershor, i referohen investigimit mbi mosdeklarimin e të ardhurave të Ramës, pasi qytetarët që realizojnë të ardhura bruto mbi 2 milionë lekë në vit, duhet të dorëzojnë në organet tatimore, deklaratën vjetore të të ardhurave individuale. Ky investigim përshkallëzohet, pasi në kryeartikullin e datës 10 qershor, theksohet se të ardhurat e deklaruar nga Rama, nga shitja e librit "Kurban", nuk përkojnë me paratë që ka marrë nga shtëpia botuese. "Zbardhen deklaratat vjetore, S'paguhen 498 mijë lekë tatim në burim. Të ardhurat, Edi Rama nuk justifikon 4.9 milionë lekë" (Maho, N. 10.6.2013, f.6). Burime parësore janë burimet konfidenciale nga zyra e "Tatim Taksave", ndërsa si burim dytësor përdoret deklarata e Endri Fugës, që mbulon drejtorinë e Komunikimit për PS-në. Deklarata dhënë për gazetën e cila botohet e plotë, konsiston në sqarimin e situatës duke zhveshur Ramën nga çdo përgjegjësi dhe duke akuzuar organet tatimore si të politizuara, që sulmojnë liderin e opozitës, gjatë fushatës zgjedhore. "Për aq kohë sa këto institucione kanë arritur deri aty sa të zhdukin deklaratat tatimore të liderit të opozitës, prej tyre nuk mund të presësh asnjë lloj sjelljeje profesionale"(Po aty). Burimi i tretë i përdorur është Laura Vorpsi, zëdhënëse e PD-së e cila përmes një konference për shtyp, ironizon Ramën: "...Ia ka hedhur fajin postës që nuk ka dorëzuar në destinacion, por ka fshehur për qëllime politike, deklaratën e tij të të ardhurave. Kjo është sajesa e rradhës nga salloni mavi i Ramës" (Po aty).

Investigimi dhe botimi i këtyre kryeartikujve kryhet përmes rregullave dhe parimeve profesionale, të cilat ndërthuren me parimet etike, pasi në Kodin e Etikës përcaktohet që "Gazetarët kanë të drejtë të marrin informacion, ta botojnë atë dhe ta kritikojnë. Informacioni duhet të jetë i saktë, i balancuar dhe i verifikuar"(Kodi i Etikës, 2006:4), kritere të cilat ezaurohen plotësisht në këtë rast, në ligjërimin mediatik.

Në një sintezë përmbledhëse mund të konkludojmë: Në gazetën "Panorama" gjatë periudhës së marrë në studim dominon një ligjërim që vjen më tepër nga intervistat, deklaratat, vendimet, por edhe përmes një gazetarie hulumtuese dhe investiguese. Ligjërimi mediatik gjatë zhvillimit të fushatës zgjedhore 2013, shfaq ngjashmëri me ligjërimin mediatik të periudhës maj-qershor 2009, pasi sërish mungojnë kryeartikuj

analizues në raport me punën e qeverisë, apo studimin se sa qeveria ka mbajtur premtimet e dhëna në fushatën paraardhëse, gjatë ushtrimit të mandatit të saj.

Opinionet e aktorëve kryesorë të lajmeve përdoren nga gazetarët si një strategji, për të mos marrë pjesë përmes komenteve për të dhënë vlerësime subjektive mbi ngjarjen për të cilën shkruhet, gjë që është e dukshme gjatë analizës së kryeartikujve.

Ligjërimi mediatik në studimin e kryeartikujve për periudhën e marrë në studim ruan një ekuilibër ndërmjet përdorimit të burimeve, ku si burime parësore dhe dytësore shërbejnë aktorë politikë nga të dy krahët, nga spektri i djathtë dhe i majtë, pavarësisht tonit të përdorur i cili favorizon partinë qeverisëse në pushtet, duke synuar të ndikojë mbi mendimet, qëndrimet dhe vlerësimet e lexuesve.

5.4. Ligjërimi mediatik përmes kryeartikujve, gazeta “Shekulli”, 2013

Në varësi të tematikave të trajtuara janë përfshirë 26 kryeartikuj nga 30 kryeartikuj në total, ndërsa për pjesën tjetër studimi mbyllet me identifikimin e tematikave të cilat nuk përkojnë me qëllimet dhe objektivat e këtij punimi. Kategoritë tematikore të përfuara nga analiza janë tematikat mbi: Procesin zgjedhor, institucionet, incidentet, fushatën zgjedhore, sondazhet dhe 5 kryeartikuj mbi profilin e aktorëve politikë.

Kryeartikuj, Shekulli 2013

Kryeartikuj që klasifikohen të rëndësishëm për studim të mëtejshëm	Kryeartikuj që klasifikohen jo të rëndësishëm për studim të mëtejshëm
<ul style="list-style-type: none"> • 9 kryeartikuj mbi procesin zgjedhor • 2 kryeartikuj mbi institucionet • 2 kryeartikuj, incidente me pasojë vdekjen e një personi • 4 kryeartikuj mbi fushatën • 4 kryeartikuj mbi sondazhet • 5 kryeartikuj mbi profilin e aktorëve politikë 	<ul style="list-style-type: none"> • 4 kryeartikuj

Procesi zgjedhor

Në kryeartikullin e datës 31 maj, në gazetën “Shekulli”, tematikë kryesore është procesi zgjedhor i cili po shoqërohet me blerjen e votave. “Blerja e votave. Zbardhen e-maillet e PD-së për administratën. Berisha e përgëzon publikisht drejtoren Ermira Mustafaj”(Tanushi, L. 31. 5. 2013, f.1). Elementët që janë përzgjedhur për të treguar ngjarjen janë identifikimi dhe denoncimi për drejtuesit e institucioneve, të cilët detyrojnë vartësit të marrin pjesë në mitingje dhe të mbledhin vota. Paraqitet denoncimi i Saimir Tahirit, referuar një dokumenti që i drejtohet 29 punonjësve nga drejtoresha e institucionit, i cili pasqyrohet në artikull.

Kryeartikulli i datës 1 qershor, karakterizohet nga një ton goditës për qeverinë dhe të djathtën shqiptare, përmes një ligjërimit që bën thirrje për një pjesëmarrje masive në zgjedhje, në mënyrë që të mos kenë mundësi për manipulim rezultati zgjedhor. “Apeli i fortë i ish-ambasadorit Withers: Dilni dhe votoni në numër të madh, që çdo lloj përpjekje për manipulim të dështojë. Shqiptarë stop diktaturës në 23 qershor” (1.6.2013, f.1).

Ish-ambasadori amerikan Withers, përmes intervistës së tij shërben si burim parësor për kryeartikullin. Deklata e tij mbi zgjedhjet që rrezikojnë të çënohen, demokracinë e shkatërruar, institucione të cilat karakterizohen nga abuzimi me pushtetin apo institucione të politizuara si “Ministria e Brendshme”, bën përgjegjëse qeverinë shqiptare, përmes një ligjërimit ndikues, pasi gazeta synon të ndikojë mbi opinionin publik, në raport me qeverinë shqiptare.

Përdorimi i pajisjeve përgjuese si softueri “Fin Fisher” i zbuluar në Maqedoni, ngre pikëpyetje në kryeartikullin e datës 2 qershor, nëse procesi zgjedhor shoqërohet me përgjime: “Shqipëria ka 9 shërbime survejimi, kur vendet e zhvilluara kanë katër. Akuzat për përgjime nga opozita, dëshmia e një mjeku dhe ‘ligjërimit’ i survejimit me kamera. Na përgjon telefonët dhe kompjuterët?” (Rrozhani, A. 2. 6. 2013, f.1).

Burim parësor përmes një reagimi për Shekullin është Arjan Dyrmishi, studiues në “Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim”, që e studion situatën në dy rrafshet, etik dhe tregtar pasi lidhet me të drejtat e patentave. Burime dytësore janë Majko i cili ka kundërshtuar miratimin e ligjit që lejon përgjimin, si dhe ish-kryetari i SHISH-it Fatos

Klosi, i cili në një deklaratë të mëparshme, shprehej: ”**Ata** gjithmonë kanë parapëlqyer një **shtet policor**, që di gjithçka për ‘**armiqtë**’”. Vlerësimi i pasojave në këtë rast nuk kërkon ndërhyrjen e komenteve të gazetarit pasi kjo realizohet përmes citimit të burimit, që kategorizon grupin tjetër “ata” në mënyrë negative. Nëse i referohemi kontekstit historik-politik të para viteve 90, partia komuniste shfaqte të njëjtat karakteristika, prandaj atashimi i njërës me tjetrën është evident në këtë rast.

Në kryeartikullin e datës 4 qershor, në gazetën “Shekulli”, trajtohet tematika e procesit zgjedhor, duke u fokusuar tek numri i fletëve të prodhuara në raport me numrin e votuesve, e cila klasifikohet si proces skandaloz. “Skandali, më pak fletë se votues. PS depoziton në KQZ kërkesën për prodhimin e fletëve shtesë” (Tanushi, L. 4. 6. 2013, f.1). Në artikull trajtohet padia nga PS e depozituar në KQZ, duke iu referuar pretendimeve të saj për 2000 fletë më pak. Si burim parësor përdoret PS-ja, ndërsa si burim dytësor kryetarja e KQZ-së, Lefterije Lleshi, e cila përgjigjet, se do të bëhen verifikimet e duhura në raport me informacionet e përcjella nga PS.

Përfshirja politike e drejtuesve të institucioneve me pasoja mbi punonjësit, që nuk ndajnë të njëjtat bindje politike, trajtohet në kryeartikullin e datës 6 qershor. “Më flakën nga puna se nuk shkova në mitingun e PD-së; Pas 35 vitesh punë, edukatorja pushohet se është me PS-në” (6.6.2013, f.1). Si burim parësor përdoret edukatorja e çerdhes nr.10, Diana Corraj, e cila akuzon drejtoreshën si militante të PD-së.

Kryeartikulli i datës 8 qershor, në gazetën “Shekulli”, i rezervohet konstatimeve të raportit të hartuar nga misioni vëzhgues i OSBE/ODIHR, për periudhën nga 15 maji deri në 3 qershor. Për këtë tematikë, gazeta ndërton një ligjërime të tillë: “Situata parazgjedhore në Shqipëri. Akuza për qeverinë. Rrugët e reja dhe projektet u shoqëruan nga flamujt e PD-së. ODIHR: KQZ me 4 anëtarë, e paligjshme” (Tanushi, L. 8. 6. 2013, f. 1). Elementët që theksohen në ligjërimit mediatic janë: Funksionimi i KQZ-së me 4 anëtarë, që shpie në pamundësi për të marrë vendime që kërkojnë 5 vota, vendimet e Kolegjit Zgjedhor që tejkalojnë kompetencat e tij, shfrytëzimi i administratës shtetërore dhe i fondeve publike nga mazhoranca, gjatë zhvillimit të fushatës.

Në kryeartikullin e datës 9 qershor, në gazetën “Shekulli”, trajtohet tematika e procesit zgjedhor, përmes fokusimit tek verifikimi elektronik i kartave. “Dështon verifikimi

elektronik i kartave, denoncojnë përfaqësuesit e PS-së. Skandal në KQZ, votohet dy herë” (9. 6. 2013, f. 4-5). Në këtë artikull ashtu si edhe në shumë të tjerë, elementi që theksohet është qëndrimi i socialistëve, i shprehur përmes denoncimeve që bëjnë, për parregullsitë dhe problematikat që shoqërojnë procesin zgjedhor.

Procesi zgjedhor shoqërohet me akuza të PS-së, kundrejt KQZ-së, akuza të cilat materializohen kundrejt kryetares së KQZ-së, pas dështimit të kontratës për numërimin dhe verifikimin elektronik të kartave. Burimet e përdorura nga dy forcat politike, ndajnë qëndrime të ndryshme pasi për përfaqësuesit e PD-së “nuk duhet të aplikohet verifikimi elektronik i kartave pasi ky proces shoqërohet me probleme”(Tanushi, L. 19.6.2009, f.7) ndërsa për përfaqësuesin e PS-së në KQZ, Genci Gjoncaj, “procesi është sabotuar qëllimisht nga KQZ dhe ky institucion ka përgjegjësi për mbarëvajtjen e procesit”(Poaty).

Kryeartikulli i datës 21 qershor, në gazetën “Shekulli”, trajton tematikën e përfshirjes së administratës në fushatë, nga PD-ja. Emrat e punonjësve që kundërshtojnë përfshirjen janë të skeduar në lista. “Listat e zeza të PD. Skedohen punonjësit e administratës që nuk duan të përfshihen në fushatë. Nga pastrueset, policët, ushtarakët, mësuesit deri tek zyrtarët e lartë” (Rrozhani, A. 21.6.2013, f. 4-5). Bëhen publikë emrat e punonjësve, të cilët refuzojnë apo abstenojnë në një grup seksioni.

Institucionet

Kryeartikulli i datës 29 maj, në gazetën “Shekulli”, trajton funksionin e KQZ-së në vendimarrje për të përcaktuar përqindjen e parave për fushatë për subjektet politike, rolin e kuvendit, i cili akoma nuk ka miratuar shpërndarjen dhe mungesën e fondeve nga qeveria, për ta kryer këtë proces. Theksohet reagimi i PS-së “PD s’ka nevojë për lekë, po përdor administratën” (Tanushi, L. 29. 5. 2013, f. 1).

Kryeartikulli i datës 12 qershor, në gazetën “Shekulli”, trajton përfshirjen e institucioneve në fushatë. Flamur Noka i cili njëkohësisht është drejtues i Ministrisë së Brendshme dhe kandidat i PD-së, akuzohet nga kryebashkiaku i Kukësit, për shkelje të ligjit. “Ministri i Brendshëm, kandidat për deputet **alarmon Ambasadën Amerikane**. Kryebashkiaku i Kukësit, Halili, informon ambasadorin për presionet e Nokës” (Kovaçaj, N. 12. 6. 2013, f. 4-5).

Incidente

Kryeartikulli i datës 24 maj, në gazetën “Shekulli”, i referohet ngjarjes që ka shkaktuar dëme materiale në shtëpinë dhe biznesin e kryetarit të PS-së në Prezë, Lavdi Kajmaku. Përmes intervistës së dhënë për gazetën, viktima akuzon se kjo ngjarje ka prapavijë politike. Në artikull trajtohet dhe vonesa e zjarrfikësve, të cilët kanë mbërritur një orë e gjysmë pas ngjarjes. Koka e lajmit e përdorur për këtë ngjarje:”Digjen me benzinë shtëpia dhe biznesi i kryetarit të PS-së...Djegia ka prapavijë politike...Shkatërrohet plotësisht shtëpia dhe ambientet e firmës së luleve, 200 milionë lekë dëme” (Tanushi, L. 24. 5. 2013, f. 4).

Kryeartikulli i datës 3 qershor në gazetën “Shekulli”, trajton tematikën e incidentit të ndodhur por të mohuar nga policia e shtetit shqiptar.”Qëlloi me gurë mbi kryeministrin në Burrel, Petrit Hoxha kërkon ndjesë publike në gjyq, pas 48 orëve në qeli. **“Atentatori” i Berishës: Votoj PD-në**” (Kovaçaj, N. 3. 6. 2013, f. 1). Në artikull jepen informacione për incidentin, rolin e policisë në fshehjen e informacioneve, të cilët i qëndruan këtij versioni edhe kur iu kërkuar prononcim për ngjarjen, nga gazeta. Jepet edhe pendesa e autorit demokrat, i cili kërkon falje publike, për veprimin e bërë nën efektin e alkoolit.

Fushatë

Kryeartikulli i datës 7 qershor, në gazetën “Shekulli”, mbështetet në intervistën e kryetarit të LSI-së, Ilir Meta. Gazeta përdor këtë titull “Kreu i LSI siguron elektoratin e majtë për vazhdimin e aleancës parazgjedhore me PS. Meta me Ramën edhe pas zgjedhjeve” (7.6.2013, f. 1). Përmes ligjërimit mediatic të përdorur gazeta i drejtohet publikut, i cili merr mesazhin që e siguron për vazhdimësinë e koalicionit Rama-Meta. Duke ditur që publiku nuk është homogjen, por heterogjen përse i përket ideve dhe bindjeve politike, ky ligjërim vlerësohet sidomos nga elektorati i majtë.

Kryeartikulli i datës 10 qershor, hapet me një titull të tillë: “Berisha terrorizon Sarandën nën Mitingu në qytetin bregdetar, qeveria sjell 1000 vetë nga Vlora dhe Gjirokastra”(Shehu, P. 10.6.2009, f. 4-5).

Historia e përdorur gjatë narrativës i referohet masave të jashtëzakonshme për kontroll, terrorizimit të qytetarëve të ilustruar me foto nga qeni anti-eksploziv, sjelljen e 50 motoristëve nga Tirana për propagandë dhe presion, autobusët me rreth 1000 persona që të mos dështonte mitingu, përfshirjen e administratës në miting përmes një urdhërese të brendshme të administratës së rrethit, shkrirjen e një grupseksioni të PD-së pasi anëtarët kanë kaluar në mbështetje të PS-së si dhe dështimin e mitingut të PD-së në Delvinë, si rezultat i një pjesëmarrje të ulët. “Nuk kanë qenë më shumë se 1000 veta në sheshin në qendër të Delvinës, ku pjesa më e madhe ishin punonjësit e bashkisë dhe fëmijë të marrë me detyrim nga Drejtoria Arsimore e qytetit të Delvinës”(Po aty).

Kryeartikulli i datës 16 qershor, i rezervohet fushatës elektorale të liderit të së djathtës Berishës, në Tropojë. Elementi kryesor në këtë artikull është përshkrimi i masave të marra: “Qindra gardistë mbrojnë kryeministrin në Veri. ‘Harron’ të vizitohet Vuçidolin ku lindi. Berisha me autobindë në Tropojë. Snajperë mbi ndërtesa, qen anti-eksploziv në Has dhe Bajram Curri” (Tanushi, L. Shekulli, 16. 6. 2013, f. 4-5). Mënyra e riprezantimit të kësaj ngjarje, fokusohet tek përdorimi i të gjitha strukturave shtetërore të sigurisë si garda, policia rrugore, etj, si dhe mjete të sigurta të blinduara, për të mbrojtur Berishën. Nuk lihet pa u përfshirë në shkrim dhe jeleku antiplumb i Berishës, i cili u kthye në objekt të ligjërimit politik, mes liderëve të dy forcave kryesore politike. “...nuk ka hequr as jelekun mbi këmbë, ndonëse së fundmi në dy dalje TV ka tentuar që ta kthejë në formë shakaje”(Po aty).

Intervista e kreut të PS-së e përzgjedhur si kryeartikull i datës 20 qershor, përforcon funksionin ndikues favorizues të ligjërimit mediatic të “Shekullit” ndaj të majtës, përmes sigurisë që përcjell lideri i saj: Kreu i PS-së jep mesazhet e fundit para 23 qershorit për KQZ-në, votimet dhe qeverinë e re Rama: “”Unë kryeministri i ri “Meta shumë koherent me kulturën perëndimore të formimit të qeverisë””(20.6.2013, f. 6).

Sondazhe

Gazeta “Shekulli” në kryeartikullin e datës 25 maj, i referohet sondazhit të bërë nga kompania italiane “Piepoli”, e cila përmes rezultateve të publikuara nxjerr fitues, koalicionin e majtë, duke theksuar besimin e shqiptarëve tek lideri i së majtës. Gjatë leximit të artikullit, tregohet se sondazhi i realizuar përmes 1000 intervistave telefonike,

tregon një rritje të dy forcave kryesore politike dhe një rënie në përqindje të partive të vogla. Elementë që theksohen në strukturim të lajmit, është besimi i shqiptarëve tek Edi Rama dhe gara politike e cila zhvillohet mes së majtës dhe liderit Berisha. “Sondazhi i dytë i organizuar nga kompania italiane Piepoli thëllon fitoren e koalicionit të majtë. **E majta 9 pikë para Berishës.** Koalicioni i majtë 50,5%, koalicioni i djathtë 42%”. **Shqiptarët besojnë te Edi Rama si lider,** i cili arrin 51% të votave. Berisha renditet i dyti” (Tanushi, L. Shekulli, 25. 5. 2013, f. 1).

Gazeta “Shekulli” në kryeartikullin e datës 5 qershor, i referohet sondazhit të bërë nga “IPR Marketing”, i cili përmes rezultateve të publikuara tregon një rritje të PS-së, nga 48% në 50%. “Koalicioni i majtë i drejtuar nga Edi Rama sipas sondazhit të publikuar mbrëmë, nga Ora News ka thelluar diferencën me koalicionin e djathtë, duke e çuar në 7 pikë diferencën” (Tanushi, L. Shekulli, 5. 6. 2013, f.1). Theksohet rritja e së majtës si dhe përgjigjet e të anketuarve, 65% e të cilëve, janë në favor të taksës progresive. Kjo mënyrë taksimi është lloji i taksës që mbështet PS-ja, ndryshe nga PD-ja e cila është në favor të taksës së sheshtë.

Gazeta “Shekulli” në kryeartikullin e datës 15 dhe 18 qershor, i referohet rezultateve të përfutuara nga sondazhi italian pak ditë para datës së zgjedhjeve. “Sondazhi italian 6 ditë para votimeve, koalicioni i së majtës ruan avantazhin me të djathtën. Zgjedhjet, e majta fiton me 51%” (Tanushi, L. Shekulli, 18. 6. 2013, f. 6). Siç e shpjeguem më sipër, kur trajtuam analizën e ligjërimit mediatik në fushatën zgjedhore të 2009, sondazhet përveç funksionit të monitorimit ndikojnë edhe vetë në mjedisin politik duke u bërë pjesë e tij. Prandaj përzgjedhja e kësaj tematike nga gazeta, nuk është e rastësishme, pasi krijon siguri për elektoratin e majtë dhe shërben si guidë për elektoratin gri apo ndryshe, të pavendosurit.

Profil personi

Gazeta “Shekulli” në kryeartikullin e datës 26 maj, analizon profilin e Kastriot Islamit duke paraqitur jetën e tij politike 22 vjeçare në PS, konfliktet me PD-në, qëndrimet e tij në vitin 1992 kundër kompensimit të ish të përndjekurve politikë dhe ndryshimin e përkatësisë politike të tij. Pas 22 vitesh karrierrë politike me PS-në, Islami ndryshon parti dhe kalon tek PD.

“Dosja e ‘Kaçit të zi’ Ish socialisti që u konvertua në demokrat për një vend deputeti. Historia e vitit 1991 e deri sot. Si e sulmonte PD-ja në ’92 dhe si u fsheh në autobuzin e basketbollistëve matjanë në 1996...Akuzat publike që i bënte Berishës” (Tanushi, L. 26. 5. 2013, f. 6-7).

Ligjërimi mediatic i referohet një videoje të postuar nga Islami në profilin e tij në FCB, në zgjedhjet paraardhëse të 2009, ku subjekti kryesor është Berisha, si kundërshtar politik. Gjuha e përdorur në këtë video, (e cila nuk është fshirë edhe pas kalimit të Islamit tek PD-ja) është e ashpër pasi Berisha klasifikohet, fatkeqësi e kombit. Strategjitë për të përlligjur këtë etikim bazohen tek kategorizimi i tij si komunist, hajdut, shkatërrimtar, rrugaç, vrasës. Secili nga këto attribute shoqërohet me ngjarje të periudhave të ndryshme, të cilat konkretizohen me foto dhe video. Jepet foto e **Berishës** në kohën e rregjimit komunist për të përlligjur emërtimin **komunist**, jepen sekuenca që lidhen me piramidat e dështuara kur klasifikohet si **hajdut**, jepen pamje nga trazirat e vitit 1997 kur emërtohet **shkatërrimtar** i vendit apo **vrasës**, duke e bërë përgjegjës për viktima dhe të plagosur. Burim parësor në këtë artikull është Islami përmes veprimeve të tij, të cilat shërbejnë për të ndërtuar profilin e tij. Islami nuk paraqet besueshmëri tek elektorati, si rezultat i interesave personale pasi mandati i deputetit e bën që të kalojë ”në kampin armik”. Ky artikull është me interes pasi përmes Islamit, ndërtohet një profil i dytë, ai i Berishës duke i atribuar karakteristika negative.

Gazeta “Shekulli” në kryeartikullin e datës 27 maj, trajton si tematikë administrimin e faqes në rrjetin social FCB së kryeministrit Berisha, duke ngritur si hipotezë se faqja nuk administrohet nga Berisha, por nga mbesa e tij.”Kush qëndron pas faqes “Sali Berisha”... Në 8 dhjetor 2012, Ditën e Rinisë, kryeministri shqiptar Sali Berisha njoftoi se ishte bërë anëtar i rrjeteve sociale” (Rrozhani, A. 27. 5. 2013, f. 4/5). Pasi prezantohet veprimi i Berishës, artikulli ndërtohet në kundërshti me imazhin e ndërtuar nga Berisha, si njeri i cili përqafton të renë. Përmendet kur ai është shprehur me ironi për përdorimin e twitterit nga Rama dhe strategjinë e përzgjedhur nga Berisha, i cili më vonë se kundërshtari politik vendosi të përdorë rrjetet sociale për të qenë më afër njerëzve. “Kam një lakmi të thellë që në FCB të jem miku juaj, ndaj e zgjedha këtë takim që të vij tek ju përmes FCB tim” (Po aty). Tematika e trajtuar dhe e zhvilluar gjatë narrativës është profili i Berishës duke iu referuar një këndvështrimi negativ, përse i përket kompetencave të tij në këtë fushë.

Gazeta “Shekulli” në kryeartikullin e datës 11 qershor, analizon profilin e Arben Ristanit, një figurë e njohur në PD. Artikulli fokusohet në arrestimin e tij në vitin 1994, kohë kur ushtronte profesionin e tij si gjyqtar.”Burgimi i gjyqtarit në 1994 për mitmarrje. Arben Ristani jeta në qelinë e burgut 313. Arrestimi pas vendimit me akuzën për korrupsion, liroi nga burgu kontrabandistin e naftës” (Tanushi, L. 11.6.2013, f. 4-5). Artikulli i referohet shkrimit të botuar në gazetën ‘Koha Jonë’ të vitit 1994, ku përveç të tjerave Ristani ka qenë gjyqtar në procesin gjyqësor të zhvilluar kundrejt gazetarëve, Frangaj dhe Leka. Gjatë karrierës së tij juridike, Ristani ka qenë edhe avokat i Ilir Hoxhës (djalin e Enver Hoxhës), i cili shprehet që ”si unë dhe avokati im e dinim që ligji zbatohet politikisht” (Po aty).

Me interes për këtë kategori është edhe kryeartikulli i datës 14 qershor, i cili ndërtohet në prononcimin e bërë nga Tom Doshi, për gazetën “Shekulli”. Ai akuzon kryetaren e parlamentit, për lidhje me sigurimin e shtetit gjatë dikaturës komuniste.“Kur ka qenë vajzë e re ka bashkëpunuar. Pashuku ka qenë pronar i vilës ku Jozefina bashkë me një ish deputet u takuan” (Tanushi, L. 14. 6. 2013, f. 4-5). Të gjitha pyetjet e drejtuara kandidatit për deputet të PS-së Tom Doshit (përveç pyetjes së fundit), shërbejnë për të ndërtuar profilin e Topallit, me tone akuzuese për të kaluarën e saj kompromentuese. Burim parësor është Doshi, ndërsa dytësor është Skënder Gjinushi, i cili në atë kohë ka qenë Ministër Arsimit. Figurë tjetër që përmendet përmes pronocimit të Gjinushit, është **Berisha**, politikat e të cilit paraqiten me tone negative përsa i përket vazhdimin të **‘luftës së klasave’**, nga ai.

“Dëshmia e ish-shoqëruesit të udhëheqjes. Rrëfej **Berishën e Bllokut**” (22.6.2013, f.12-13) është titulli i përzgjedhur për kryeartikull, dy ditë para datës së zgjedhjeve, me pikësynimin e qartë, ndikimin e opinionit publik.

“Funksioni ndikues do të thotë që jo vetëm paraqiten mendime, qëndrime e vlerësime, por edhe synohet të ndikohet mbi mendimet, qëndrimet e vlerësimet e lexuesve, të ndryshohen ato në një drejtim të caktuar, të nguliten bindje politike, të nxiten reagime shoqërore e deri të përftoheshin te njerëzit paragjykime, shije e prirje sipas një orientimi të caktuar.Përgjithësisht funksionet shoqërore të kësaj veprimtarie janë informues dhe formues, organizues dhe propagandues, njohës dhe edukues” (Lloshi, 1999: 216).

Përmes historisë së këtij kryeartikulli, ndërtohet një profil i Berishës për vitet kur ka shërbyer si mjek i dytë për udhëheqësit kryesorë të Partisë së Punës, përpjekjet e tij për të siguruar një pozitë afër familjeve më të fuqishme të kohës, miqësitë e tij me

profesorët që shërbenin brenda Bllokut. Mënyra e ndërtimit të kryeartikullit, përmes përdorimit të burimit parësor Naim Saraçi, si dhe intervista e tij për gazetën kanë një objektiv kryesor, ndërtimin e profilit të Berishës si komunist.

Ligjërimi gazetaresk është një ndër format më të fuqishme të ligjërimeve, pasi mund të sjellë ndryshime “përmes formimit të kuptimeve, influencimit, qëndrimeve të audiencës dhe besimeve (veçanërisht përmes përforcimit të tyre) dhe transformimin e vetëdijes së atyre që e lexojnë dhe e konsumojnë atë” (Richardson, 2007:28). Në përputhje me teorinë e përcaktimit të axhendës, sipas së cilës media jo vetëm kryen funksionin se për çfarë të mendojmë, por edhe influencën mënyrën se si të mendojmë, çfarë të mendojmë, duke iu referuar kornizimit mediatic, strukturimit të lajmit, tonit të përdorur në ligjërime, burimeve të përdorura, gazeta “Shekulli” gjatë fushatës zgjedhore favorizon të majtën, në mënyrë të dukshme: Përmes funksionit ndikues të ligjërimit mediatic, gazeta “Shekulli” synon të ndikojë mbi lexuesin më shumë përmes funksionit shoqëror propagandues, se informues dhe edukues.

5.5. Ligjërimi mediatic përmes kryeartikujve, “Gazeta Shqiptare”, 2013

Në varësi të tematikave të trajtuara, janë përfshirë 15 kryeartikuj nga 30 kryeartikuj në total, ndërsa për pjesën tjetër studimi mbyllet me identifikimin e tematikave të cilat nuk përkohjnë me qëllimet dhe objektivat e këtij punimi. Kategoritë tematike të përfuara nga analiza janë tematikat mbi: procesin zgjedhor, institucionet, incidentet dhe fushatën zgjedhore.

Kryeartikuj, Gazeta Shqiptare 2013

Kryeartikuj që klasifikohen të rëndësishëm për studim të mëtejshëm	Kryeartikuj që klasifikohen jo të rëndësishëm për studim të mëtejshëm
<ul style="list-style-type: none"> • 5 kryeartikuj mbi procesin zgjedhor • 1 kryeartikull mbi institucionet • 2 kryeartikuj mbi incidente • 7 kryeartikuj mbi fushatën 	<ul style="list-style-type: none"> • 14 kryeartikuj

Procesi zgjedhor

“Gazeta Shqiptare” me datën 29 maj, hapet me kryeartikull: ”Zyrtari i DASH: Do sigurohemi për besimin e shqiptarëve te institucioni zgjedhor. Berisha takon Moore: Kuvendi s’ka shpallur vakanca në KQZ. Edi Rama pas takimit: Do nisem drejt SHBA”(Tanushi, D. 29.5.2013, f.6). Në këtë artikull tregohen takimet e zyrtarit Moore i cili i shoqëruar nga ambasadori Arvizu, takon krerët e politikës shqiptare, Ramën, Berishën, Metën dhe Selamin. Jepet qëndrimi i Berishës i cili është për zgjidhjen sa më të shpejtë në raport me anëtarët e larguar të KQZ-së, ku përmenden dorëheqjet si dhe votimi i kandidaturave të reja. Një ndër problematikat e trajtuara, është edhe zhvillimi i zgjedhjeve sipas standardeve të duhura, e artikuluar dhe nga zyrtari i DASH. Si burim parësor përdoret Rama, në raport me burimet e tjera si Berisha, Meta dhe Moore.

Mënyra e zhvillimit të procesit zgjedhor është një tematikë e artikuluar në vazhdimësi nga ndërkombëtarët, për vetë kontekstin politik shqiptar dhe specifikat e tij: Kryeartikulli i datës 30 maj “Zyrtari i Dash: Nëse ka dhunë, hyni në kurs përplasjeje me Uashingtonin SHBA: Ngërç në KQZ” (Tanushi, D. 30.5.2013, f.7), përmes narrativës së tekstit prezanton qëndrimin e Moore përsa i përket zgjedhjeve, ndërsa përsa i përket plotësimit të KQZ-së me 7 anëtarë ai mendon se “as qeveria dhe as opozita nuk janë të përgatitura për të patur shtatë anëtarë” (Po aty). Përzgjedhja e kësaj ngjarje për t’u kthyer në lajmin kryesor të ditës, është në përputhje me funksionet që duhet të kryejë media, pasi mesazhi kryesor që përcjell zyrtari i DASH konsiston në paralajmërimin se nëse do të përdoret dhuna gjatë procesit zgjedhor, kjo do të sjellë përplasje me Shtetet e Bashkuara, mesazh i rëndësishëm jo vetëm për opinionin publik por edhe për vetë partitë politike.

Kryeartikulli i datës 4 qershor, “Ambasadori: Vizat nuk negociohen, ose përmbushen kushtet ose jo. SHBA, Arvizu: Dikush e urren nismën “Act Now””(Madani, V. 4.6.2013, f. 2), i referohet qëndrimit të ambasadorit në raport me mundësinë e heqjes së vizave me SHBA-në, duke përdorur si etalon matës nivelin e refuzimit të vizave, i cili duhet të jetë nën 3% për një shtet. Shqipëria nivelin e refuzimit në 2012 e ka pasur 40,5%, prandaj nuk përmbush kushtet për liberalizimin e vizave. Qëndrimi i ambasadorit për nismën e ndërmarrë “Act Now”, është sqarues pasi thekson se është një nismë që s’ka lidhje me politikën, në kundërshtim me atë që thotë qeveria Berisha.

“Gazeta Shqiptare” në datën 11 qershor 2013, del me kryeartikullin “ Kryetari i PS: Të bëj apel të mos vihesh në shërbim të fushatës. Drejtoresha e çerdheve: Edi Rama më kërcënoi me sms. Rama ngatërron adresë”. Mënyra se si ngjarja prezantohet përfshin intervistën e drejtoreshës Mimoza Basha, pas mesazhit dhe telefonatës nga Rama. Përmendet dhe rasti i drejtoreshës Vojsava Thanasi së shkollës “Ismail Qemali”, e akuzuar nga Rama për përfshirje të saj në fushatë pro PD-së, duke i ofruar nxënësve para për votën. Një informacion i tillë kundërshtohet nga drejtoresha përmes argumentit që fëmijët janë nën moshën 18 vjeç, pra nuk kanë të drejtën e votës. Element i rëndësishëm është theksimi, se këto mesazhe janë kërcënuese dhe përmes tyre ushtrohet presion. Emri i drejtoreshës së çerdhes është bërë mediatik edhe më përpara, përmes emisionit investigativ “Fiks fare”, pasi ajo është pushuar 5 herë nga puna dhe në të gjitha rastet ka fituar dëmshpërblim. Prezantohet edhe emri i bashkëshortit Murat Basha, i cili është nënkryetar i një partie, në linjë opozitare me partinë e drejtuar nga Rama. Burim kryesor është Mimoza Basha: “...I kujton se ajo ishte shkarkuar nga puna pasi kishte denoncuar vjedhjet në administratën që drejtohej prej tij” (Delisula, R. Gazeta Shqiptare, 11.6.2013, f. 2-3), prandaj veprimin e Ramës e klasifikon si presion të pastër politik. Burimet e përdorura si dhe kornizimi mediatik në përzgjedhjen e elementëve kryesorë, synojnë ndikimin e opinionit publik, në disfavor të Ramës.

Kryeartikulli i datës 13.6.2013, në faqen e parë, në “Gazetën Shqiptare” është intervistë e ambasadorit të SHBA-së, Aleksandër Arvizu, dhënë në emisionin “A Show” të gazetarit Adi Krasta, në “Vizion Plus”. Gazeta përzgjedh këtë intervistë si tematikën më të rëndësishme të ditës përmes titullit: “I druhem ngërçit. Arvizu: Po afrohen para për votën”. Në këtë artikull burimi është ambasadori, i cili shpreh shqetësimin e tij për ngërçin politik që mund të krijohet, nëse rezultati i zgjedhjeve do të dalë me numër të barabartë deputetësh për secilin koalicion, si dhe shqetësimin për blerjen e votës përmes parave apo edhe kërcënimeve me largim nga puna. Një element jo më pak shqetësues është edhe numri jo i plotë i anëtarëve të KQZ-së.

Nëse i referohemi burimeve të përdorura në këtë kategori tematikore, si burime parësore përdoren ndërkombëtarët, deklaratat e të cilëve përmes kornizimit mediatik reflektojnë në ligjërimin mediatik, trajtimin e problematikave që shoqërojnë procesin zgjedhor, në përputhje me funksionet e medias.

Institucione

Kryeartikulli i datës 10 qershor, në “Gazetën Shqiptare”: “Drejtoresha e arkivave të shtetit kundër deklaratës së kryesocialistit Rama. S’ka arkiv hipotekor pronash jashtë vendit” (Rabeta, L. 10. 6. 2013, f. 6-7). Në këtë artikull jepet qëndrimi i drejtoreshës e cila shpjegon që deklarata e Ramës është e pamundur të realizohet, pasi nuk mund të flitet për një arkivë të mirëfilltë kadastrale jashtë Shqipërisë, për procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave. Si burime kryesore dhe dytësore përdoren, drejtoresha Nika, e cila kontaktohet nga gazeta për të marrë informacion përse i përket arkivave mbi pronat dhe se çfarë përmbajnë ato, ndërsa Rama si burim dytësor, përmes një kornizmi mediatik që disfavorizon liderin e PS-së.

Incidente

Kryeartikulli i datës 26 maj, në “Gazetën Shqiptare”, trajton tematikën e incidentit të ndodhur kryetarit të PS-së, gjatë zhvillimit të fushatës, i cili klasifikohet si akt politik nga viktima. “Incidenti i dytë në pak ditë, i digjen dy makina në oborrin e shtëpisë. **Akt politik. Prezë, plumba shtëpisë së kreut të PS-së**” (Koramani, A. 26. 5. 2013, f. 8).

Kryeartikulli i datës 2 qershor, trajton ngjarjen: ”**Atentat** në shtëpi, flet kreu lokal i **PD**: Akt terrorist. Tritol Kollozit. ‘Mora 1080 sms brenda ditës’” (Mehmeti, E. &Visha, T. Gazeta Shqiptare, 2. 6. 2013, f. 3). Ngjarja e përshkruar tregon për dëmtimet materiale të pësuarra, të cilat për fat nuk kanë prekur njerëzit, për panikun tek banorët si dhe hetimi i të gjitha pistave. Si burim parësor është Kollozi i cili i kontaktuar nga gazeta e cilëson këtë veprim si një akt të pastër terrorizmi. Jepet edhe qëndrimi i dy forcave politike, ku PD akuzon se pas këtij veprimi janë njerëzit e krimit, ndërsa PS distancohet nga ngjarja.

Ligjërimi mediatik në të dy rastet riprezanton ngjarjet, përmes një gjuhe gazetareske që përshtatet më tepër me funksionin kumtues të ligjërimin, sesa ndikues.

Fushatë

Tematika që dominon në ligjërimin mediatik tek “Gazeta Shqiptare”, është fushata zgjedhore, e cila përzgjedh si burimin kryesor dominues Edi Ramën. Në kryeartikullin e datës 12 qershor trajtohet festa e anuluar në kuadër të 22 vjetorit të themelimit të PS-së, si rrjedhojë e axhendës politike të Ramës. Burimet në këtë kryeartikull, Dritëro Agolli

dhe Servet Pëllumbi, urojnë fitoren e së majtës, ndryshe nga burimet e përdorura tek “Panorama” , ku ish-lideri i PS-së Fatos Nano, mendon se zgjedhjet e vitit 2013, do të shënojnë fundin politik të Ramës.

Mesazhi që përcjell Rama në kryeartikullin e datës 14 qershor, përmes intervistës dhënë për emisionin televiziv “Opinion”, synon të ndikojë mbi opinionin publik, pasi ai deklaroi që është i gatshëm të mos fitojë zgjedhjet nëse populli dhunohet. Frika ndaj parregullsive, që mund të shoqërojnë procesin zgjedhor si rrjedhojë e qëndrimeve të partisë në qeverisje, artikullohet në mënyrë të vazhdueshme nga lideri dhe aktorët e tjerë politikë të së majtës, gjatë fushatës zgjedhore. Të njëjtën gjë lideri Rama rikonfirmon edhe në kryeartikullin e datës 21 qershor, por këtë herë me një gjuhë politike, përmes së cilës ushtron presion, “Po u prek vota? Të gjejnë vrimë e të futen; Edi Rama: Kryeministri del nga partia e parë” (21.6.2013, f.1). Elementi i dytë i përzgjedhur nga gazeta në titull, është bërë pjesë e replikave dhe kundër-replikave mes aktorëve politikë të koalicionit të majtë (PS-LSI), si dhe e ligjërimit mediatic, përmes gazetarisë së procesit, për të kuptuar nëse është pjesë e marrëveshjes politike, përcaktimi se kush do të jetë kryeministri i ardhshëm, në rast fitoreje.

“Gazeta Shqiptare” edhe në kryeartikullin e datës 15 qershor 2013, trajton tematikën e ndarjes së pushtetit ndërmjet PS-së dhe LSI-së. Pas deklaratave të bëra nga politikanë të LSI-së të cilët pohojnë se kryeministri pas zgjedhjeve të 23 qershorit do jetë Ilir Meta, jepet qëndrimi i kryetarit të bashkisë së Beratit drejtuar qytetarëve të tij: ”**Nasufi i PS: S’kemi pakt me LSI.** Kryetari i bashkisë së Beratit, Fadil Nasufi u ka thënë dje, banorëve të këtij qyteti, që të mos u besojnë deklaratave personale të përfaqësuesve të LSI-së”(15.6.2013, f.1). Elementë të rëndësishëm të trajtuar janë së pari, theksimi që deklarata të tilla bëhen bazuar tek dëshirat e individëve të caktuar dhe së dyti, nuk janë pjesë e marrëveshjes së koalicionit PS-LSI. Ky informacion është me vlerë për partitë politike, pasi synojnë të ndikojnë mbi elektoratin dhe kryesisht elektoratin e majtë, por nuk mund të konstatojmë të njëjtën vlerë për median, referuar funksioneve të saj gjatë fushatave zgjedhore, në raport me kornizimin strategjik të lajmeve.

Ligjërimit mediatic duhet të përqëndrohet me tepër tek pasojat e vendimeve politike dhe tek dallimet politike dhe ideologjike, sesa tek beteja për pushtet, pasi votuesit kanë

nevojë të informohen “për aktorët politikë, vizionet, politikat, dhe pasojat e këtyre politikave” (Hansen, H. 2009: 9).

Kryeartikujt e datës 16 dhe 17 qershor, trajtojnë intervistat e liderit të PS-së dhe kandidatit për deputet Arben Malaj, i cili garon jo më nën siglën e PS-së por si kandidat i pavarur. Në ligjërimin politik të mediatizuar të Ramës përfshihen midis tjerash, premtimet për legalizimet falas si dhe gënjeshttrat e Berishës për përdorimin e termit shpellarë për të ardhurit nga veriu: “**Saliu** gënjen për **shprehjen shpellarë**... Ky burrë kërkon t’iu mbajë peng në **shpellën e mendësisë së tij**, duke shfrytëzuar traditat, vlerat dhe besnikërinë tuaj...” (16. 6. 2013, f.1). Ligjërimi negativ i personalizuar i aktorëve politikë, bëhet pjesë e ligjëritimit mediatik, sepse në mënyrë të vazhdueshme ai fokusohet në karakteristika të tilla si personalizimi apo karakteri, në vend që të fokusohet tek partitë politike, programet e tyre, apo çështje të tjera të rëndësishme.

Kryeartikulli i datës 19 qershor, në “Gazetën Shqiptare”, trajton tematikën e fushatës nga lideri i së majtës i cili e ka shtrirë fushatën zgjedhore përtej kufijve, duke i bërë thirrje emigrantëve shqiptarë që jetojnë në Greqi, të vijnë dhe të votojnë PS-në. Ky artikull hapet me titullin “Mister shuma e paguar për reklamën në Tv “Mega” Spoti në Tv greke Rama: Bashkëatdhetarë, ejani votoni PS”. Patjetër që përmendet dhe kundërshtari politik Berisha i cili krahasohet me ish liderin historik të PS-së, Fatos Nanon. “E ka kapur **sindromi i Fatos Nanos**...prapa më vjen historia” (Tanushi, D. Gazeta Shqiptare, 19. 6. 2013, f. 2). Elementi që theksohet, gjatë narrativës së tekstit, është mungesa e informacionit në lidhje me shifrën e paguar për spotin, paraqitet teksti i plotë i reklamës, si dhe jepen informacione mbi premtimet për legalizimet falas, përmirsimin e nivelit të arsimit nga takimet elektorale të Ramës.

Ajo që verhet në analizën e ligjëritimit mediatik gjatë fushatës zgjedhore maj-qershor 2013, tek “Gazeta Shqiptare”, është dallimi me ligjërimin mediatik gjatë fushatës zgjedhore maj-qershor 2009. Sikurse e kemi shpjeguar një ndër faktorët e përzgjedhjes së kësaj gazete ishte ndryshimi i pronësisë, pasi nëse në vitin 2009, një arsye e përzgjedhjes së “Gazetës Shqiptare” ishte origjina e huaj e pronësisë, përkatësisht italiane, në vitin 2011, gazeta si dhe “grupi mediatik Edisud në Shqipëri iu shit grupit mediatik Fokus” (Nezaj, 2014:233). Vazhdimësia e studimit mbi këtë organ mediatik, i

referohet përveç të tjerave pikërisht këtij faktori, ndryshimit të pronësisë, për të kuptuar sa dhe si influencon ky element në ligjërimin mediatik.

Realisht ligjërimi mediatik shfaq karakteristika të ndryshme gjatë dy periudhave kohore që zgjat analiza, pasi nëse i referohemi kornizimit mediatik si “ideja qëndrore organizuese për përmbajtjen e lajmeve, e cila e vendos atë në një kontekst dhe i jep asaj qenësi duke përdorur përzgjedhjen, theksimin, përjashtimin dhe përpunimin” (Griffin&al, 2015:375), gazeta në vitin 2009, shfaq anshmëri politike pro forcës së majtë, PS-së dhe liderit të saj, në mënyrë të dukshme , ndërsa në vitin 2013, jo.

Nëse në ligjërimin gazetaresk të vitit 2009 përzgjedhja e leksikut kundrejt PD-së dhe liderit të saj konsiston në një riprezantim negativ të këtij grupi, në ligjërimin gazetaresk të periudhës së marrë në studim gjatë vitit 2013, sipas studimit rezulton përzgjedhja e një leksiku më neutral në raport me fushatën paraardhëse.

Në fushatën e vitit 2009, si burime parësore dominojnë emra të njohur të PS-së, duke filluar që nga lideri i saj si dhe figura të tjera politike që i japin zë problemeve që shoqërojnë procesin zgjedhor dhe fushatën zgjedhore, pasi gazeta synon ndikimin ose dhënien e mesazhit lexuesit të tyre, përmes favorizimit të PS-së, haptazi, ndërsa në fushatën e vitit 2013 në kategorinë tematikore që trajton procesin zgjedhor, si burime dominuese përdoren ndërkombëtarët, apo aktorë të tjerë të cilët nuk sigurojnë një mbulim mediatik të vazhdueshëm, në favor të PS-së dhe liderit të saj.

Në një përmbledhje të analizës së ligjërimin, gjatë fushatave të vitit 2009 dhe 2013, në raport me parimet dhe rregullat bazë të gazetarisë, është e rëndësishme të theksohet që, gazetarët duhet të botojnë një informacion të saktë, të balancuar dhe të verifikuar. Saktësia është një ndër elementët më të rëndësishëm të përdorur në ligjërimin mediatik, por krahas saj duhet përdorur dhe verifikimi, për të kuptuar nëse informacioni është i saktë, apo jo. Përdorimi i këtyre elementëve nga ana e gazetarit bëhet në funksion të kërkimit të së vërtetës, e cila mund të përkufizohet si:

“E vërteta gazetareske është diçka më shumë se sa thjesht saktësia. Është një proces përzgjedhjeje që zhvillohet me kohë falë ndërveprimit mes publikut, atij që përbën lajm dhe gazetarit. Ky parim parësor i gazetarisë-kërkimi i së vërtetës pa ndonjë lloj interesi – është tek e fundit ajo që e dallon nga çdo formë tjetër komunikimi.”(Kovach dhe Rosenstiel, 2009:55)

Kërkimi i së vërtetës në gazetari, nuk është një proces kërkimor i lehtë pasi faktorë të ndryshëm si aktorët politikë, pronësia, faktori kohë, nevoja organizative për lajme, etj, mund të influencojnë negativisht për arritjen e qëllimit. Ajo që rezulton përmes analizës së ligjërimit mediatik është roli dominant i burimeve, përmes përdorimit të gjerë të citimeve, në raport krahasues me punën kërkimore hulumtuese të gazetarëve. Përdorimi i gjerë i citimeve që mbështeten në akuza dhe kundërakuza nga të majtët dhe të djathtët, dominojnë në mënyrë të dukshme në faqet e gazetave, në kundërshti me funksionet që duhet të kryejë media, pasi në shumicën e rasteve politikanët kanë interesa të tjera, nga interesat që kanë gazetarët në punën e tyre, prandaj është e domosdoshme që të bërit gazetari, të mos kthehet në një gazetari pohimi.

Nëse i referohemi ekuilibrit dhe balancimit të informacionit, vërehet që informacioni që merret duke pasur si burim liderët kryesorë, balancohet duke përdorur kundërshtarët politikë, si burime dytësore. Ajo që duhet theksuar është, që informacionet përzgjidhen duke i paraqitur burimet parësore përmes një toni favorizues narrativ, që përkon me anshmërinë politike të gazetës, në krahasim me burimet dytësore.

Nëse i referohemi dhe njëherë të vërtetës gazetareske, t'i atribuosh shkrimin një burimi, nuk do të thotë se gazetari po i përcjell të vërtetën publikut, pasi kjo nuk e zëvendëson verifikimin dhe gazetarinë investigative, apo thënë ndryshe detyrë e gazetarit është që të verifikojë besueshmërinë e lajmit dhe më pas t'ia përcjellë publikut. Ligjërimit mediatik i dominuar nga personalizimi, konfliktualja dhe negativja (për më tepër shih çështjen, 5.8) përmes akuzave, apo krahasimeve me figura politike të së kaluarës në kontekst negativ, të pranishme në çdo numër gazete, e kthejnë në diçka të pamundur procesin e verifikimit- i cili përbën thelbin e gazetarisë.

5.6. Ligjërimit mediatik, gazetari procesi apo gazetari përmbajtje?

Studim i artikujve tek gazeta "Panorama"

Bazuar në hulumtimin e bërë më lart në pasqyrën e shtypit të shkruar gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2009 e 2013, dhe gjithë trajtesën e mëparshme, për të kuptuar përmes cila formave prodhohet kultura konfliktuale në median e shkruar, në këtë çështje është trajtuar një analizë sasiore e artikujve të publikuar në gazetën "Panorama", duke

përdorur kriterin e klasifikimit të tematikave, në gazetari procesi dhe gazetari përmbajtje.

Në këtë pikë studimore është e nevojshme t'i rikthehemi dhe njëherë kocepteve gazetari procesi dhe gazetari përmbajtje:

“Gazetaria e procesit përqëndrohet te taktikat politike, manipulimet dhe beteja për pushtet në prapaskenë” (Hansen, 2009:42). Ndryshe nga gazetaria e procesit: “Gazetaria e përmbajtjes përqëndrohet te pasojat e vendimeve politike, dhe te dallimet politike dhe ideologjike” (Po aty).

Për t'i kthyer përgjigje kësaj pyetje është kryer studimi i artikujve të publikuar tek gazeta “Panorama” dhe më konkretisht i 339 artikuj për periudhën maj-qershor 2009, si dhe 399 artikuj për periudhën maj-qershor 2013, duke ndërtuar fillimisht kategoritë tematikore të përfuara përmes tematikave të identifikuara gjatë periudhës së marrë në studim dhe më pas është studiuar narrativa e tekstit.

Përsa i përket artikujve të publikuar ndarja sipas kategorive tematikore, për vitin 2009 konsiston: 20% zë procesi zgjedhor, 53% fushata zgjedhore, 9% incidente që burojnë nga ngjarje, akuza apo kundërakuza politike, 16% zënë institucionet dhe 2% sondazhet.

Kategoritë tematikore të artikujve në përqindje, Panorama 2009

Procesi zgjedhor	Fushata zgjedhore	Incidente	Institucione	Sondazhe
20%	53%	9%	16%	2%

Përsa i përket artikujve të publikuar ndarja sipas kategorive tematikore, për vitin 2013 konsiston:17% zë procesi zgjedhor, 70% fushata zgjedhore, 5% incidente që burojnë nga ngjarje, akuza apo kundërakuza politike, 8% zënë institucionet dhe 1% sondazhet.

Kategoritë tematikore të artikujve në përqindje, Panorama 2013

Procesi zgjedhor	Fushata zgjedhore	Incidente	Institucione	Sondazhe
17%	70%	5%	8%	1%

Sikurse vërehet dhe përmes tabelave kategoria tematikore që dominon në ligjërimin mediatik në vitin 2009 dhe 2013 është fushata zgjedhore, e cila nëse e studiojmë dhe në nivel krahasues mes dy periudhave rritet përsëri, me një diferencë prej 17%. Përderisa studimi kryhet gjatë periudhave në të cilat zhvillohen fushata zgjedhore është e kuptueshme rëndësia dhe trajtimi i artikujve që përfshihen në këtë kategori, pasi nëse i rikthehem dhe njëherë funksioneve kryesore që duhet të kryejë media sipas studiusve Gurevich& Blumler mund të rendisim disa prej tyre si:

“Mbikqyrja dhe raportimi i zhvillimeve sociopolitike, përcaktimi i axhendës në mënyrë kuptimplotë referuar çështjeve kryesore të ditës, të shërbejnë si platforma për të bërë avokim, të shërbejë si vëzhgues i shoqërisë për ta bërë qeverinë të përgjegjshme ndaj të qeverisurve, të mbrojë të drejtën e qytetarit për t’u informuar dhe për t’u dëgjuar gjithashtu, të shërbejë si nxitje për qytetarët për të mësuar, për të zgjedhur dhe për t’u përfshirë në vend që thjesht të ndjekin proceset politike” (1990:270).

Referuar këtyre funksioneve në nivel teorik është bërë studimi i artikujve, që përfshihen në kategorinë tematikore që trajton fushatën zgjedhore, duke përcaktuar artikujt që përqëndrohen tek taktikat politike, manipulimet dhe lufta për pushtet në raport me artikujt që përqëndrohen tek pasojat e vendimeve politike, tek dallimet politike dhe ideologjike, thënë ndryshe tek raportin mes gazetarisë së procesit dhe gazetarisë së përmbajtjes. Përmes studimit rezulton një raport i tillë në ligjërimin mediatik të vitit 2009 dhe vitit 2013:

Fushata zgjedhore, “Panorama”2009

Gazetari procesi	Gazetari procesi/ Gazetari përmbajtje	Gazetari përmbajtje
60%	18%	22%

Fushata zgjedhore, “Panorama” 2013

Gazetari procesi	Gazetari procesi/ Gazetari përmbajtje	Gazetari përmbajtje
69%	12%	19%

Në ligjërimin mediatik, rezulton një dominim i gazetarisë së procesit në raport me gazetarinë e përmbajtjes. Axhenda mediatike dominohet nga axhenda politike, e cila prodhon një ligjërim mediatik të fokusuar tek fushata që zhvillojnë partitë politike dhe liderët përkatës. Tematika që përfshihen tek gazetaria e procesit janë informacione që duhet t’i jepen publikut, si psh ftesa e LSI-së për bashkëpunim me PS, refuzimi i saj, manipulimet, largimet dhe koalicionet politike, beteja për pushtet etj. I rëndësishëm mbetet raporti që duhet krijuar ndërmjet këtyre dy kategorive, gazetari procesi dhe gazetari përmbajtje, i cili nuk vlerësohet në mënyrën e duhur.

Një strategji e përdorur rëndom nga organet mediatike është diferenca ndërmjet kryeartikullit dhe artikujve të botuar. Përzgjedhja e kryeartikullit përfshin trajtimin e tematikave të ndryshme, duke synuar një informim të bazuar mbi parimet dhe funksionet që duhet të kryejë media në një sistem demokratik, edhe pse jo i përsosur. Argumentet e përdorura për ndërtimin e kryeartikullit ndryshojnë në raport me artikujt e tjerë. Vlerësimi në raport krahasues nuk është i njëjtë, pasi kryeartikulli është artikulli më i rëndësishëm i ditës, ndërsa për artikujt e tjerë faktorë të tjerë si nevoja organizative për lajme, presioni i kohës, sensacioni, etj, janë premisa bazë që na drejtojnë drejt një gazetari procesi.

Nga sa pamë duket qartë që kemi të bëjmë me një gazetari procesi, ku pasqyrohen aktivitete, fjalime, konferenca, intervista pa u bërë një analizë, pa u thelluar në përmbajtjen e tyre në mënyrë të pavarur, pasi jo gjithçka duhet të jetë lajm, për hir të asaj që duhet lajmi. E vetmja gjë që bëhet në këtë lloj gazetarie, është interpretimi pozitiv apo negativ në varësi të anshmërisë së gazetës, si dhe copëzimi i pjesëve të ligjëratës për të theksuar dhe vënë në dukje atë pjesë që i shërben qëllimit të tyre.

“Fatkeqësisht mediat nuk po luajnë ndonjë rol të lavdërueshëm. Me përjashtim të pak rasteve të veçuara, shumica e mediave shqiptare i janë dorëzuar tundimit të spektaklit.

....Në vend që të orientojnë bisedën dhe debatin drejt programit dhe ideve, shumica e gazetarëve dhe e analistëve merren mjeshhtërisht me strategjitë elektorale dhe personale të individëve. Ky sistem i mbyllur mediatik duket sikur funksionon në mënyrë të pavarur nga nevojat e qytetarëve.” (Hasimja, E, Panorama, 08. 06. 2009, fq. 21.)

Ndryshe nga sistemi mediatik, sistemi politik duket sikur funksionon në mënyrë të varur nga nevojat dhe kërkesat e qytetarëve. Rezultatet e përftuara nga sondazhi Zogby, (i zhvilluar në muajin janar, të vitit elektorale 2009) i dhanë mundësi aktorëve politikë që të ndryshojnë ligjërimin e tyre duke iu afruar më tepër shqetësimeve kryesore të përfshira në axhendën publike.

“Kështu pamë sesi papunësia u bë argumenti kryesor i fushatës, pasuar kjo nga ekonomia, infrastruktura, shëndetësia apo arsimit, ndërkohë që ishte bërë modë që në politikën “para sondazhit” kishim kryesisht një gamë tjetër shqetësimesh, kryesisht të diktuar nga ligjërimi i elitës, si demokracia, standardet e shoqërisë së lirë, institucionet etj.” (Çili. H. Panorama, 19.06.2009, f. 19.)

Me përjashtime të rralla të opinionistëve të ndryshëm, që shkruajnë dhe botojnë artikuj, duke u mbështetur në një gazetari përmbajtje të bazuar në argument dhe kundër argument të pasojave të vendimeve dhe ideologjive të secilës parti, në përgjithësi ka shumë për të përmirësuar. Kjo mënyrë e bërjes së gazetarisë është shumë larg asaj se çfarë aspirohet sot në botë nga media.

Dallimet dhe ideologjitë politike të partive politike edhe pse paraqesin vështirësi për arsye tashmë të ezauruara në kapitullin, që studion partitë politike në Shqipëri dhe ligjërimin e tyre, përsëri duhet të përfshihen në ligjërimin mediatik dhe axhendën mediatike pasi “sikurse kanë thënë specialistët më të mirë të komunikimit, është media në radhë të parë televizioni, që e prodhojnë politikën në formën dhe në përmbajtjen e saj më të thellë” (Fuga, 2008:431).

Artikuj analitikë mbi arritjet apo dështimet e qeverisë, analiza mbi premtimet elektorale të partive politike zhvillohen përmes një gazetarie të përgjegjshme në raport me funksionet që duhet të kryejë. Një fakt konstatues përmes analizës është që artikuj të kësaj kategorie përfshihen minimalisht në ligjërimin mediatik, dhe në rastet kur përfshihen karakterizohen nga anshmëria dhe interesat mediatike, përmes praktikave profesionale që qëndrojnë larg parimeve dhe rregullave gazetareske.

Për studiues kritikë të medias si Cappella&Jamieson (1997), efektet e kornizimit strategjik të lajmeve, referuar fitores apo humbjes së aktorëve politikë, “luftës dhe lojërave” politike, nuk janë pozitive. Argumenti kryesor në studimin e tyre mbështetet në dallimin që sjell kornizimi strategjik i lajmeve në raport krahasues me kornizimin e çështjeve (që fokusohen tek problemet dhe tek zgjidhja e tyre) tek publiku, pasi theksohet që “korniza strategjike për lajmet politike aktivizon përgjigje cinike kundrejt politikanëve, politikave, qeverisë, fushatave, dhe formimit politik (1997:139), ndërsa “kornizimi i çështjeve, nga ana tjetër mund të shtypë reagimet cinike” (Po aty).

Në mungesë të trajtimit të gazetarisë së përmbajtjes, kornizimit të çështjeve, në vend që të zhvillohet një gazetari cilësore, zhvillohet një gazetari e mbështetur në komente, ku rolin kryesor e kanë liderët politikë që përforcojnë ”kultin e unit”, përmes fokusimit tek vetvetja dhe tek kundërshtari politik, në mënyrë antagoniste.

Përveçse një gazetari procesi, vihet re edhe një fokus në konfliktualitetin mes aktorëve politikë të pasqyruar në media. “Në vend që të theksohet ngjarja, konflikti, gara mes aktorëve politikë, duhet përqendrimi mbi çështje dhe perspektiva politike” (Patterson& Wilkins, 2009:207)

Shpesh si një formë e propagandës do të shohim titujt për rrahje, për fyerje, për dhunë etj, duke i dhënë një ngjyrë dhe paramendim të caktuar konfliktit, pa marrë parasysh ndikimin dhe pasojat që sjell kjo në publik.

5.7. Kategoritë burimore tek “Shekulli” në fushatën zgjedhore 2013

Në këtë çështje, trajtohet studimi i 256 artikujve tek gazeta “Shekulli”, i cili ka si objektiv identifikimin e burimeve kryesore të cilët kanë pushtetin për të përcaktuar axhendën mediatike, në raport me aktorët e tjerë politikë, edhe pse në këtë pikë të analizës, përmes studimit të kategorive tematikore dhe narrativës të tekstit, është faktuar që burimet e përdorura në ligjërimin mediatik, nuk kanë të njëjtën forcë, përse i përket përcaktimit dhe dominimit të axhendës mediatike.

Në etiketimin organizata politike përfshihen partitë politike, grupet e presionit dhe organizata publike si sindikatat, shoqatat e konsumatorëve, OJQ-të etj, të cilat synojnë të realizojnë objektivat e tyre politike, duke përdorur mjete të ndryshme, ku media klasifikohet si një ndër mjetet kryesore të përdorura nga organizatat politike, pasi mesazhet e aktorëve politikë i përcillen publikut apo target grupit të synuar, duke synuar një komunikim politik efektiv. Përtej dëshirës për të qenë pjesë e axhendës mediatike dhe për ta dominuar atë, janë disa rregulla dhe ligje të cilat kufizojnë këtë veprimtari në mediet vizive, pasi për shtypin nuk ka kufizime të kësaj natyre, sepse për median e shkruar përcaktimi kryesor është: Shtypi është i lirë dhe liria e tij mbrohet me anë të ligjit.

Institucione të caktuara, monitorojnë kohën që i lihet subjekteve politike, në mediet vizive, për të ruajtur paanshmërinë dhe balancimin politik, pasi fushata dhe procesi zgjedhor janë elementë të rëndësishëm në një sistem demokratik, megjithatë e parë nga një këndvështrim tjetër, interpretimi mbi kohën në dispozicion dhënë subjekteve politike, mund të jetë i anshëm edhe pse është vendosur për të ruajtur paanshmërinë. Koha që i lihet subjekteve politike, është në raport përpjestues me mbështetjen e elektoratit që ky subjekt ka, apo e thënë ndryshe, ato që ndodhen në pozita më të larta, më me tepër pushtet, do të vazhdojnë të ruajnë këto pozita dhe ato që ndodhen në pozita inferiore do të mbesin përsëri në të njëjtin nivel. Kjo logjikë na shpie drejt procesit të hegjemonisë, ku padyshim media luan një rol të rëndësishëm, duke shërbyer si një platformë e debatit politik, por jo për të gjithë njëlloj, përmes procesit të dominimit, përjashtimit apo mënjanimit.

1) Organizata politike si kategori burimore: Në ligjërimin mediatik kjo kategori burimore në nivel krahasues me kategoritë e tjera, dominon pasi ka përqindjen më të lartë, rreth **63%**, referuar numrit të artikujve të publikuar gjatë periudhës së marrë në studim tek gazeta “Shekulli”. Kjo kategori ka dinamikat e veta, pasi ka një dallueshmëri evidente brenda saj, të cilën po e konkretizojmë si më poshtë:

a) Partitë politike në raport me organizatat jopartiakë: Për vetë kontekstin e vendit tonë i cili karakterizohet nga një tranzicion i tejzgjatur, aktorët jopartiakë me objektiva politikë, nuk kanë akses në ligjërimin mediatik, pasi prezenca e tyre është pothuaj inekzistente, si rrjedhojë e kapitalit të pamjaftueshëm financiar, për t’u bërë pjesë e

axhendës mediatike përmes krijimit të lajmeve, apo kapitalit kulturor të mbështetur tek autoriteti dhe besueshmëria e tyre.

b) Partitë kryesore politike në raport me partitë e vogla: Aksesit që gëzojnë partitë që kanë një mbështetje më të vogël elektorati se partitë kryesore, është i papërfillshëm në raport krahasues më të dytat. Referuar numrit të artikujve të publikuar për dy grupet, partitë e vogla (të përfaqësuara përmes liderëve), zënë një hapësirë afërsisht tek **15%** në total, gjë që vërteton argumentin, që partitë politike kryesore dominojnë ligjërimin mediatik. Partitë e vogla, përfshihen në ligjërimin mediatik, përmes problematikave që janë shqetëuese për to, si psh: Për FRD-në niveli alarmant i korrupsionit, çështja çame për AP-në, apo rikonstituimi i KQZ-së për PBDNJ-në etj. Një strategji e përdorur është që partitë e vogla përdoren në funksion të partive të mëdha, për të prishur apo rregulluar imazhin e partive kryesore apo liderëve të tyre, në funksion të ideologjisë dhe interesave të gazetës: “Mos votoni PD-në e Kaç Islamit, por Ballin; PBK u bën thirrje ballistëve që të mos votojnë më për PD-në pas afrimit tek kjo parti të Kaç Islamit” (Shekulli, 2. 6. 2013, f. 3), apo “Dule: Ne jemi koalicioni i Shqipërisë Europiane” (Shekulli, 3. 6. 2013, f. 2) dhe “Topi: Selami zvarranik, Shehi pijanec” (Shekulli, 8. 6. 2013, f. 3).

Përmes një analize krahasuese në përqindje, përse i përket **kandidatëve për deputetë** ndërmjet partive të mëdha dhe të vogla, rezulton që kandidatët e partive të vogla zënë një hapësirë, afërsisht te **14 %** kur përdoren si burime: Pjesë e ligjërimin mediatik bëhen kandidatët, Hamiti i “Aleancës Popullore”, Frroku i “Partisë Kristian Demokratike” si dhe Hoxha i partisë “Fryma e Re Demokratike”. Në rastin e parë përmes kandidatit të AP-së akuzohet Shpëtim Idrizi i PDIU-së, për një konventë dështimi të kësaj force politike. Në rastin e dytë, Mark Frroku akuzon shtetin për një eliminim politik të partisë që përfaqëson, përmes sulmeve mbi familjen e tij, ndërsa Mit’hat Hoxha kandidat i FRD-së përfshihet në një incident, i cili klasifikohet nga e shoqja (si burim), si incident me motive politike.

c) Partitë kryesore (PD, PS dhe LSI): Tre partitë kryesore politike në vendin tonë, janë dominuese në ligjërimin mediatik referuar përzgjedhjes burimore, me një shifër afërsisht **85%** në raport me partitë e tjera, që operojnë në skenën politike shqiptare. Strategjia e përdorur nga gazeta “Shekulli” në artikuj, ndryshon nga strategjia e përdorur në kryeartikuj, në raport me përzgjedhjen e burimeve, pasi në kryeartikuj

përzgjidhen tematika të ndryshme ku si rrjedhojë kemi edhe burime të ndryshme, ndërsa në artikujt e tjerë të përfshirë në ligjërimin mediatik, kemi një dominim të partive politike kryesore e cila bëhet përmes liderëve: Një studim i artikujve në këtë nënkategori, paraqet një tablo të qartë të përfaqësimit të këtyre forcave politike përmes liderëve të tyre, me një shifër afërsisht 74%. Tituj të tillë si “Meta falendëron Ramën për pranimin e kompromisit dhe përsërit ftesën ndaj Berishës për miratimin e tre ligjeve...” (Tanushi, L. Shekulli, 24. 5. 2013, f. 6), apo “Rama: Me votë e heqim Saliun nga puna (Shekulli, 26. 5. 2013, f. 3), apo Berisha: “Me PS në pushtet, të pasurit largohen” (Shekulli, 2. 6. 2013, f. 2), janë prezentë në çdo numër, duke përforcuar idenë paraprake të dominimit të partisë nga lideri i saj dhe dominimit të ligjërimin mediatik nga lideri i partisë politike, pavarësisht tematikës së trajtuar, e cila mund të jetë e ndryshme.

2) Institucionet si kategori burimore: Në një vend demokratik institucionet janë vendimtare për ecurinë e procesit zgjedhor, pasi ligjet dhe rregullat mbi të cilat janë ngritur, janë mbipartiake, por në kontekstin shqiptar, të karakterizuar nga një tranzicion i tejzgjatur shpesh hasen problematika përsa i përket performancës së institucioneve, që vjen si rezultat i autoritarizmit dhe personalizimit institucional. Sipas tipologjisë analitike të ndërtuar, institucionet të cilat shërbejnë si burime në ligjërimin mediatik kapin një shifër rreth **15%** krahasuar me kategoritë e tjera: KQZ-ja si një ndër institucionet kryesore të kësaj periudhe, bëhet pjesë e ligjërimin mediatik përmes veprimtarisë së saj, vendimeve, problematikave dhe performancës së saj, vlerësuar me tone negative në shumicën e artikujve të publikuar si: “Skandal në KQZ, votohet dy herë” (Tanushi, L. Shekulli, 9. 6. 2013, f. 1). Akuzat për performancën e politizuar të drejtuesve të institucioneve janë të vazhdueshme, pasi tituj të tillë si: “Kreu i qeverisë i’u është përgjigjur thirrjeve të ambasadorit amerikan duke refuzuar zgjidhjen e ngërçit të KQZ-së në kuvend” (Shevroja, E. Shekulli, 27. 5. 2013, f. 2), apo “Policia i shemb shtëpinë kandidatit të opozitës” (Shekulli 7. 6. 2013, f. 4), apo “Ministri i Brendshëm, kandidat për deputet alarmon Ambasadën Amerikane...Halili informon ambasadën për presionet e Nokës” (Kovaçaj, N. Shekulli, 12. 6. 2013, f. 1), apo “Drejtori i shkollës së Policisë, fushatë për PD-në, fyen Ramën (Tanushi, L. Shekulli, 19. 6. 2013, f. 4), janë të përfshirë në ligjërimin mediatik gjatë gjithë periudhës së marrë në studim. Pavarësisht nëse janë përdorur si burime parësore, apo si burime dytësore, ligjërimi mediatik

karakterizohet nga një ton negativ në të shumtën e rasteve, ndonjëherë neutral dhe pothuaj asnjëherë pozitiv, për performancën e institucioneve, në funksion të ideologjisë dhe interesave mediatike dhe politike.

3) Ndërkombëtarët si kategori burimore: Padyshim që janë një zë i rëndësishëm në ligjërimin mediatik, referuar faktorëve përcaktues për vlerat e lajmit si dhe kontekstit të vendit tonë. Ky target grup, përfaqësuesit e të cilit shërbejnë si burime në ligjërimin mediatik, kapin një shifër rreth **15%** krahasuar me kategoritë e tjera: Ambasadori i SHBA-së Arvizu, ish-ambasadori i SHBA-së Withers, drejtori për Europën Qëndrore dhe Jugore në Departamentin e Shtetit Amerikan Moore, kryetari i delegacionit të Parlamentit Europian për Europën Juglindore Kukan, shefja e misionit OSBE-ODIHR McCormack, kreu i delegacionit të Bashkimit Europian në Shqipëri, eurodeputeti gjerman Fleckenstein etj, përdoren si burime në trajtimin e tematikave të ndryshme. Titujt e përzgjedhur në ligjërimin mediatik të gazetës “Shekulli”, kanë një ton negativ për mënyrën e funksionimit të institucioneve që paraqesin problematika si psh: KQZ-ja e cila nuk ka numrin e plotë të anëtarëve prandaj duhet të riformatohet, apo politizimi i tyre. “Situata parazgjedhore në Shqipëri, Akuza për qeverinë: Rrugët e reja dhe projektet u shoqëruan nga flamujt e PD-së ODIHR: KQZ me 4 anëtarë, e paligjshme” (Tanushi, L. Shekulli 8. 6. 2013, f. 1). Në mënyrën se si riprezantohet ngjarja, përgjegjësia bie mbi qeverinë Berisha: “Shfrytëzimi i administratës shtetërore dhe i fondeve publike për fushatë nga mazhoranca, evidentohen tepër qartë në raportin e përgatitur nga ekspertët e ODIHR-it” (Tanushi, L. Shekulli 8. 6. 2013, f. 6), si dhe tituj të tjerë të ngjashëm, mbështeten në thirrje që bëjnë ndërkombëtarët, që procesi zgjedhor të mos shoqërohet me dhunë dhe incidente dhe në kritika për qeverinë dhe kryeministrin.

4) Në këtë kategori të katërt burimore evidentojmë individë të ndryshëm, të cilët kthehen në burime për vlerat që ka ngjarja që përzgjidhet për t’u kthyer në lajm nga gazeta, të cilët në artikujt e publikuar për periudhën e marrë në studim, kanë një shifër rreth **7%**. Këto individë përdoren si burime në rastet kur janë përfshirë në incidente, që shoqërojnë fushatën zgjedhore si: “Qëlloi me gurë mbi kryeministrin në Burrel, Petrit Hoxha kërkon ndjesë publike në gjyq, pas 48 orëve në qeli” (Kovaçaj, N. Shekulli, 3. 6. 2013, f. 1). Një arsye tjetër e përzgjedhjes burimore është denoncimi i vazhdueshëm nga

qytetarë, për presionin që ushtron qeveria përmes largimit nga vendi i punës nëse vota nuk shkon për PD-në, si: “Edukatorja e çerdhes nr:10: Më flakën nga puna se nuk shkova në mitingun e PD-së” (Tato, A. Shekulli, 6. 6. 2013, f. 1), apo për blerjen e votave. Për debatin e krijuar mes liderit Rama dhe drejtoreshës së gjimnazit “Ismail Qemali” i cili u bë mjaft mediatik mbështetur në akuza dhe kundërakuza, gazeta “Shekulli” përmes prononcimit të një maturanteje të kësaj shkolle, tregon se ajo do ta shesë votën në këmbim të premtimeve që i kanë bërë. “Pas të gjithë hamendësimeve se Rama akuzonte kot drejtoreshën e shkollës së mesme ‘Ismail Qemali’, sot kemi një provëz të vogël, dëshminë e...” (3. 6. 2013, f. 7).

Një nënkategori që përfshihet në këtë kategori, është edhe përdorimi i figurave që kanë patur më përpara funksione politike, apo administrative të rëndësishme të cilët denoncojnë problematika si strategjitë ilegjitime të PD-së për të siguruar vota, apo pakënaqësi lidhur me Berishën: “Flet Isuf Çipi, ish-anëtar i PD-së dhe ish kryetar Bashkie Klos, Mat. Pse u zhgënjeva nga Berisha...” (18. 6. 2013 f. 7). Në raport me tonin e përdorur gjatë riprezantimit të ngjarjeve, spikat toni negativ për qeverinë, institucionet, liderin e PD-së dhe figura të tjera të kësaj force politike.

Në një sintezë përmbledhëse referuar analizës së mësipërme, mund të konkludojmë që gazeta “Shekulli”, shërben si një model, ku aksesin më të madh e kanë *partitë politike kyesore, të cilat kanë pushtetin për të përcaktuar axhendën mediatike* në raport me aktorët e tjerë politikë përmes procesit të dominimit dhe së dyti një element tjetër i rëndësishëm për tu theksuar është dominimi i partive politike PS, PD dhe LSI nga liderët e tyre. Në këtë pikë të analizës është legjitime të pranojmë që gazeta luan një rol të rëndësishëm në procesin e hegjemonisë, pasi ajo shërben si një platformë ku jo të gjithë kanë të njëjtat të drejta dhe mundësi të përcjellin mesazhet e tyre favorizuese kundrejt publikut, pasi kemi të bëjmë me një model me “...Akses të strukturuar, të diferencuar të medias, duke favorizuar ata në elitë ose në pozicionet dominante dhe duke diskriminuar grupet anësore ose vartëse” (Mcnaair, 2009:158). Edhe pse media mes tjerash është një biznes konkurrues, për të siguruar të ardhura materiale, gjë që mund të arrihet përmes përfshirjes në axhendën mediatike të informacioneve të vlefshme nga aktorë politikë jo kryesorë, dallohet një diferencim në disavantazh të tyre, pasi faktorët e

tjerë si kapitali financiar, kulturor, organizativ janë faktorë më me influencë në këtë përzgjedhje.

5.8. Personalizimi, konfliktualja dhe negativja në ligjërimin mediatik

Ligjërimi mediatik në mbulimin e çështjeve politike po drejtohet gjithnjë e më tepër drejt këtyre karakteristikave si personalizimi, konfliktualja dhe negativja. Studiues të ndryshëm bien dakord për këto karakteristika të cilat njëkohësisht pranohen edhe si faktorë përcaktues në vlerat e ngjarjes që përzgjidhet për t'u kthyer në lajm. Gazetarët politikë akuzohen se shpesh më tepër rëndësi i japin aktorëve politikë kryesorë si liderët apo kandidatët se sa vetë partive politike, duke u fokusuar në karakteristika të tilla si personalizimi apo karakteri, në vend të partive politike, programeve të tyre apo çështjeve të tjera të rëndësishme.

“Referimi tek njerëzit apo personalizimi- referimi tek njerezit ose personalizimi është gjithashtu një vlerë e ndërtuar në mënyrë shoqërore ... Fiksimi me individët dhe përdorimi i tyre nga mediat si simbole, shmangin diskutime serioze dhe shpjegime themelore të faktorëve social dhe ekonomik...Është mëse e qartë se personalizimi është një pikëpamje krijuese e ideologjisë” (Fowler, 1991: 15).

Studiuesit Rahat dhe Sheaffer (2007), në studimin e tyre mbi konceptin e personalizimit, në shtypin izraelit dallojnë personalizimin institucional dhe personalizimin e sjelljes: Personalizimi institucional ka në fokus pushtetin që i atribuohet politikanëve si individë, ndërsa personalizimi i sjelljes qëndron tek rritja e profilit më shumë si individë sesa si element i një partie. Interes për ne shfaq elaborimi i konceptit personalizim, duke i'u referuar ndarjes mes personalizimit dhe private:

”Personalizimi i sjelljes nga media, në një rën anë i referohet një përqëndrimi më të lartë në politikën individuale dhe një fokus të zvogëluar ndaj partive” (*Brants & Voltmer, 2011:93 cituar nga Rahat & Sheaffer, 2007: 67*), duke i kushtuar vëmendje karakteristikave politike dhe aktiviteteve të politikanëve individualë. Ajo që emërtohet private, në anën tjetër "i referohet një përqëndrimi të medias në karakteristikat personale dhe jetën personale të kandidatëve individualë" (Po aty, fq. 68). Përsa i përket medias do të shohim se ende ka ngecur në qerthullin e një pasqyrimi të ndikuar, duke përdorur të gjitha teknikat në ndërtimin e një ligjërimi, të fokusuar tek liderët politikë përmes personalizimit dhe përdorimit të asaj që etiketohet private.

Në raport me gazetarinë e përqëndruar mbi konfliktualitetin ka zëra kritikues si James Fallows të cilët studiojnë pasojat që shfaqen në sjelljen e qytetarëve nga kjo mënyrë e të

bërit gazetari. “Gazetaria e përqëndruar mbi konfliktualitetin politik, është përgjegjëse në lidhje me largimin e njerëzve nga politika gjë që reflektohet me uljen e numrit të votuesve dhe me tensionin që krijohet mes aktorëve politikë” (Patterson&Wilkins, 2009:207).

Më poshtë po paraqesim në formë tabelare, për lehtësi krahasimi, pjesë të ligjërimit mediatic të fokusuar tek liderët kryesorë, përgjatë periudhës së fushatës elektorale. Në këtë çështje kemi marrë në analizë krahasimi, për zgjedhjet e vitit 2013 edhe ligjërimit e liderit të partisë “Lëvizja Socialiste për Integrim”, duke qënë pjesë e koalicionit të majtë, si dhe për rëndësinë dhe pozicionin politik që pati në këto zgjedhje.

Ligjërimi mediatic, personalizimi, konfliktualja dhe negativja, “Panorama”, 2009

Berisha për Ramën	Rama për Berishën
Zoti Edvin, po tregon që je një shpirtzi i pashembullt në histori	Katër vjet të tjera me Sali Berishën janë një dëm i pallogaritshëm për këtë vend
Rama rreziku më i madh për vendin	Berisha na kërkon votën pasi ka një biznes për të mbajtur me qeverinë
Rama e mori këngën nga çetnikët serbë	Kryeplaku i politikës së vjetër
Rama recitoi Hil Mosin, serviri Tom Doshin	Berisha gënjeu... Mos votoni politikën e vjetër
Rama fshihet pas karriges së Bashkisë	Berisha, deputet në opozitë
Rama edhe 48 orë afat të hyjë në zgjedhje	Vota për këtë kryeministër, simbol i politikës së vjetër
Rama ofendoi demokracinë... Gramshi nuk do ta harrojë votën kundër të PS për hidrocentralet	Në duart e një familjeje që e ka kthyer qeverisjen në një biznes të drejtëpërdrejtë familjar
Edi Rama t’i kërkojë falje Tropojës për Bregoviç	Jam te Skënderbeu, Berisha të shkojë te Bajram Curri
Rama po tjetërson pronat	Serbia pa viza, ne jo përfaj të Berishës

Sauku gjunjëzoi mamuthin e korrupsionit në 2005	Tre herë e ka marrë përgjigjen nga populli i kryeqytetit për prapambetjen e tij dhe nuk ka mësuar asgjë
Do nxjerr Ramën nga politika Rama do të ketë fatin e Ramizit, si te Medreseja	Na jepni votën të largojmë Berishën
Nga një anë mendoja se ky mund të ketë një mendësi...Se sekretari i parë dikur nuk kishte nevojë të kandidonte	Berisha enveristi i djeshëm

Ligjërimi mediatik, personalizimi, konfliktualja dhe negativja, "Gazeta Shqiptare", 2009

Berisha drejtuar Ramës	Rama drejtuar Berishës
Tirana, fundi politik i Ramës	I them kryeplakut të politikës së vjetër se karrigia e deputetit mund t'i duhet atij që do të jetë në opozitë
Ne rritëm pagat, Rama gënjen	Unë nuk do të jem kryeministri i një qeverie që bën biznes për një familje të vetme dhe ndan pasuritë e vendit me klientët e pushtetit të familjes kryeministore
Çohu motiv i çetnikëve serbë; Çdo lider europian kryeson listën	Çohu është për të rrëzuar Berishën
Lustraxhi busti	Unë nuk do të jem një kryeministër si Sali Berisha dhe të tjerë që janë provuar dhe stërprovuar
Rama recitoi Mosin, kandidoi Doshin	Vota për Saliun është votë vetëm për

	oborrit e tij familjar
Edi Rama një Enver i dytë	Berisha po mban gjallë Enver Hoxhën
Rama trilloi për vjedhjen e orës së Bushit	Sali Berisha rishfaqet për të bërë të njëjtin premtim të 18 viteve, ndërkohë që kishte 4 vjet në dispozicion për t'i legalizuar shtëpitë
Do ti jap dy ditë afat që të ndryshojë mendim, që të vendosë emrin në listat e deputetëve	Për mua politika nuk është luftë për pushtet siç është për Sali Berishën
Rama s'kandidon sepse e di që do të humbasë	Të bëjë të vetmen gjë që i ka mbetur, të humbasë me dinjitet, duke hequr dorë nga presionet për të marrë votën me pahir
Ke mbledhur zhul	Ndërkohë që gjysma tjetër e parave tuaja shkon për shpenzime dhe qoka të familjes dhe oborrit kryeministrot, siç bën Sali Berisha
Rama do të bojkotojë zgjedhjet	Qeveria ime do të jetë jo vetëm e socialistëve por edhe e demokratëve sepse edhe ju jeni mërziur me Sali Berishën
Njeriu që nga 500 leje ndërtimi, 70% i merr për vete	I shkaktoi kryeqytetit një traumë që do të mbahet mend në historinë e vendit, si trauma më e madhe e korrupsionit shtetëror, që është shpërthimi tragjik i Gërdecit
Edi Rama festoi 18 vjetorin apo 80 vjetorin e partisë së tij	Rruga e Kombit, haraç për Berishën

Bazën e vet militante e zëvendësoi me 99-shat e tij, vetëm e vetëm se me ata ndan fitimet përrallore të lejeve të ndërtimit dhe korrupsionit të Bashkisë	Në 18 vjet ne vazhdojmë të jemi në Shqipërinë e izoluar dhe pa viza....Për faj të kryeministrit tonë që punon për veten dhe familjen e tij
Ti nuk ke dhe je i zhveshur nga çdo moral njerëzor, je më lakuriq sesa ke dalë në plazhet e botës	Vota për Saliun është votë vetëm për oborrin e tij familjar

Ligjërimi mediatik, personalizimi, konfliktualja dhe negativja, “Panorama” 2013

Berisha drejtuar Ramës	Rama drejtuar Berishës	Meta drejtuar Berishës
Çolja i Ramës thotë do blej votat e malokëve	Kush ka parë malin, do kthejë pronën në bregdet	Berisha në pension politik
Platforma e Ramës është përçarja	Saliu me 200 roje	S’na duhet një kryeministër që e ka mendjen si të bëjë lajm
Rama vuan nga dromofobia	Më mirë në autobus me qytetarët sesa me antiplumb si Saliu	Po rrënojnë ekonominë (i referohet ndërtimit të tuneleve)
Rama i papenduar për Naton, e quajti natë	Gjyshi full time	Berisha më keq se Sudja
Rama krahason Samiun e Naimin me bandën e bllokmenëve	Saliu s’ua hedh dot me tunelin (i referohet tunelit Tiranë-Elbasan)	
Nuk jam gjysmë burrë si ti	Saliu me jelek antiplumb	
Je i skllavëruar nga Blloku	Katragjyshi e Flamuri (i	

Hoxhist	referohet Flamur Nokës) nxisin përçarjen, unë i dua kuksianët e tropojanët, jo me fjalë, por me vepra	
Bandë në autobusin mavi, Arben Ndoka sapo ka dalë nga burgjet	Gjyshi sot duhet t'u lexonte mbesave Çufon dhe Bubin	
Rama paragjykime për komunitetin mysliman	Berisha manipuloi postën, dorëzova deklarin e pasurisë	
Koço e Fideli rilindas, aq sa Zani Çausi Skëndërbe	Natë është Berisha dhe jo Nato	
Rama dhe Ilir Hoxha duan të rikthejnë etërit	Saliu s'ka më takat, por ju fut thikën e ndasisë... ka shpikur se unë kam thënë shpellarë	
Rama tregoi fytyrën do të rilindë Bllokun	Saliu i lodhur dhe i rëndëuar nga zullumet dhe antiplumbi	
Rama i sëmurë urren babanë, s'çlirohet nga kompeksi i Edipit	Saliu të përgjigjet për tunelin e gjatë të papunësisë e të varfërisë	
Rama martohet sa herë ka zgjedhje; Për kreun e PS, familja është tregti, ne besojmë te familja, Rama ndërron gratë për vota	Në Shqipëri ka vetëm një shpellar dhe ai është Sali Berisha	

Berisha drejtuar Ramës	Rama drejtuar Berishës	Meta drejtuar Berishës
Mjeran, s'di asgjë për punët shtetërore	Hiqe jelekun antiplumb dhe çetën me 200 roje	Do ta nxjerrim në pension
Vuan nga dromofobia	Komunisti më i keq luftoi 25 vjet Naton	Saliut t'i jepni ujë në bisht të lugës
23 qershori Vaterlo për Ramën	Berishën e vuri aty Partia e Punës	Mos prisni ta shaj Berishën
Je dështak në profesion	Berisha të lexojë Bubin Kaçurrel	Ta përcjellim Berishën përgjithmonë në opozitë
Je gjysmëburrë vuan nga kompleksi i Edipit	T'i japim fund rregjimit të një familje që rrënoi Shqipërinë	Berisha ka marrë të tatëpjetën, humb thellë
Ju quan malokë do t'iu blejë votën	Atë që i ka bërë Berisha naftës, s'ia ka bërë pushtuesi	Premtimet e Berishës më keq se Sudja
Rama vuan nga urrejtja ndaj babait	Kryeministri shpif nuk i kam ofenduar skraparllinjte	
Rama i ktheu fondet në rroga partie	Saliu plak, i lodhur, do ti vjedhë votat vetëm po e lamë ne	
Rama po luan me rilindasit, si Enveri në 1960	Saliu gënjen për shprehjen shpellarë..., Kërkon t'iu mbajë peng në shpellën e mendësisë së tij	
Taksa marksiste, largon	Saliu të distancohet nga	

investitorët	krimi	
Martohet sa herë ka zgjedhje	“Duart e pastra” të Berishës me llumin e aferave	

Ligjërimi mediatik, personalizimi, konfliktualja dhe negativja, “Shekulli”, 2013

Berisha drejtuar Ramës	Rama drejtuar Berishës	Meta drejtuar Berishës
Ramës xhaketa ime i duket si parzmore	Ra Sala prej fiku	Berisha të largohet bashkë me karrigen
Ti mjeran vjen në parlament me çelësin në qafë	Sali mos i merr në qafë drejtorët e shkollave	Edhe pse dikush çdo ditë e më shumë thotë në TV se ekonomia jonë është më e fortë se asnjëherë tjetër, ju vetë e ndjeni se si ajo cdo ditë po prek xhepat e familjes tuaj
Pazarxhiu i 1 prillit.	Do të ndëshkohesh	Berisha çoi Renean në veri (për të manipuluar zgjedhjet)
Zotëria i quan nxënësit dele dhe mësuesit më të paditur se 100 vjet më parë	Me votë e heqim Saliun nga puna	I vetmi që lufton në fushatën e Partisë Demokratike është Z. Sali Berisha
Shoku i autobusit mavi	Shqipëria do Rilindje, jo gjysh me antiplumb	
Ti je i humbur siç ke qënë deri më sot, edhe me këmishë të jem ti je i	Saliu thotë Nato... I vetmi vend i Natos ku nuk ka ujë... Punojmë tokën me	

humbur, je i mundur je i pashpresë	bel dhe kuaj	
Alternativa e shokut mavi bazohet tek mallkimi, sharja dhe kërcënimi	Berisha nuk i ka më duart e pastra	
Shoku i autobusit mavi, gënjeshtër është dobësia më e madhe e burrit. Mungesa e plotë e karakterit për burrin	Berisha urren Vlorën	
Është modeli i një njeriu të dështuar, modeli i një burri aventurier, që ndahet dhe bashkohet me gra sa herë vijnë zgjedhjet për qëllime elektorale	Do të braktisim tunelet ku na futi Berisha	

Ligjërimiti mediatic në shtypin e shkruar të pavarur dominohet nga një shkallë e lartë konfliktualiteti dhe personalizimi, që realizohen përmes: Përqëndrimit më të lartë në politikën individuale të aktorëve politikë në raport me partitë politike dhe fokusimit në karakteristikat personale individuale. Kjo formë dominuese në ligjërimitin mediatic rezulton problematike, pasi e largon gazetarin nga diskutime mbi çështje serioze dhe të rëndësishme, për opinionin publik.

Në analizën krahasuese ndërmjet këtij kampioni gazetash, rezulton se kjo dukuri është karakteristike gjithëpërfshirëse sepse: Axhenda mediatike dhe ligjërimiti mediatic dominohen nga akuzat dhe kundërakuzat që liderët i drejtojnë njëri-tjetrit, jo vetëm në raport me performancën e punës së tyre, por edhe në aspektin personal, e cila më tepër se një fushatë konkurrence prodhon një fushatë konflikti për hir të pushtetit, ndërmjet liderëve.

Gjuha më e ashpër dhe në frekuenca të larta është ajo mes kreut të opozitës Edi Rama dhe Kryeministrit Sali Berisha, pasi Ilir Meta është më i moderuar në deklaratat e tij, për vetë pozicionin e tij politik, ku sapo ka dalë nga një koalicion bashkëqeverisës me PD-në dhe ka hyrë në një koalicion të ri, me PS-në.

Nga studimi i shtypit të kësaj periudhe, në vend të një pasqyrimi programesh dhe idesh, rezulton se në shumicën e artikujve, mbizotëron konfliktualiteti dhe negativiteti: Dominimi i shtypit të shkruar nga këto artikuj, nuk prodhon aspak një gazetari përmbajtjeje në mënyrë profesionale.

PËRFUNDIME

Analiza e ligjërimit politik përmes fjalimeve politike, në raport me ideologjinë e majtë/e djathtë, konsiston në një mungesë të dallimeve ideologjike, mbi të cilat duhet të ndërtohet diada e majtë/ e djathtë: Mungesa e debatit politik sipas dallimeve ideologjike ndërmjet politikave të majta dhe të djathta, ndikon në krijimin e një kulture politike konfliktuale, duke devijuar politikën nga ajo çfarë normalisht duhet të trajtojë, sepse në vend të debatit politik përmes diadës e majtë-e djathtë, prodhohet një ligjërim politik (përmes strategjive legjitimuese-delegjitimuese, “ne/ata”) i ndërtuar mbi baza morali, ku theksohet antagonizmi politik jo më si kundërshtarë politikë që veprojnë brenda të njëjtës hapësirë politike, por si armiq.

Në ligjërimin politik, përmes fjalimeve të “Partisë Demokratike” dhe të “Partisë Socialiste”, spikat imazhi i liderit i cili njehsohet me partinë dhe institucionet qeveritare, prandaj herë-herë fushata merr përmasat e një arene gladiatorësh, ku janë liderët ata që duhet të fitojnë betejën dhe jo programi dhe ideologjia që përcjell secila parti. Strategjitë e përdorura legjitimojnë veten dhe delegjitojnë kundërshtarin politik, përmes një kulture politike konfliktuale dhe aspak konsensuale, që synon pushtetin.

Ligjërimi mediatik gjatë fushatave zgjedhore të viteve 2009 dhe 2013 nuk është i lirë nga paragjykimet, gjatë riprezantimit të ngjarjeve që kthehen në lajme: Ai reflektton ideologjinë dhe interesat e organeve mediatike dhe politike. Interpretimi dhe analizimi i teksteve në një ligjërim mediatik hetohet, jo vetëm në aspektin e përzgjedhjes së temave, ku kategoria tematikore dominuese është fushata zgjedhore, por dhe përmes formës së ligjërimit dhe natyrës së ndërtimit të tekstit. Ndërthurja e këtyre elementëve narrativë, influencon në ndikimin e vazhdueshëm të lexuesit, për t’u drejtuar drejt zgjedhjes të atij subjekti politik apo vendimi shoqëror, që ky organ mediatik ka zgjedhur të mbështesë, sepse ligjërimi gazetaresk është një ndër format më të fuqishme të ligjërimëve, i cili mund të sjellë ndryshime, në transformimin e vetëdijes së lexuesve.

Pushteti jo i barabartë ndërmjet forcave politike reflektohet në ligjërimin mediatik, në avantazh të forcave më të fuqishme, duke përforcuar idenë se mediet luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e hegjemonisë. Media performon sipas një modeli me strukturë

të diferencuar që favorizon grupet me më tepër pushtet. Ligjërimi mediatik dominohet nga partitë kryesore të cilat eklipsohen nga liderët përkatës, Berisha, Rama dhe Meta, përmes një personalizimi partiak dhe institucional. Ligjërimi mediatik i dominuar nga një tip i tillë ligjërimi politik, largon median nga funksionet që duhet të kryejë në një sistem demokratik.

Një tipar dallues i gjuhës që zhvillohet tek ne vitet e fundit në ligjërimin e medias së shkruar dhe asaj masive, është shfrytëzimi pa kriter i fyerjes dhe fjalori i pakulturuar i ligjërimin të shkujdesur. Në raport me praktikën diskursive profesionale, në mjaft artikuj kemi shkelje të etikës që vjen përmes mungesës së saktësisë, anshmërisë politike, etj. Kjo dukuri ndikohet nga vetë realiteti historik shoqëror që po përjeton vendi ynë në këto dekada, por edhe nga rënia e nivelit të gazetarisë. Në nivel krahasues, gazeta “Panorama” është më e ekuilibruar në ligjërimin e saj dhe më e saktë në raport me praktikën diskursive profesionale.

Problematikat e shtypit lidhen me një sërë faktorësh si presioni i kohës, nevoja organizative për lajme, kultura politike dhe mediatike, pronësia, komercializimi etj, të cilat reflektohen në përzgjedhjen e tematikave dhe trajtimit të tyre, duke u larguar nga cilësia si udhërrëfyes. Një ndër burimet e studimit është “Gazeta Shqiptare”, e cila përveç rëndësisë që ka në tregun mediatik, është përzgjedhur në studimin e vitit 2009 dhe vitit 2013 edhe për të kuptuar sa influencon ndryshimi i pronësisë, në ligjërimin mediatik. Dallimet e evidentuara si rrjedhojë e këtij faktori, nuk mund të përliqjen me ndryshimin e linjës editoriale, sepse kjo nuk legjitimon keqinformimin, anshmërinë, personalizimin partiak apo institucional.

Në ligjërimin mediatik, rezulton një dominim i gazetarisë së procesit i fokusuar në betejën për pushtet, manipulimet, në raport krahasues, me gazetarinë e përmbajtjes. Axhenda mediatike dominohet nga axhenda politike, e cila prodhon një ligjërim mediatik të fokusuar tek fushata që zhvillojnë liderët Berisha, Rama, Meta, me sfond blu apo rozë, përmes një kulture politike konfliktuale. Artikuj që analizojnë vendimet politike dhe pasojat e tyre, programet e partive, analiza mbi arritjet apo dështimet e qeverisë në nivel krahasues me premtimet elektorale zhvillohen përmes një gazetarie të përgjegjshme, në raport me funksionet që duhet të kryejë. Një fakt konstatues përmes

analizës është që artikuj të kësaj kategorie përfshihen minimalisht në ligjërimin mediatik, dhe në rastet kur përfshihen karakterizohen nga anshmëria dhe interesat mediatike dhe politike. Në mungesë të saj, në vend që të zhvillohet një gazetari cilësor, zhvillohet një gazetari e mbështetur në komente, përmes interpretimit pozitiv apo negativ, ku rolin kryesor e kanë liderët politikë që përforcojnë "kultin e unit".

Përveçse një gazetari procesi, vihet re edhe një fokus në konfliktualitetin mes aktorëve politikë të pasqyruar në media. Shpesh si një formë e propagandës do të shohim titujt që i referohen akuzave dhe kundërakuzave, fyerjeve, dhunës verbale, etj, duke i dhënë shpeshherë një ngjyrë dhe paramendim të caktuar konfliktit, pa marrë parasysh ndikimin dhe pasojat që sjell kjo në publik.

Përmes studimit rezulton që në shtypin shqiptar dallohet personalizim institucional, duke u fokusuar tek pushteti që i atribuohet politikanëve si individë, personalizim i sjelljes duke u fokusuar tek individit më shumë se tek partia, si dhe tek karakteristikat personale të kandidatëve.

Dominimi i shtypit të shkruar nga këto artikuj nuk është në të mirë të fushatës dhe informimit të publikut. Pra, si përfundim mund të themi se kemi një panoramë të një gazetarie procesi, konfliktuale dhe të personalizuar, e cila vihet në shërbim të pushtetit të liderëve, duke përforcuar pabarazitë, ideologjinë dhe pushtetin ekzistues.

BIBLIOGRAFIA

Botime dhe monografi shkencore

Almond, G. A. Verba, S. (1963) *The civic culture: Political attitudes and democracy in Five Nations*. Little, Brown & Co: Boston.

Althusser, L. (2014) *On the Reproduction of Capitalism: Ideology and Ideological State Apparatuses*. Trans. Goshgarian G. M. Verso: New York.

Balla, S. (2011) *Fjala e lirë, sfidë europinane*. UET Press: Tiranë.

Balle, F. (2011) *Mediat dhe Shoqëritë*. Papirus: Tiranë.

Bell, D. (1960) *The End of Ideology: On the Exhaustion of Political Ideas in the Fifties*. Glencoe, IL: Free Press.

Bertrand, J. C. (2007) *Deontologjia e mediave*. Instituti Shqiptar i Medias: Tiranë.

Biberaj, E. (1999) *Albania in Transition: The Rocky Road to Democracy*. Westview Press: Colorado.

Biberaj, E. (2011) *Shqipëria në tranzicion*. AIIS: Tiranë.

Blumler, J.G. Gurevitch, M. (1995) *The crisis of Public Communication*, London:Routledge

Bobbio, N. (1987) *The future of democracy*. Polity Press: Cambridge.

Bobbio, N. (1997) *E djathta dhe e majta: gjykime dhe kuptime të një dallese politike*. IDK: Tiranë.

Boggs, C. (1976) *Gramsci's Marxism*. Pluto: London.

Brants, K.& Voltmer, K. (2011) *Political Communication in Postmodern Democracy Challenging the Primacy of Politics*. Palgrave Macmillan: London.

Budini, B. (2008) *Edi Rama, politikani pop(ulist)-star*. UET: Tiranë.

Cappella, J. N. Jamieson, K.H. (1997) *Spiral of Cynicism: The Press and the Public Good*. New York: Oxford University Press.

- Chilton, P. (2004) *Analysing political discourse: Theory and practice*. Routledge: London.
- Chouliaraki, L. Fairclough, N. (1999) *Discourse in late modernity: Rethinking critical discourse analysis*. Edinburgh University Press: Edinburgh.
- Etika dhe Gazetaria në Shqipëri* (2006), Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias: Tiranë.
- Etzioni-Halevy, E. (2009) *Klasat dhe Elitat në Demokraci dhe në Demokratizim: lexime të zgjedhura*. Dudaj: Tiranë.
- Fairclough, N. (1992a) *Discourse and Social Change*. Polity Press: Cambridge.
- Fairclough, N. (1995a) *Media Discourse*. Arnold: London.
- Fairclough, N. Wodak, R. (1997) *Critical Discourse Analysis: An overview, in T.A.van Dijk(ed.) Discourse Studies: A Multidisciplinary Introduction, Vol.2, f67-97*. Sage Publications: London.
- Fairclough, N. (2000) New Labour, New Language? Routledge: London.*
- Fairclough, N. (2003) *Analysing Discourse*. Routledge: London & New York.
- Fairclough, I. Fairclough, N. (2012) *Political Discourse Analysis: A Method for Advanced Students*. Routledge: London.
- Fevziu, B. (2012) *100 Vjet Shtet*. UETPress: Tiranë.
- Foucault, M. (1972) *The archaeology of the knowledge and the discourse on language*. Pantheon books: New York.
- Fowler, R. (1991) *Language in the news*. Routledge: London.
- Fuga, A. (2008) Brirët e dhisë: lexime në komunikim. Ora: Tiranë.*
- Fuga, A. (2003) Majtas jo djathtas. Ora: Tiranë.*
- Fuga, A. (2008) Media, politika, shoqëria (1990-2000). Dudaj: Tiranë.*
- Fukayama, F. (1992) *The end of history and the last man*. NY Press: New York.

- Genette, G. (1980) *Narrative discourse*. Cornell University Press: Ithaca, New York.
- Giddens, A. (2002), *Sociologjia*. Çabej: Tiranë.
- Godole, J. (2014) *Gazetaria Shqiptare në tranzicion*, Papirus: Tiranë.
- Gordon, C. (2009) *Making meanings, creating family: Intertextuality and framing in family interaction*. Oxford University Press: New York.
- Gramsci, A. (1971) *Selections from the Prison Notebooks*. International: New York.
- Griffin, E. Ledbetter, A. Sparks, G. Budini, B. & Gjergji, B. *Vështrim i parë mbi Teorinë e Komunikimit*, McGraw Hill Education: Tiranë
- Gurevitch, M. & Blumler, J. G. (1990) *Political communication systems and democratic values*. In: Lichtenberg, J. (ed). *Democracy and the mass media*. Cambridge University Press: New York.
- Hall, S. Critcher, C. Jeffeson, T. Clarke, J. Roberts, B. (1978) *Policing the crisis: mugging, the state, and law and order*. Macmillan: London.
- Hall, S. ([1973] 1980): 'Encoding/decoding'. In Centre for Contemporary Cultural Studies (Ed.): *Culture, Media, Language: Working Papers in Cultural Studies, 1972-79* London: Hutchinson, pp. 128-38
- Hall, S. (1997) *Representation: Cultural Representations and Signifying Practices*. Sage: London.
- Halliday, M. A. K. (1985). *An introduction to functional grammar*. London; Baltimore, Md., USA: E. Arnold.
- Hallin, D. C. & Mancini, P. (2004) *Comparing Media Systems*. Cambridge University Press: Cambridge.
- Hansen, H. (2009) *Raportimi i Drejtë dhe i Balancuar i zgjedhjeve*. Instituti Shqiptar i Medias: Tiranë.
- Jamieson, K. H. (1992) *Dirty Politics: Deception, Distraction, and Democracy*. Oxford University Press: New York.
- Kabo, P. (2006) *Autoritarizëm në tranzicion*. Plejad: Tiranë.

- Katz, E. & Lazarsfeld, P.F. (1955) *Personal influence: The part played by people in the flow of mass communications*. The Free Press: New York.
- Katz, E. Peters, XH. Liebes, T. Orloff, A. (2009) *Tekste kanonike të kërkimit në media*. ISHM: Tiranë.
- Kovach, B. & Rosenstiel, T. (2009) *Elementët e Gazetarisë*, Instituti Shqiptar i Medias: Tiranë
- Krasniqi, A. & Hackaj, A. (2014) *Shqiptarët Dhe Modeli Social Evropian, Demokracia e brendshme në partitë politike shqiptare*. Friedrich-Ebert-Stiftung: Tiranë.
- Krasniqi, A. (2006) *Partitë politike në Shqipëri 1920-2006*. ISHSP: Tiranë.
- Kuhn dhe Neveu (2002) *Gazetaria Politike*. Instituti Shqiptar i medias: Tiranë.
- Lijphart, A. (1999) *Patterns of democracy*. Yale University Press: New Haven.
- Lippman, W. (1998) *Public Opinion*. Transaction Publishers: New Brunswick, New Jersey.
- Littlejohn, Stephen W. Foss, Karen A. (2009) *Encyclopedia of Communication theory*. SAGE Publications: California.
- Littlejohn, Stephen W. Foss, Karen. A., Oetzel, J. G (2017) *Theories of Human Communication (11th ed.)*. Waveland Press, Inc: Long Grove, Illinois.
- Lukes, S. (1974) *Power: A radical View*. Macmillan Press: London.
- Lloshi, Xh. (1999) *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*. SHBLU: Tiranë.
- McLean, I. & McMillan, A. (2011) *Fjalor Politik*. IDK: Tiranë.
- McNair, B. (2009) *Hyrje në Komunikimin Politik*. Maluka: Tiranë.
- Mouffe, Ch. (2005) *On the Political*. Routledge: Abingdon – New York.
- Nezaj, S. (2014) *Menaxhimi i krizës në medien e shkruar*. UET: Tiranë.
- Patterson, P. Wilkins, L. (2009) *Etika në Media- Çështje dhe raste*. UFO Press: Tiranë.
- Pëllumbi, S. (2006) *Pluralizmi Politik. Përvojë dhe sfidë*. IS: Tiranë.
- Randall, D. (2003) *Gazetari Universal*. Instituti Shqiptar i Medias: Tiranë.

- Raportimi dhe Shkrimi i Lajmeve* (1991), Dubuque: Wm.C.Brown.
- Reisigl, M. Wodak, R. (2001) *Discourse and Discrimination: Rhetorics of Racism and Anti-Semitism*. Routledge: London.
- Richardson, J. (2007) *Analysing newspapers, An approach from critical discourse analysis*. Palgrave Macmillan: New York.
- Rivers, W. L. & Schramm, W. L. (1969) *Responsibility in Mass communication*. Harper & Row: New York.
- Rugova, B. (2009) *Gjuha e Gazetave*, Koha: Prishtinë.
- Ruli, G.(2001) *Shqiptarët në Ballkan* , ISHSN: Tiranë.
- Russ, M. S. (2010) *Gazetaria*, Natyra: Tiranë.
- Seiler, D. L. (2002) *Partitë politike*. UET Press: Tiranë.
- Siebert, Fred S. Theodore, P. Wilbur, S. (1956) *Four Theories of the Press*. University of Illinois Press: Urbana, Illinois.
- Shinasi, R. (2006) *Probleme politike shqiptare*. Instituti i Studimeve Kombëtare Shqiptare: Shkodër.
- Shkurtaj, Gj. & Topalli, T. (2009) *Sociolinguistika e shqipes nga dialektologjia te etnografia e të folurit*. Morava: Tiranë
- Toolan, M. J. (2001) *Narrative: A critical linguistic introduction*. Routledge: London & New York.
- Titscher, S. Meyer, M. Wodak, R. Vetter, E. (2000) *Methods of Text and Discourse Analysis*. Sage Publications: London.
- Van Dijk ,T. A (1977) *Text and context. Explorations in the semantics and pragmatics of discourse*. Longman: London.
- Van Dijk, T. A. (1988) *News as discourse*. Hillsdale, N.J: Lawrence Erlbaum.
- Van Dijk, T. A. (1991) *Racism and the press*. Routledge: London.
- Van, Dijk. T. A. (1998) *Ideology: a multidisciplinary approach*. SAGE: London.

Van Dijk, T. A. (2008) *Discourse and Context. A sociocognitive approach*. Cambridge University Press: Cambridge.

Zogaj, P. (2001) *Paradhoma e një presidenti*. Ora: Tiranë.

Wodak, R. & Meyer, M. (2001) *Methods of Critical Discourse Analysis*. Sage Publications: London.

Wodak, R. (2009) *The Discourse of Politics in Action*. Palgrave Macmillan: London.

Artikuj shkencorë

Flowerdew, J. Li, D. C. S., & Tran, S. (2002). *Discriminatory news discourse: some Hong Kong data*. *Discourse & Society*, 13(3), 319-345.

Gabriel A. Almond, G. A (1956) "Comparative Political Systems," *The Journal of Politics* 18, no. 3: 391-409.

Gjokutaj, Ç. (2012) "Politika, konfliktualiteti, televizioni", MAPO. UET PRESS: Tiranë, 13 Maj, f. 10.

Rahat, G. Sheaffer, T. (2007) The personalization(s) of Politics: Israel 1949-2003, *Political Communication*, 24(1): 65-80.

Stewart, G. (2016). *The great social-political divide: Left or right*. Palestine Chronicle, January 25.

Van Dijk, T. (1997). What is political discourse analysis? In Blommaert, J. and Bulcaen, C. (eds.) *Political Linguistics*. Amsterdam: Bejamins, 11-52.

Verba, S. Schlozman, K. L., Brady, H. Nie, N. H. (1993) Citizen Activity: Who Participates: What Do They Say. *American Political Science Review* 87(2): 303-318.

Artikuj shtypi

Alarm për zgjedhjet, qeveria fsheh të dhënat për kartat, *Gazeta Shqiptare*, 01.06.2009, fq. 2

Atentat me 30 plumba drejtuesit të PD në Kukës. I plagosuri, vëllai i drejtorit të SHKB në Ministrinë e Brendshme, *Panorama*, 24.5.2013, f. 7

Berisha: Edi Rama, një Enver i Dytë, *Gazeta Shqiptare*, 05.06.2009, fq. 6

Berisha: Me PS në pushtet, të pasurit largohen, *Shekulli*, 2.6.2013, f. 2

Blushi, T. Fushata, 10 milionë euro karburante, *Gazeta Shqiptare*, 15.06.2009, fq. 3

Blushi, T. Kartat, qeveria gënjen Bashkimin Europian, *Gazeta Shqiptare*, 5.06.2009, fq. 3

Blushi, T. Ndërkombëtarët alarmohen për vonesat e procesit, Rama dhe Berisha vazhdojnë mitingjet, *Gazeta Shqiptare*, 6. 6. 2009, f. 1

Bushati, G. Zgjedhjet, Berisha fyen Ramën: Ke mbledhur zhul, *Gazeta Shqiptare*, 10. 06. 2009, fq. 2

Çili, H. Çfarë (nuk) na mësuan zgjedhjet, *Panorama*, 19.06.2009, f. 19

Çollaku, A. Rrihet kryetari i Partisë Socialiste. Kryeplaku i PD e masakron për parullën shkruar në mur, *Gazeta Shqiptare*, 03.06.2009, fq. 2

Deputetja Vasilika Hysi: Të mblidhet më parë Komisioni i Ligjeve. PS: Votojmë vetëm tri ligjet, jo amnistinë..., *Panorama*, 27. 05. 2013, fq. 5

Dule: Ne jemi koalicioni i Shqipërisë Europiane, *Shekulli*, 3.6.2013, f.2

Flet drejtoresha: Biseda në telefon, si më kërcënoi Edi Rama. Intervista/ Rrëfimi i drejtoreshës së "Ismail Qemalit" për telefonatën me kreun e PS, *Panorama*, 24.05.2013, f. 2

Hasimja, E. Spektakël në vend të programeve, *Panorama*, 08.06.2009. f. 21

I druhem ngërçit. Arvizu: Po afrohen para për votën, *Gazeta Shqiptare*, 13.6. 2013, f. 1

Kaja, A. Nasufi i PS: S'kemi pakt me LSI, *Gazeta Shqiptare*, 15.6.2013, f. 3

Kartat, qeveria gënjen BE-në. PS: Të shtyhen zgjedhjet, *Gazeta Shqiptare*, 05.06. 2009, fq. 3

Koramani, A. Incidenti i dytë në pak ditë, i digjen dy makina në oborrin e shtëpisë. Akt politik. Prezë, plumba shtëpisë së kreut të PS-së, *Gazeta Shqiptare*, 26.5.2013, f. 8

Kovaçaj, N. Ministri i Brendshëm, kandidat për deputet alarmon Ambasadën Amerikane. Kryebashkiaku i Kukësit, Halili, informon ambasadorin për presionet e Nokës, *Shekulli*, 12.6.2013, f. 4-5

Kovaçaj, N. Qëlloi me gurë mbi kryeministrin në Burrel, Petrit Hoxha kërkon ndjesë publike në gjyq, pas 48 orëve në qeli. "Atentatori"i Berishës: Votoj PD-në, *Shekulli* 3.6.2013, f. 1

Kreu i LSI siguron elektoratin e majtë për vazhdimin e aleancës parazgjedhore me PS. Meta me Ramën edhe pas zgjedhjeve, *Shekulli*, 7.6.2013, f. 1

Kryetari i PS: Po i joshin nxënësit me 200 mijë lekë për të votuar PD-në. Rama: Drejtorët e shkollave në fushatë do dalin para drejtësisë, *Gazeta Shqiptare*, 26. 5.2013, f. 4

Kryetari i PS: Të bëj apel të mos vihesh në shërbim të fushatës. Drejtoresha e çerdheve: Edi Rama më kërcënoi me sms, *Gazeta Shqiptare*, 11.6. 2013, f. 1

Listat e partive përmbajnë kandidatë me dosje, *Panorama*, 18.06.2009, f. 2

Madani, V. Ambasadori: Vizat nuk negociohen, ose përmbushen kushtet ose jo. SHBA, Arvizu: Dikush e urren nismën “Act Now”, *Gazeta Shqiptare*, 4.6. 2013, f. 2

Mehmeti, E. & Visha, T. Atentat në shtëpi, flet kreu lokal i PD: Akt terrorist. Tritol Kollozit: Mora 1080 sms brenda ditës, *Gazeta Shqiptare*, 2. 6. 2013, f. 3

Meta: Dua 30 deputetë, Rama të na bashkohet, *Gazeta Shqiptare*, 24.6.2009, fq. 6

Meta ftesë Ramës: Pakt për mbrojtjen e votës, *Panorama*, 21.6.2009, fq. 1

Mos votoni PD-në e Kaç Islamit, por Ballin, *Shekulli*, 2.6.2013, f. 3

Policia i shemb shtëpinë kandidatit të opozitës, *Shekulli*, 7.6.2013, f. 4

Pse u zhgënjeva nga Berisha...Lufta për mbijetesën e familjes dhe djali i mbetur invalid gjatë trazirave të vitit 1997, *Shekulli*, 18.6.2013, f. 7

Publikohet anketa. Sondazhi për majin, Partia Demokratike 9 pikë para Partisë Socialiste, *Panorama*, 8.6.2009, fq. 1

Rabeta, L. Drejtoresha e arkivave të shtetit kundër deklaratës së kryesocialistit Rama. S’ka arkiv hipotekor pronash jashtë vendit, *Gazeta Shqiptare*, 10.6. 2013, f. 6-7

Rabeta, L. Si ndryshojnë procedurat e punësimit dhe largimit nga puna në shtet. Statusi i Nëpunësit. Ligji i ri, ja si mbrohet administrata, *Gazeta Shqiptare*, 3.1. 2013, f. 6-7

Rama: Me votë e heqim Saliun nga puna, *Shekulli*, 26.5.2013, f. 3

Rrozhani, A. Kush qëndron pas faqes “Sali Berisha”... Në 8 dhjetor 2012, Ditën e Rinisë, kryeministri shqiptar Sali Berisha njoftoi se ishte bërë anëtar i rrjeteve sociale, *Shekulli*, 27.5.2013, f. 4-5

Rrozhani, A. Listat e zeza të PD. Skedohen punonjësit e administratës që nuk duan të përfshihen në fushatë, *Shekulli*, 21.6. 2013, f. 4-5

Skandalet e Berishës, ngriu Ngjelën, shkë..... për Ballën, seks për Pangon... Hap pas hapi, thuhet të “pathënat” në spote për qeverisjen e Berishës, *Gazeta Shqiptare*, 7.06.2009, fq. 2-5

SMS e Ramës? Sondazhet e porositura nuk na dëmtojnë. Meta: Kemi edhe ne sondazhe, por s’i shqetësojmë qytetarët me sms, *Panorama*, 06. 06. 2013, fq. 2

Sondazhi Italian Partia Demokratike parti e parë, por e majta krijon qeverinë, *Panorama*, 17.6.2009, fq. 1

Sondazhi: Koalicioni i PD në Tiranë me 17 mandate, i PS 15. Koalicioni i djathtë dy pikë para koalicionit të majtë, *Panorama*, 18. 06.2013, fq. 6

Studimi, LSI vendimtare për qeverinë. Fiton e majta, por opozita duhet të jetë e bashkuar, *Gazeta Shqiptare*, 9.6.2009, fq. 6

SHBA: Zgjedhjet ne rrezik. ZV/Ambasadori ne terren, Konspekton problemet me kartat, *Gazeta Shqiptare*, 4. 6. 2009.

Shevroja, E. Kreu i qeverisë iu është përgjigjur thirrjeve të ambasadorit amerikan duke refuzuar zgjidhjen e ngërçit të KQZ-së në kuvend, *Shekulli*, 27.5.2013, f. 2

Shllaku, B. Atentati, ekzekutohet me eksploziv kreu i PDK, *Gazeta Shqiptare*, 19.6.2009, fq.2

Tanushi, L. Blerja e votave. Zbardhen e-maillet e PD-së për administratën. Berisha e përgëzon publikisht drejtoreshen Ermira Mustafaj, *Shekulli*, 31.5.2013, f. 1

Tanushi, D. Mister shuma e paguar për reklamën në Tv “Mega” Spoti në Tv greke Rama: Bashkëatdhetarë, ejani votoni PS, *Gazeta Shqiptare*, 19.6.2013, f. 1

Tanushi, L. Burgimi i gjyqtarit në 1994 për mitmarrje. Arben Ristani jeta në qelinë e burgut 313, *Shekulli*, 11.6.2013, f. 4-5

Tanushi, L. Dështon verifikimi elektronik i kartave, denoncojnë përfaqësuesit e PS-së. Skandal në KQZ, votohet dy herë, *Shekulli*, 9.6.2013, f. 4-5

Tanushi, L. Digjen me benzinë shtëpia dhe biznesi i kryetarit të PS-së...Djegia ka prapavijë politike..., *Shekulli*, 24.5.2013, f. 4

Tanushi, L. Dosja e ‘Kaçit të zi’ Ish socialisti që u konvertua në demokrat për një vend deputeti. Historia e vitit 1991 e deri sot..., *Shekulli*, 26.5.2013, f. 6-7

Tanushi, L. Drejtori i shkollës së Policisë, fushatë për PD-në, fyten Ramën, *Shekulli*, 19.6.2013, f. 4

Tanushi, L. Koalicioni i majtë i drejtuar nga Edi Rama sipas sondazhit të publikuar mbrëmë, nga Ora News ka thelluar diferencën me koalicionin e djathtë, duke e çuar në 7 pikë diferencën, *Shekulli*, 5.6.2013, f. 1

Tanushi, L. Kur ka qenë vajzë e re ka bashkëpunuar. Pashuku ka qenë pronar i vilës ku Jozefina bashkë me një ish deputet u takuan, *Shekulli*, 14.6.2013, f. 4-5

Tanushi, L. Meta falenderon Ramën për pranimin e kompromisit dhe përsërit ftesën ndaj Berishës për miratimin e tre ligjeve..., *Shekulli*, 24.5.2013, f. 6

Tanushi, L. ODIHR: KQZ me 4 anëtarë, e paligjshme, *Shekulli*, 8.6.2013, f. 1

Tanushi, L. PD s’ka nevojë për lekë, po përdor administratën, *Shekulli*, 29.5.2013, f. 1

Tanushi, L. Qindra gardistë mbrojnë kryeministrin në Veri. ‘Harron’ të vizitojë Vuçidolin ku lindi. Berisha me autobлиндë në Tropojë, *Shekulli*, 16.6.2013, f. 4-5

Tanushi, L. Situata parazgjedhore në Shqipëri. Akuza për qeverinë. Rrugët e reja dhe projektet u shoqëruan nga flamujt e PD-së. ODIHR: KQZ me 4 anëtarë, e paligjshme, *Shekulli*, 8.6.2013, f. 1

Tanushi, L. Skandali, më pak fletë se votues. PS depoziton në KQZ kërkesën për prodhimin e fletëve shtesë, *Shekulli*, 4.6.2013 f.1

Tanushi, L. Skandal në KQZ, votohet dy here, *Shekulli*, 9.6.2013, f. 1

Tanushi, L. Sondazhi i dytë i organizuar nga kompania italiane Piepoli thëllon fitoren e koalicionit të majtë, *Shekulli*, 25.5.2013, f. 1

Tanushi, L. Sondazhi italian 6 ditë para votimeve, koalicioni i së majtës ruan avantazhin me të djathtën. Zgjedhjet, e majta fiton me 51%”, *Shekulli*, 18.6.2013, f. 6

Tanushi, L. Shfrytëzimi i administratës shtetërore dhe i fondeve publike për fushatë nga mazhoranca, evidentohen tepër qartë në raportin e përgatitur nga ekspertët e ODIHR-it, *Shekulli*, 8.6.2013, f. 6

Tato, A. Edukatorja e çerdhes nr:10: Më flakën nga puna se nuk shkova në mitingun e PD-së, *Shekulli*, 6.6.2013, f.1

Topi: Selami zvarranik, Shehi pijanec, *Shekulli*, 8.6.2013, f. 3

Vritet kreu demokristian. Ndoka: Ekzekutim politik, Topalli është mostër, *Gazeta Shqiptare*, 19.6.2009, fq.1

Vritet kreu i PDK. Bomba me celular, trondit fushatën, *Panorama*, 19.6.2009, fq. 1

Khaja, G. Babai: Nuk kemi hasëm, djalin ma vrau politika, *Gazeta Shqiptare*, 19.6.2009, fq. 3

Zgjedhjet në kaos. SHBA dhe KiE: Qeveria të garantojë kartat, bllokohet KQZ, *Gazeta Shqiptare*, 06.06.2009 fq. 3

Zyrtari i DASH: Do sigurohemi për besimin e shqiptarëve te institucioni zgjedhor. Berisha takon Moore: Kuvendi s’ka shpallur vakanca në KQZ, *Gazeta Shqiptare*, 29.5.2013, f. 6

Fjalime

Deklaratë e Edi Ramës për mediat, *Zëri i Popullit*, 22. 5. 2013, fq. 3.

Fjalimi i Aldo Bumçit në Konventën e Partisë Demokratike për “Shqipërinë e zhvilluar”, *Rilindja Demokratike*, 26. 5. 2013, fq. 9.

Fjalimi i Astrit Patozit në Konventën e Partisë Demokratike për “Shqipërinë e zhvilluar”, *Rilindja Demokratike*, 26. 5. 2013, fq. 8.

Fjalimi i Astrit Patozi në Vlorë, *Rilindja Demokratike*, 4. 6. 2009, fq. 7.

Fjalim i Astrit Patozit në Sarandë, “55” 21.6.2009, f.3

Fjalimi i Astrit Patozit në Vlorë, *Rilindja Demokratike*, 21. 05. 2013, fq. 19.

Fjalimi i Ben Blushit në hapjen e fushatës në qytetin Studenti, *Zëri i popullit*, 29. 5. 2009, fq. 5.

Fjalimi i Edi Ramës i mbajtur në Asamblenë e Partisë Socialiste, *Zëri i Popullit*, 9. 5. 2009, fq. 5.

Fjalimi i Edi Ramës në shpalljen zyrtare të koalicionit “Bashkimi për ndryshim”, *Zëri i Popullit*, 13. 5. 2009, fq. 6.

Fjalimi i Edi Ramës i mbajtur në konferencën kombëtare të PS, *Zëri i Popullit*, 17.5.2009, fq. 2.

Fjalimi i Edi Ramës në zonën e Bregut të Lumit, *Zëri i Popullit*, 19. 5. 2009, fq. 3.

Fjalimi i Edi Ramës në Durrës, *Zëri i Popullit*, 22. 5. 2009, fq. 5.

Fjalimi i Edi Ramës me emigrantët shqiptarë në Greqi, *Zëri i Popullit*, 22. 5. 2009, fq. 5.

Fjalimi i Edi Ramës në hapjen e fushatës në qytetin Studenti, *Zëri i popullit*, 29. 5. 2009, fq. 2.

Fjalimi i Edi Ramës në Kombinat, *Zëri i Popullit*, 3. 6. 2009, fq. 3.

Fjalimi i Edi Ramës në Krujë, Fushë- Krujë, *Zëri i Popullit*, 9. 6. 2009, fq. 2.

Fjalimi i Edi Ramës në 18 vjetorin e themelimit të PS, *Zëri i Popullit*, 13. 6. 2009, fq. 2.

Fjalimi i Edi Ramës në Tiranë, *Zëri i Popullit*, 27. 6. 2009, fq. 2.

Fjalimi i Edi Ramës në mbledhjen e grupit parlamentar, *Zëri i Popullit*, 1. 5. 2013, fq. 3-4.

Fjalimi i Edi Ramës në Tiranë, në Njësinë Bashkiake Nr 1, *Zëri i Popullit*, 1. 5. 2013. fq. 6

Fjalimi i Edi Ramës, *Zëri i Popullit*, 2. 5. 2013, fq. 3.

Fjalimi i Edi Ramës, *Zëri i Popullit*, 7. 5. 2013, fq. 3.

Fjalimi i Edi Ramës në Shkodër, *Zëri i Popullit*, 11. 5. 2013, fq. 3.

Fjalimi i Edi Ramës në Lezhë, *Zëri i Popullit*, 15. 5. 2013, fq. 3-4.

Fjalimi i Edi Ramës në Korçë, *Zëri i Popullit*, 17. 5. 2013, fq. 3.

Fjalimi i Edi Ramës në Vlorë, *Zëri i Popullit*, 19. 5. 2013, fq. 2.

Fjalimi i Edi Ramës në ditën e dytë të Konventës së Partisë, *Zëri Popullit*, 21. 5. 2013, fq. 3.

Fjalimi i Edi Ramës në Tiranë, *Zëri i Popullit*, 24. 5. 2013, fq. 3- 4.

Fjalimi i Edi Ramës në qarkun e Elbasanit, *Zëri Popullit*, 28. 5. 2013, fq. 3.

Fjalimi i Edi Ramës në Devoll, *Zëri i Popullit*, 29. 5. 2013, fq. 3.

Fjalimi i Edi Ramës në Bushat, *Zëri i Popullit*, 31. 5. 2013, fq. 3.

Fjalimi i Edi Ramës në Kukës, *Zëri i Popullit*, 7. 6. 2013, fq. 3.

Fjalimi i Edi Ramës në Bulqizë, *Zëri i Popullit*, 13. 6. 2013, fq. 3.

Fjalimi i Edi Ramës në Laç, *Zëri i Popullit*, 15. 6. 2013, fq. 3.

Fjalimi i Edi Ramës në Librazhd, *Zëri i Popullit*, 18. 6. 2013, fq. 3.

Fjalimi i Edi Ramës në Korçë, *Zëri i Popullit*, 18. 6. 2013, fq. 3.

Fjalimi i Edi Ramës në Kamëz, *Zëri i Popullit*, 19. 6. 2013, fq. 3- 4.

Fjalimi i Edi Ramës në Kavajë, *Zëri i Populli*, 20. 6. 2013, fq. 3.

Fjalimi i Edi Ramës në Tiranë, *Zëri i Popullit*, 21. 6. 2013, fq. 3- 4.

Fjalimi i Genc Rulit në Gjirokastrë, *Rilindja Demokratike*, 21. 5. 2013, fq. 19.

Fjalimi i Gramoz Ruçit në qytetin Studenti, *Zëri i popullit*, 29. 5. 2009, fq. 5.

Fjalimi i Jozefina Topallit në Asamblenë Parlamentare të Natos, *Rilindja Demokratike*, 27. 5. 2009, fq. 4.

Fjalimi i Jozefina Topallit në takimin e forumit të gruas në Partinë Demokratike, *Rilindja Demokratike*, 29. 05. 2009, fq. 4.

Fjalimi i Jozefina Topallit në takimin me forumin e gruas në Korçë, *Rilindja Demokratike*, 7. 6. 2009, fq. 4.

Fjalimi i Jozefina Topallit në Shkodër, *Rilindja Demokratike*, 13. 06. 2009, fq. 11.

Fjalimi i Jozefina Topallit në Konventën e Partisë Demokratike për “Shqipërinë e zhvilluar”, *Rilindja Demokratike*, 26. 5. 2013, fq. 9.

Fjalim i Jozefina Topallit në Shkodër, ”55”, 28.5.2013, f.3

Fjalimi i Luiza Xhuvanit në qytetin Studenti, *Zëri i popullit*, 29. 5. 2009, fq. 5.

Fjalimi i Lindita Nikollaj në qytetin Studenti, *Zëri i popullit*, 29. 5. 2009, fq. 5.

Fjalimi i Lulzim Bashës në Konventën e Partisë Demokratike për “Shqipërinë e zhvilluar”, *Rilindja Demokratike*, 26. 5. 2013, fq. 11.

Fjalimi i Majlinda Bregut në Konventën e Partisë Demokratike për “Shqipërinë e zhvilluar”, *Rilindja Demokratike*, 26. 5. 2013, fq. 11.

Fjalimi i Pandeli Majkos në Tiranë, *Zëri i Popullit*, 24. 5. 2013, fq. 5.

Fjalimi i Ridvan Bodes në Konventën e Partisë Demokratike për “Shqipërinë e zhvilluar”, *Rilindja Demokratike*, 26. 5. 2013, fq. 8.

Fjalimi i Sali Berishës në inaugurimin e rrugës Rrëshen– Kalimash, *Rilindja Demokratike*, 26. 6. 2009, fq. 13.

Fjalim i Sali Berishës i mbajtur në inaugurimin e tunelit të Kalimashit, ”55” 1.6.2009, f.3

Fjalim i Berishës i mbajtur në Tiranë, “55” 2.6.2009, f.3

Fjalim i Sali Berishës në Divjakë, “55” 11.6.2009, f.3

Fjalim i Sali Berishës në Tiranë, “55” 15.6.2009, f.3

Fjalim i Sali Berishës në Tropojë, “55” 16.6.2009, f.3

Fjalim i Sali Berishës në Tiranë, “55” 27.6.2009, f.3.

Fjalim i Sali Berishës në Durrës, “55”, 15.6.2013, f.2

Fjalimi i Sali Berishës i mbajtur në Konventën për Barazi Gjinore, *Rilindja Demokratike*, 4. 5. 2013, fq. 2.

Fjalimi i Sali Berishës në hapjen e fushatës elektorale në Tiranë, *Rilindja Demokratike*, 14. 5. 2013, fq. 2.

Fjalimi i Sali Berishës në Berat, *Rilindja Demokratike*, 19. 5. 2013, fq. 3.

Fjalimi i Sali Berishës në Konventën e Partisë Demokratike për “Shqipërinë e zhvilluar”, *Rilindja Demokratike*, 26. 5. 2013, fq. 2.

Fjalim i Sali Berishës në Dibër, ”55”, 25.5.2013, f.3

Fjalim i Sali Berishës në Shkodër, “55”, 28.5.2013, f.3

Fjalim i Sali Berishës në Kuçovë, “55”, 25.5.2013, f.3

Fjalim i Sali Berishës në Kamzë, ”55”, 31.5.2013, f.3

Fjalim i Sali Berishës në Pogradec, “55”3.6.2013, f.2

Fjalim i Sali Berishës në Delvinë “55”, 10.6.2013, f.2

Fjalim i Sali Berishës në Laç, “55”, 11.6.2013, f.2

Fjalimi i Valentina Leskaj në parlament, *Zëri i Popullit*, 12. 5. 2009, fq. 10.

Konferenca e Kastriot Islamit me statusin sekretar për çështjet zgjedhore në PS, *Zëri i popullit*, 28. 5. 2009, f. 5

Konferenca për shtyp e Kastriot Islamit, *Zëri i Popullit*, 16. 5. 2009, fq. 2.

Materiale nga interneti

Çfarë janë partitë politike: <http://shtetiweb.org/2012/09/04/cjane-partite-politike/> (Parë më 05 nëntor, 2017)

Galtung, J. Ruge, M. H. The Structure of Foreign News, Source: Journal of Peace Research, Vol. 2, No. 1 (1965), pp. 64-91 Published by: Sage Publications, Ltd. Stable URL: <http://www.jstor.org/stable/423011> . (Parë më 15 nëntor, 2018)

Gramoz Ruçi: https://sq.wikipedia.org/wiki/Gramoz_Ru%C3%A7i (Parë më 24 shtator, 2015)

Harcup, T. O'Neill, D. (2001) “What is News? Galtung and Ruge Revisited.” Journalism Studies 2 (2): 261–280. doi: 10.1080/14616700118449 [\[Taylor & Francis Online\]](#) , [\[Google Scholar\]](#), 278–279). (Parë më 15 dhjetor, 2016)

Illir Meta: https://sq.wikipedia.org/wiki/Illir_Meta (Parë më 15 shtator, 2016)

Intervistë e dhënë për DW në shqip: <http://www.dw.de/blerja-e-mediave-n%C3%AB-ballkan-nga-elitat-politike-antidemokratike-e-rrezikshme/a-16616212> (Parë më 5 maj, 2017)

Kodi Etik: [http://w.w.wosce.org/sq/albania/21235/Kodi Etik i Medias Shqiptare](http://w.w.wosce.org/sq/albania/21235/Kodi%20Etik%20i%20Medias%20Shqiptare) (Parë më 15 tetor, 2014)

Lami. R. (2013) *Paqartësia e strukturimit të raporteve Parti politike-Ideologji* marrë nga <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/ep-content/uploads/2013/12/Doktorature-Roland-Lami-Fakulteti-i-Shkencave-Sociale-Departamenti-i-Sociologjise.pdf> (Parë më 15 shtator, 2016)

Misioni I OSBE/ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve 2009, Raporti Përfundimtar, www.osce.org/dihr (Parë më 17 tetor, 2016)

Misioni I OSBE/ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve 2013, Raporti Përfundimtar, www.osce.org/dihr (Parë më 15 shtator, 2016)

Programet e Partisë Demokratike: <http://politike.al/sq/programet-e-pd-nga-1990/> (Parë më 20 qershor, 2014)

Programet e Partisë Socialiste: <http://politike.al/sq/programet-e-ps-nga-1991/> (Parë më 10 korrik, 2014)

Programet e Lëvizjes Socialiste për Integrim: <http://politike.al/sq/programet-e-lsi-nga-2004/> (Parë më 4 korrik, 2015)

Raporti Nr. 1: [http://www.academia.edu/2411311/Raporti i Ligjërimit Politik në Shqipëri](http://www.academia.edu/2411311/Raporti_i_Ligj%C3%ABrimit_Politik_n%C3%AB_Shqip%C3%ABri) (Parë më 5 qershor, 2014)